


# DORACAK

për zbatimin e masave  
për ndjekje të komunikimeve





# DORACA K

për zbatimin e masave  
për ndjekje të komunikimeve

**DCAF** Geneva Centre  
for Security Sector  
Governance



Republika e Maqedonisë së Veriut  
Akademija për gjykatës dhe prokuror  
Pavell Shatev

Shkup, dhjetor 2019

---

**DORACAK**  
**PËR ZBATIMIN E MASAVE PËR NDJEKJE TË KOMUNIKIMEVE**

**Autorë:**

Spasenka Andonova, prokurori publik  
Andrej Bozhinovski  
Dr. Bogdanço Gogov  
Daniela Dimovska, gjykatës  
Dr. Jovan Jovçeski  
Dr. Biljana Karovska - Andonovska  
Sandra Krstiq, gjykatës  
Snezhana Petroviq Arsovska  
Xhemali Saiti, gjykatës  
Natasha Saramandova, prokurori publik

**Redaktorë:**

Dr. Gordan Kalajxhiev  
Dr. Penelopa Gjurçilova

**Botues**

©DCAF, 2019  
All rights reserved  
DCAF – Geneva Center for Security Sector Governance  
Chemin Eugène-Rigot 2E, CH-1202 Geneva, Switzerland  
©DCAF, 2019

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara  
DCAF – Qendra e Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura – filiali Shkup  
Rr. Maqedonia 11-1/2, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.985:316.77(497.7)(035)  
343.985:316.77]:355.45(497.7)(035)  
342.738(035)

DORACAK për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve [Elektronски извор] / [autorë Jovan Jovçeski ... и др.]. - Shkup : Qendra për qeverisje me sektorin e sigurisë - Gjenezë, filiali Shkup DCAF, 2019

Начин на пристап (URL): <https://dcaf.ch/resources?type=publications&year=2019&lang=all>. - Текст во PDF формат, содржи 166 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 25.11.2019. - Други автори: Biljana Karovska-Andonovska, Bogdanço Gogov, Andrej Bozhinovski, Xhemali Saiti, Sandra Krstikj, Daniela Dimovska, Natasha Saramandova, Spasenka Andonova, Snezana Petrovikj-Arsovska

ISBN 978-608-66453-4-2

1. Jovçeski, Jovan [автор] 2. Karovska-Andonovska, Biljana [автор] 3. Gogov, Bogdanço [автор] 4. Bozhinovski, Andrej [автор] 5. Saiti, Xhemali [автор] 6. Krstikj, Sandra [автор] 7. Dimovska, Daniela [автор] 8. Saramandova, Natasha [автор] 9. Andonova, Spasenka [автор] 10. Petrovikj Arsovska, Snezana [автор]

а) Посебни истражни мерки - Следење на комуникации - Македонија - Прирачници б) Национална безбедност - Посебни истражни мерки - Следење на комуникации - Македонија - Прирачници в) Право на приватност - Прирачници

COBISS.MK-ID 111714570

## PRAPAVIJA E PROJEKTIT DHE FALENDERIME

Në shtetet evropiane, duke përfshirë këtu edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, shërbimet që zbatohen ligjin dhe shërbimet sekrete kërkohet të marrin urdhëresë gjyqësore para përdorimit të Masës së Posaçme Hetimore (MPH), ose metodave të tjera për mbledhje të informatave që perceptohen si intruzive sa i përket të drejtës së privatësisë. Përmes autorizimit të MPH, gjykatësit dhe prokurorët veprojnë si garantues të sundimit të ligjit dhe balancojnë interesat konkurruese të ofrimit të sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Për këto arsye, Programi i lançuar nga DCAF-i në Maqedoninë e Veriut në vitin 2017, për mbështetje të organeve kombëtare në përmirësim të llogaridhënies në sektorin e sigurisë dhe zbulimit, kishte planifikuar që nga vetë fillimi të angazhohet (mes palëve të tjera) edhe sektorin gjyqësor në vend, dhe të asistojë në zhvillimin e kapaciteteve dhe ekspertizës në autorizimin gjyqësor të përgjimeve të komunikimeve.

Pas vështrimit të burimeve ekzistuese mbi këtë temë dhe konsultimeve me përfaqësues të gjyqësorit dhe bashkësisë akademike maqedonase, lindi ideja për krijimin e një produkti informativ që do t'i përshtatet nevojave të gjyqësorit maqedonas, që u konsiderua si prioritet për projektin e DCAF-it lidhur me gjyqësorin. Sistemi kombëtar për përgjim të komunikimeve po kalonte një fazë domethënëse të ndryshimeve ligjore dhe institucionale, kurse jurisprudenca evropiane që përjetonte ndryshime me hapa të mëdhenj mbi përdorimin e mbikëqyrjes sekrete nga organet shtetërore, po vendoste standarde të larta për sa i përket detyrës së Gjykatave që të analizojnë në mënyrë kritike kërkesat për përdorim të MPH. Projekti i DCAF-it dha propozimin që të gjitha këto rregullativa kombëtare dhe standarde evropiane të mblidhen së bashku dhe të analizohen në një Doracak që do udhëhiqte praktikuesit nëpër fazat e ndryshme procedurale të kontrollit gjyqësor ndaj MPH.

Për këtë qëllim, bashkë me Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë, dhe me mbështetje nga institucionet gjyqësore në Shkup, në prill të vitit 2018 mundëm të bëjmë bashkë një grup pune të përbërë nga gjykatës, prokurorë dhe ekspertë gjyqësorë me dëshirë për të mbështetur përpilimin e këtij burimi të informatave. Pyetjet që lindën, siç janë, çfarë do krijojmë saktësisht dhe si do e bëjmë këtë, ishin pyetje të vështira dhe që nuk mund t'iu jepej përgjigje lehtë. Na u deshën muaj të tërë, me diskutime të gjata dhe analiza të thella të ligjeve, procedurave, praktikave, dhe vendimeve referente të gjykatave relevante evropiane para se të vendosim mbi formën e detajuar që do kishte ky Doracak. Në fund të shtatorit të vitit 2018 ia dolëm të vendosim strukturën e qartë të Doracakut, që përbëhet nga tre kapituj kryesorë: (1) I pari, që trajton themelet teorike dhe ligjore të autorizimit gjyqësor të MPH, (2) I dyti, që ofron "drejtim se si të jepet urdhëresa për përdorim të MPH gjatë hetimeve penale", siç përshkruhet nga njëri nga gjykatësit që është pjesë e këtij projekti, dhe, (3) I treti, që eksploron një temë krejtësisht të re për literaturën gjyqësore në vend: autorizimin e metodave intruzive për qëllime të sigurisë kombëtare. Anëtarët e grupit të punës, u ndanë në tre grupe, secili ekip mori përsipër përpilimin e një kapitulli, nën udhëheqjen dhe udhëzimin praktik të koordinatorit të grupit. E pastaj filloi puna e të shkruarit të këtij Doracaku.

Përpilimi i Doracakut ishte një proces me pjesëmarrje të të gjithëve. Duke pasur parasysh agjendat e ngjeshura dhe obligimet profesionale që kanë personat që u përfshinë në përgatitjen e këtij Doracaku, është vërtetë për t'u përshëndetur, por edhe pak befasisues fakti që këta persona e morën

përsipër përpilimin e tërësishëm të tij. Struktura dhe përmbajtja u vendos dhe u hartua ekskluzivisht nga ta, duke marrë për bazë njohuritë, ekspertizën, tentimet për kërkim dhe kohën që kanë. Asnjë pjesë e këtij Doracaku nuk i është dhënë për përgatitje ndonjë konsulenti të jashtëm. Dhjetë autorët e këtij Doracaku investuan mund të jashtëzakonshëm individual dhe kolektiv, duke u mbështetur në durim dhe profesionalizëm përgjatë një viti. Prandaj kemi nderin të falenderojmë këta dhjetë autorë, dedikimi dhe zelli i të cilëve e bëri të mundur këtë botim. Besojmë që pjesëmarrja në këtë projekt u ka dhënë forcë dhe i ka inspiruar për të vepruar si agjentë që do sjellin ndryshimin, që rrisin standardet e veprimit në një nivel më të lartë, duke ndikuar në tërë sistemin gjyqësor.

U zgjodhën tre koordinatorë, nga një për secilin kapitull, nga vetë ekipi i përpilimit për të ofruar udhëzime konceptuale, për të udhëhequr procesin e përpilimit dhe angazhimin e autorëve të ndryshëm. Gjykatësi i Gjykatës Supreme Xhemali Saiti, gjykatësit Sandra Krstikj dhe Andrej Bozhinovski, MSc, këtë detyrë e kryen në mënyrë të shkëlqyeshme, dhe dhanë mund të konsiderueshëm individual si dhe kohë në këtë projekt. Dedikimi, udhëheqja dhe kontributi i tyre i madh ishin motored që bënë që ky Doracak të shndërrohet nga një ide në diçka të vërtetë.

Drafti i parë i integruar i këtij Doracaku u përfundua në janar të 2019, kur edhe filloi procesi i shqyrtimit të detajuar të brendshëm nën koordinim dhe kontributin redaktues të Profesor Gordan Kalajxhiev dhe koleges sonë dr. Penelopa Gjurçilova. Puna me dhjetë autorë të ndryshëm, nga një sërë institucionesh dhe me perspektiva të ndryshme, nuk ishte detyrë e lehtë për redaktorët. DCAF-i falenderon nga zemra dhe shpreh mirënjohje të thellë për të dy. Zgjuarsia e tyre, puna e palodhshme, këmbëngulja dhe lidhshipi, ishin ato që bënë të mundur këtë botim unik dhe revolucionar.

Ky Doracak është shkruar në një periudhë transformuese për mjedisin e zbulimit dhe sistemin për ndjekje të komunikimeve në Maqedoninë e Veriut. Ligjet, institucionet dhe proceset kanë ndryshuar mjaft përgjatë një viti të vetëm. Gjithë këto ndryshime duhej që të observoheshin, të kuptoheshin dhe të inkorporoheshin në tekst, gjë që ngadalesontë procesin e të shkruarit dhe që kërkonte ndryshime dhe plotësime në vetë strukturën dhe përmbajtjen e Doracakut. Në pranverë të 2019-tës u shtua edhe kapitulli i katërt, për të ofruar një vështrim të përgjithshëm të sistemit komplet të mbrojtjes demokritike në përdorim të ndjekjes së komunikimeve. Dr. Jovan Jovçeski udhëhoqi hartimin e këtij kapitulli dhe e falenderojmë sinqerisht për këtë kontribut kaq me vlerë.

Falenderime u shkojnë edhe ekspertëve ligjorë që morën përsipër recensionin e jashtëm të këtij Doracaku., Dr. Sunçana Roksandiç dhe gjykatësi Alesh Zalar, nga Kroacia dhe Sllovenia, të cilët lexuan tekstin dhe e shqyrtuan atë nga këndvështrimi i tyre profesional duke marrë për bazë zhvillimet më të fundit evropiane lidhur me ligjet në të drejtën penale dhe të drejtat e njeriut. Dr. Marjan Gjurovski dhe Aleksandar Tumanovski, MSc, dhanë vështrim ekspertësh që e njohin mirë sistemin ligjor maqedonas, me sfidat konceptuale dhe praktike që ai i ka. Që të gjithë recensentët ndanë perspektivat e tyre nga të cilat mësuam shumë. Ky Doracak fitoi në cilësi si rezultat i analizës rigorozë të këtyre personave.

Kemi kënaqësinë të falenderojmë Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë, që bëri ky projekt të bëhet realitet i suksesshëm. Ata kanë qenë partner të DCAF-it që në fazat e hershme. Na kanë ndihmuar të drejtohem nëpër institucionet dhe personat e duhur, dhe, me çdo punëtori dhe tavolinë të rrumbullakët që kemi organizuar së bashku në këtë projekt, janë siguruar që ky Doracak të jetë një produkt i planifikuar, për dhe përshtatur nevojave të gjyqësorit maqedonas. Gjatë muajve që do të pasojnë botimin e Doracakut, Akademia do të marrë përsipër transformimin e Doracakut në kurikulum trajnimi

për gjykatës dhe prokurorë, që do përfshihet edhe në programin e tyre vjetor për trajnim. Shpresojmë që ky do të jetë një angazhim afatgjat që do të gjenerojë vetëdije më të lartë dhe kuptim më të mirë të mundësive që anëtarët e gjyqësorit kanë për të vepruar me profesionalizëm, itnegritet, dhe në frymën e ndarjes së forcave dhe kështu të kontribuojnë në pavarësi më të madhe të gjyqësorit.

Ky Doracak botohet në tri gjuhë: në gjuhën angleze, maqedone dhe në gjuhën shqipe. Një falenderim i veçantë shkon për Ivan Kolekevskin, Edona Vincën, Filip Markoviqin, Daniela Takevan, MA dhe Gazmend Qokun që kanë marrë përsipër përkthimin dhe lekturimin dhe kanë bërë këto detyra në kohë dhe me profesionalizëm.

Falenderim i veçantë shkon për kolegët tanë, Dr. Kire Babanoski, Vlado Gjerdovski, MSc, dhe Matilda Todorova për kontributin e vlefshëm që kanë dhënë për kompletim të Doracakut. Ata kanë pasur detyra të ndryshme, që nga rishikimi dhe mbështetja redaktuese e deri tek menaxhimi i aktiviteteve të përkthimit dhe botimit, që të gjitha këto të domosdoshme për suksesin e projektit.

Në fund, do të deshëm të falenderojmë donatorët e këtij Programi, që kanë bërë të mundur këtë produkt për gjyqësorin: Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës, Agjencinë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim (Sida) dhe Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

**Dr. Teodora Fuior, koordinatorë e projektit, DCAF**  
**Marc Remillard, menaxher i programit, DCAF**

"Përmbajtja e këtij botimi jo domosdoshmërisht reflekton pozitat ose mendimet e donatorëve"



Kingdom of the Netherlands



Sweden  
Sverige



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss agency for Development  
and cooperation SDC

**LETËR**  
**nga**  
**Drejtoresha e Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë**

Të nderuar,

Një nga temat më të rëndësishme që zgjojnë interes tek opinioni profesional dhe akademik në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjithsesi janë masat e posaçme të hetuesisë dhe zbatimi i tyre. Shkaku i interesit të shtuar ka të bëjë me vetë natyrën e masave të posaçme të hetuesisë, të cilat paraqesin risi relative në sistemin penalo-juridik të Maqedonisë (të vendosura në vitin 2001), si dhe tek fakti se përmes këtyre masave fitohen dëshmi jashtëzakonisht të rëndësishme, të cilat më së shpeshti janë marrë nga rastet e cenimit ose ndërhyrjes serioze dhe kufizimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut ndaj të akuzuarit dhe personave të tjerë. Për këtë arsye, duhet të pamundësohet arbitrareteti në zbatimin e këtyre masave nga ana e organeve të autorizuara për shkak të rrezikut të shkeljes ose kufizimit të të drejtave me të cilat ruhet integriteti dhe fshehtësia e komunikimeve personale të personit që është i përfshirë në këto masa. Megjithatë, nga ana tjetër, me qëllim të ruajtjes së interesit publik, nevojitet luftë e suksesshme kundër kriminalitetit, dhe, për këtë, Ligji për Procedurë penale parasheh procedurë të posaçme për kontroll të shtuar për organet që i zbatojnë këto masa. Mekanizmi i miratuar juridik domosdo duhet të zbatohet me kujdes nga ana e organeve gjyqësore, sepse puna e tyre, në këtë pjesë është e vënë “në fokus” të opinionit, mediave, por edhe nga ana e qytetarëve të interesuar.

Programi i DCAF-it për Reforma në Shërbimet e Sigurisë dhe të Zbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me Akademinë, si një nga partnerët e projektit, e realizoi Projektin “Doracak për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve”. Qëllimi i projektit është forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit, të prokurorisë publike dhe të ekspertizës në autorizimet dhe mbikëqyrjen mbi përdorimin e masave të posaçme hetuese për grumbullimin e informatave nga ana e shërbimeve të sigurisë dhe të zbulimit. Rezultat i këtij bashkëpunimi, pas një viti, është botimi i Doracakut i cili ofron pasqyrë praktike të parimeve dhe standardeve ekzistuese, me të cilat do të shërbehen profesionistët juridikë në raport me kërkesën, autorizimin dhe mbikëqyrjen e ndjekjes së komunikimeve. Përmbajtja e Doracakut përmes analizave të standardeve ndërkombëtare dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ofrojnë orientime të qarta dhe praktike për gjykatësit dhe prokurorët publikë në zbatimin e këtyre masave, si dhe për mënyrat e grumbullimit të dëshmive, por gjithnjë duke mbajtur kujdes mbi autorizimet.

Miratimi i pakos së më shumë ligjeve nga fusha e ndjekjes së komunikimeve në prill të vitit 2018, në masë të konsiderueshme i ka reformuar institucionet dhe proceset që janë pjesë e sistemit në vendin tonë për ndjekje të komunikimeve.

Dëshiroj të shpreh **falënderimin** për iniciativën e DCAF-it për nisje të këtij projekti në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili ka të bëjë me shumë tema aktuale dhe të ndjeshme. Në bashkëpunimin e deritanishëm, pa dyshim me rëndësi të madhe ishte organizimi i më shumë takimeve të punës dhe tryezave të rrumbullakëta, të cilat, besoj se iu kanë ndihmuar anëtarëve të Këshillit (grup gjykatësish maqedonas, prokurorësh dhe ekspertësh juridikë) gjatë përgatitjes së Doracakut. Në fund dëshiroj të theksoj angazhimin tim për thellimin dhe avancimin e bashkëpunimit me DCAF-in në drejtim të ngritjes së vetëdijes dhe forcimin e kapaciteteve të gjykatësve, prokurorëve publikë dhe të kapaciteteve të përfaqësuesve të të gjitha institucioneve relevante, e me këtë edhe forcimin e përgjigjeve nacionale ndaj sfidave që vijnë me zbatimin e këtyre masave.

**Prof. dr. Natasha Gaber Damjanovska**  
Drejtoreshë e Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë



# PËRMBAJTJA

REZYME	13
RECENSIONE	15
SHKURTESA TË PËRDORURA	18
HYRJE	19

## PJESA 1

### NOCIONI, PARIMET DHE STANDARDËT PËR NDJEKJE TË KOMUNIKIMEVE

1. Nocioni i privatësisë dhe e drejta e respektimit të privatësisë	21
1.1. Spektri i së drejtës për privatësi dhe sfera të mbrojtjes	23
1.2. Privatësia në shtëpi	24
1.3. Fshehtësia e komunikimeve si aspekt i privatësisë	25
1.4. Të dhënat personale si aspekt i privatësisë	26
2. Respektimi i privatësisë kundrejt nevojës për masa efikase në funksion të sigurisë dhe luftës kundër krimit	28
3. Kufizimi legjitim i së drejtës për privatësi	29
4. Parimet dhe standardet ndërkombëtare për zbatim të masave për ndjekje të komunikimeve	30
4.1. Parimet ndërkombëtare	30
4.1.1. Parimi i ligjshmërisë	31
4.1.2. Parimi i subsidiaritetit	31
4.1.3. Parimi i proporcionalitetit	32
4.1.4. Parimi i miratimit gjyqësor të masave invazive	33
4.2. Standarde ndërkombëtare	34
4.2.1. Standarde të miratuara lidhur me parimin e ligjshmërisë	37
4.2.2. Standarde lidhur me parimin e subsidiaritetit	35
4.2.3. Standarde lidhur me parimin e proporcionalitetit	36
4.2.4. Standarde lidhur me parimin e miratimit gjyqësor të masave invazive	38
5. Raste të mbikëqyrjes së fshehtë	39

## PJESA 2

### MASA TË POSAÇME HETIMORE NË PROCEDURËN PENALE

1. Hyrje	45
1.1. Lloje të masave të posaçme hetimore në legjislacionin nacional	46
2. Vepra penale për të cilat mund të përcaktohen masa të posaçme hetimore	49
2.1. Raste nga praktika gjyqësore në vend	50
2.2. Kur vendoset për zbatimin e masave të posaçme hetimore dhe kur fillohet me zbatimin e tyre	52
2.3. Kërkesa nga Prokuroria Publike për ndjekje të komunikimeve	54
2.4. Pranimi në Prokurori	55

3. Procedura për shqiptim të masave të posaçme hetimore nga gjykata	57
3.1. Anonimizimi	58
4. Bazat e dyshimit si shkallë supozimi për aktivizim të masave	60
4.1. Arsyeja përse të dhënat apo provat nuk mund të mbliidhen në mënyrë tjetër	61
4.2. Urgjenca e procedimit	61
5. Përdorimi i masave të posaçme hetimore si prova në procedurë penale	62
6. Kohëzgjatja e masave dhe vazhdimi i tyre	64
6.1. Refuzimi i kërkesës për shqiptimin e masës së posaçme hetimore	64
6.2. Zgjerim i urdhëresës	65
6.3. Ndërprerja e MPH	66
6.4. Informimi i personit përkatës	66
6.5. Qasja ligjore në të dhënat e siguruara	67
6.6. Shlyerja ose shkatërrimi i të dhënave të mbledhura pers`onale	67
6.7. Ruajtja dhe asgjësimi i të dhënave të siguruara me masat e posaçme hetimore për ndjekje të komunikimeve	68
SHTOJCA TË PJESËS 2	70

### PJESA 3 SIGURIA KOMBËTARE

1. Nocioni i sigurisë kombëtare	77
1.1. Përkufizimi i nocioneve siguri dhe mbrojtje kombëtare në legjislacionin vendor	77
1.2. Dokumente juridike ndërkombëtare për siguri kombëtare dhe ndërkombëtare	79
2. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar	82
3. Roli dhe pozita e shërbimeve të sigurisë dhe të zbulimit në shoqërinë demokratike	84
4. Masat invazive si pjesë përbërëse e metodologjisë së punës së shërbimeve për siguri dhe zbulim	86
5. Parandalimi te siguria	87
6. Kërcënimi ndaj sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare	88
7. Organet e autorizuara për zbatimin e masës për ndjekjen e komunikimeve me qëllim të ruajtjes së sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit	89
8. Masa për ndjekje të komunikimeve	90
8.1. Kushtet e përdorimit të masave për ndjekje të komunikimeve	93
8.2. Kushtet për dhënien e urdhrit	93
8.3. Kërkesa për dhënie të urdhëresës dhe vendimmarrja në bazë të kërkesës	94
8.4. Arsyeshmëria e zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve	96
8.5. Përmbajtja e urdhëresës për ndjekje të komunikimeve dhe anonimizimi i saj	97
8.6. Mënyra e anonimizimit	98
8.6.1. Anonimizimi i urdhëresës për nevoja të ATO-s	98
8.6.2. Anonimizimi i urdhëresës për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit	99
8.6.3. Evidentimi në Regjistrin e Urdhëresave	99

8.7. Kohëzgjatja dhe vazhdimi i masës për ndjekje të komunikimeve	100
8.8. Raportet	101
8.9. Ndërprerja e masës për ndjekje të komunikimeve	101
9. Veprimi në rastet urgjente	101
10. Ruajtja dhe asgjësimi i të dhënave të grumbulluara me zbatimin e masës së ndjekjes së komunikimeve	102
11. Obligimi për ruajtje të sekretit zyrtar	104
SHTOJCA TË PJESËS 3	106

#### PJESA 4 MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI MBI MASAT E POSAÇME TË HETIMIT

1. Hyrje	113
2. Mbikëqyrja e zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve në përputhje me legjislacionin kombëtar	116
3. Kontrolli i zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve në përputhje me legjislacionin kombëtar	118
4. Mbikëqyrja (e pavarur) publike mbi zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve	120
4.1. Këshilli për Mbikëqyrje Qytetare	120
4.2. Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	120
4.3. Drejtoria për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara	121
4.4. Avokati i Popullit	121
4.5. Raporti vjetor i Prokurorit Publik të R. së Maqedonisë së Veriut	121
4.6. Subjekte të tjera	122
SHTOJCA TË PJESËS 4	123
BIBLIOGRAFIA	125
SHTOJCAT E DORACAKUT	127



## REZYME

Projekti “Doracak për ndjekje të komunikimeve” është pjesë e programit të DCAF-it për reformim të shërbimeve të sigurisë dhe të zbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që filloi në vitin 2017, si mbështetje e përpjekjeve reformuese nacionale për ngritjen e përgjegjësisë në sektorin e sigurisë dhe zbulimit, konform standardeve evropiane dhe praktikave pozitive. Projekti ka për qëllim ta fuqizojë kapacitetin dhe ekspertizën gjyqësore në autorizimin dhe mbikëqyrjen e përdorimit të masave të posaçme hetimore (MPH) për grumbullim të informatave nga ana e shërbimeve të sigurisë dhe të zbulimit.

Doracaku është hartuar nga ekspertë juridikë dhe nga vetë anëtarët e sistemit të organeve të drejtësisë, të cilëve edhe u kushtohet në radhë të parë. Në këtë doracak janë përfshirë të gjitha 12 MPH të përcaktuara me ligj, me qëllim që të jepet një pasqyrë për vëllimin e këtyre masave, si dhe që t’u mundësohet përdoruesve qasje e shpejtë në to. Masat për ndjekje të komunikimeve janë të përpunuara në mënyrë të detajuar. Ky doracak siguron pasqyrë koncize dhe praktike të parimeve dhe standardeve ekzistuese, që mund t’i udhëzojë prokurorët dhe gjykatësit në thelbin e kërkesës, autorizimit dhe mbikëqyrjes lidhur me ndjekjen e komunikimeve.

Procesi i krijimit të këtij doracaku zgjati rreth një vit dhe u realizua nga Këshilli për Mbikëqyrje – një grup gjykatësish, prokurorësh dhe ekspertësh juridikë nga Maqedonia. DCAF siguroi udhëzime metodologjike për procesin e hartimit, dhe anëtarëve të Këshillit për Revizion ua lehtësoi qasjen në praktikat pozitive gjyqësore evropiane, me çka ndihmoi në zhvillimin e njohurive, aftësive dhe ekspertizës në kuadër të grupit.

Përmes analizës së standardeve ndërkombëtare, e veçanërisht jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe përmes analizës së legjislacionit nacional në këtë sferë, doracaku – përmes katër pjesëve të posaçme të cilat ndërlidhen njëra me tjetrën – ofron tregues dhe udhëzime të qarta e praktike, që duhet të paraqesin bazë për prokurorët dhe gjykatësit në parashtrimin e kërkesës, autorizimin, realizimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave të posaçme hetimore e metodave të tjera invazive për grumbullim të informatave nga sektori i sigurisë dhe i zbulimit.

Në këtë drejtim, në **pjesën e parë të Doracakut** është bërë një vështrim i shkurtër mbi të drejtat individuale, të cilat, me zbatimin e MPH dhe metodave të tjera, janë potencialisht të rrezikuara. Fokusi në këtë pjesë të doracakut është drejtuar kah paraqitja e parimeve dhe standardeve të përcaktuara ndërkombëtare, si dhe në përmbajtjen e tyre, si bazë për zbatim të harmonizuar të masave dhe metodave invazive. Analiza e aspekteve të paraqitura përcillet nga një vështrim në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku prezantohen dhe ilustrohen raste të caktuara në kontekst të materies së trajtuar.

**Në pjesën e dytë** të Doracakut, veç e veç janë përpunuar karakteristikat themelore të masave të posaçme hetimore, që janë të përfshira në legjislacionin nacional, si dhe elementet relevante për parashtrim të kërkesës dhe miratim të saj lidhur me zbatimin e këtyre masave, kohëzgjatjen e zbatimit, kushtet për zgjerim të urdhrit për zbatim të masave, informimin e personave të prekur, asgjësimin e provave të siguruar etj.

**Pjesa e tretë** e Doracakut shtjellon masat të cilat i zbatojnë organet e specializuara shtetërore, siç janë shërbimet ushtarake dhe të sigurisë e të zbulimit, me qëllim të mbrojtjes së shtetit nga veprime që mund ta rrezikojnë ekzistencën, sovranitetin, institucionet themelore ose vlerat themelore të tij. Theks i posaçëm i jepet masave për ndjekje të komunikimeve që i parasheh legjislacioni i ri nacional për ndjekje të komunikimeve, në interes të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit.

**Pjesa e katërt** e Doracakut shqyrton kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave të posaçme hetimore, cilat janë institucionet që janë përgjegjëse për këto masa, si dhe mbikëqyrjen (e pavarur) publike të zbatimit të po këtyre masave.

## RECENSIONE

Autorët e Doracakut për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve, në punimin e tyre, japin paraqitje të tërësishme dhe gjithpërfshirëse, por më tepër paraqitje teorike të materies ligjore që lidhet me masat, të cilat janë të rëndësishme për njohjen e shfrytëzuesit me materien në fjalë. Intervenimi në të drejtën për privatësi është përpunuar edhe përmes lëndëve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjë që paraqet shembull pozitiv.

Janë përpunuar instrumentet të cilat përdoren për komunikim nga aspekti ligjor i tyre edhe atë përmes standardeve të qartësisë, precizitetit dhe parashikimit, si dhe nevojën për balans dhe proporcionalitet në restriksionet e parashikuara për mbrojtjen e të drejtave të tjetrit. Shfrytëzuesit e Doracakut, me siguri dhe qartësi mund të kuptojnë dhe të vlerësojnë se cilat janë subjektet të përcaktuara me ligj, të cilët mund të kërkojnë të bëhet intervenim në të drejtën për privatësi dhe cilat janë shkaqet për të cilat ai mund të kërkohej.

E qartë është paraqitja e listës, e cila tregon se cilat subjekte do të bëjnë intervenimin në ndjekjen e komunikimeve duke dhënë urdhëresa dhe kërkesa për ndërprerjen e tyre. Janë prezantuar shembuj nga praktika për urdhëresa dhe kërkesa të tilla, të cilat gjithsesi do të jenë interesante për të gjithë pjesëmarrësit në zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve.

Në Doracak mungon elaborimi më i detajizuar dhe analiza për kontrollin dhe mbikqyrjen e zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve, ashtu siç është vepruar me segmentet e tjera nga kjo lëmi. Mungon edhe paraqitja praktike e shembujve të dispozitave ligjore në pjesën e kontrollit dhe mbikqyrjes në ligjshmërinë e procedurës. Kjo, gjithsesi se mund të jetë rezultat edhe i mosekzistencës së praktikës së tillë.

Duke marrë parasysh se Doracaku ka edhe elemente të punimit shkencor, që duhet të vlerësohet pozitivisht, analiza e theksuar më lartë paraqitet si nevojë e cila duhet të bëhet sidomos pasi Ligji për Ndjekje të Komunikimeve ka probleme të caktuara në përmbajtje dhe zbatim.

Leximi i vazhdueshëm i tij, do ta lehtësojë punën e të gjitha subjekteve dhe do të ndihmojë në veprimin e drejtë nga ana e tyre. Shikuar globalisht, duke pasur parasysh ligjshmërinë mbi sigurinë, mbrojtjen dhe luftën kundër kriminalitetit të rëndë si dhe moslëndimin e të drejtave të tjera të qytetarit.

**Margarita Caca Nikollovska**

Kryetare dhe Gjykatëse e Gjykatës Kushtetuese të B e H  
Ish Gjykatëse e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

\* \* \*

Doracaku për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve, që është pjesë e programit të DCAF-it për reforma në siguri dhe zbulim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është një libër serioz dhe është shumë e qartë që është mjaft i rëndësishëm, jo vetëm për praktikuesit e ligjit, por edhe më gjerësisht për tërë opinionin. Ky Doracak trajton një nga çështjet më të ndjeshme të sistemit juridik dhe gjyqësor: autorizimin dhe mbikëqyrjen e përdorimit të masave të posaçme hetimore (MPH) për mbledhje të informatave nga shërbimet e sigurisë dhe zbulimit. Doracaku është shkruar përgjatë më shumë se një viti nga ekspertë ligjorë dhe anëtarë të sistemit gjyqësor që kanë marrë parasysh seriozisht sistemin

ligjor të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) gjatë analizës së ligjeve kombëtare. Pra, rekomandimet që jepen në këtë Doracak ndjekin kufinj të ligjorë dhe parimet themelore të vendosura nga GjEDNj. Kështu, nuk ka dyshim që ky Doracak do të jetë një udhëzues i mrekullueshëm për prokurorët dhe gjykatësit gjatë kërkesës, miratimit, përdorimit dhe realizimit të mbikëqyrjes të zbatimit të masave të posaçme hetimore dhe metodave të tjera intruzive për mbledhje të informatave nga shërbimet e sigurisë dhe zbulimit. Është e pamundur të theksohet se cili Kapitull është më i rëndësishmi. Megjithatë, pa marrë parasysh se ky Doracak a do përdoret nga praktikuesit nëpër procedurat penale ose nga shërbimet ushtarake dhe ato të sigurisë e zbulimit, rekomandohet që Kapitulli i parë dhe ai i katërti të lexohen me interes nga të gjitha palët. Është shumë e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm për atë që përmbajnë parimet dhe standardet ndërkombëtare kur përdorim masa dhe metoda intruzive. Kjo vlen edhe për mbikëqyrjen e tyre. Përgëzoj edhe një herë të gjithë autorët që kanë arritur të përpilojnë udhëzime të rëndësishme për një fushë kaq të ndjeshme. Edhe pse shërben si mjet i rëndësishëm për mbrojtje të të drejtave të njeriut, përdorimi i MPH duhet të garantojë respektim të të drejtave të njeriut.

**Doc. dr. sc. Sunçana Roksanđić Vidlička**

Docent në Katedrën e të Drejtës Penale, Fakulteti Juridik, Universiteti në Zagreb  
Hulumtues në Grupin Partner të Maks Plank për Kriminologji Ballkanike

\* \* \*

Masat e posaçme hetimore (MPH) kërkohen, urdhërohen dhe zbatohen nga agjencitë që zbatojnë ligjin, nga agjencitë e sigurisë dhe zbulimit dhe nga gjykatat nëpër botë për të luftuar krimin serioz, duke përfshirë këtu edhe terrorizmin, dhe për të shmangur rreziqet ndaj sigurisë kombëtare. Veçanërisht gjykatat dhe gjykatësit janë ata që shpesh gjejnë veten në pozita të vështira gjatë ushtrimit të autorizimit *ex-ante* dhe kontrollit *ex-post* të MPH për arsye të ndryshme siç janë për shembull termet e paqarta ligjore, dykuptimësia dhe zbrazëtirat, fhshetësia e operacioneve dhe e dosjeve, qasja e limituar drejt të dhënave dhe provave relevante në fazën e hershme të procesit, mungesa e kompetencës procedurale, vlerësimi që elementet policore janë më të rëndësishme se elementet e gjyqimit e kështu me rradhë. Edhe pse kërkesa për autorizim dhe kontroll gjyqësor është në funksion të sigurisë publike dhe çështjeve të sigurisë kombëtare lidhur me ligjin dhe përfaqëson një mbrojtje të madhe ndaj çfarëdo lloj keqpërdorimi, kjo nuk e parandalon automatikisht përdorimin tejmasë të MPH. Përkundrazi praktika ligjore nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut thekson vazhdimisht sfidat serioze që lidhen me zbatimin e standardeve minimale për të drejtat e njeriut, jo vetëm për qeveritë dhe ligjvënësit e Vendeve Anëtare të Këshillit të Evropës por edhe për gjyqësorin e tyre. Për shembull, si të zbatohet standardi që çdo urdhëresë e dhënë për MPH të ketë baza të arsyetueshme me fakte? Ç'nënkuptohej me standardin që arsyet e paraqitura për MPH të jenë relevante dhe të mjaftueshme? Ç'është dallimi mes standardit të nevojës dhe standardit të nevojës së rreptësishme? A mundet që mbledhja dhe ruajtja e informatave lidhur me e-mailat dhe përdorimin personal të internetit në vendin e punës të konsiderohet si ndërhyrje në të drejtën e respektimit të jetës, shtëpisë dhe korrespondencës private? Si të sigurohet qasje tek dhe vlerësim i informatave të klasifikuara? A përfshin standardi për ligj cilësor edhe cilësinë e praktikës kombëtare ligjore?

Përgjigjet e këtyre por edhe pyetjeve të tjera mund të gjehen pikërisht në këtë Doracak. Ai nuk paraqet burim të ligjit material por është një udhëzues praktik për prokurorët dhe gjykatësit se si të in-



terpretojnë dhe zbatojnë parimet bazike të sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore.

Ky Doracak nuk trajton tërësisht të gjitha çështjet relevante ligjore që mund të paraqiten gjatë procesit të vendimmarrjes lidhur me MPH, por në fakt të gjitha këto çështje as edhe nuk mund të trajtohen. Megjithatë, vlera e shtuar e këtij Doracaku është e shumëfishtë. Ai trajton në kapituj të veçantë MPH që autorizohen për arsye të procedurave penale dhe që autorizohen për mbrojtje të sigurisë kombëtare. Që të dy kapitujt e udhëheqin lexuesin drejt hapave proceduralë, ashtu siç kërkojnë ligjet dhe rregullativat e vendit, dhe përmes parimeve ligjore, rregullave dhe standardeve të ligjeve materiale siç interpretohen në jurisprudencën vendore dhe atë evropiane. Përmenden disa nga vendimet më të theksuara të GjEDNj për të shpjeguar parimet dhe standardet më të rëndësishme.

Struktura e këtij Doracaku, bashkë me Përmbajtjen, u mundëson praktikuesve të kërkojnë dhe të gjejnë lehtë informatat lidhur me çështjet dhe sfidat kryesore që kanë të bëjnë me MPH.

Vetë hartimi i këtij Doracaku nga ekspertët e vendit ishte një proces i të mësuarit nga njëri-tjetri si kolegë. Fakti që doracaku vjen nga ekspertët vendor do mundësojë që ai të plotësohet vazhdimisht me komente relevante mbi ligjet dhe rregullativat që do ndryshohen dhe mbi hartimit e praktikës gjyqësore të vendit dhe asaj evropiane. Kështu, konsistenca dhe parashikueshmëria e praktikës gjyqësore kombëtare lidhur me autorizimin dhe rishikimin e MPH do sigurohet në afat të gjatë kohor.

Ky Doracak gjithashtu mund të kontribuojë në guximin e nevojshëm gjyqësor kur janë të nevojshme informata, qartësime ose dokumente shtesë para se të jepet urdhëresë gjyqësore për MPH ose për qëllime të zgjatjes së tyre. Kjo ndodh shpesh kur nuk sigurohen informata të mjaftueshme faktike në kërkesën e urdhëresës gjyqësore dhe si rezultat gjykata nuk mund të bëjë balancin mes interesit të sigurisë publike ose sigurisë kombëtare dhe seriozitetit të ndërhyrjes në të drejtën individuale të njeriut. Veç kësaj, gjykata duhet që në mënyrë të gumximshme të urdhërojë, atëherë kur e sheh si të nevojshme ose të arsyeshme, kushte të caktuara për urdhëresë gjyqësore, mes tjerash, të marrë raport mbi zbatimin e MPH nga agjencia e zbatimit të ligjit ose agjencia e zbulimit si dhe transkriptat e bisedave të përgjuara.

Edhe pse është përpiluar nga prokurorë dhe gjykatës, shpresojmë që ky Doracak do udhëzojë edhe ligjvënësin në vend gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes parlamentare mbi MPH e zbatuara si dhe gjatë hartimit dhe rritjes së cilësisë së ligjeve mbi MPH meqë jep udhëzime të qarta për sa i përket zbatimit të parimeve kushtetuese të ndarjes së forcave.

E fundit po jo më pak e rëndësishme, ky Doracak paraqet tentimin e parë dhe inovativ në hartimin e demokracive për udhëheqje praktike të prokurorëve dhe gjykatësve si edhe për anëtarë të tjerë të zbatimit të ligjit, agjencitë e sigurisë dhe zbulimit, kur kanë të bëjnë me MPH. Struktura dhe pjesa e standardeve evropiane mund të shërbejnë si model për qasje të ngjashme ndaj politikave edhe në vende të tjera.

I jam mirënjohës DCAF-it për mundësinë që mu ofrua për të dhënë kontributin tim në këtë projekt të rëndësishëm.

**Alesh Zalar**

Kryetar i Qendrës Evropiane për Zgjidhje të Kontesteve  
Ish gjykatës dhe Kryetar i Gjykatës Penale Lublanë  
Ish Ministër i Drejtësisë në Slloveni

## SHKURTESA TË PËRDORURA

ARMV	- Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut
ATO	- Agjencia Teknike-Operative
BE	- Bashkimi Evropian
GjSRMV	- Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut
KE	- Këshilli i Evropës
KEDNj	- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KP	- Kodi Penal
GjEDNj	- Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
LASK	- Ligji për Agjencinë e Sigurisë Kombëtare
LKE	- Ligji për Komunikime Elektronike
LNK	- Ligji për Ndjekje të Komunikimeve
LPB	- Ligji për Punë të Brendshme
LPP	- Ligji për Procedurë Penale
LP	- Ligji për Polici
MPB	- Ministria e Punëve të Brendshme
MPH	- Masa të Posaçme Hetimore
MM	- Ministria e Mbrojtjes
NATO	- Organizata Veri-Atlantike
OKB	- Organizata e Kombeve të Bashkuara
PNDQP	- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Qytetare dhe Politike
PP/PTHP	- Prokuroria Publike/Prokuroria Themelore Publike
RMV	- Republika e Maqedonisë së Veriut
RNAK	- Regjistër për Ndjekje të Autorizuar të Komunikimeve
SAKI	- Sistem automatik kompjuterik-informativ

## HYRJE

Përfshirja e masave invazive në legjislacionet penalo-proceduriale është relativisht moment i ri në të Drejtën Komparative dhe Ndërkombëtare. Bëhet fjalë për masa që deri vonë përdoren vetëm në praktikën e të ashtuquajturave shërbime sekrete (të zbulimit dhe të sigurisë), ku ende paraqesin metodologji bazike për punë. Legalizimi i masave invazive nënkuptonte zgjerim gradual të subjekteve që ligjërisht mund ta përdorin atë metodologji si përgjigje ndaj formave të krimit të organizuar, terrorizmit dhe kërcënimeve tjera bashkëkohore për sigurinë.

Masat invazive përdoren vetëm kur kjo është e domosdoshme dhe me qëllim që të sigurohen prova dhe të dhëna të cilat nevojiten për zhvillim të suksesshëm të procedurës penale ose për mbrojtje të interesave të sigurisë kombëtare, e që nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër. Masat e këtilla padyshim kontribuojnë për luftim efikas të formave të rënda të krimit dhe formave të tjera të shkeljes dhe rrezikimit të sigurisë publike dhe kombëtare, por njëkohësisht zbatimi i tyre paraqet cenim të vërtetë të jetës private të individit. Për këtë shkak, gjatë procesit për legalizim të zbatimit të tyre, është me rëndësi thelbësore të krijohet një ekuilibër ndërmjet dy antipodeve kundërshtuese: efikasitetit të legjislacionit penal dhe korpusit të të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Koncepti i veprimit parandalues nënkupton rregullimin normativ të sigurisë dhe mbrojtjes me ligje, doktrina dhe strategji adekuate, ndërkaq puna operative përfshin masa dhe aktivitete të institucioneve shtetërore në bazë të zbatimit të përpiktë të rregullave normativo-teorike për mbrojtjen e vlerave vitale dhe interesat e shtetit.

Preventiva e sigurisë dhe mbrojtjes nënkupton aktivitete diplomatike, politike, të sigurisë, të zbulimit, informimit, financiare, doganore, gjyqësore dhe aktivitete të tjera që janë parakusht për siguri dhe mbrojtje efikase shtetërore.

Parandalimi, si formë bazë e ruajtjes së sigurisë është objekt shqyrtimi shumëvjeçar i shumë shkencëtarëve dhe ekspertëve nga fusha të ndryshme shkencore. Diskutimet janë të orientuara kah kuptimi teorik i parandalimit, si dhe të asaj se cilat institucione janë bartëse të aktiviteteve të parandalimit dhe nevojës për përgatitjen e analizës për gjendjen e sigurisë. Marrë në përgjithësi, parandalimi lidhet me një varg masash dhe aktiviteteve që duhet të mundësojnë t'i iket kërcënimit dhe rrezikut për sigurinë dhe mbrojtjen.

Preventiva e sigurisë mund të përcaktohet si: masa me të cilat ulen apo në formë tjetër kontribuon për uljen kuantitative dhe kualitative të kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj sigurisë dhe ndjenjës së pasigurisë tek qytetarët, drejtpërdrejt ose përmes zvogëlimit të aktiviteteve kërcënuese ose përmes intervenimeve politike, me qëllim të zvogëlimit të potencialit që paraqet rrezik ndaj sigurisë dhe mbrojtjes.

Të gjitha përpjekjet preventive në esencë janë të orientuara drejt: mjedisit shoqëro-ro-social dhe situatës konkrete, ndaj kryerësit potencial ose grupe dhe organizata, viktimave të mundshëm dhe objekteve për sulme. Koncepti - kërcënim - shfrytëzohet për të përshkruar bartës të ngjarjes së mundshme që ka potencial të shkaktojë dëm ndaj shtetit ose qytetarëve.

# PJESA 1

---

**NOCIONI, PARIMET DHE STANDARDET PËR NDJEKJE TË KOMUNIKIMEVE**





## 1. Nocioni i privatësisë dhe e drejta e respektimit të privatësisë

E drejta e privatësisë është një nga të drejtat themelore të njeriut. Edhe pse nocioni *privatësi* në shikim të parë është i njohur për të gjithë, prapëseprapë nuk ekziston përkufizim i përgjithshëm për privatësinë. Autorë të caktuar janë të mendimit se “fjala privatësi është shumë e papërcaktueshme, për shkak se ka shumë gjëra në jetën tonë të përditshme, të cilat nuk mund t’i ruajmë për vete dhe shumë gjëra të tjera që duam t’i ruajmë në privatësi” (*Geret, 2001, faqe 7*). Privatësia nënkupton qasje të kufizuara të tjerëve ndaj individit (*Flaerti, 1989, faqe 8*). Ajo mbron individualitetin, pavarësinë, dinjitetin dhe integritetin e individit (*Blaushtajn, 1964, faqe 971*). Përmes rregullimit juridik të konceptit për privatësi, shteti në fakt duhet të sigurojë respektim të asaj të drejte nga të gjithë individët tjerë, institucionet dhe nga vetë shteti.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) edhe pse është e mendimit se jeta private është një koncept i gjerë për të cilin nuk mund të jepet përkufizim gjithëpërfshirës, përmes praktikës së vet gjyqësore, jep disa udhëzime të caktuara në kuptim të rëndësisë dhe shtrirjes që ka (*Heris, O’Boill, Varbrik, 2009, faqe 364*). Në rastin *Nimic kundër Gjermanisë*, qëndrimi i GjEDNj-së ishte se jeta private nuk mund të kufizohet vetëm në “rrethin e brendshëm” ku individ i jeton jetën e vet personale, sepse ajo do të kishte qenë shumë kufizuese, dhe për shkak se bota e jashtme nuk mund të shkyçet krejtësisht, mirëpo respektimi i jetës private deri në një shkallë duhet ta përfshijë edhe të drejtën e vendosjes dhe zhvillimit të lidhjeve me qenie të tjera njerëzore.

Qëndrimet lidhur me privatësinë (juridike, sociologjike, etike etj.) dallojnë në çdo shoqëri. Ajo përjetohet ndryshe te individë të ndryshëm, e po aq të ndryshme janë edhe pritshmëritë për të. Përveç kësaj, “qëndrimet për privatësinë ndryshojnë me kalimin e kohës” (*Geret, 2001, faqe 7*). Sidomos tani, pritshmëritë racionale për privatësinë ndikohen nga tendencat aktuale shoqërore në sfera të ndryshme dhe nga nevoja për adaptimin e atyre pritshmërive me tendencat bashkëkohore. Rrjedhimisht, përcaktimi i nocionit privatësi patjetër duhet të vendoset në kontekst të rrethanave të përgjithshme shoqërore në periudhë të caktuar kohore dhe të shikohet në atë kontekst.

### 1.1. Spektri i së drejtës për privatësi dhe sfera të mbrojtjes

E drejta për privatësi mbron një spektër jashtëzakonisht të gjerë të interesave personale. Spektri i privatësisë dhe sferat e mbrojtjes janë çështje komplekse që kryesisht kanë të bëjnë me identifikimin e segmenteve të jetës së një individ, të cilat mund të inkorporohen në kuadër të së drejtës së respektimit të privatësisë. Spektri i interesave personale të mbrojtura shtrihet në aspekte të ndryshme të jetës personale dhe marrëdhënive familjare, nga të drejtat identitare dhe prindërore, e deri tek e drejta për mjedis të shëndetshëm jetësor si aspekt i jetës private. Edhe GjEDNj-ja gjerësisht e definon këtë shtrirje të nenit 8 të KEDNj-së, që ka të bëjë me mbrojtjen e jetës private dhe familjare, shtëpisë dhe komunikimit, madje edhe kur nuk është në mënyrë specifike e përcaktuar në këtë nen. Megjithatë, shtrirja e këtij neni nuk është e pakufizuar (*Guide on Article 8 of the ECHR, 2019*).

Shtrirja e së drejtës për privatësi ka tendencë zgjerimi. Zhvillimi i teknologjive bashkëkohore informatike dhe të komunikimit ka ndikim të madh mbi këto tendenca. Evoluimi i qëndrimeve për

raporte të caktuara të marrëdhënieve njerëzore gjenerojnë raporte dhe rrethana të reja që mund të jenë në kuadër të spektrit të jetës private.

Mund të ketë disa lloje të privatësisë:

- **privatësi hapësinore**, që ka të bëjë me shtëpinë dhe hapësirë tjetër ku individi kalon jetën e tij;
- **privatësi informative**, si aspekt i privatësisë që ka të bëjë me mbledhje të dhënash për individin, menaxhim të atyre të dhënave dhe përdorimin e tyre; dhe
- **privatësi komunikative**, që ka të bëjë me shënime apo korrespondenca personale, dhe çdo lloj komunikim tjetër (*Boban, 2012, faqe 584*).

Si sfera kryesore të jetës private janë **privatësia dhe fshehtësia**, si dhe **intimiteti** si një pjesë e posaçme e sferës së fshehtësisë (*Dropuliq, 2002, faqe 48*). Sipas së ashtuquajturës Teori e Tri Sferave, **sfera sociale** është ajo sferë relevante për zgjidhje të konfliktit ndërmjet hulumtimit të së vërtetës në procedurën penale dhe mbrojtjes së interesave individuale (*Rezner, 2007, faqe 6; Shreder, 2010, faqe 83*), e ajo përfshin bisedat zyrtare dhe ngjarjet tjera, kundrejt **sferës private**, ku përfshihen bisedat private dhe ngjarje të tjera private, si dhe kundrejt **sferës intime**, si sferë e jetës intime dhe proceseve të brendshme.

## 1.2. Privatësia në shtëpi

E drejta e respektimit të privatësisë në shtëpi është garanci për një rrjedhë normale të jetës private dhe familjare, në hapësirën që një person e ka përcaktuar si vendqëndrim dhe vendbanim të tij. Pacenueshmëria e shtëpisë paraqet aspektin qendror të aktiviteteve policore për bastisje të një hapësire të caktuar dhe privimin nga liria të një personi të dyshuar ose të akuzuar, duke hyrë në shtëpinë e atij personi dhe duke konfiskuar gjësende të rëndësishme, që mund të shërbejnë si provë në procedurën penale.

Interpretimi i shtëpisë sipas nenit 8 të GjEDNj-së, nuk kufizohet vetëm në vendin ose hapësirën ku jeton individi, por si shtëpi konsiderohet edhe hapësira ku personi qëndron përkohësisht. Për shembull, sipas nenit 8, paragrafi 1, shtëpi llogaritet edhe dhoma e hotelit, që shfrytëzohet nga një i pastrehë për qëndrimin e të cilit paguan pushteti lokal (*O'Rurk kundër Britanisë së Madhe*).

Pronësia mbi një objekt nuk është kusht i domosdoshëm, sepse sipas nenit 8 shtëpi llogaritet edhe hapësira ku një person jeton ose qëndron me qira apo nën kushte të tjera. Si relevante për çdo rast konkret merret parasysh kontinuiteti i lidhshmërisë me një hapësirë të caktuar dhe aspektet tjera, si për shembull: adresa e paraqitur e qëndrimit, adresa për pranim të dërgesave postare, pjesëmarrje në mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtje të hapësirës dhe ngjashëm.

GjEDNj-ja me termin shtëpi, në kontekst të realizimit të së drejtës që garanton neni 8 i KEDNj-së, përfshin edhe hapësira afariste dhe hapësira të tjera zyrtare ku zhvillohet ndonjë aktivitet afarist. Gjykata këtë qëndrim e mori në rastin *Nimic kundër Gjermanisë*, ku konstatoi shkelje të nenit 8 të KEDNj-së, me arsyetimin se bastisja e zyrës së avokaturës së ankimesit ka qenë joproporcionale me qëllimin që është dashur të arrihet me atë bastisje. Njëkohësisht, GjEDNj-ja konstatoi se mandati për bastisje ka qenë i formuluar në mënyrë shumë të përgjithësuar, që ka mundësuar bastisje e konfiskime pa kurrfarë kufizimi dhe pa kërkesa të parapara procedurale për bastisje në zyrën ku ka pasur material konfidencial edhe për klientët tjerë të avokatit (ankimesit). Shpjegimi për këtë perceptim kaq të gjerë të shtëpisë qëndron në faktin se aktivitetet zyrtare



dhe afariste, sidomos të personave të cilët ushtrojnë profesione të lira, siç janë avokatët, artistët e të tjerë, shpesh mund të identifikohen me shtëpinë, në kuptim të vendit ku janë kryer këto aktivitete. Përveç kësaj, shumë raporte ose marrëdhënie private mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktiviteteve zyrtare dhe për atë arsye, ndonjëherë është e pamundur që në mënyrë precize të veçohen këto hapësira për nga natyra e relacioneve në to.

### 1.3. Fshehtësia e komunikimeve si aspekt i privatësisë

Në korpusin e të drejtave të njeriut, e drejta e fshehtësisë së komunikimeve, përfshirë këtu edhe të drejtën për jetë, barazinë para ligjit, lirinë e të shprehurit, të drejtën për gjykim të drejtë, lirinë e besimit ose të drejtën për votim, bëjnë pjesë në kategoritë e të drejtave të brezit të parë. Sot kësaj të drejte i njihet statusi i “së drejtës së vjetër në një botë të re” (Ruiz, 1997, faqe 1). Zhvillimi i epokës kompjuterike në mënyrë dramatike ndryshoi mënyrën e komunikimit dhe dukshëm zgjeroi mundësitë e teknologjisë bashkëkohore të komunikimit. Si rezultat i këtyre ndryshimeve është koncipuar e ashtuquajtura shoqëri informatike, në formimin e së cilës rol qendror kanë komunikimet dhe mediat elektronike, si forma bashkëkohore të komunikimit të menjëherëshëm tekstual, audio dhe vizual, që funksionon pavarësisht nga vendndodhja gjeografike e personave që komunikojnë. Ky ekspansion i mjeteve bashkëkohore për komunikim ndryshoi format dhe mënyrën e komunikimit, e me këtë nxori në sipërfaqe, si çështje me rëndësi, aspektin e fshehtësisë së komunikimeve.

Fshehtësia e komunikimit mund të përkufizohet si e drejtë e personit që dikujt i thotë, i përcjell, i shkruan ose i beson diçka si informatë, e dhënë ose sekret, apo kur me dikë diçka ndan ose përjeton si emocion, e vetëm ai të vendosë për atë se a duhet ta dijë përmbajtjen e asaj që është thënë ose besuar edhe dikush tjetër dhe cili do të jetë ai person (Karovska-Andonovska, 2013, faqe 100). Boshtin e kësaj të drejte e përbën komunikimi i pacensuruar me persona të tjerë, pa marrë parasysh llojin dhe mjetet përmes së cilave zhvillohet procesi i komunikimit. E drejta nuk do të jetë shkelur nëse përmbajtja e komunikimit zbulohet nga pala tjetër pjesëmarrëse në atë komunikim. Zbulimi i përmbajtjes nga ana e një personi që ka marrë pjesë në atë komunikim është çështje mirëbesimi të ndërsjellë në mes atyre që kanë komunikuar dhe në rast të padisë nga personi tjetër, shkelja e fshehtësisë eventualisht mund të kategorizohet si shkelje e së drejtës për jetë private.

E drejta e fshehtësisë së komunikimit ka të bëjë edhe me vetëkomunikimin, të shprehur në formë të regjistrimeve personale të ruajtura si materiale (ditarë, shënime, qëndrime, arkiv personal dhe përmbajtje të tjera). Regjistrimet personale materiale mund të përmbajnë shënime në të cilat personi nuk është drejtpërdrejtë i prekur, si dhe shënime që kanë të bëjnë me jetën private ose jetën publike të pronarit të regjistrimit material. Në lidhje me vetëkomunikimin dhe trajtimin e tij si provë në procedurë penale, autorë të caktuar gjermanë (për shembull, D. Rezner, F.K. Shreder) propozojnë zbatimin e të ashtuquajturës “Teori të Tri Sferave” dhe janë të mendimit se regjistrimet materiale në të cilat personi nuk është drejtpërdrejtë i prekur, mund të përdoren si prova, ndërsa për regjistrimet që kanë të bëjnë me jetën private dhe janë të paceshme, ekziston ndalesë absolute për dorëzim ose përdorim të tyre, përveç atyre që në rret-

hana të caktuara dhe në rast të ekzistimit të një interesi madhor shoqëror, mund të përdoren si prova në procedure penale.

E drejta mbron fshehtësinë e vetë aktit të komunikimit, ndërsa përmbajtja e komunikimit është irelevante. Spektri i së drejtës në rast të komunikimit verbal, shtrihet dhe mbron fshehtësinë e fjalëve të thëna, që nga momenti i realizimit të kontaktit verbal, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së bisedës, deri në përfundimin e saj. Neni 8 i KEDNj-së mbron fshehtësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë verbal, si dhe fshehtësinë e komunikimit verbal me pajisje telefonike (*Klasandoters kundër Gjermanisë; Margareta dhe Roxher Anderson kundër Suedisë*). Në rast të komunikimit verbal me telefon celular, mbrojtja e fshehtësisë përfshin fjalët e thëna, por edhe informatën për vendndodhjen e njësive mobile telefonike.

Fshehtësia e komunikimit që zhvillohet përmes sistemit publik telefonik po ashtu është e mbrojtur, njëjtë si dhe komunikimi që zhvillohet përmes sistemeve të brendshme të komunikimit, të cilat drejtohen nga autoritetet publike. Për shembull, në rastin *Halford kundër Britanisë së Madhe*, GjEDNj konstatoi shkelje të nenit 8 të KEDNj-së sepse ndjekja e komunikimeve zyrtare dhe private të ankimeses (zyrtare policie) në kuadër të sistemit të brendshëm të komunikimit të policisë, nuk ka qenë konform rregullores ekzistuese ligjore, e njëkohësisht nuk ka pasur ndonjë alternativë ligjore me të cilën eventualisht do të ishte rregulluar ndjekja e komunikimeve jashtë sistemeve publike të komunikimit.

Në rast të komunikimit me shkrim, e drejta shtrihet dhe mbron të drejtën për fshehtësi të letrave të dërguara dhe të pranuar, si dhe të korrespondencës tjetër. E drejta për fshehtësi duhet të respektohet që nga momenti kur kanali (transmetuesi i përmbajtjes së komunikimit) do ta pranojë korrespondencën (shkresë, letër, urim, dokument, e-mail porosi dhe ngjashëm) nga dërguesi, deri në momentin kur ajo do t'i dorëzohet personit të cilit i është destinuar. Sipas GjEDNj-së, e drejta për fshehtësi përfshin edhe komunikimin telegrafik, që sot është gjithnjë e më pak aktual (*Guzardi kundër Italisë*) dhe komunikimin me pejxher (*Tejllor-Sabori kundër Mbretërisë së Bashkuar*), si dhe komunikimin elektronik jashtëzakonisht aktual me e-mail/ (*Koplend kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

#### **1.4. Të dhënat personale si aspekt i privatësisë**

Trajtimi bashkëkohor i së drejtës së respektimit të privatësisë, sidomos në shtetet evropiane, merr një dimension më të gjerë përmes trajtimit të të dhënave personale si një nocion apo aspekt i posaçëm i privatësisë ose madje edhe si e drejtë e re që buron nga e drejta për privatësi. Të dhënat personale paraqesin segment kyç të privatësisë për secilin individ, sidomos tani, kur aktivitetet shoqërore në të gjitha sferat funksionojnë mbi baza të dhënash me kapacitete të mëdha. Me të drejtat personale mund të përcaktohet identiteti i një personi ose karakteristika të ndryshme të identitetit të personit (fizike, fiziologjike, mentale, ekonomike, kulturore ose sociale).

Që të llogaritet një e dhënë si personale, informata duhet t'i përkasë një personi të caktuar fizik, respektivisht duhet të jetë "për" personin. Çfarëdo lloj informate mund të jetë e dhënë personale, përfshi edhe të dhënat audio, video dhe gjenetike, gjurmë gishtash etj. (*Gunderman, 2010, faqe 10*). Ndërlidhja e problematikës së sigurisë informatike dhe mbrojtjes së të dhënave personale, rezultoi me formim të një sfere të re të privatësisë, të quajtur privatësi elektronike. Problematika e *e-privatësisë* më së shpeshti ka të bëjë me postën elektronike dhe mbrojtjen e të dhënave personale që mb-

lidhen përmes rrjeteve kompjuterike (Boban, 2012, faqe 587). Për këtë shkak, avancimi i teknologjive imponon obligim për sistemet bashkëkohore juridike që në kontinuitet ta rikonfigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale, duke ndjekur dinamikën e këtij progresi.

Duke qenë një temë delikate, përpunimi i të dhënave personale që kanë të bëjnë me vepra penale, dënime të shqiptuara, masa alternative dhe masa sigurie, duhet të rishikohet si nga këndvështrimi i kundërvajtësve, identiteti i të cilëve duhet të mbrohet së paku deri në përfundim të procedurës së ankimit, ashtu edhe nga këndvështrimi i viktimave. Sipas Gundermanit, kjo do të thotë që jo vetëm që nuk do të publikohet emri i të dyshuarit, por edhe në rast se bëhet fjalë për incizim, atëherë fytyra e të dyshuarit do të mjegullohet dhe se autoritetet policore me kujdes do të vlerësojnë sa informata do të transmetojnë para opinionit, me qëllim që ta mbrojnë identitetin e të akuzuarit. Sa u përket viktimave, të dhënat e tyre duhet të trajtohen me respektin dhe kujdesin më të madh, për hir të privatësisë së tyre. Ato duhet të ruhen në fshehtësi të plotë, përveç nëse vetë viktimat nuk kërkojnë të kundërtën (Gunderman, 2010, faqe 35-37).

Sistemi i parimeve dhe masave për mbrojtje të privatësisë përmes mbrojtjes së të dhënave personale, në shtetet evropiane është vendosur përmes një sërë aktesh ndërkombëtare. **Konventa (e 108-të) për Mbrojtje të Individëve lidhur me përpunimin automatik të të dhënave personale** në Këshillin e Evropës, që daton nga viti 1981, paraqet dokumentin e parë dhe fundamental ndërkombëtar me karakter obligativ, që u soll me qëllim që të sigurohet respektimi i së drejtës për privatësi, lidhur me përpunimin automatik të të dhënave personale për çdo individ, në kuadër të shteteve-nënshkruese të Konventës. Në këtë kontekst, po aq e rëndësishme është edhe **Karta për të Drejtat Themelore e Bashkimit Evropian** nga viti 2000, e cila në mënyrë eksplicite parasheh të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, duke veçuar nenin 8 nga neni paraprak, e i cili ka të bëjë me mbrojtjen e jetës personale dhe familjare, shtëpisë dhe komunikimeve.

Korniza juridike për mbrojtjen e të dhënave personale në nivel të Bashkimit Evropian rrumbullakohet me disa akte dhe dokumente, të miratuara në prill të vitit 2016, zbatimimi i të cilave filloi dy vjet më vonë, në vitin 2018. Ndër më të rëndësishme janë: **Rregullorja (2016/679) për Mbrojtje të Personave Fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të atyre të dhënave** dhe **Direktiva (2016/680) për Mbrojtje të Personave Fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale në funksion të hetimeve penale**. Me Rregulloren 2016/679 janë lënë jashtë fuqisë juridike ligjet nacionale dhe Direktiva/ 95/46/CE e BE për Mbrojtje të Individëve lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizje të lirë të atyre të dhënave, si dokument bazik dhe gjithëpërfshirës me të cilin deri atëherë rregullohej mbrojtja dhe transferi i të dhënave personale në kuadër të BE.

Me rregullat e reja, në nivel të BE-së vendoset legjislacion unik pan-evropian për mbrojtje të të dhënave personale, në vend të kolazhit të deritanishëm jokonsistent të ligjeve nacionale. Në fakt, kjo llogaritet si një nga dobitë e pakos reformuese. Bëhet fjalë për parimin “Një kontinent – një ligj”, që duhet të mundësojë trajtim të barabartë të të dhënave të individëve dhe zbatim të rregullave identike për mbrojtje të të dhënave të secilit shtet-anëtar të BE.

Me pakon e akteve reformuese për mbrojtje të të dhënave personale, ndër të tjera, janë përfizuar, si dhe kanë hyrë në fuqi me mekanizma të caktuar, parimet themelore për përpunim të të dhënave personale:

- ligjshmëri;
- drejtësi dhe transparencë;
- qëllim i kufizuar;
- minimizim i të dhënave;
- saktësi;
- magazinim i kufizuar;
- integritet dhe besueshmëri;
- përgjegjësi.

## 2. Respektimi i privatësisë kundrejt nevojës për masa efikase në funksion të sigurisë dhe luftës kundër krimit

Prej kohësh serioziteti i kërcënimeve globale, para së gjithash krimi i organizuar dhe terrorizmi, e veçanërisht format e tyre transnacionale, i imponuan bashkësisë ndërkombëtare nevojën që të kërkojë alternativa për mënyra më efikase ballafaqimi me këto fenomene. Në përpjekjet për të gjetur një sistem efikas të masave dhe veprimeve, jo vetëm për zbulim të krimit, por edhe për parandalim të tij, bota demokratike sërish u përball me sfidën serioze të vendosjes së një baraspeshimi të drejtë ndërmjet:

- Zbatimit të masave invazive hetimore, si instrument adekuat për të arritur efikasitet më të madh të drejtësisë penale; dhe
- Mbrojtjes së korpusit të të drejtave dhe lirive të njeriut nga shkelja dhe rreziku i tepëruar gjatë zbatimit të qëllimit të parë.

Në këso rrethanash, promovimi i masave invazive hetimore dhe teknikave për grumbullim provash, doli në pah si përgjigje e imponuar ndaj kërcënimeve në rritje nga format e rënda të kriminalitetit. Në anën tjetër, zbatimi i masave të reja “jokonvencionale” në luftën kundër kërcënimeve kombëtare dhe globale për sigurinë, do të thoshte zbrapsje nga disa të drejta të njeriut që tradicionalisht kanë qenë të mbrojtura, sidomos e drejta për privatësi në të gjitha aspektet e saj (fshehtësia e komunikimit, të dhënat personale, privatësia e shtëpisë, e kështu me radhë).

Duke marrë parasysh këtë, evident është dyfishimi ndërmjet sigurisë si interes publik dhe privatësisë, si e drejtë personale. Ky dyfishim shpesh imponon nevojën që *a priori* të kufizohet privatësia, në funksion të mbrojtjes të sigurisë kombëtare dhe publike. Nuk kontestohet fakti se siguria kombëtare dhe publike paraqesin prioritetet më të larta të secilit shtet, por pa dyshim, as argumenti se siguria nuk mund të arrihet me shkelje të të drejtave dhe lirive individuale. Rrjedhimisht, ndërmjet interesit të përgjithshëm për mbrojtje të sigurisë dhe interesit të individëve për ruajtje të privatësisë, duhet patjetër të vendoset një ekuilibër korrekt dhe sjellje proporcionale. Nga interesi individual i mbrojtjes së privatësisë duhet të hiqet dorë vetëm në rast se vlerësohet se shkelja e saj është mënyra e vetme për ta mbrojtur interesin madhor shoqëror. Vlerësimi sigurisht se nuk duhet të gjeneralizohet.

Nevoja për të ndërhyrë në privatësinë e individit duhet të matet me kujdes për secilin rast individualisht dhe në kontekst të të gjitha rrethanave të rastit konkret. Në të kundërtën, çdo ndërhyrje apriori do të paraqesë nënvlerësim të privatësisë para interesit për mbrojtje të sigurisë.

Garancitë që i njeh procedura bashkëkohore penale tani më janë standarde mirë të etabluara, e nëse i llogarisim si arritje civilizuese, vështirë se do të mund të kthehemi prapa. (*Kambovski, 2005, faqe 382*). Çdo përgjigje që i jepet krimit, duhet patjetër të jetë vërtetim i parimeve themelore të shteteve demokratike, përmes sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut (*KE, Rec. 1996*).

### 3. Kufizimi legjitim i së drejtës për privatësi

Neni 8 i **Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut** (KEDNj) garanton të drejtën e respektimit të privatësisë dhe përcakton se:

Çdokush gëzon të drejtën t'i respektohet jeta private dhe familjare, shtëpia dhe korespondenca personale.

**Shteti nuk guxon të ndërhyjë në realizimin e kësaj të drejte, përveç nëse kjo ndërhyrje nuk është konform ligjit dhe nëse është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë nacionale, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalim të trazirave ose krimit, mbrojtjes së shëndetit, moralit apo për mbrojtje të të drejtave dhe lirive të të tjerëve.**

Në nenin 8, paragrafi 1 të KEDNj-së përcaktohet spektri i privatësisë dhe sferat e mbrojtjes, ndërsa paragrafi 2 parasheh garancinë për mosndërhyrje të shtetit në të drejtën për privatësi, por edhe kushtet dhe llojet e interesave të përgjithshme, për shkak të të cilave kjo e drejtë prapëseprapë mund të kufizohet. Pra, e drejta e privatësisë nuk është absolute dhe mund të kufizohet në llogari të disa interesave të tjera më madhore të shoqërisë ose të të drejtave tjera të individëve. Kështu, shteti, në mënyrë legjitime mund ta cenojë të drejtën e përgjithshme për privatësinë e individit në kushte të caktuara ("konform ligjit" dhe "e domosdoshme në shoqëri demokratike"), nëse kjo është në "interes të sigurisë nacionale, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit", apo me qëllim që të parandalohet vepër penale ("për të parandaluar trazira ose vepra kriminale"), për mbrojtje të shëndetit dhe moralit apo mbrojtje të të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Interesat e përcaktuara shoqërore si baza për kufizim legjitim të së drejtës për privatësi të individit, vetëm në dukje janë të përkufizuara në mënyrë të saktë. Bëhet fjalë për interesa të sigurisë nacionale dhe publike, mirëqenies ekonomike, parandalimit të trazirave dhe veprimeve kriminale, mbrojtje të shëndetit ose mbrojtje të të drejtave dhe lirive të të tjerëve, si dhe mbrojtje të moralit. Si praktikë, në të shumtën e rasteve shtetet i referohen mbrojtjes së sigurisë nacionale ose parandalimit të aktiviteteve kriminale, si interesa të larta shoqërore të cilat duhen mbrojtur, ndërsa më rrallë thirren në mbrojtje të mirëqenies ekonomike ose në mbrojtje të shëndetit të qytetarëve të vet. Ndërsa, në kuptim të mbrojtjes së moralit, si interes i lartë shoqëror, standardet për atë se çfarë është e çfarë nuk është morale dallojnë nga shteti në shtet, e madje edhe brendapërbrenda një shteti. Në çdo rast konkret, e drejta diskrete e shtetit për të ndërhyrë në privatësinë e individit varet nga konteksti i rrethanave, si dhe nga tradita, politikat dhe praktikat e ndryshme në shtete të ndryshme. Në vlerësimin e domosdoshmërisë për një ndërhyrje të tillë në jetën private të individit të caktuar, shtetet zbatojnë doktrinën e "margjinës së vlerësimit".

**Margjina e vlerësimit (ose margjina e së drejtës diskrete të shtetit** është doktrinë me një spektër të gjerë zbatimi në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Doktrina u zhvillua

nga GjEDNj dhe në jurisprudencën gjyqësore paraqet udhërrëfyes të procedurës për vlerësim të shteteve-nënshkruese të KEDNj-së, kur ato duhet të sanksionohen për kufizim të ndonjë të drejte të qytetarëve, të mbrojtur me dispozitat e KEDNj-së. Doktrina mundëson që gjykata t'i tejkalojë dallimet praktike në implementimin e dispozitave të KEDNj-së të shteteve-nënshkruese, me çka krijohet e drejtë e anulimit të delegimit të obligimeve që burojnë nga KEDNj.

Doktrina po ashtu fuqizon rolin e KEDNj-së si kornizë mbikëqyrëse për mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, që obligon gjykatësit e GjEDNj-së t'i marrin parasysh dallimet ndërmjet të drejtës nacionale të shteteve-nënshkruese e si ata trajtojnë këtë përmbajtje, dhe procedurës që parasheh KEDNj. Doktrina "margjina e vlerësimit" përmban koncepte që janë analoge me parimin e subsidiaritetit dhe këto zbatohen në fusha të ndryshme në të drejtën e Bashkimit Evropian. Qëllimi i kësaj doktrine është t'i balancojë të drejtat individuale me interesat nacionale, si dhe të ndihmojë në zgjidhjen e çfarëdo lloj konflikti potencial. Mirëpo, doktrina "margjina e vlerësimit" nuk mundëson fuqi të pakufizuar në vlerësimin e shteteve, sepse nënkuptohet që "margjina nacionale e vlerësimit shkon dorë për dorë me mbikëqyrjen evropiane" (Killkeli, 2001, faqe 7).

Nga praktika e deritanishme e GjEDNj-së mund të konstatohet se gjykatat nacionale të drejtën diskrete më së shumti e përdorin për kushtin për domosdoshmëri, kur në rrethana konkrete ato vlerësojnë se zbrapsja nga e drejta për privatësi është legjitime. Gjykata ka të drejtën diskrete ta vlerësojë domosdoshmërinë duke marrë parasysh specifikat e rastit konkret, si dhe në kontekst të ambientit të sigurisë në vend, por edhe domosdoshmërisë nga aspekti i vlerave morale, normave zakonore, politike dhe rrethanave të tjera.

## **4.Parimet dhe standardet ndërkombëtare për zbatim të masave për ndjekje të komunikimeve**

### **4.1. Parimet ndërkombëtare**

Masat invazive hetimore (në legjislacionin e Maqedonisë përkufizohen si masa të posaçme hetimore ose shkurtimisht - MPH), padyshim paraqesin kërcënim serioz për korpusin e të drejtave dhe lirive individuale të qytetarëve, duke marrë parasysh fuqinë agresive dhe depërtuese në sferën e jetës private të individit. Gjithsesi, ato janë e keqja më e vogël dhe e pashmangshme, kundrejt së keqes që kanoset nga krimi i organizuar dhe terrorizmi.

Konkluzionet e Rezolutës nga Kongresi XVI i Shoqatës Ndërkombëtare për të Drejtën Penale janë të një rëndësie të posaçme për rregullimin normativ, zbatimin praktik dhe valorizimin e njohurive të siguruar nga zbatimi i këtyre masave (Kongresi XVI Ndërkombëtar i Ligjit Penal, Budapest, 5-11 shtator 1999, Pjesa III, faqe 10). Në Rezolutë rekomandohet që masat dhe teknikat invazive mund të përdoren në qoftë se:

- Zbatimi i masave është i rregulluar me ligj - **parimi i ligjshmërisë;**
- Nuk ekzistojnë masa të tjera më të buta për realizim të qëllimit të njëjtë - **parimi i subsidiaritetit;**
- Masat zbatohen vetëm për vepra të rënda penale - parimi i proporcionalitetit; dhe
- Paraprakisht është marrë pëlqim nga gjykata, respektivisht zbatimi i këtyre masave realizohet nën mbikëqyrje të saj - **parimi i miratimit të masave invazive nga gjykata.**

Parimet e paraqitura më lart, si dhe standardet e miratuara lidhur me zbatimin e këtyre parimeve, janë rikonfirmuar dhe plotësuar me standarde përkatëse për zbatimin e tyre dhe përmes akteve tjera të organizatave tjera ndërkombëtare, sidomos Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe veçanërisht përmes praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në krijimin e parimeve dhe standardeve, këto organizata këmbëngulin të sigurojnë veprim të balancuar të organeve të autorizuara në zbatimin e masave invazive, kundrejt nevojës për respektim të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Krijimi i standardeve është proces që zhvillohet në kontinuitet dhe i cili vazhdimisht plotësohet.

Në këtë drejtim dhe me peshë të njëjtë janë edhe konventat ndërkombëtare të OKB-së, që u miratuan më vonë (*Konventa e KB kundër Krimin të Organizuar Transnacional, 2000, neni 20; Konventa e KB Kundër Korrupsionit, 2003, neni 50*), standardet e krijuara nga Këshilli i Evropës për zbatim të masave invazive (përmes organeve të tij: Komitetit të Ministrave, Komisionit të Venecias, Asamblesë Parlamentare, Komisionit të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Marrëdhënie Juridike dhe të Drejtat e Njeriut), rekomandimet që Komiteti i Ministrave ua sugjeron shteteve-anëtare të Këshillit të Evropës (*KE, Rec. (1996)8; KE, Rec. (2001) 11; KE, Rec. (2005) 10*), etj.

#### **4.1.1. Parimi i ligjshmërisë**

Parimi i ligjshmërisë i obligon shtetet që procedurën, kushtet dhe rrethanat tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e masave invazive, t'i kenë të përcaktuara me dispozita precize ligjore, me qëllim që t'i shmangët arbitraritetit të së drejtës diskrete të shtetit.

Dispozita e nenit 8 paragrafit 2 të KEDNJ-së, lejon që shteti ta suprimojë të drejtën e përgjithshme për privatësi të individit, të paraparë në paragrafin 1 të nenit të njëjtë, nëse në mënyrë kumulative janë plotësuar dy kushte: “të jetë konform ligjit dhe të jetë i domosdoshëm në shoqëri demokratike”. Kushti, “të jetë konform ligjit” paraqet kërkesë eksplicite dhe promovim të parimit të ligjshmërisë. Me fjalë të tjera, masat duhet të jenë të rregulluara me ligj, i cili duhet në mënyrë koncize ta përkufizojë rrethin, respektivisht kategorinë e personave të cilët mund të jenë subjekt i zbatimit të masave; llojin e veprave penale për të cilat lejohet zbatimi i këtyre masave; kohëzgjatjen e masave, që duhet të jetë një kornizë e pranueshme kohore; mënyrën e zbatimit të masave; mënyrën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të po këtyre masave; regjimin e përdorimit dhe ruajtjes së incizimeve të siguruara nga zbatimi i masave; dhe rrethanave tjera që janë të rëndësishme për zbatimin e tyre, e që reflektohen në liritë dhe të drejtat e individit.

Kërkesa e këtillë në mënyrë të drejtpërdrejtë prek parimin e sigurisë juridike të qytetarëve, që paraqet fundament të konceptit të sundimit të ligjit, respektivisht të konceptit të shtetit të së drejtës. Ekzistimi i këtij parimi mundëson mbrojtje nga pasiguria juridike dhe padrejtësia gjatë zbatimit të ligjit, e njëkohësisht shteteve u mundëson t'i zbatojnë autorizimet që i kanë, siç janë paraparë me rregullat ligjore.

#### **4.1.2. Parimi i subsidiaritetit**

Parimi i subsidiaritetit imponon obligim për zbatim të masave invazive pa përjashtim, si dhe qasje graduale në shqiptimin e masave, nga më pak invazive në më shumë invazive, respektivisht zbatim të domosdoshëm të masave më pak invazive të hetuesisë, në qoftë se me to mund të arrihet qëllimi legjitim.

Parimi i subsidiaritetit përfshin dy elemente domosdoshmërisht reduktuese kumulative:

- I pari, shteti fillimisht t'i përdorë masat konvencionale operative, e vetëm në raste të skajshme të ushtrisë masa invazive hetimore; dhe
- I dyti, nëse shteti vendos për masa të këtilla, atëherë ai duhet domosdoshmërisht të aplikojë veprim gradual në përzgjedhjen e masave, nga më pak invazive në më shumë invazive.

Zbatimi i këtyre masave invazive paraqesin *Ultima Ratio*, respektivisht instrumentin e fundit të cilin shteti duhet ta përdorë në përpjekjen për ta përmirësuar efikasitetin e legjislacionit penal. Me fjalë tjera, ndërhyrja në jetën private të individit nuk do të jetë konform parimit të subsidiaritetit në qoftë se shteti ka pasur në dispozicion masa të tjera alternative, pa ose me karakter më pak invaziv, me zbatimin e të cilave ka mundur t'ia arrijë qëllimit të njëjtë legjitim.

Parimi i subsidiaritetit logjikisht nënkupton edhe ndalesën që këto masa të etablohen dhe të paraqesin metodë për mbledhje të indikacioneve. Masat invazive hetimore janë instrumenti i fundit në sistemin e masave për parandalim dhe zbulim të krimit, të cilat shteti domosdoshmërisht i përdor për shkak të pamundësisë që vepra kriminale të hetohet me masa tjera alternative, derisa në të njëjtën kohë shoqëria ka nevojë urgjente të mbrohet ndonjë e mirë me interes të përgjithshëm.

Zbatimi i këtyre masave është instanca e fundit që ndërmerr një shoqëri në përpjekjen për t'i mbrojtur vlerat dhe të mirat vitale në shoqëri. Për t'i aprovuar ato, nevojitet ekzistimi i disa rrethanave të caktuara, respektivisht indikacione se është kryer ose do të kryhet një vepër e caktuar penale. Zbatimi i shpeshtë, pa respektuar parimin e subsidiaritetit, respektivisht rregullin *Ultima Ratio*, krijon psikozë dhe bindje (karakteristike për strukturat policore) se "me ndihmën e mjeteve teknike mund të arrihet deri te vendi i krimit dhe të gjendet autori i veprës penale".

#### **4.1.3. Parimi i proporcionalitetit**

Me parim proporcionaliteti nënkuptohet baraspeshë në zbatimin e masave invazive hetimore, ndërmjet vlerës së interesit shoqëror që mbrohet dhe shkallës së invazionit mbi jetën private të individit gjatë realizimit të asaj mase mbrojtëse.

Parimi i proporcionalitetit do të thotë gjetje e një ekuilibri të drejtë ndërmjet mbrojtjes së të drejtave individuale, nga njëra anë, dhe interesave të shoqërisë në tërësi, nga ana tjetër. Ky ekuilibër mund të arrihet vetëm nëse kufizimet e të drejtave të individit nga neni 8 paragrafi 1 i KEDNj-së janë proporcionale me qëllimin legjitim. Parimi i proporcionalitetit kërkon balancë ndërmjet shkallës dhe intensitetit të ndërhyrjes në të drejtën për privatësi të individit, dhe dobisë konkrete nga hetimi që ndërmerret.

Duke marrë parasysh natyrën imponuese të masave, proporcionalitet duhet të ekzistojë midis qëllimit që duhet të arrihet dhe mjeteve që përdoren për atë qëllim, kundrejt interesave të përgjithshme të shoqërisë dhe mbrojtjes së të drejtave të individëve. Edhe pse parimi i proporcionalitetit, ashtu si edhe parimi i subsidiaritetit, nuk përmenden si terme në mënyrë eksplicite në nenin 8, paragrafin 2 të KEDNj-së, të dyja kanë rol kyç në jurisprudencën e GjEDNj-së.



#### 4.1.4. Parimi i miratimit gjyqësor të masave invazive

Kuptimi thelbësor i parimit të miratimit gjyqësor qëndron në faktin se zbatimi i masave invazive paraprakisht duhet të jetë i miratuar nga gjykata, gjegjësisht zbatimi i tyre duhet të ndodhë nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e gjykatës.

Parimi i miratimit gjyqësor vendos obligim ligjor që organet e autorizuar të kërkojnë miratim paraprak nga pushteti gjyqësor për secilin zbatim të planifikuar të masave invazive. Kuptimi i këtij pozicioni, kushtimisht vartës i pushtetit ekzekutiv në raport me pushtetin gjyqësor, është i domosdoshëm në një shoqëri demokratike dhe paraqet korrektor dhe garanci për të drejtat dhe liritë themelore të individit nga shkelja tej mase e tyre gjatë zbatimit të masave.

Në procedurën e propozimit të këtyre masave, preferohet që të ketë një instancë e jashtme e pavarur, jashtë rrethit të pushtetit ekzekutiv, e cila krejtësisht e “pangarkuar” nga përpjekjet për të rritur efikasitetin e përndjekjes penale, në mënyrë reale dhe të paanshme do ta vlerësojë, për secilin rast veç e veç, nevojën dhe domosdoshmërinë për zbatimin e masave invazive. Rrjedhimisht, pushteti gjyqësor, madje është shumë i qëlluar dhe i preferuar për të qenë instancë e jashtme objektive, sepse krahas pavarësisë së tij, kompetencës dhe pozicionit që ka në sistem, është edhe i interesuar për zbatim ligjor dhe efikas të masave në aspekt funksional, sepse në fund të fundit është gjykata ajo që me praktikimin e drejtësisë do t’i përdorë provat dhe të dhënat e siguruar nga zbatimi i masave.

Qëllimi i këtij parimi është që të sigurohet respektim i autorizimeve dhe kufizimeve ligjore në zbatimin e masave nga ana e organeve të autorizuar, për të parandaluar keqpërdorimin dhe përdorimin e tepruar të tyre. Thënë ndryshe, qëllimi është që të imponohet respektimi i rregullit se këto masa do të jenë instrumenti i fundit dhe i skajshëm të cilin shteti duhet ta përdorë në përpjekjet e tij për ta përmirësuar dhe zmadhuar efikasitetin e drejtësisë penale.

Për këtë shkak, parimi i miratimit gjyqësor, në thelb paraqet mbikëqyrje dhe kontroll kompetent e të thellë në një stad jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe vendimtar në procedurën e zbatimit të masave. Në këtë stad organet për ndjekje penale marrin vendim përfundimtar për zbatim të masave dhe për atë qëllim kërkojnë miratim. Bashkangjitur me kërkesën, propozuesi i autorizuar duhet t’i cekë të gjitha rrethanat dhe faktet që argumentojnë se rasti në aspekt juridik-penal nuk mund të trajtohet ndryshe kur ekziston nevojë urgjente shoqërore për reagim të shtetit, me qëllim të mbrojtjes së një të mire ose vlere të caktuar me interes të përgjithshëm.

Prandaj, kjo mbikëqyrje dhe ky kontroll, simbolikisht i quajtur miratim gjyqësor për zbatim të masave invazive, ka rëndësi vendimtare pikërisht për faktin se paraqet mbikëqyrje dhe kontroll kyç dhe përfundimtar, të jashtëm dhe kompetent, për atë se a do të miratohet ndërhyrja në sferën e jetës private të individit, ndërsa të gjitha format tjera të mbikëqyrjes dhe kontrollit në vazhdim kanë të bëjnë me faza ku zbatimi i masave tani më ka filluar (mbikëqyrje dhe kontroll aktual) ose ka përfunduar (*ex post* - mbikëqyrje dhe kontroll).

Kjo mbikëqyrje dhe ky kontroll i gjykatës në këtë stad, në përmbajtjen e vet përputhet me të ashtuquajturin *Ex Ante* - kontroll i gjykatës mbi zbatimin e masave, dhe paraqet pjesë përbërëse të procedurës që ajo ndjek gjatë marrjes së vendimit lidhur me kërkesën e parashtruar për zbatim të masave. Në këtë procedurë, gjykata bën vlerësimin e fakteve, provave, njohurive dhe të dhënave të paraqitura në kërkesën e parashtruar dhe merr vendim meritore për atë se a do të miratohet zbatimi i masave. Mbikëqyrja dhe miratimi aprovues, respektivisht *Ex Ante* - kontrolli gjyqësor,

në këtë fazë i mundëson pushtetit gjyqësor të vlerësojë a kanë respektuar organet për ndjekje penale parimin e ligjshmërisë, subsidiaritetit dhe proporcionalitetit gjatë propozimit të masave invazive, e njëherazi ta përcaktojë përshtatshmërinë dhe arsyeshmërinë ekonomike në planifikimin dhe realizimin e qëllimeve të parapara të shërbimeve të autorizuara për zbatim të masave, gjegjësisht efikasitetin e tyre.

Dispozita nga neni 68, paragrafi 6 i LNK-së paraqet një instrument të rëndësishëm juridik për kontrollin që bën pushteti gjyqësor (dhe prokuroria) në fazën e miratimit të masave, por edhe gjatë zbatimit të tyre, lidhur me parandalimin e fenomenit dhe ndjekjes (mbikëqyrjes) masovike të komunikimeve të qytetarëve. Kjo dispozitë obligon operatorët të sigurojnë barasvlefshmëri në ndjekjen e komunikimeve.

Me fjalë tjera, gjykata ka mundësi ligjore të mos e miratojë zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve ose ta ndalojë zbatimin e tyre, edhe pse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që kjo të ndodhë, në qoftë se operatorët nuk kanë pajisje teknike që mund të garantojnë barasvlefshmëri në ndjekjen e komunikimeve. Barasvlefshmëria vlen si për subjektin komunikimi i të cilit ndiqet, ashtu edhe për përmbajtjen që ndiqet, me çka ligjërisht ndalohet të ndiqen (numër i pacaktuar dhe i pakufizuar) persona tjerë të cilët nuk janë përfshirë me urdhëresën gjyqësore, e po ashtu ndalohet të ndiqet përmbajtje tjetër nga ajo që ceket në urdhëresë. Për mosrespektim të obligimit të lartpërmendur nga ana e operatorëve parashihet vetëm dënim me para.

Kjo mbikëqyrje dhe ky kontroll miratues gjyqësor lidhur me zbatimin e masave invazive nuk duhet të barazohet me mbikëqyrjen dhe kontrollin klasik të gjykatës lidhur me zbatimin e masave invazive, për shkak se:

- mbikëqyrja dhe kontrolli miratues bëhet para se të fillojë zbatimi i masave invazive hetimore, për dallim nga mbikëqyrja dhe kontrolli klasik, i cili kryhet rrjedhimisht apo *Ex Post*;
- qëllimi i mbikëqyrjes dhe i kontrollit miratues gjyqësor është të jepet pëlqim, respektivisht miratim për zbatim të masave, ndërsa qëllimi i mbikëqyrjes dhe kontrollit klasik është respektimi i parimit të ligjshmërisë lidhur me zbatimin e masave invazive;
- për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme dhe vendimtare të mbikëqyrjes dhe kontrollit miratues gjyqësor, gjykata është “e përjashtuar” nga mbikëqyrja dhe kontrolli klasik dhe ky miratim është ngritur në nivel të një parimi të pavarur në procedurën për zbatim të masave invazive, ndërsa mbikëqyrja dhe kontrolli klasik i zbatimit të masave invazive hetimore janë pjesë përbërëse e parimit të ligjshmërisë; dhe
- edhe pse sipas përmbajtjes miratimi është *Ex Ante* - mbikëqyrje dhe kontroll gjyqësor, sipas funksionalitetit që ka, ai paraqet pjesë të procedurës gjyqësore në marrjen e vendimit lidhur me kërkesën e parashtruar për zbatim të masave invazive hetimore.

## **4.2. Standarde ndërkombëtare**

### **4.2.1. Standarde të miratuara lidhur me parimin e ligjshmërisë**

GjEDNj-ja konkludon se masat invazive janë instrument i domosdoshëm i organeve për ndjekje penale në shoqëritë bashkëkohore demokratike, si mjet adekuat për parandalim të kriminalitetit,

mirëpo nëse zbatimi i tyre nuk është i rregulluar me ligj, ekziston rrezik për rrënim ose madje shkatërrim të demokracisë, me arsyetimin se kjo bëhet për mbrojtje të saj (*Klas kundër Gjermanisë*).

Nën termin ligj, në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së nënkuptohet çfarëdo lloj kornize juridike të shtetit domicil me të cilën përcaktohet zbatimi i masave invazive. Në këtë drejtim, nëse shteti nuk ka kornizë juridike, kjo do të thotë shkelje e nenit 8 të KEDNj-së. GjEDNj-ja nuk insiston që korniza juridike të jetë në formë të aktit juridik - si ligj, por kërkon akt juridik që ka peshë juridike (*DeVidendau kundër Belgjikës*).

Krahas anës formale të kornizës juridike, insistohet edhe në karakteristika të caktuara përmbajtjesore të cilat ligji duhet t'i plotësojë, e që kanë të bëjnë me precizitetin, qartësinë dhe përkuftizimin e normave, me ç'gjë do t'u mundësohet qytetarëve që të parashikojnë, deri në një shkallë të kuptueshme, se kur mund të jetë shkelur jeta e tyre private (*Sandey Tajms kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Mbrojtja nga keqpërdorimi i masave intruzive duhet patjetër të përfshijë dispozita praktike dhe precize, të cilat rregullojnë autorizimin për mbikëqyrje, e që janë shumë të qarta dhe koncize (*Melloun kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

Rregullat duhet të jenë në formë obligative juridike dhe duhet që opinioni publik t'i ketë në dispozicion (*Hjuit dhe Herman kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Rregullat duhet t'i përkufizojnë kategoritë e njerëzve të cilët janë objekt mbikëqyrjeje, llojet e veprave penale për të cilat hetimi justifikohet, kohëzgjatjen e pranueshme të mbikëqyrjes dhe rrethanat në të cilat çdo incizim do të ruhet në dosje të caktuar nga ana e shtetit (*Huvig/ kundër Francës*). Rregullat po ashtu duhet ta përcaktojnë vëllimin dhe mënyrën se si do të zbatohet mbikëqyrja në praktike (*Kop kundër Zvicrës; Tejlor-Sabori kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

Në kontekst të asaj që theksuam më lartë, sipas interpretimit gjyqësor të GjEDNj-së, ligji duhet të jetë mjaftueshëm i aksesshëm për qytetarët, që ata të jenë të njoftuar se në çfarë rrethanash mund të jenë të rrezikuara të drejtat dhe liritë e tyre individuale. Kjo, nga ana tjetër nuk do të thotë që ligji duhet t'u krijojë mundësi qytetarëve që të jenë në gjendje të parashikojnë se ata janë objekt i zbatimit të masave të posaçme, sepse me atë do të rrënohej efikasiteti i përndjekjes penale dhe shteti kushtimisht do të çarmatoste veten. Dispozitat ligjore po ashtu duhet të jenë precize dhe kategorike, që qytetarët të mund ta përshtatin sjelljen e tyre me ligjin. Mirëpo, kërkesat për precizitet të ligjit nuk llogariten të rrezikuara nëse dispozita të caktuara mund të interpretohen në disa mënyra (*Kastells kundër Spanjës*).

#### 4.2.2. Standarde lidhur me parimin e subsidiaritetit

Parimi i subsidiaritetit nuk është i parashtruar në mënyrë eksplicite në nenin 8, paragrafi 2 i KEDNj-së, siç është parimi i ligjshmërisë, mirëpo ai është i inkorporuar në mënyrë përmbajtjesore dhe nënkuptohet nën termin “i domosdoshëm”. Kështu, duke shprehur mendimin e vet për kuptimin e termit “i domosdoshëm”, GjEDNj në rastin ***Kempbell kundër Mbretërisë së Bashkuar*** konkludon se “ndërhyrja në jetën private të individit nuk do të llogaritet e domosdoshme në qoftë se shteti ka pasur në dispozicion masa të tjera alternative, me zbatimin e të cilave mund të arrihej qëllimi i njëjtë”.

Parimi i subsidiaritetit do të thotë qasje graduale në zbatimin e masave invazive, që do të thotë se njëherë duhet të shterohen të gjitha mjetet tjera që shteti i ka në dispozicion, e masat invazive të zbatohen vetëm si alternativë e fundit. Në implementimin e parimit të subsidiaritetit,

e një rëndësie të posaçme është që të ndërtohen mekanizmat e mbrojtjes procedurale në procedurën e propozimit të këtyre masave te organet që janë të detyruara me ligj për t'i zbatuar ato. Kontrolli disa shkallësh në procedurën e propozimit ndaj organeve të autorizuara për zbatimin e tyre, krijon garanci të caktuara se nuk do të keqpërdoren dhe se njëkohësisht po këto masa nuk do të etablohen si metoda rutinore dhe të zakonshme për mbledhje të indikacioneve.

Edhe pse kanë të bëjnë me parimin e ligjshmërisë, një pjesë e kërkesave për ekzistimin e një ligji cilësor prapëseprapë janë të një rëndësie domethënëse edhe për jetësim të parimit të subsidiaritetit. Kërkesat për mbrojtje procedurale dhe zvogëlim të autorizimeve diskrete të shtetit kanë ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e garancive që këto masa intruzive të mos zbatohen në mënyrë arbitrare.

Edhe pse këto rregulla nuk duhet të përmbajnë përkufizime gjithëpërfshirëse (*Hjuitt dhe Herman kundër Mbretërisë së Bashkuar*), ato nuk mundin thjesht t'ia lënë rastësisë faktin se a do të ketë mbikëqyrje me ushtrim të lirë të së drejtës diskrete nga ana e ekzekutivit apo gjykatës (*Valenthuela Kontreras/ kundër Spanjës*). Po ashtu, legjislacioni duhet të jetë i shoqëruar me mbrojtje adekuate procedurale nga ushtrimi arbitrar i së drejtës diskrete nga ana e pushtetit ekzekutiv, gjatë zbatimit të masave (*Huvig kundër Francës*). Nëse shteti ka të drejta diskrete, që sigurisht se nuk mund të shfuqizohen, ligji duhet të alarmojë për vëllimin e asaj të drejte diskrete në mënyrë shumë të qartë (*Silver kundër Mbretërisë së Bashkuar; Leander kundër Suedisë*), me qëllim që të mundësojë drejtësi gjatë procedimit. Shteti po ashtu duhet t'i zvogëlojë të drejtat e veta diskrete në nivel minimal (*Sandey Tajms kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

#### **4.2.3. Standarde lidhur me parimin e proporcionalitetit**

Parimi i proporcionalitetit, ashtu si edhe parimi i subsidiaritetit, nuk është i përkufizuar në mënyrë eksplicite në nenin 8, paragrafin 2 të KEDNj-së, mirëpo termi i përdorur “e domosdoshme” sublimon të dy parimet. GjEDNj në disa raste ka dhënë mendimin e vet për domethënien e termit “e domosdoshme” dhe në rastin e *Sandey Tajms kundër Mbretërisë së Bashkuar* thekson se: “Me termin *e domosdoshme* në një shoqëri demokratike nënkuptohet që ndërhyrja në jetën private të individit të jetë veprim që mbështetet në një nevojë urgjente shoqërore. Nuk mjafton që kjo ndërhyrje të jetë vetëm e duhur dhe e arsyeshme, por njëkohësisht shteti duhet të tregojë se ekziston marrëdhënie proporcionaliteti në mes qëllimit që duhet të arrihet dhe mjetet që përdoren për atë qëllim”.

Me termin proporcionalitet nënkuptohen dy momente (*Xhejms kundër Mbretërisë së Bashkuar*):

- proporcionalitet ndërmjet qëllimit të masave dhe mjeteve që përdoren për atë qëllim;
- proporcionalitet apo baraspeshë juridike ndërmjet interesit të përgjithshëm të shoqërisë dhe mbrojtjes së të drejtave të individit.

Gjatë përcaktimit të proporcionalitetit, shqyrtohen rrethanat se a është ndonjë ndërhyrje e caktuar në jetën private të qytetarëve tepër e bezdisshme ose imponon ngarkesë të tepërt për individë të caktuar, e po ashtu merret parasysh se cili është interesi i shoqërisë. Shteti duhet

të vërtetojë se ndërhyrja në jetën private të individit nuk ka qenë më e madhe se që ka qenë e nevojshme.

Në kontekst të kësaj, në raste kur ndërhyrja në jetën private të individit është e karakterit imponues ose kur informatat që i mbledh shteti janë të një karakteri të ndjeshëm (si për shembull, mbikëqyrje sekrete e personave me funksione dhe detyra të posaçme, si: gjykatës, politikanë, klerikë etj.), veprimi duhet të argumentohet fuqishëm (*Kop kundër Zvicrës*).

Shteti duhet të sigurojë prova të qarta për domosdoshmërinë e zbatimit të masave invazive dhe të ndërtojë kornizë juridike që do të sigurojë mbrojtje adekuate dhe efikase nga keqpërdorimi i mundshëm. Në këtë kontekst vihet në dukje se teknikat e ndryshme hetimore, siç janë: mbikëqyrja e tabulateve telefonike dhe postës (*Kop kundër Zvicrës*), përpunimi i tabulateve telefonike, gjegjësisht identifikimi i numrave që ka kërkuar telefoni ose numra që kanë kërkuar telefonin (*PG kundër Mbretërisë së Bashkuar*), mbikëqyrje e pejxherit (*Tejlor-Sabori kundër Mbretërisë së Bashkuar*), përdorimi i pajisjeve të fshehta për përgjim (*Kan kundër Mbretërisë së Bashkuar*) dhe video-mbikëqyrja (*Govëll kundër Mbretërisë së Bashkuar*), janë shkelje *prima facie* të së drejtës për privatësi dhe kërkojnë argumentim konform nenit 8, paragrafit 2 të KEDNj-së.

Trajtim të tillë kanë edhe të gjitha teknikat tjera hetimore, me të cilat bëhet mbikëqyrje në stacionet policore, hapësirat e punës, si dhe në shtëpi. Njësoj është edhe me rastet kur mbikëqyrja është bërë nga person që nuk është pjesë e strukturave policore, por atë e ka bërë me kërkesë, këshillë ose ndihmë të policisë (*Hallford kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Por GjEDNj-ja thotë se nuk ka shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane në të gjitha ato teknika hetimore ku mbikëqyrja ose incizimi i një personi të caktuar bëhet në vend publik, në rrethana të tilla ku personi nuk ka pritshmëri të arsyeshme për privatësi (*PG kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Nëse informatat e mbledhura më vonë sistematizohen në një incizim të përhershëm, mund të ndodhë korrigjim i nenit 8 të KEDNj-së (*PG kundër Mbretërisë së Bashkuar*), siç do të vendosej edhe në situatat kur mblidhen dhe analizohen informata për publikun, pa marrë parasysh nëse janë siguruar me zbatim të ndonjë mase të posaçme hetimore (*Rotari kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

Në raste të caktuara, operacionet sekrete ose të fshehta mund të shkaktojnë shkelje të nenit 8 të KEDNj-së. Kur i referohemi termit *jetë private* siç e kupton shumica, mund të konstatohet se angazhimi i agjentëve sekretë dhe kategorisë *bashkëpunim sekret*, kompromiton të drejtën e zhvillimit të lirë të marrëdhënieve mes njerëzve dhe shkel pritshmërinë e arsyeshme për privatësi në komunikim, ose me fjalë tjera, shkelet e drejta e individit të komunikojë lirisht, pa u frikësuar se kontakton me agjentë sekretë apo informatorë.

Ndodh që i dyshuari aspak nuk është i vetëdijshëm se është objekt mbikëqyrjeje të posaçme nga shteti, e madje as nuk është i informuar për të drejtën për t'u mbrojtur në heshtje, respektivisht të mos japë deklarata që do të mund të ishin përdorur për ta trajtuar atë personalisht apo ndonjë person të afërm. Rrjedhimisht, gjithnjë e më të shpeshta janë opinionet dhe pritjet se GjEDNj në të ardhmen e afërt do t'i klasifikojë operacionet sekrete dhe bashkëpunimin sekret si ndërhyrje *prima facie* në të drejtën për privatësi të qytetarëve dhe rrjedhimisht, do të kërkojë rregullore strikte ligjore, konform nenit 8 të KEDNj-së.

Në kontekst të kësaj që u tha më lart, GJEDNj veçon veprimet e policisë që cilësohen si dinakëri, e jo metoda të paligjshme për sigurim të provave (*A kundër Gjermanisë*) dhe në rastin e njëjtë konstaton se veprimet e tilla nuk paraqesin shkelje të nenit 6 të KEDN-së, në qoftë se prova kontestuese mbështetet edhe me prova të tjera, e nëse në ndërkohë policia nuk cenon lirinë e vullnetit të individit.

Sa i përket angazhimit të agjentëve sekretë, GJEDNj në mënyrë eksplicite mbron qëndrimin se nuk lejohet nxitje për kryerje të veprës penale dhe se çdo provë e siguruar në këtë mënyrë paraqet shkelje të nenit 6 të KEDNj-së. Me fjalë të tjera, shteti lejon krimin, e në të njëjtën kohë nuk mundet dhe nuk duhet të ndalojë madje as edhe një mendim të shtrembëruar kriminal në kokën e një individit, por assesi nuk guxon t'i lejojë askujt, e edhe më pak vetes, të japë kontribut në realizimin e qëllimit kriminal një personi të caktuar. Në rastin *Tesheira de Kastro kundër Portugalisë*, GJEDNj thekson se: "Roli i agjentëve sekretë duhet të kufizohet dhe të ketë mbrojtje edhe në raste të luftës kundër tregtisë me drogë. Edhe pse rritja e shkallës së krimit të organizuar padyshim kërkon të ndërmerren masa përkatëse, e drejta e zbatimit të drejtë të drejtësisë nuk mund të sakrifikohet për arsye ekspeditiviteti. Kërkesat e përgjithshme për drejtësi, të inkuorpuara në nenin 6 të KEDNj-së, vlejné për procedurat me të gjitha llojet e veprave penale, nga ato më të lehtat deri te ato më të ndërlikuarat. Interesi publik nuk mund ta arsyetojë përdorimin e provave të siguruara përmes nxitjes policore".

Sa i përket përfshirjes së informatorëve si dëshmitarë në procedim, kur ata janë të përfshirë në vepër penale (kjo kategori kriminale dhe procedurë-penale njihet me sinonime të ndryshme: dëshmitar e bashkëpjesëmarrës në vepër penale, dëshmitar i penduar, dëshmitar bashkëpunëtor, bashkëpunëtorë të drejtësisë etj.), gjykata rekomandon kujdes të posaçëm me provat e siguruara nga ata, duke mbajtur qëndrimin se nuk ka shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane, nëse informatori kontestohet në pyetje të kryqëzuar gjatë procedimit dhe nëse dëshmia e informatorit nuk është provë e vetme (*Karlin Veb kundër Mbretërisë së Bashkuar; Baraxh kundër Zvicrës*).

#### **4.2.4. Standarde lidhur me parimin e miratimit gjyqësor të masave invazive**

Lidhur me dhënien e pëlqimit paraprak për zbatim të masave, mbikëqyrjes dhe kontrollit të vazhdueshëm në zbatimin e masave, GJEDNj vlerëson se rregullat sipas fuqisë së ligjit duhet t'i përcaktojnë rrethanat në të cilat lejohet mbikëqyrja e imponuar (*Kruslin kundër Francës*) dhe duhet të përmbajnë mbrojtje përkatëse dhe efikase nga keqpërdorimi. Kjo do të mundësojë që mbikëqyrja detyruese të mos imponohet rastësisht dhe pa kujdesin adekuat (*Klas kundër Gjermanisë*).

Rregullat duhet ta përcaktojnë vëllimin dhe mënyrën e mbikëqyrjes në praktikë (*Kop kundër Zvicrës*), e po ashtu duhet të ekzistojnë edhe metoda përkatëse përgjegjësie për autorizimin e zbatimit të mbikëqyrjes dhe kontrollin e tij. Mbikëqyrja nuk duhet t'i besohet gjykatës (*Klas kundër Gjermanisë*), edhe pse preferohet, madje është me rëndësi (*Kop kundër Zvicrës*), por duhet t'i besohet ndonjë organi të aftë dhe të pavarur që mund të praktikojë kontroll në vazhdimësi.

Një nga format demokratike të mbikëqyrjes dhe kontrollit publik është edhe informimi i personit përkatës, në raste kur masat kanë qenë të suspenduara. Kjo e drejtë e individit mund të burojë nga parimi i kushtetutës gjermane për të drejtën e individit për vetëpërcaktim informativ. Në kontekst të kësaj, GJEDNj vlerëson se në momentin që do të ndërpritet mbikëqyrja "ndoshta

do të duhet të informohet subjekti i mbikëqyrjes, edhe pse nuk ekziston rregull se zbulimi i tillë është domosdoshmërisht i nevojshëm” (*Klas kundër Gjermanisë*).

GjEDNj-ja nuk pretendon t'i krijojë obligim shtetit që çdoherë t'i informojë qytetarët për zbatimin e masave. Në rastet kur provat e mbledhura me zbatimin e këtyre masave përdoren si prova në procedim penal kundër personave të caktuar, sigurisht që këta persona do të jenë të informuar. Mirëpo, në rastet kur masat janë suspenduar, gjykata konsideron se pasi që të ndërpritet mbikëqyrja, ndoshta është e nevojshme të lajmërohet subjekti i mbikëqyrjes, “por kjo nuk kërkohet kur informimi i tillë nuk është praktik ose do ta kishte rrënuar efikasitetin e operacionit” (*Klas kundër Gjermanisë*).

## 5. Raste të mbikëqyrjes së fshehtë

Lidhur me parimin e ligjshmërisë, në rastin *Kan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNj ka hedhur poshtë ankesën e parashtruesit se vendimi i gjykatës vendore që bazohet në provë të siguruar në mënyrë joligjore, paraqet shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, me arsyetimin se pranimi i provës së siguruar në mënyrë joligjore nga gjykata vendore është bërë për shkak të natyrës së joligjshmërisë. Në fakt, GjEDNj ka marrë parasysh se incizimi i kontestuar është bërë në bazë të udhëzimeve qeveritare, respektivisht direktivave shtetërore, dhe arsyeja e vetme e shkeljes së nenit 8 të KEDNj-së është se ato nuk janë paraparë me ligj. Mirëpo, GjEDNj po ashtu nuk konteston faktin që deklaratat inkriminuese në këtë incizim janë dhënë vullnetarisht dhe pa nxitje, e se incizimi është provë e fuqishme dhe e vlefshme. Parashtruesi i ankesës ka pasur mundësinë ta kontestojë vërtetësinë e këtij incizimi, si dhe të drejtën që ky incizim të pranohet si provë para gjykatës vendore. Prandaj, gjykata ka vendosur se gjykimi dhe vendimi gjyqësor i gjykatës vendore, parë në tërësi, nuk paraqet shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane, edhe pse paraqet shkelje të nenit 8 të KEDNj-së.

Edhe pse në shikim të parë kjo duket kontradiktore, prapëseprapë GjEDNj si dhe praktika gjyqësore në Angli, mban qëndrimin se mes parimit të ligjshmërisë, kur shkelja është e natyrës teknike, dhe parimeve të drejtësisë dhe së vërtetës, ajo anon nga drejtësia dhe e vërteta. Me fjalë të tjera, procedura nuk do të konsiderohet e padrejtë vetëm me pranimin e provës së siguruar në mënyrë joligjore si të tillë, por në këtë rast duhet të vlerësohen rrethanat: a është prova valide, a është dhënë prova vullnetarisht, a ka pasur i akuzuari mundësinë ta kontestojë dorëzimin e saj në procedim dhe para së gjithash, e çfarë natyre është shkelja e ligjshmërisë gjatë sigurimit të provës kontestuese, gjegjësisht a është shkelja e natyrës teknike apo bëhet fjalë për keqpërdorim të autorizimeve të organeve për ndjekje penale.

Në rastin *Alen kundër Mbretërisë së Bashkuar* ankimesi ka qenë i dyshuar për pjesëmarrje në vrasje, është arrestuar dhe konform ligjit i është treguar mundësia e së drejtës për mbrojtje në heshtje, të cilën më vonë i akuzuari edhe e ka shfrytëzuar. Policia disa herë pa sukses është përpjekur ta marrë në pyetje, në prani të avokatit mbrojtës. Duke mos pasur prova të mjaftueshme, policia ka kërkuar përgjim të qelisë së tij, si dhe të hapësirës së paraparë për vizita, duke i arsyetuar këto metoda me faktin se të gjitha metodat tjera hetimore nuk janë treguar të suksesshme. Përveç kësaj, policia ka organizuar që në qelinë e njëjtë të vendoset edhe një informator policie, i cili është dashur ta nxisë të dyshuarin të flasë për rastin. Ngjashëm si edhe me rastet tjera kundër

Mbretërisë së Bashkuar, GjEDNj ka konstatuar se është shkelur e drejta e privatësisë nga neni 8 i KEDNj-së, sepse incizimi audio dhe video është bërë pa ekzistimin e kornizës precize ligjore.

Edhe përkundër kësaj, dilemat juridike që i ka shqyrtuar gjykata, kanë qenë ngushtë të lidhura me dilemën se a paraqesin incizimet kontestuese të përdorura si provë në procedimin penal, shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, gjegjësisht të së drejtës për gjykim të drejtë. Gjykata ka cilësuar që vendimi për këtë çështje do të varet nga më shumë rrethana të këtij rasti, e sidomos nga ajo se për çfarë lloj joligjshmërie bëhet fjalë. Njëjtë si edhe me rastin *Kan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, gjykata vlerëson se procedura gjyqësore nuk do të konsiderohet e padrejtë vetëm për arsye se është pranuar prova e siguruar në mënyrë joligjore si e tillë, por kërkon të përcaktohen edhe rrethana të tjera që kanë të bëjnë me atë se a është prova valide, a është dhënë ajo vullnetarisht, a ka pasur mundësi i akuzuari ta kontestojë paraqitjen e kësaj prove në procedim dhe mbi të gjitha, cila është natyra e shkeljes ligjore gjatë sigurimit të provës kontestuese.

Gjykata ka konstatuar se ka problem flagrant në përdorimin e informatorit si dëshmitar, dhe këtë e ka shqyrtuar nga aspekti i së drejtës për mbrojtje në heshtje dhe privilegjit për vetakuzim. Edhe pse këto të drejta nuk përmenden në mënyrë eksplicite në KEDNj, gjykata i merr si të vlefshme nga koncepti i gjykimit korrekt si garanci të rëndësishme implicite. Sipas GjEDN-së, qëllimi i këtyre parimeve është të mbrohet liria e të akuzuarve që vetë të vendosin a do të flasin ose do të heshtin gjatë marrjes në pyetje nga ana e policisë apo organeve tjera me autorizime të posaçme. Në rastin konkret, liria e këtillë në thelb është kontestuar me vetë faktin që autoritetet kanë shfrytëzuar mjete kurdisjeje me qëllim që të nxjerrin pranim fajësie, edhe pse i akuzuari ka refuzuar fuqishëm që t'u përgjigjet çfarëdo lloj pyetjeve. Deklaratat që ka dhënë i akuzuari nuk kanë qenë spontane, por në njëfarë mënyre haptazi të nxjerra nga pyetjet insistuese të dëshmitarit (informatorit). Sipas GjEDNj-së, ka pasur ngjashmëri të madhe me marrjen në pyetje nga ana e policisë, por në këtë rast pa kurrfarë garancish që zakonisht i takojnë gjatë intervistimit formal policor. Në këtë kontekst, i akuzuari sigurisht që nuk i ka marrë këto garanci të domosdoshme, si për shembull prani të avokatit mbrojtës, udhëzime për të drejtat që i takojnë e tjera. Prandaj, gjykata ka konkluduar se provat e siguruara në këtë mënyrë, në thelb nuk janë dhënë vullnetarisht dhe se me këtë është shkelur e drejta e të akuzuarit të mbrohet në heshtje dhe e drejta e privilegjit për vetakuzim.

Lidhur me cilësinë e ligjit, në *Doerga kundër Holandës*, GjEDNj konstaton se përgjimi është kryer në bazë të disa rregullave jo aq të qarta dhe precize, në kuptim të rrethanave se si janë ndjekur, incizuar dhe ruajtur bisedat telefonike nga autoritetet kompetente në qendrat ndëshkuese-korrektuese, duke nënvizuar se ligji duhet ta qartësojë kompetencën e organit që i shqipton masat invazive, ta precizojë kohëzgjatjen e tyre dhe mënyrën e zbatimit, me qëllim që të sigurojë mbrojtje të personave të prekur nga veprimet arbitrare. Një ligj cilësor parasheh edhe sigurimin e kushteve adekuate për ruajtje të materialeve të komunikimeve të ndjekura, si dhe përkufizim të situatave kur komunikimet e incizuara mundën ose duhet të shlyhen ose shkatërrohen, si dhe mënyrën dhe procedurën për shlyerjen apo shkatërrimin e tyre. Në rastin e njëjtë, GjEDNj nuk është pajtuar me interpretimin e Gjykatës Supreme të Holandës se obligimi i përcaktuar për shlyerje të bisedave të të burgosurve, që autoritetet e qendrës ndëshkuese-korrektuese kanë incizuar, duhet të bëhet “menjëherë pasi që t'i ketë dëgjuar shefi i shërbimit për sigurim i qendrës”. Sipas GjEDNj, ato biseda duhet të shlyhen “menjëherë sapo përfundon rreziku që buron nga bisedat e



incizuara”. Po ashtu, lidhur me ruajtjen adekuate të materialit të incizuar, në rastin *Kraksi kundër Italisë*, GjEDNj ka konstatuar se autoritetet nuk kanë ndërmarrë masat adekuate për ruajtjen e sigurt të tyre, pasi që materialet e bisedave të incizuara janë deponuar në regjistër, gjegjësisht në arkiv, sepse pjesë të bisedave të incizuara (një pjesë e të cilave kanë qenë ekskluzivisht të karakterit privat) janë publikuar në medime.

Mendimi i GjEDN-së në rastin *Dragojeviq kundër Kroacisë* ka të bëjë me parimin e subsidiarititetit. Në këtë rast ankimesi ka qenë i dyshuar për përfshirje në tregti me drogë dhe me kërkesë të prokurorisë, gjykatësi hetues ka miratuar përdorimin e masave për mbikëqyrje sekrete për ndjekje të fshehtë të telefonit të personit. Në vitin 2009 i akuzuari është shpallur fajtor për tregti me drogë dhe pastrim parash, dhe është dënuar me 9 vite burg. Në vitin 2010 Gjykata Supreme ka vërtetuar dënimin e tij, e në vitin 2011 ankesa e tij kushtetuese është hedhur poshtë.

Pas shqyrtimit të ankesës, GjEDNj ka konstatuar se përgjimi i telefonit të ankimesit paraqet ndërhyrje në të drejtën e tij të respektimit të jetës dhe korrespondencës së tij private. Konform së drejtës nacionale, paraprakisht është dhënë pëlqim për përdorim të mbikëqyrjes sekrete. Mirëpo, në rastin e ankimesit, urdhrat e dhëna nga gjykatësi hetues kanë qenë të bazuara vetëm në deklaratë nga kërkesa e prokurorisë dhe në insistimin se “hetimi nuk ka mundur të kryhet në mënyrë tjetër”, pa përmbajtur informata a kanë pasur në dispozicion mjete më pak intruzive. Qasja e këtyllë është vërtetuar nga Gjykata Supreme dhe Gjykata Kushtetuese. Në një fushë kaq të ndjeshme, siç është përdorimi i mbikëqyrjes sekrete, gjykata e ka pasur të vështirë të pranojë një interpretim të tillë të së drejtës nacionale, që ka paraparë hetim paraprak të detajuar gjyqësor për shkallën e përdorimit të masave për mbikëqyrje sekrete. Anashkalimi i kësaj kërkesë nga ana e gjykatave vendore me arsyetim retroaktiv, ka dhënë hapësirën e duhur për arbitraritet dhe nuk ka mundur të sigurojë mbrojtje adekuate e të mjaftueshme nga keqpërdorimi potencial.

Në rastin e ankimesit, gjykatat penale kanë kufizuar vlerësimin e tyre për përdorimin e mbikëqyrjes sekrete aq sa ka qenë e duhur për të lejuar provën që është siguruar në atë mënyrë, pa prekur në thelbin e kërkesave të Konventës lidhur me vlerësimet për ndërhyrje arbitrare në të drejtat e ankimesit, në bazë të nenit 8 të KEDNj-së. Shteti nuk ka ofruar kurrfarë informatash lidhur me mjetet juridike që mund t'i ketë në dispozicion një person që është në pozitën e ankimesit. Prandaj, e drejta nacionale autoritare kompetente, ashtu siç e kanë interpretuar dhe zbatuar gjykatat vendore, nuk ka qenë mjaftueshëm e qartë sa i përket spektrit të shtrirjes dhe mënyrës së zbatimit të drejtës diskrete të dhënë autoriteteve publike, e as që ka mundësuar masa adekuate mbrojtëse nga keqpërdorimi eventual. Rrjedhimisht, procedura për dhënie të urdhërësive dhe mbikëqyrjes së zbatimit të masave për ndjekje të telefonit të ankimesit nuk ka qenë konform kërkesave për ligjshmëri, e as që ka kufizuar në mënyrë adekuate ndërhyrjen në të drejtën e ankimesit për respektim të jetës dhe korrespondencës së tij private të asaj që llogaritet “e domosdoshme në një shoqëri demokratike”. GjEDNj-ja (njëzëri) ka konstatuar se ka shkelje të nenit 8 të KEDNj-së, që ka të bëjë me mosrespektimin e parimit të subsidiarititetit gjatë përcaktimit të masave intruzive, por nuk ka vërtetuar shkelje të nenit 6, paragrafit 1 të KEDNj-së për kinse mungesën e paanshmërisë të Këshillit Gjyqësor dhe përdorimit të provës së siguruar me mbikëqyrje sekret.

Në rastin *kundër Zheljko Sabo*, prefekt i Vukovarit, Gjykata Supreme e Kroacisë ka pranuar provë të siguruar më incizim sekret, por pa urdhëresë nga gjykata. Edhe pse është vlerësuar që

incizimi është i paligjshëm, prapëseprapë është përdorur si provë ligjore në procedimin penal, për shkak të mbizotërimit të vlerës së interesit publik kundrejt shkeljes së të drejtave personale të të akuzuarit, të garantuara me kushtetutë. Gjykata Supreme e Kroacisë u thirr në dispozitën e nenit 10, paragrafit 3 të LPP-së të Kroacisë, si bazë ligjore mbi të cilën mbështeti vendimin e saj, e cila dispozitë përkufizon raportin e interesit publik dhe të drejtës së privatësisë së individit.

Përndryshe, në këtë rast bëhet fjalë për procedurë gjyqësore kundër prefektit, i cili është incizuar fshehtas duke i ofruar ryshfet zonjës Marija Budimir, këshilltare në këshillin komunal dhe anëtare e partisë politike BDK (HDZ), që ajo të kalojë na radhët e grupit të këshilltarëve të parvarur dhe të jetë në përkrahje të tij, me çka do të formohej shumicë e re në Këshillin e Qytetit. Sabo u dënua me 16 muaj burg dhe atë vendim të Gjykatës Supreme e vërtetoi edhe Gjykata Kushtetuese, pas ankesës së të dënuarit.

Në rastin *Roman Zakarov kundër Rusisë*, ku ankimesi i referohet të drejtës vendore dhe akuzon tre operatorë të telefonisë mobile se kanë instaluar pajisje të cilat shërbimit për siguri nacionale i mundëson t'i dëgjojë të gjitha komunikimet pa urdhëresë gjyqësore, GjEDNJ konstatoi se rregullat juridike vendore nuk kanë dhënë garanci adekuate kundër arbitraritetit. GjEDNJ cilësoi se duke marrë parasysh faktin që zbatimi i masave për ndjekje sekrete të komunikimeve në praktikë nuk është i hapur për shqyrtim për individë të prekur ose për publikun në përgjithësi, do të ishte e kundërligjshme nëse pushtetit ekzekutiv ose gjykatësit i jepet e drejta diskrete ta bëjë atë. Për atë shkak, ligji duhet ta përcaktojë vëllimin e secilës së drejtë diskrete që kanë autoritetet kompetente dhe mënyrën se si e ushtrojnë atë, me qartësi të mjaftueshme dhe me qëllim që individit t'i mundësohet mbrojtje adekuate nga ndërhyrjet arbitrare në jetën private të tij.

Në rastin *Ramanauskas kundër Lituanisë* bëhet fjalë për nxitje për kryerje të veprës penale gjatë zbatimit të masave të posaçme hetimore. Ankimesi ka pohuar se me ndërmjetësim të V.S., një i njohur privat i tij, i është afruar personit A.Z. të cilin ai nuk e ka njohur. Në këtë rast gjykata ka cilësuar se veprimet e personave kanë pasur ndikim në nxitjen e ankimesit që ta kryejë veprën penale për të cilën është dënuar dhe se nuk ka indikacione se vepra penale do të ishte kryer pa ndërhyrjen nga ata persona.

Për dallim nga ky rast, në rastin *Shenon kundër Mbretërisë së Bashkuar* bëhet fjalë për pranim të provave që janë siguruar me “ndreqje”, gjegjësisht me inskenim të një kurthi nga ana e një gazetari. GjEDNJ ka vlerësuar se roli i shtetit ka qenë i kufizuar lidhur me akuzën ndaj ankimesit, e cila është bazuar në informatat e parashtruara nga një person i tretë. Aplikuesi ka qenë i vënë “në kurth” nga një gazetar, person privat, i cili nuk ka qenë agjent i shtetit dhe nuk ka vepruar në emër të policisë, e as në bazë të instruksioneve apo udhëzimeve të policisë, madje nuk ka qenë nën kontrollin e saj në asnjë mënyrë tjetër. Policia nuk ka pasur kurrfarë informatash paraprake për operacionin e personit M, por pasi që ka ndodhur ngjarja, policisë i janë dorëzuar audio-regjistrime dhe video-incizime. GjEDNJ thekson se në rastin e parë rrethanat në të cilat janë siguruar provat, janë marrë në shqyrtim nga gjykatësi i shkallës së parë, me theks të posaçëm në kontekst të zbatimit tyre, duke i përjashtuar ato sepse janë siguruar me vendosje kurthi. Në fund, GjEDNJ konkludon se pranimi i provave të kontestuara nuk ka rezultuar me shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

# PJESA 2

---

MASA TË POSAÇME HETIMORE NË PROCEDURËN PENALE





## 1. Hyrje

Baza juridike për zbatim të masave të posaçme hetimore është paraparë me Amendamentin XIX të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të miratuar në vitin 2003, me të cilin u zëvendësua neni 17 i deriatëhershëm i Kushtetutës.

Garantohet liria dhe pacenueshmëria e letrave dhe e të gjitha formave të tjera të komunikimit. Vetëm në bazë të vendimit të gjykatës, në kushte dhe në procedurë të përcaktuar me ligj, mund të bëhet përjashtim nga e drejta e pacenueshmërisë së letrave dhe të gjitha formave të tjera të komunikimit, nëse kjo është e domosdoshme me qëllim të parandalimit ose zbulimit të veprave penale, me qëllim të zhvillimit të procedurës penale ose kur këtë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës.

Ngjashëm me nenin 8 të KEDNj-së, në paragrafin e parë të amendamentit është përcaktuar spektri i privatësisë që mbrohet (liria dhe paprekshmëria), si dhe sferat e mbrojtjes (letrat dhe të gjitha format tjera të komunikimit) të privatësisë së individit. Për dallim nga neni 8 i KEDNj-së, sfera e mbrojtjes së privatësisë është më e ngushtë dhe ka të bëjë me letrat dhe format tjera të komunikimit, e jo edhe me jetën private dhe familjare të individit. Kjo zbrazëti juridike në kornizën juridike kushtetuese plotësohet me zbatim të drejtpërdrejtë të dispozitave të KEDNj-së (neni 8), me ratifikimin e së cilës ajo paraqet burim direkt të së drejtës në legjislacionin vendor.

Në paragrafin e dytë theksohen katër parimet themelore që përcaktojnë zbatimin e masave invazive dhe bazat legjitime për zbatimin e këtyre masave. Kështu, parimi i miratimit gjyqësor të masave (“vetëm në bazë të vendimit të gjykatës”) dhe parimi i ligjshmërisë (“nën kushte në procedurë të paraparë me ligj”) ceken në mënyrë eksplicite, ndërsa parimi i subsidiaritetit dhe proporcionalitetit, ashtu si edhe në nenin 8 të KEDNj-së, nënkuptohen me përkufizimin terminologjik të termit të përdorur *domosdoshmërisht* (“nëse kjo është e domosdoshme”).

Sa u përket qëllimeve, Kushtetuta parasheh dy segmente interesash, si baza legjitime për zbatimin e masave invazive:

- segmenti i parë përfshin zbatimin e masave invazive për qëllime penale (“me qëllim të zhvillimit të procedurës penale”); dhe
- segmenti i dytë ka të bëjë me zbatimin e masave invazive për mbrojtje të interesave kombëtare (“kur këtë e kërkon interesi i sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës”).

Mbi këtë bazë, në vitin 2004 u miratua Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Procedurë Penale, me të cilin u promovuan tetë masa të posaçme hetimore. Në nëntor të vitit 2010 u miratua Ligji i ri për Procedurë Penale, me të cilin parashihen dymbëdhjetë masa të posaçme hetimore. Procedura për ndjekje dhe incizim të komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike, si një nga masat e posaçme hetimore, u përkufizua me Ligjin për Ndjekje të Komunikimeve (LNK) të vitit 2006, i cili në dy raste, në vitin 2008 dhe 2012, u ndryshua dhe u plotësua dukshëm. Ligji i ri për Ndjekje të Komunikimeve (tani më në fuqi) u miratua në vitin 2018, ndërsa disa aspekte teknike

dhe operative të ndjekjes së komunikimeve janë të rregulluara me Ligjin për Agjencinë Teknike-Operative (ATO) dhe Ligjin për Komunikime Elektronike (LKE). Korniza normative u rrumbullakësua me ligjet që përcaktojnë kompetencat e organeve që janë të autorizuara për ndjekje të komunikimeve, si për shembull: Ligji për Punë të Brendshme, Ligji për Polici, Ligji për Mbrojtje, Ligji për Prokurori Publike dhe Ligji për Doganë.

### **1.1. Lloje të masave të posaçme hetimore në legjislacionin nacional**

Llojet e masave të posaçme hetimore janë paraparë në nenin 252 të LPP-së, siç vijon:

#### **1. Ndjekje dhe incizim i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike në procedurën e përcaktuar me ligj të posaçëm (LNK)**

Kjo masë ka të bëjë me komunikimet telefonike, si dhe me të gjitha llojet tjera elektronike midis njerëzve, që paraqesin pjesë të pandashme të termit *jetë private*, të përkufizuar sipas të kuptuarit juridik të GjEDNJ-së. Me këtë masë nuk përfshihen: komunikimet e drejtpërdrejta (komunikime verbale ose të ashtuquajtura përgjime ambientale) letrat dhe dërgesat e postës si formë jodirekte e komunikimit.

Këtë masë mund ta përcaktojë gjykatësi përgjegjës, me urdhëresë të posaçme me shkrim, pas propozimit paraprak nga prokurori publik, ku duhet të cekën arsyet për domosdoshmërinë e zbatimit të kësaj mase. Për zbatimin e kësaj mase (si dhe për gjitha të tjerat) ligjvënësi kërkon plotësimin kumulativ të dy kushteve të përgjithshme: probabiliteti se me zbatimin e saj do të sigurohen të dhëna dhe prova për zhvillim të suksesshëm të procedurës penale, si dhe kushti që provat dhe të dhënat mos sigurohen në ndonjë mënyrë tjetër.

#### **2. Ndjekje dhe incizim i shtëpisë, hapësirës së mbyllur ose të rrethuar, që i përket asaj shtëpie ose hapësirë afariste e shënuar si private apo në automjet, dhe hyrje në ato hapësira për krijim të kushteve për ndjekje të komunikimeve**

Me këtë masë përfshihen vetëm komunikimet e drejtpërdrejta (përgjimi i hapësirës ku ndodh komunikimi, respektivisht përgjim ambiental), të cilat zhvillohen në shtëpinë e individit, gjegjësisht hapësirën e shënuar si private. *Ekziston kufizim eksplicit (neni 268 i LPP-së) se kjo masë mund të zbatohet vetëm në hapësira dhe automjete që i përkasin personit të dyshuar për vepër të caktuar penale.* Ka përjashtim kur subjekt i masës mund të jetë vetëm shtëpia e personave të tjerë, por që të lejohet zbatimi i masës në rast të këtyre, duhet të ekzistojë dyshim i bazuar se i dyshuari qëndron në atë shtëpi. Në të kundërtën, gjykatësi nuk ka bazë të lejojë që kjo masë të zbatohet në shtëpinë e një personi që nuk është i dyshuar për përfshirje në aktivitete inkriminuese.

Me incizim mendohet të kuptuarit e termeve të nenit 21 të LPP-së, nënkupton incizim vizual-tonik apo vetëm incizim vizual ose vetëm regjistrim tonik, varësisht nga vlerësimi i nevojës dhe mundësive në raste konkrete. Duke marrë parasysh se në shtëpinë e të dyshuarit qëndrojnë edhe anëtarë tjerë të familjes, incizimi duhet patjetër të ndërpritet, në qoftë se rastisin në përmbajtje ose veprime që janë të sferës së jetës intime private dhe familjare, dhe që nuk kanë kurrfarë lidhshmërie me qëllimin për të cilën është përcaktuar masa.

#### **3. Observim i fshehtë dhe incizim i personave dhe lëndëve me pajisje teknike jashtë shtëpisë ose hapësirës afariste të shënuar si private**

Qëllimi i kësaj mase nuk është vetëm regjistrim i ndodhive të jashtme në objektin e observimit (siç nënkuptohet në të shumtën e rasteve në praktikën e gjykatës dhe prokurorisë sonë) dhe si-

gurim i njohurive për lëvizjet e të dyshuarit, kontaktet me persona të caktuar, prezencë në vende të caktuara, lidhshmërinë që ka me gjësende të caktuara dhe ngjashëm, por edhe sigurim i njohurive për përmbajtjen e komunikimit të të dyshuarit. Kjo masë ka të bëjë me komunikimet e drejtpërdrejta verbale, të realizuara në vend publik, por jo me komunikimet telefonike dhe komunikimet tjera elektronike që janë të përfshira me masën nga pika 1. Masa mund të shoqërohet edhe me ndjekje fizike të të dyshuarit, por thuhet pa përjashtim në të njëjtën kohë përdoren pajisje teknike për incizim dhe regjistrim të të gjitha veprimeve, aktiviteteve, kontakteve dhe ndodhjeve të dyshimta, që mund të jenë në dobi të verifikimit dhe vërtetimit të fakteve relevante juridike - bashkëveprues, ndihmës, mbulues, gjësende me të cilat është kryer vepra penale e ngjashëm. Me ndihmën e kësaj mase, i dyshuari mund të kapet gjatë kryerjes së veprës penale (*in flagranti*). Incizimi mund të jetë vizual ose vizual dhe tonik.

#### **4. Inspektimi i fshehtë dhe kërkimi në sistemin kompjuterik**

Kjo masë paraqet ndjekje elektronike, por me ndihmën e “veglave” bashkëkohore informatike, ajo shumë lehtë mund të kalojë në mbikëqyrje të plotë mbi përmbajtjen e komunikimeve. Ajo është pandan i bastisjes në shtëpi, por bëhet pa dijeninë e të dyshuarit dhe ndodh në “hapësirë” më të vogël, por prek një pjesë të madhe të jetës private të individit. Pajisjet dhe programet bashkëkohore informatike paraqesin vegla të jashtëzakonshme për ndërhyrje të fshehtë në “jetën kompjuterike” të individit.

Masa zbatohet me ndihmën e pajisjeve dhe veprimeve të posaçme informatike, që ndërmerren nga sektorë specialë, të ekipuar në organe të autorizuara për zbatim të saj, qëllimi i së cilës është kërkimi i fshehtë brenda të dhënave që përmban sistemi kompjuterik i të dyshuarit. Kjo masë njihet edhe si kërkim *online*, për shkak se njohuritë sigurohen dhe provat mbledhen në distancë, përmes internetit, me ndihmën e përdorimit të programeve të posaçme forenzike kompjuterike, të cilat instalohen në kompjuterin që është objekt përpunimi dhe në atë mënyrë mundësojnë shikim dhe kërkim, pa u vërejtur kjo nga përdoruesi i kompjuterit. Masa mund të përdoret një herë ose në afat më të gjatë, varësisht nga qëllimet e përcaktuara. Duke marrë parasysh shkallën e ndërhyrjes në privatësinë e personit kompjuteri i të cilit është objekt ndjekjeje, kjo masë e posaçme hetimore mund të miratohet nga gjykatësi i procedurës paraprake me urdhëresë me shkrim, vetëm pas propozimit të argumentuar nga prokurori publik.

#### **5. Kërkimi automatik dhe krahasimi i të dhënave personale**

Kjo masë mbulon të ashtuquajturin raster për kërkim. Në përmbajtje të saj, kjo masë është krahasim kompjuterik i të dhënave personale të qytetarëve që gjenden në bazat e të dhënave personale nëpër institucionet private dhe shtetërore, të cilat evidentojnë të dhëna personale të qytetarëve mbi baza të ndryshme. Masa nuk merret me të dhënat personale tani më të evidentuara me të cilat disponojnë shërbimet e sigurisë.

#### **6. Inspektim në telefonata dhe komunikime të tjera të realizuara elektronike**

Kjo masë paraqet “ndjekje” të përmbajtjeve të komunikimeve paraprakisht të realizuara dhe pandan (njësoj si masa inspektim i fshehtë dhe kërkim në sistemin kompjuterik) i masës hetimore *bastisje shtëpie*, me atë dallim që kjo bëhet pa dijeninë e të dyshuarit, ndodh në një “hapësirë” më të vogël dhe bëhet *post festum*, e jo në kohë reale (*online*). Kjo masë shfrytëzon përparësitë e trafikut elektronik-komunikues, gjegjësisht mundësinë e ruajtjes në formë të gjurmëve elekt-

ronike-logime të të gjitha aktiviteteve (meta të dhëna) të pjesëmarrësve në trafikun elektronik komunikues (sipas LKE, 12 muaj).

Sipas mënyrës së realizimit (përmes internetit dhe me ndihmën e programeve të posaçme forenzike kompjuterike – *remote forensic software*), kjo masë është shumë e përafërt edhe me masën inspektim i fshehtë dhe kërkim në sistemin kompjuterik, por me vëllim shumë më të vogël të përfshirjes së të dhënave personale të të dyshuarit dhe për faktin që kjo masë nuk zbatohet në kohë reale. Në këtë mënyrë mund të bëhet inspektim në të gjitha bisedat telefonike të zhvilluara përmes internetit, si dhe në të gjitha format e komunikimeve elektronike (e-mail; Facebook; chat e të ngjashme).

Me propozim të policisë gjyqësore, këtë masë e përcakton prokurori publik, me urdhëresë me shkrim. Nëse prokurori publik ka nevojë të sigurojë të dhëna vetëm për kontakte të realizuara (pen-regjistra) në trafikun kompjuterik (pa ndërhyrë në përmbajtjen e komunikimit të realizuar), në vend që të shqiptojë urdhër për zbatim të kësaj mase të posaçme hetimore, mund të dorëzojë kërkesë tek operatorët e komunikimeve publike të cilët janë të obliguar t'i përgjigjen kërkesës (neni 287, paragrafi 8 i LPP-së).

### **7. Simulim i blerjes së lëndëve të ndaluara**

Kjo masë paraqet formë veprimi me angazhim të hetuesit të fshehtë. Në kuptim juridik- penal kjo masë paraqet pjesëmarrje fiktive në fazën e realizimit të krimit (vetëm në blerje, e jo edhe në shitje) nga ana e hetuesit të fshehtë, në rolin e bashkëvepruesit të veprës penale. Qëllimi i kësaj mase është që përmes simulimit të blerjes së lëndëve të ndaluara, të zbulohen dhe vërtetohen veprat penale, sidomos nga fushat e tregtisë së palejueshme. Kjo masë mundëson të sigurohen njohuri dhe prova për personat e kyçur në prodhimtarinë e palejueshme, qarkullim dhe tregti të lëndëve, për ata që ndihmojnë dhe fshehin, për mënyrën e kryerjes së veprave penale etj. Masën e përcakton prokurori publik, me urdhëresë me shkrim.

### **8. Simulim i dhënies dhe marrjes mitë**

Si edhe masa paraprake, kjo masë paraqet formë veprimi me angazhim të hetuesit të fshehtë. Në kontekstin juridiko-penal, kjo masë paraqet pjesëmarrje fiktive në fazën e realizimit të krimit nga ana e hetuesit të fshehtë, në rolin e bashkëvepruesit të veprës penale. Qëllimi i saj juridik-penal është që të ndihmojë në zbulimin dhe vërtetimin e veprave penale korruptive. Te kjo masë, element veçanërisht i ndjeshëm në aspekt juridiko-penal është “konstatimi” i qëllimit të formuar kriminal tek i dyshuari, para aktivizimit të masës. Masën e përcakton prokurori publik, me urdhëresë me shkrim.

### **9. Dërgesë e kontrolluar dhe transport i personave dhe gjësendeve**

Kjo masë paraqet operacion sekret, por në raste të caktuara edhe konglomerat të masës *observim i fshehtë* dhe masës *hetues i fshehtë* (nëse në transport merr pjesë “njeri i infiltruar”). Në kuptim juridiko-penal kjo paraqet pjesëmarrje fiktive në fazën e realizimit të krimit nga ana e hetuesit të fshehtë, në rolin e bashkëvepruesit ose ndihmësit në vepër penale. Masën e përcakton prokurori publik, me urdhëresë me shkrim.

### **10. Shfrytëzimi i personave me identitet të fshehtë për ndjekje dhe mbledhje të informatave dhe të dhënave**

Kjo masë paraqet një nga format e veprimit të masës *angazhim (ose zbatim) i hetuesit të fshehtë*. Kjo masë i përfshin të gjitha format e pjesëmarrjes fiktive të hetuesit të fshehtë në cilëndo



fazë të veprës penale, por me pjesëmarrje të kufizuar vetëm në dhënien ndihmë të aktiviteteve kriminale, për qëllime të sigurimit të informatave dhe të dhënave. Masën e përcakton prokurori publik, me urdhëresë me shkrim.

Hetuesi i fshehtë nuk guxon të marrë pjesë në procesin e krijimit të qëllimit kriminal të autorit të veprës penale, por në instancë të fundit vetëm t'i japë drejtim qëllimit kriminal tani më të formuar, në të kundërtën veprimet e tilla të hetuesit të fshehtë paraqesin veprim nga pozicionet e agjentit provokator, të ndaluar me ligj. Këta persona kanë regjim të posaçëm pjesëmarrjeje në procedurën penale, sepse merren në pyetje si dëshmitarë të mbrojtur. Identiteti i personave me identitet të fshehtë mbetet në fshehtësi (neni 270 i LPP-së), gjegjësisht identiteti i tyre paraqet sekret zyrtar (paragrafi 4 nga neni 259 i LPP-së). Masën e miraton prokurori publik, me urdhëresë me shkrim.

### **11. Simulim i hapjes së llogarisë bankare**

Si edhe masa paraprake, kjo masë paraqet një nga format e veprimit të zbatimit të masës *angazhim i hetuesit të fshehtë*. Nga aspekti juridiko-penal, kjo masë mund t'i përfshijë format e pjesëmarrjes fiktive të hetuesit të fshehtë në të gjitha fazat e veprës penale (faza përgatitore, realizimi kriminal dhe faza post-kriminale). Qëllimi i masës është të ndihmojë në zbulimin dhe vërtetimin e veprave penale që kanë të bëjnë me aktivitete dhe vepra korruptive që përdorin transaksione kundërligjore parash me qëllim vënie para në qarkullim, apo me gjësende të lëvizshme ose patundshmëri të përfituara me kryerje të veprave penale, respektivisht që burojnë nga veprimet inkriminuese. Masa përcaktohet nga prokurori publik, me urdhëresë me shkrim.

### **12. Simulim i regjistrimit të subjektit juridik ose përdorim i subjekteve juridike ekzistuese për mbledhje të të dhënave dhe provave**

Masa paraqet një nga format e veprimit të zbatimit të masës *angazhim i hetuesit të fshehtë*. Nga aspekti juridiko-penal kjo masë mund t'i përfshijë të gjitha format e pjesëmarrjes fiktive të hetuesit të fshehtë në të gjitha fazat e veprës penale, por me pjesëmarrje të kufizuar (pasive dhe me vrojtim) në aktivitetet kriminale (lejohet vetëm dhënie ndihmë), me qëllim të mbledhjes së provave dhe të dhënave. Sipas përmbajtjes, kjo është masë me të cilën ofrohen shërbime apo veprime të simuluar afariste që i ndërmarrin hetuesit e fshehtë ose persona tjerë të besueshëm. Masa përcaktohet nga prokurori publik, me urdhëresë me shkrim.

## **2. Vepra penale për të cilat mund të përcaktohen masa të posaçme hetimore**

Për shkak se masat e posaçme hetimore i shohim si masa të arsyeshme vetëm për t'u ballafaquar me format më të rënda të veprave penale, si një lloj "e keqe më e vogël", është e kuptueshme qasja restriktive e ligjvënësit që, në mënyrë precize parasheh për cilat vepra penale mund të përdoren ato dhe në çfarë rrethanash. Kjo bëhet kur ekzistojnë baza dyshimi, konform nenit 253 të LPP-së, siç vijon:

1) për vepra penale për të cilat parashihet dënim me së paku 4 vjet burg, e të cilat përgatiten, janë në realizim e sipër ose janë të kryera nga grup i organizuar, bandë ose bashkim tjetër kriminal ose

2) për vepra penale: vrasje sipas nenit 123, grabitje sipas nenit 141; ndërmjetësim në prostitucion sipas nenit 191, paragrafët 1, 3 dhe 4; shfaqje e materialeve pornografike një

të mituri sipas nenit 193; prodhim dhe distribuim i pornografisë së të miturve sipas nenit 193; përdhunim ose veprim tjetër seksual ndaj një të mituri që nuk ka mbushur 14 vjet sipas nenit 193-b; prodhim dhe lëshim i paautorizuar në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve sipas nenit 215, paragrafët 1 dhe 3; dëmtim dhe hyrje e paautorizuar në sistem kompjuterik sipas nenit 251, paragrafët 4 dhe 6; reket sipas nenit 258; shantazh sipas nenit 259, paragrafi 2; uzurpim i të mirave nën mbrojtje të përkohshme apo trashëgimisë kulturore ose i rariteteve natyrore sipas nenit 265; zhvendosje, gjegjësisht eksport jashtë shtetit i të mirave nën mbrojtje të përkohshme apo trashëgimisë kulturore ose i rariteteve natyrore sipas Nenit 266 paragrafi 1; përvetësim i trashëgimisë kulturore me rëndësi të posaçme në pronësi shtetërore sipas nenit 266-a; pastrim parash dhe të ardhura tjera nga veprime të dënueshme sipas nenit 273, paragrafët 1, 2 dhe 3 dhe paragrafët 5, 6, 8 dhe 12; kontrabandë sipas nenit 278, paragrafët 3 dhe 5; mashtrim doganor sipas nenit 278; shpërdorimit detyrë dhe autorizimeve sipas nenit 353; abuzim në shërbim sipas nenit 354; mashtrim në shërbim sipas nenit 355; marrje nga shërbimi sipas nenit 356; pranim ryshfeti sipas nenit 357, paragrafët 1, 4, 5 dhe 6; dhënie ryshfet sipas nenit 358, paragrafet 1 dhe 4; ndërmjetësim kundërligjor sipas nenit 359, paragrafi 6; ndikim i paligjshëm mbi dëshmitarë sipas nenit 368, paragrafi 3; shoqërim-bashkim kriminal sipas nenit 394, paragrafi 3; organizatë terroriste sipas nenit 394, paragrafët 1, 2 dhe 3; terrorizëm sipas nenit 394 dhe financim terrorizmi sipas nenit 394-c, të gjitha këto nga Kodi Penal ose

3) për vepra penale kundër shtetit (Kapitulli XXVIII) dhe vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare (Kapitulli XXXIV) nga Kodi Penal.

Masat e posaçme hetimore mund të përcaktohen ndaj një personi që ka kryer veprë penale nga të sipërpërmendura në mënyrë taksative, ndaj një personi që ndërmerr veprime për kryerje të ndonjë veprë penale nga të cekurat më lartë, si dhe ndaj një personi që përgatit kryerje të njërës nga këto vepra penale, ku dënohen edhe veprimet përgatitore, konform dispozitave të Kodit Penal.

Këto masa mund të zbatohen edhe ndaj personit që pranon dërgesa nga një i dyshuar apo transporton për të, por edhe kur i dyshuari përdor mjet komunikativ të personit të parë.

## **2.1. Raste nga praktika gjyqësore në vend**

### **Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

#### **Rasti “Kezharovski”**

#### **Kvp.KOK2.Kvp.nr.14/2017 Gjykata Supreme e RMV-së**

Edhe pse nga ana e mbrojtjes është kërkuar që urdhrat për përcaktim të MPH-së të paraqiten si prova dhe t’u mundësohet shikimi në to, gjykata nuk e ka lejuar këtë. Gjykata e shkallës së parë këtë vendim e arsyeton me faktin se urdhrat kanë karakter të sekretit shtetëror, e jo të gjithë personat prezent kanë certifikatë sigurie për qasje në informata të klasifikuara. Nga ana tjetër, këto urdhëresa nuk kanë qenë të propozuara si prova, por

mund të jenë vetëm vlerësim për gjyqin, por jo edhe për palët, sepse të gjithë nuk kanë certifikata përkatëse sigurie.

Sipas mendimit të Gjykatës Supreme të RMV-së, e në pajtim me praktikën e GjEDNj-së, parimi i gjykimit të drejtë nënkupton që secilës palë t'i jepet mundësi e arsyeshme ta paraqesë rastin e vet dhe para gjykatave t'i ketë të gjitha garancitë të cilat parashihen me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Kjo nënkupton që të akuzuarve t'u mundësohet përcaktimi i së drejtës materiale, si dhe t'u sigurohet parimi i barazisë së argumenteve, siç parashihet me LPP dhe KEDNJ.

Konform praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, secilit person të akuzuar duhet t'i mundësohet që për qëllime përgatitjeje, mbrojtja e tij të jetë e njoftuar me rezultatet e hetimit të kryer gjatë procedurës (*Natunen kundër Finlandës*, numri arkivor 21022/04, vendim i datës 31 mars 2009, s.42, *C.G.P. kundër Holandës*, numri arkivor 29835/96, vendim i datës 15 janar 2007 etj.).

Mosparaqitja e provave materiale që përmbajnë detaje të cilat mund të lirojnë të akuzuarin nga përgjegjësia ose që dënimi i tyre të jetë më i vogël, paraqet kufizim të kushteve dhe mundësive të domosdoshme për përgatitje të mbrojtjes, dhe kjo do të thotë shkelje e së drejtës së garantuar në nenin 6, paragrafin 3-b të KEDNJ-së.

Në rastin konkret, duke marrë parasysh edhe praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, gjykata vlerëson se mbrojtjes nuk i është lejuar qasje në urdhëresat e dhëna për MPH dhe paraqitjen e tyre si prova, e duke marrë parasysh se mbrojtja ka kërkuar këtë, ky kufizim është në kundërshtim me parimin për përcaktim të së vërtetës materiale, si dhe parimin për barazi të argumenteve. Në këtë rast ka ekzistuar mundësia të sigurohen këto prova konform Ligjit për Informata të Klasifikuara, që thotë se provat të cilat janë të klasifikuara, me kërkesë mund të deklasifikohen dhe të paraqiten gjatë procedurës, siç edhe në fakt ka ndodhur me dëgjimin e medimeve transmetuese dhe leximin e regjistrimeve të komunikimit, me qëllim të sigurimit të barazisë së palëve, pa u shkelur e drejta për mbrojtje.

## **Vendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

### **Rasti “Kryetari i komunës”**

**1.** Kvp.nr. 97/201. Neni 357, paragrafi 1 lidhur më nenin 22 të KP. Gjkata vlerëson se MPH nuk mund të zbatohen për këtë vepër penale dhe kërkon që regjistrimet të hiqen dhe të mos përdoren si prova.

**2.** Kvp KOK 1 Kvp.nr 3/2013, Gjkata e Shkallës së Parë ka shkelur dispozitat e procedurës penale nga neni 355, paragrafi 1, pika 8 nga LPP, ku si prova ka paraqitur vendime paraprake, për të cilat Gjkata Supreme tani më ka vendosur se janë kundërligjore, sepse janë mbështetur në prova të siguruara me MPH, në kundërshtim me ligjin.

### **Gjkata e Apelit Shkup, RMV KZH. nr.1619/08**

#### **Rasti “Bogorodica”**

Gjkata e Apelit Shkup me datën 03.02.2009, në seancën për shqyrtim të lëndës penale KZH. nr.1619/08 për vepër penale *pranim ryshfeti* sipas nenit 357, paragrafi 1, lidhur me nenin (l.n.) 22

dhe me nenin 45 të KP-së, dhe për vepër penale *dhënie ndihmë autorit* pas kryerjes së veprës penale sipas nenit 365, paragrafi 2 l.n. 45 të KP-së, lidhur me paragrafin 1, l.n. 45 të KP, mori Vendimin KZH.nr.1619/08 që të veçohen provat e siguruara me masa të posaçme hetimore, konform nenit 142-b, paragrafi 1 i LPP nga aktet e lëndës III KOK nr.5/07 dhe pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, provat të mbyllën në regjistër të posaçëm dhe të ruhen ndaras.

Këtë vendim gjykata e mbështet në bazë të konstatimit për shkelje të ligjshmërisë së procedurës, duke siguruar prova përmes zbatimit të masave të posaçme hetimore.

Në rastin konkret, si me urdhër të Gjykatës Pen.nr.25/07 nga data 15.01.2007, ashtu edhe me urdhër të Prokurorit Publik të RMV-së, sektori për ndjekje të autorëve të veprave penale për krim të organizuar dhe korrupsion, nga zbatimi i masave të posaçme hetimore, ngarkohet për vepër penale *pranim ryshfeti* sipas nenit 357, paragrafi 1 të KP-së, për të cilën vepër penale parashihet dënim me burg prej 1 deri në 10 vjet.

Duke marrë parasysh se nuk janë plotësuar rrethanat dhe kushtet ligjore për zbatim të masave të posaçme hetimore sipas nenit 142-b, paragrafi 1 të LPP-së, respektivisht këto masa janë përcaktuar dhe zbatuar lidhur me vepër penale për të cilën nuk është paraparë dënim me burg prej së paku 4 vjet ose vepra është kryer nga grup i organizuar, bandë ose shoqëri kriminele, mund të urdhërohet zbatimi i masave të posaçme hetimore. Këto prova janë siguruar në mënyrë të paligjshme, që është në kundërshtim me dispozitën e cituar ligjore, dhe këto nuk mund të përdoren si prova mbi të cilat do të bazohet vendimi i gjykatës.

## **2.2. Kur vendoset për zbatimin e masave të posaçme hetimore dhe kur fillohet me zbatimin e tyre**

Një nga masat e posaçme hetimore më intruzive, që sipas raporteve vjetore të Prokurorisë Publike zbatohet më së shpeshti, është ndjekja dhe incizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike. Kjo në fakt është zbulim i fshehtë i përmbajtjes së procesit teknik të dërgimit, transmetimit dhe pranimit të çfarëdo lloj bisede, të dhënave, zërave, sinjaleve, tekstit të shkruar, fotografive statike dhe lëvizëse, të cilat shërbejnë për këmbim të informatave midis njerëzve, në mes njerëzve dhe gjësëndeve, mes gjërave, ose për menaxhim me çfarëdo lënde me ndihmë të sistemit telekomunikativ, si dhe protokolleve të internetit, bisedave përmes protokolleve të internetit, faqe interneti dhe postë elektronike, përmes qasjes në pajisje teknike te operatorët me ndërmjetësim të ATO ose zbatimit të njësisive dhe pajisjeve speciale teknike pa ndërmjetësim të ATO dhe operatorëve, dhe njëkohësisht krijimit të regjistrimeve teknike për përmbajtjen e komunikimit, me mundësi riprodhimi.

Para se të vendoset për zbatimin e një mase hetimore të këtillë, por edhe cilëndo masë tjetër të posaçme me të cilën intensivisht ndërhyhet në privatësinë e individit, organet për zbulim të veprave penale paraprakisht duhet të kenë njohuri cilësore operative për personat që duhet të përfshihen në procesin e përpunimit të mëtutjeshëm. Kjo veçanërisht vlen për:

- mënyrën e veprimit të tyre,
- mënyrën, llojin dhe sasinë e komunikimit,
- numrin e personave të involvuar,
- dinamikën e ndërmarrjes së aktiviteteve,
- llojin e aktiviteteve që ndërmerren nga ana e tyre,

- struktura dhe lidhshmëria strukturore e personave,
- grupet.

Në këtë kontekst, para së gjithash mendohet për mundësinë e sigurimit të të dhënave bazë, që do të kenë vlerë përdorimi në procesin e vendimmarrjes se a do fillohet me zbatimin e një mase hetimore të këtillë. E gjithë kjo në mënyrë të qartë na bën të konkludojmë se bëhet fjalë për procedurë parahetimore, gjatë së cilës shumë informata dhe të dhëna, dhe ato analizohen dhe selektohen, me qëllim që të krijohet një kuantum të dhënash, që më tutje ta diktojnë mënyrën e procedimit.

Kjo nuk është e rastësishme, por përkundrazi është e domosdoshme, sepse duhet të ketë lidhshmëri logjike ndërmjet asaj që transmetohet si informatë në komunikim, me veprime konkrete të ndërmarra nga persona të involvuar si rrjedhshmëri natyrore e asaj që flitet dhe kontraktohet. Vetëm në këtë mënyrë mund të fitohet pasqyrë e plotë për ndërmarrje të veprimeve të cilat drejt-përdrejt burojnë nga komunikimi paraprak, e të cilat përmbajnë element kundërligjor. Pikërisht për këtë shkak, që të mund të flitet për domosdoshmëri dhe sukses në zbatimin e kësaj mënyre për mbledhje të të dhënave dhe provave, e që nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër, duhet paraprakisht të sigurohet njëfarë sigurie dhe efikasitet në dokumentim.

**Prokurori publik që drejton këtë procedurë parahetimore duhet të sigurojë qasje dhe terren përkatës logjistik. Kjo do të thotë se policia gjyqësore duhet t'i sigurojë resurset e duhura njerëzore dhe materiale për realizim të kësaj mase hetimore. Kjo duhet të arrihet në marrëveshje me prokurorin publik, i cili duhet të insistojë në ekip kompakt dhe me përvojë, që gjithë kohës do të jetë në koordinim të ndërsjellë me të. Kjo, në raste të caktuara dikton dhe imponon numrin e personave të përfshirë, spektrin e veprimit të tyre në terren, si dhe dinamikën e veprimeve që ndërmerren, me ç'rast duhet t'i kushtohet kujdes sidomos lidhjeve të tyre brenda dhe jashtë shtetit. Për zbatim të suksesshëm të këtyre masave mund të flitet vetëm në kushte kur ka ekipim të mirë nga ana e policisë gjyqësore.**

**Propozimi** për zbatim të MPH-së iniciohet nga person i autorizuar nga policia gjyqësore dhe ai duhet të përmbajë:

- të dhëna të sakta për personat apo lëndët për të cilat propozohet zbatimi i masave të posaçme hetimore,
- përcaktim të identitetit të personit,
- llojin e masës së posaçme hetimore që propozohet, me propozim për kohëzgjatje të zbatimit të saj dhe
- të përmbajë arsye mjaftueshëm sqaruese, duke paraqitur të gjitha njohuritë operative me të cilat disponon policia gjyqësore për personat konkret të përfshirë në propozim, shoqëruar me sqarim të argumentuar për atë se a ka ndërmarrë paraprakisht policia gjyqësore masa dhe aktivitete që të sigurojë në mënyrë tjetër të dhëna dhe prova relevante për inicim të procedurës, rezultatet nga aktivitetet e tyre, respektivisht rreziqet dhe pengesat me të cilat janë ballafaquar gjatë sigurimit të tyre, me qëllim që prokurori publik të jetë vërtetë i bindur se ekziston domosdoshmëri për zbatim të këtyre masave të posaçme hetimore në këtë fazë të procedimit.

Propozimi i kësaj mënyre të grumbullimit të të dhënave dhe dëshmive më shpesh jepet nga ana e policisë gjyqësore, megjithatë ligji i jep mundësi prokurorit publik, i cili e udhëheq procedurën parahetimore, sipas vlerësimit të vet të iniciojë zbatimin e tyre.

### 2.3. Kërkesa nga Prokuroria Publike për ndjekje të komunikimeve

Pas pranimit të propozimit, prokurori publik përgatit **Kërkesë** për zbatim të masës së posaçme hetimore, të cilën duhet ta justifikojë dhe në të cilën saktësisht duhet të radhisë personat, numrat e telefonave, lëndët ndaj të cilave duhet të zbatohen masat e posaçme hetimore të propozuara, bashkangjitur me këtë kërkesë, duhet të dorëzohet edhe propozimi nga organi i autorizuar i policisë gjyqësore.

Me iniciativë personale ose me propozim të personit të autorizuar nga policia gjyqësore prokurori publik përgjegjës përcjell kërkesën me shkrim për zbatim të masës deri te gjykatësi përgjegjës i procedimit paraprak, e cila duhet të përmbajë:

- emërtimin ligjor të veprës penale;
- personin ose lëndët ndaj të cilave do të zbatohet masa e posaçme hetimore;
- mjetet teknike që do të përdoren;
- vëllimin dhe vendin e zbatimit të masës së posaçme hetimore;
- njohuritë dhe provat në bazë të të cilave mbështeten dyshimi dhe sqarim për arsyet pse të dhënat apo provat nuk mund të sigurohen në ndonjë mënyrë tjetër;
- organin që duhet ta zbatojë urdhrin;
- kohëzgjatjen e masës së posaçme hetimore;
- llojin e sistemit të telekomunikimit, numrin e telefonit ose të dhënë tjetër për identifikim, si dhe numër identifikimi për secilin prej tyre veç e veç.

Parimi i subsidiaritetit (“në mënyrë tjetër nuk mund të sigurohen provat dhe të dhënat e nevojshme”) paraqet parim crucial mbrojtës, por në praktikën e deritanishme ky parim të shumtën e rasteve “harrohet të kontrollohet dhe vlerësohet në mënyrë kritike”. Kjo vlen për propozuesin e masës, gjegjësisht organet të autorizuara për zbatim të masës, e për fat të keq, edhe për kërkesit e masës-PP, e edhe për gjykatën, si instancë e fundit dhe e vetme që miraton kërkesën. Në këtë mënyrë rrënohet parimi i subsidiaritetit, gjegjësisht rregulli *Ultima Ratio* gjatë zbatimit të masave invazive.

**Mënyra e punës së policisë gjyqësore, masa e përcaktimit në mënyrë rutinore edhe si masë e zakonshme për mbledhje të njohurive, tregon për mosekzistimin e një mekanizmi efikas të mbrojtjes procedurale në procedurën e propozimit të saj.**

**Kërkesa** të cilën prokurori publik e drejton te gjykatësi i procedurës paraprake, duhet të përmbajë *argumentim* të mjaftueshëm, që do ta prezantojë më bindshëm para gjykatësit të procedurës paraprake për domosdoshmërinë e zbatimit të kësaj mënyre të mbledhjes së provave materiale. Pra, kërkesa e prokurorit publik duhet të jetë e qartë, precize dhe mirë e sqaruar.

Bashkangjitur me këtë kërkesë, i obligueshëm është edhe dorëzimi i akteve të tjera:

- propozim i dorëzuar nga policia gjyqësore për nevojën e zbatimit të masës,

- akte për llojin dhe mënyrën e të dhënave të mbledhura që janë të domosdoshme për zbatim të masës,
- akte plotësuese prej të cilave mund të përcaktohet përfshirja e personave, lidhshmëria e tyre, hierarkia e funksioneve, e nëse bëhet fjalë për bashkim kriminel, edhe frekuencën e komunikimeve dhe vendet e mundshme të lëvizjes.

Të gjitha këto të dhëna janë të nevojshme me qëllim që gjykatësi i procedurës paraprake të ketë pasqyrë të vërtetë dhe apropos kësaj, të mundet në mënyrë të lirë, pa pengesa dhe në bazë meritorie të marrë vendim për nevojën e zbatimit të njërës nga masat. Në mungesë të të dhënave të mjaftueshme, gjykatësi i procedurës paraprake mund të gjendet në situatë që të mos mund të vendosë a është vërtetë i domosdoshëm zbatimi i ndonjërës nga masat. Në praktikë shpesh ndodh që kërkesa e parashtruar nga prokurori publik për zbatim të masave, të pranohet në mënyrë jokritike, për arsye të thjeshtë se gjykatësi i procedurës paraprake pranon *vlerësimin* që ka bërë prokurori publik kur ka marrë vendimin për zbatim të mënyrës të këtillë invazive të sigurimit të të dhënave.

**Për këtë arsye nevojiten raporte më përmbajtjesore dhe më të plota, të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e kërkesës që prokurori publik i dorëzon te gjykatësi përgjegjës i procedurës paraprake. Me raporte të këtilla, gjykatësi i procedurës paraprake mund ta përcaktojë mundësinë që me zbatim të masës, do të sigurohen të dhëna dhe prova për zhvillim të suksesshëm të procedurës penale dhe se provat e informatat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër.**

Theksimi i kësaj nevoje imponohet edhe nga fakti që të gjitha komunikimet që ndiqen në bazë të urdhrimit paraprak nga gjykatësi i procedurës paraprake, sublimohen në një kopje e cila në origjinal dorëzohet në prokurorinë publike. Kopja e dytë mbetet tek organi që ka përgatitur lëndën, por si provë në procedim përdoret kopja që është dorëzuar në Prokurorinë Publike, në intervale të caktuara kohore, varësisht nga kohëzgjatja e masave. Nuk lejohet ri incizimi, kopjimi ose cilado mënyrë tjetër e modifikimit të provave që janë siguruar me kopjim në ruajtës informatash - CD, të shoqëruar me regjistrime në formë të shkruar, të klasifikuara në regjistra.

## 2.4. Pranimi në Prokurori

Varësisht nga lloji i masës, pranimi i propozimit për përcaktim të masave të posaçme hetimore evidentohet në libra të posaçëm intern, të cilët mbahen në prokurori, ku plotësisht respektohet shkalla e konfidencialitetit. Pranimin dhe evidentimin e bën person i emëruar me vendim intern të prokurorit publik që udhëheq me Prokurorinë. Këta libra, si dhe të gjitha aktet që përgatiten gjatë zbatimit të masave të posaçme hetimore, ruhen në kasafortë të posaçme ku qasje ka vetëm personi i emëruar.

Nevoja për sigurim të këtillë në nivel adekuat konfidencialiteti buron pikërisht nga karakteri specifik dhe i masave të posaçme hetimore, sidomos masa për ndjekje të komunikimeve, sepse me zbatimin e tyre dukshëm shkelen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me aktet më të larta juridike.

Procesi i mbrojtjes së të dhënave fillon që nga moment i përgatitjes së propozimit për zbatim të masave të posaçme hetimore nga ana e organeve të autorizuar, në atë mënyrë që pas pranimit të këtij propozimi në Prokurori Publike formohet numër unik identifikimi, i cili është unik dhe

numër valid bartës përgjatë gjithë kohëzgjatjes së masave të posaçme hetimore, i cili evidentohet në evidencën interne të Prokurorisë.

**Numri identifikues** paraqet kusht teknik të nevojshëm që urdhri i dhënë në bazë të kërkesës, të mundet teknikisht me sukses të përcillet në ATO, sepse në atë mënyrë sigurohet mospërsëritja dhe individualiteti i më shumë karakteristikave dhe njëkuptimësia e operatorit gjatë identifikimit teknik të tyre në sistemin e komunikimeve elektronike.

Bëhet fjalë për numër specifik identifikimi që mund të përbëhet nga maksimum 25 karaktere, specifike për secilin numër telefonik veç e veç. Karakteristikat e dhëna, kryesisht janë shkurtesa të institucionit që ka dorëzuar propozimin apo kërkesën, dita, muaji dhe viti i dorëzimit të propozimit apo kërkesës, numri rendor i komunikimit në propozim ose kërkesë, simbolet identifikuese për secilin operator veç e veç e kështu me radhë.

Nevoja për mënyrë të re identifikimi të akteve që përgatit Prokuroria, nuk do të thotë ngarkesë ose ndryshim i plotë i sistemit, gjegjësisht mënyrës së punës, por vetëm formë përmes së cilës sigurohet shkallë e lartë e mbrojtjes së të dhënave. Dispozitat e deritanishme ligjore nuk e parashihnin në mënyrë strikte dhe precize mënyrën e pranimit, përpunimit dhe dërgimit të akteve të këtilla, e madje mungonin edhe akte nënligjore përmes të cilave saktësisht do të përcaktohej jo vetëm niveli i konfidencialitetit dhe mënyra e punës, por edhe masat e nevojshme të sigurisë për mënyrën e pranimit, përpunimit dhe dërgimit të kërkesave te gjykatësi i procedurës paraprake, duke marrë parasysh mënyrat e vendosura rutinore për pranim dhe dërgim të të gjitha akteve tjera në Prokurori dhe jashtë saj.

Gjatë dërgimit nuk lejohet përdorimi i çfarëdo lloji njësie portative, as dërgim, respektivisht ekspeditim i kërkesës së këtillë përmes postës ose nëpërmjet personave të paautorizuar. Dokumentet e klasifikuara me nivelin “Sekret Shtetëror (SSh)” apo nivel më të ulët, të paketuara në mënyrë pedante, (brenda shtetit) dërgohen përmes shërbimit zyrtar për dërgesa ose përmes personave të autorizuar për qasje në informata të klasifikuara me nivel “SSh” dhe më të ulët, të cilët kanë edhe autorizim special për transfer të atyre informatave (konform Dekretit për Siguri Administrative të Informatave të Klasifikuara – “Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 82 nga 19.11.2004).

Kërkesa duhet të jetë mirë e vulosur, dhe, e vulosur (sipas praktikës së vendosur), me 3 apo me 5 vula të pozicionuara në distancë të ndryshme të pjesës së jashtme të kapakut të zarfit. Dokumentet e klasifikuara me shkallën “I” (interne) dhe më lartë, dërgohen të paketuara në mbështjellëse jotransparente, të futura në dy zarfe. Zarfi i brendshëm shënohet me klasifikim përkatës sigurie për dokumentin dhe sipas mundësisë, të ketë edhe të dhënat e plota për vendin e punës të shfrytëzuesit dhe adresën e tij.

Për dokumentin që dërgohet, përgatitet fletëpranim, që po ashtu futet në zarfin e brendshëm. Fletëpranimi, që nuk duhet të jetë i klasifikuar, përmban numër protokolli, datën dhe numrin e kopjes së dokumentit, por jo edhe të dhëna për përmbajtjen e dokumentit. Zarfi i brendshëm shihet në zarfin e jashtëm, në të cilin shënohet vetëm titulli dhe adresa e pranuesit, si dhe numri i dërgesës së shkresës. Në zarfin e jashtëm nuk duhet të shihet klasifikimi i sigurisë i dokumentit që dërgohet. Pranimi i dërgesave me dokumente të klasifikuara me shkallën “I” dhe më lartë, evidentohet në librin e korrierëve dhe dërguesve, me nënshkrim të personit të autorizuar për pranim, së bashku me numrin e dërgesës së shkresës.



### 3. Procedura për shqiptim të masave të posaçme hetimore nga gjykata

Procedurat për shqiptim të masave të posaçme hetimore nënkuptojnë veprime të caktuara nga gjykatësi i procedimit paraprak, si dhe nga anëtarët e këshillit penal nëpër gjykata, që nga momenti i pranimit të kërkesës (me shkrim ose verbale) për zbatim të MPH-së deri në ditën e arkivimit të urdhrin të dhënë.

Siç thuhet më lart në tekst, disa nga masat e posaçme hetimore i miraton gjykata, me kërkesë të prokurorit publik. Kërkesat me shkrim që vijnë në gjykatë, gjegjësisht kërkesat për shqiptim të masave të posaçme hetimore, i dorëzohen personalisht personit të autorizuar - nëpunës gjykatë, i cili posedon certifikatë sigurie të nivelit adekuat të klasifikimit të sigurisë.

Këto lloje kërkesash nuk shpërndahen për procedim përmes sistemit automatik kompjuterik-informatik (SAKI), por pasi që kërkesa me shkrim do të marrë vulën e pranimit, me datë dhe orë të caktuar pranimi, nëpunësi i autorizuar do ta përcjellë për procedim tek gjykatësi i cili e ka radhën për të pranuar kërkesë të këtillë, në qoftë se kërkesa ose propozimi është i ri, gjegjësisht nëse për herë të parë kërkohet përcaktim për zbatim të një mase të posaçme hetimore. Këto lloj kërkesa në vijë zyrtare i jepen të ashtuquajturve "gjykatës natyral" duke evidentuar me shkrim gjykatësit të cilët kanë udhëhequr raste lidhur me kërkesat për shqiptim të MPH-së, e për këtë arsye kërkesat shpërndahen sipas radhës.

Nëse kërkohet vazhdim i zbatimit të masës invazive, madje edhe kur bëhet fjalë për një person të ri për të cilin nevoja për këtë lloj mase, ka buruar si rezultat nga ndjekja pas urdhrin paraprakisht të dhënë për persona të tjerë, kërkesa për vazhdim të zbatimit të masës invazive dorëzohet për procedim tek gjykatës tjetër.

Urdhrat që jepen pas kërkesës së dorëzuar te prokurori publik, e që kanë të bëjnë me masën e posaçme hetimore - *ndjekje dhe incizim i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike* në procedurë të paraparë me ligj special sipas nenit 252, paragrafi 1, pika 1 të LPP-së, evidentohen në Regjistër me shkurtesën RNAK (Regjistër për Ndjekje të Autorizuar të Komunikimeve).

Ky regjistër plotësohet me dorë dhe nuk ekziston shënim elektronik, pra, *nuk krijohen dosje elektronike për këto lloj lëndësh*, e kjo ndodh për arsye se sipas rregullores së gjykatave, nuk është paraparë formim i lëndëve me shkurtesën RNAK.

Në **Regjistër** shënohet:

1. Numri rendor i urdhrin të shqiptuar;
2. Data e pranimit të kërkesës;
3. Parashtruesi i kërkesës;
4. Persona për të cilët kërkohet zbatim i MPH-së;
5. Vepra penale;
6. Kohëzgjatja e masës dhe
7. Data e shqiptimit të urdhrin.

Për dallim nga kjo masë hetimore, për të gjitha masat tjera të posaçme hetimore formohen lëndë pas evidentimit elektronik të kërkesave në sistemin RNAK.

**Pas marrjes së numrit evidentues, kërkesa me shkrim dorëzohet te gjykatësi i cili duhet ta procedojë me fletëdërgesë, në të cilën shënohet numri i lëndës që është gjeneruar, niveli i klasifikimit, shënimi nga Prokuroria Publike, si dhe data dhe orari kur është pranuar. Në pjesën ku mbahet evidenca se kush është njoftuar me përmbajtjen e kësaj lënde, ceken të gjithë personat që kanë qasje në të, e që detyrimisht duhet të posedojnë certifikatë sigurie. Të gjithë këta persona nënshkruhen aty personalisht dhe shënojnë datën.**

Pas përgatitjes, urdhri futet në zarf dhe gjykatësi që ka proceduar lëndën e kthen te nëpunësi i autorizuar që e ka pranuar atë. Aty jepet nënshkrim, shënohet data dhe i dorëzohet personalisht personit të autorizuar të përcaktuar nga PP, i cili me nënshkrim personal konfirmon pranimin.

Përgatitja e kërkesës me shkrim me nivel klasifikimi bëhet në hapësirë të posaçme të gjykatës, ku ka kompjuter personal të mbrojtur në mënyrë speciale, jashtë çdo kontakti me rrjetin. Nga jashtë kjo hapësirë mbulohet me video-kamera, me qëllim që të evidentohet në aspekt vizual dhe kohor çdo hyrje dhe dalje nga hapësira e parapare për përgatitje të MPH-së.

Urdhri përgatitet në tri kopje dhe në secilën faqe të urdhërit, në pjesën qendrore lart, detyrimisht duhet të qëndrojë niveli i **klasifikimit** që ka përcaktuar propozuesi-kërkuesi: “konfidenciale”; „tepër konfidenciale” apo “sekret shtetëror”. Një kopje e Urdhrit i mbetet gjykatës ku së bashku me kërkesën, mbështjellësen me të cilën është dorëzuar në PP, shtojcat tjera dhe lista e dërgesës për lëvizje të lëndës, shtihen në zarf. Zarfi vulozet me tri vula dhe në anën e përparme të zarfit detyrimisht shënohet niveli i klasifikimit të informatës që përmban. Po ashtu në anën e përparme shënohet numri i urdhrit dhe data kur është shqiptuar.

Prokurorisë Publike i dorëzohen katër kopje të urdhrit, të vendosura në dy zarfe të posaçme, në të njëjtën mënyrë si kopja për gjykatën, tri prej të cilave janë të anonimizuara konform Rregullores, prej të cilave një kopje e anonimizuar është për nevojat e ATO-s, ndërsa dy kopjet identike të anonimizuara për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit. Në njërin zarf dedikuar për ATO-n vendoset një kopje e anonimizuar e urdhrit për nevoja të ATO-s dhe një kopje e anonimizuar e urdhrit për nevoja të mbikëqyrjes dhe kontrollit. Në zarfin tjetër, dedikuar për shërbimin e autorizuar për zbatimin e MPH-së, vendoset kopja e paanonimizuar e urdhrit dhe një kopje e anonimizuar e urdhrit për nevoja të mbikëqyrjes dhe kontrollit.

### **3.1. Anonimizimi**

Konform rregullave të reja për zbatim të masave të posaçme hetimore që theksojnë nevojën e sigurimit të nivelit të lartë të mbrojtjes së të dhënave për numrat telefonikë, personat dhe lëndët ndaj të cilave zbatohen masat e posaçme hetimore, janë miratuar dy Rregullore për mënyrën e anonimizimit të urdhëresave gjyqësore, një për mënyrën e anonimizimit të urdhëresave gjyqësore kur masat ndërmerren për qëllime penale, ndërsa tjetra për mënyrën e anonimizimit të urdhëresave gjyqësore kur masat ndërmerren për mbrojtje të interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit.

Anonimizimi është proces ku të gjithë elementet identifikues të shënuar në urdhëresë, përfshi edhe të dhënat personale dhe të dhënat tjera, mënjanoohen me qëllim që subjekti i të dhënave personale të mos mund të identifikohet as në mënyrë direkte, e as në mënyrë indirekte.

Me formimin e Agjencisë Teknike-Operative (në vazhdim ATO) dhe fillimit të punës së saj (më 01.11.2018) si institucion teknik-ndërmjetësues (që ndërmjetëson në përcjelljen e sinjalit, por nuk

mund të “dëgjojë”) në mes të organeve të autorizuar për zbatim të masës dhe operatorëve, u paraqitën mangësi të natyrës “teknike” të cilat vështirësojnë, e ndonjëherë e pamundësojnë zbatimin e masave. Promovimi i numrit “identifikues” (vegël për anonimizim dhe mbrojtje të fshehtësisë së masës) si element i urdhëresës gjyqësore, fillimisht shkaktoi mosmarrëveshje se cili institucion ta përcaktojë këtë (gjykata apo PP) dhe në çfarë formati, e më vonë edhe pengesa serioze teknike në zbatimin e masës së caktuar, në qoftë se nuk është përcaktuar në mënyrë të drejtë dhe i formatuar teknikisht (që arriti deri në mungesë “thelbësore” të urdhëresës gjyqësore) mund të shkaktojë pamundësi teknike për zbatimin e masës.

Zarfi që i mbetet gjykatës me të gjitha materialet e vulosura brenda tij, i dorëzohen nëpunësit të autorizuar, i cili ka për obligim të kujdeset për këto materiale në kasaforta të posaçme që gjenden në hapësirën e specializuar për ruajtje të informatave të klasifikuara. Hapësira e këtillë e specializuar duhet të jetë nën video-mbikëqyrje 24-orësh, me evidencë elektronike për çdo hyrje dhe kjo të bëhet me standarde të posaçme për ruajtje të informatës së klasifikuar. Standardet e posaçme që kanë të bëjnë me hapësirën rreth objektit, që paraqet distancë minimale nga hapësira ku ruhen informatat e klasifikuara – **brez sigurie** dhe hapësirë ose hapësira brenda objektit, në të cilat ka ose ruhen informata të klasifikuara të nivelit - *konfidencial* ose nivel më i lartë, dhe ka nevojë për mbrojtje adekuate fizike – të ashtuquajtur **zonë sigurie**.

Për anonimizimin e urdhëresës gjyqësore përgjegjës është gjykatësi që ka dhënë urdhëresën, ndërsa kopja e anonimizuar e urdhëresës që dërgohet tek ATO duhet t’i përmbajë këto të dhëna:

- numrin e urdhëresës dhe organin që e ka lëshuar atë;
- mjetet teknike që do të zbatohen;
- kohëzgjatjen e masave të posaçme hetimore dhe numrin identifikues; dhe
- llojin e sistemit telekomunikativ, numrin e telefonit ose të dhënë tjetër për identifikim, si dhe numër identifikues për secilin prej tyre veç e veç.

Me qëllim që të mundësohet kontroll mbi zbatimin e masës, ligji parasheh që kopja e anonimizuar e urdhëresës për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit, t’i përmbajë këto të dhëna:

- numrin e urdhëresës dhe organi që e ka lëshuar;
- kohëzgjatjen e masës; dhe
- numrin identifikues.

Gjykatësi për procedurë paraprake urdhëresën e dhënë, së bashku me kopjen e anonimizuar të urdhëresës për nevojat e ATO-s dhe kopjen e anonimizuar të urdhëresës për nevojat e kryerjes së mbikëqyrjes dhe kontrollit, ia dorëzon menjëherë prokurorit publik përgjegjës. Nëse ky e zbaton masën, kopjet e anonimizuar të urdhëresës menjëherë i dorëzon te ATO, e në raste kur masa e posaçme hetimore zbatohet nga ana e policisë gjyqësore, prokurori publik përgjegjës urdhëresën e lëshuar, së bashku me kopjet e anonimizuar të urdhëresës ia dorëzon personit të autorizuar të policisë gjyqësore, që pastaj i përcjell te personi i autorizuar në ATO, i cili duhet menjëherë t’i procedojë.

**Rregullorja për mënyrën e anonimizimit të urdhëresave nuk parasheh mënyrën e anonimizimit në arsyetimin e Urdhëresës, siç ndodh me anonimizimin e vendimeve të tjera ose dënimeve, dhe i cili arsyetim po ashtu përmban të dhëna përmes të cilave subjekti i të dhënave personale mund të identifikohet në mënyrë direkte apo indirekte. Për këtë shkak edhe në pjesën e arsyetimit të urdhëresës ato të dhëna duhet të shënohen me X.**

#### **4. Bazat e dyshimit si shkallë supozimi për aktivizim të masave**

Edhe pse MPH me nivelin e tyre të supozimit për aktivizim kanë bazë për dyshime, kjo është krejtësisht irelevante në raport me nevojën e domosdoshme shoqërore të mbrohen vlerat dhe të mirat e caktuara ose thënë më ndryshe, vlera prioritare dhe e paramenduar për zbatim të MPH-së është *parimi i proporcionalitetit*. Parimi i proporcionalitetit në zbatimin e MPH-së çdoherë është i plotësuar në mënyrë kumulative me *parimin e subsidiaritetit*.

Duke e marrë parasysh që masat e posaçme hetimore gjithmonë rrënojnë të drejtën e privatësisë së individit të mbrojtur me nenin 8 të KEDNj-së, gjatë miratimit të urdhëresës për këtë lloj masash, gjykata duhet sidomos ta analizojë dhe vlerësojë arsyeshmërinë e ndërhyrjes në privatësinë e individit nga pushteti ekzekutiv. Me fjalë të tjera, legjitimiteti i pushtetit ekzekutiv të ndërhyjë në sferën private të individit në bazë të parimeve të ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe subsidiaritetit, duhet të jetë i kufizuar dhe i kontrolluar nga pushteti i pavarur gjyqësor përmes parimit të miratimit paraprak të masave nga gjykata.

**Gjatë propozimit të masave, është e domosdoshme të argumentohet me fakte dhe të ofrohen rrethanat që tregojnë për ekzistimin e dyshimit se vepra penale përgatitet apo është kryer dhe që njëkohësisht nuk është e mundur që hetimi të kryhet në mënyrë tjetër më pak invazive.**

Mosekzistimi i rregullores dhe standardeve precize ligjore, krijon kornizë të gjerë për interpretim më “të lirë” të dispozitave ligjore, kështu që të shumtën e rasteve edhe kërkesat e parashtruara nga prokurori publik dhe urdhëresat e shqiptuara për zbatim të masave të posaçme hetimore, jepen me arsyetimin e vetëm se “hetimi nuk mund të zbatohet në mënyrë tjetër”, pa paraqitur fakte dhe rrethana që mbështesin atë konstatim.

**Dobësia më e madhe në zbatimin e masës - ndjekje e komunikimeve, është mosselektiviteti i saj personal dhe përmbajtjesor. Gjatë zbatimit të saj nuk ekziston mundësi teknike që në tërësi t’u shmangët komunikimeve të personave që nuk kanë kurrfarë lidhje me veprën kriminale (mosselektivim personal), respektivisht të shmangen bisedat që nuk kanë kurrfarë lidhje me veprën kriminale (mosselektivitet përmbajtjesor).**

Selektimi personal dhe përmbajtjesor duhet të kryhet gjatë zbatimit të masës përmes të ashtuquajturës procedurë minimizimi në ndërhyrjen dhe rrezikimin e privatësisë së personave të prekur dhe *post festum* pasi që të jetë përfunduar masa. Mirëpo, pa marrë parasysh regjimin e mbrojtjes dhe fshehtësisë së njohurive të siguruara nga zbatimi i masës dhe obligimi për t’u shlyer të gjitha përmbajtjet e regjistruara që nuk kanë rëndësi për veprën kriminale, nuk mund të anashkalohet fakti se ka shkelje të jetës private edhe të personave të pafajshëm. Duke marrë pa-

rasysh shkallën e rrezikimit të jetës private të individit, çdoherë është aktuale çështja e regjimit të miratimit të kësaj mase.

#### 4.1. Arsyja përse të dhënat apo provat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër

Urdhëresa me të cilën zbatohen masat e posaçme hetimore, detyrimisht duhet të përmbajë sqarim se për cilat arsye është shqiptuar kjo masë, gjegjësisht të përmbajë fakte për lëndën, rrethanat që çojnë në dyshim të arsyeshëm se është kryer veprë penale, e sidomos rrethanat që tregojnë se nuk është e mundur që hetimi të jetë zbatuar në mënyrë tjetër më pak intruzive.

Shkalla e dyshimit vetëm sipërfaqësisht mund të paraqesë pengesë për zbatim të tepruar të masave, sepse moment crucial për miratim të masave janë dy faktorët kumulativë: nevoja e domosdoshme shoqërore në mbrojtjen e të mirës së caktuar dhe mundësia e mbledhjes së njohurive në mënyrë tjetër. Me fjalë të tjera, zbatimi i kësaj mase fillimisht nuk është i përcaktuar nga shkalla e dyshimit, por para së gjithash nga pamundësia e mbledhjes së njohurive në mënyrë tjetër, derisa ekziston nevojë urgjente shoqërore për mbrojtje të së mirës së proklamuar.

**Baza dyshimi ka kur kuantumi i informatave mjafton që ta bindë një njeri racional të besojë se bëhet fjalë për veprë të caktuar penale.**

Edhe pse LPP ende nuk ka përkufizim preciz për termin *baza dyshimi*, është e qartë se bazat e dyshimit paraqesin standard më të ulët se dyshimi i bazuar, jo vetëm për shkak se dyshimi mund të konstatohet me informata që janë më të pakta në sasi dhe përmbajtje se të atyre të nevojshme për dyshim të bazuar, por edhe për faktin që bazat e dyshimit mund të burojnë nga informata që janë më pak të besueshme nga ato të nevojshme për dyshim të bazuar. Për shembull, informatat e siguruar nga thirrje anonime telefonike nuk do të jenë vetvetiu të mjaftueshme për të përcaktuar ekzistim të bazave të dyshimit, por rrethanat e përgjithshme mund të tregojnë se aspekte të rëndësishme të rrëfimit të informatorit janë mjaftueshëm të mbështetura me njohuri tjera të policisë, që në rastin konkret arsyeton ekzistimin e bazave të dyshimit.

#### 4.2. Urgjenca e procedimit

Një nga veçoritë kryesore që karakterizon procedurën e përgjithshme penale është parimi i urgjencës, që shpreh qëllimin e ligjvënësit që ajo të zhvillohet shpejt, në mënyrë efikase dhe pa shtyrje. Ky parim edhe pse nuk është një nga parimet bazike që karakterizojnë masat e posaçme hetimore, prapëseprapë si parim i përgjithshëm gjen zbatim, sidomos në procedurën për përcaktim të masave të posaçme hetimore, për shkak se të vepruarit në kundërshtim të këtij parimi mund t'i dëmtojë interesat e përhershme ose vitale të Republikës, si dhe punën dhe efikasitetin e organeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lidhur me kërkesën për zbatim të MPH-së vendos gjykatësi i procedurës paraprake, më së voni në afat deri në 72 orë nga parashtrimi i kërkesës. Në raste të posaçme, kur ekziston dyshim i bazuar se zvarritja mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e procedurës penale, gjykatësi në procedurë paraprake mund të shqiptojë urdhëresë të përkohshme me shkrim. *Kjo lloj urdhërese, për shkak të urgjencës, jepet menjëherë, gjegjësisht jo më vonë se 12 orë nga momenti që është parashtruar kërkesa dhe me këtë urdhëresë lejohet zbatimi i masës hetimore vetëm në afat prej 48 orëve.* Edhe pse bëhet

fjalë për procedurë në raste urgjente, prokurori publik domosdo duhet të dorëzojë kërkesë me shkrim mbi bazë të së cilës gjykatësi jep urdhëresë të përkohshme me shkrim.

Për dallim nga rasti paraprak, ku ekzistonte mundësia për shqiptim të urdhëresës verbale, me zgjedhjen e re ligjore nuk parashihet dhënie urdhërese verbale, por në rast urgjence, pas kërkesës me shkrim, vendoset menjëherë, respektivisht jo më gjatë se 12 orë, në vend të afatit të deritashëm prej 72 orëve.

Parimi i urgjencës potencohet edhe në nenin 10 të Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve **“kur ekziston dyshim i bazuar se zvarritja mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e procedurës”**, mirëpo pa cekur rrethana konkrete si kritere mbi bazë të të cilave mund të matet dhe vërtetohet gjendja reale e urgjencës.

Gjërat e këtilla të padefinuara të Ligjit (te LNK nga viti 2006, në nenin e shlyer 14 përkufizoheshin rrethanat që tregonin gjendjen e urgjencës) ndikon në njëjtësim dhe unifikim të interpretimit juridik të institucionit *urgjencë në procedim*, kështu gjykatësit gjatë vlerësimit të saj i mbetet të bazohet në gjykimin dhe instiktin personal për ligjshmëri dhe drejtësi. Gjithsesi, e drejta për bindje të lirë gjyqësore nuk paraqet vendimmarrje arbitrare, por gjykatësit udhëhiqen nga disa rregulla të caktuara (analogji) që tani më janë etabluar në degë tjera juridike e që kanë të bëjnë me matje të gjendjes së urgjencës. Zakonisht gjendja e urgjencës mund të konstatohet:

- kur ekziston rrezik nga shkaktimi i vdekjes ose lëndimit të rëndë fizik të një apo më shumë personave;
- kur ekziston rrezik nga shkaktimi i dëmit material të pronës me përmasa të mëdha;
- kur ekziston rrezik për ikje të personit që është autor i veprës penale për të cilën parashihet dënim me burgim të përjetshëm; dhe
- në raste tjera kur ekzistojnë rrethana që tregojnë për mospërsëritje të gjendjes apo pakompensueshmërinë e dëmit që mund të ndodhë nëse nuk ndërmerren masat e duhura me kohë ose urgjentisht.

## **5. Përdorimi i masave të posaçme hetimore si prova në procedurë penale**

Masat e posaçme hetimore duhet të përgatiten dhe zbatohen konform dispozitave ligjore të cilat i parashohin këto masa. Veprimi i kundërt do të rezultojë me pamundësinë që provat që janë siguruar nga zbatimi i masave, të përdoren para gjykatës dhe vendimi gjyqësor të mbështetet në to.

Neni 259 i LPP-së rregullon përdorimin e provave të siguruara me zbatimin e MPH-së në procedurë gjyqësore dhe marrjen në pyetje si dëshmitarë të personave me identitet të fshehur, të cilët kanë marrë pjesë në zbatimin e masave.

Sipas paragrafit 1 të nenit të lartpërmendur, të dhënat, lajmërimet, dokumentet dhe gjësendet, që janë siguruar me zbatim të masave të posaçme hetimore, mund të përdoren si prova në procedurë penale në qoftë se ato janë siguruar në kushte dhe në mënyrë të paraparë me ligj. Prezantimi i këtyre provave para gjykatës bëhet sipas rregullave të përgjithshme për paraqitje të provave me shkrim dhe atyre materiale.

Paragrafi 2 parasheh *përrjashtim* të përdorimit të provave të siguruara me zbatimin e masave të posaçme hetimore. Deklarata të personave të cilët konform ligjit janë të liruar nga obligimi për dëshmi (sqsuar në nenin 214 të LPP-së), që janë siguar me zbatim të masave të posaçme hetimore, nuk mund të përdoren si prova.

Personat me identitet të fshehur që kanë marrë pjesë në zbatimin e masave sipas nenit 252, paragrafi 1 pika 10 e LPP-së, mund të merren në pyetje si dëshmitarë të mbrojtur, me kushte të parapara sipas neneve 226 deri 232 të LPP-së, mbi mënyrën e mbrojtjes dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve të rrezikuar. Identiteti i këtyre personave paraqet sekret zyrtar.

Gjatë marrjes së vendimit për lëndët ku personat me identitet të fshehur janë marrë në pyetje si dëshmitarë të rrezikuar, gjykata duhet ta ketë parasysh edhe dispozitën e nenit 400, paragrafi 1 të LPP-së, se vendimi nuk mund të bazohet vetëm në deklaratën e dëshmitarit të rrezikuar, që është në pajtim edhe me praktikën e GjEDN-së. Marrja në pyetje e këtyre personave para gjykatës, duhet të jetë provë e domosdoshme në procedurë, para së gjithash e nevojshme për kontroll dhe vërtetim të provave të paraqitura që janë siguar përmes masave të posaçme hetimore, e jo vetëm si provë e nënkuptuar.

Në qoftë së MPH janë zbatuar pa u përmbushur kushtet për zbatimin e tyre (neni 252, paragrafi 1 i LPP-së), apo për vepër penale që nuk parashihet në nenin 253 të LPP-së, ose pa urdhëresë nga organi i autorizuar me ligj për të dhënë urdhëresa të këtilla, apo gjatë zbatimit të tyre janë tejkaluar kompetencat, të dhënat e siguruara përmes masave të zbatuara në mënyrë të këtillë të paligjshme, nuk do të mund të përdoren para gjykatësit dhe vendimi gjyqësor nuk mund të bazohet mbi to. Situatë identike është edhe kur gjatë zbatimit të masave nuk respektohen dispozitat e neneve 263 dhe 268, paragrafi 1 i LPP-së.

Rrjedhimisht, MPH kanë kuptim dhe peshë të njëjtë juridike si edhe veprimet tjera hetimore, sepse me to mund të sigurohen prova në forma deklaratash, gjegjësisht dëshmi që në kuptim juridiko-penal mund të paraqesin pranim faji të të akuzuarit, gjegjësisht dëshmitarit, por po ashtu mund të sigurohen edhe prova materiale që në kuptim juridik penal janë identike me provat e siguruara nga këqyrja, bastisja apo llojet e ndryshme të ekspertizës.

Provat e siguruara me zbatimin e masave të posaçme hetimore mund të përdoren në procedurë penale, me kusht që të jenë të siguruara në mënyrë ligjore, siç parashihet me fleturdhëresën gjyqësore. Për këtë arsye, urdhëresa gjyqësore dhe forma e saj përbëjnë *conditio sine quanon* e ligjshmërisë së provave të siguruara me zbatimin e masave të posaçme hetimore dhe çdo mënyrë tjetër e sigurimit të provave me MPH paraqet shkelje absolute të dispozitave të procedurës penale.

Neni 12 nga LPP ligjërisht përkap materien e ligjshmërisë së provave në procedurën penale, dhe po ky nen (në paragrafin e parë) përmban ndalesë eksplicite për sigurimin e provave përmes përdorimit të çfarëdo force, dhe ndalesa të provave (në paragrafin e dytë) për vlerësim të provave të fituara në mënyrë joligjore (në mënyrë të kundërt nga mënyra që është përcaktuar me ligj), me shkelje të lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ligjit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të gjitha provat e tjera që janë dhënë në shqyrtim, ose, që kanë dalë nga dy llojet paraprake të provave.

## 6. Kohëzgjatja e masave dhe vazhdimi i tyre

Konform nenit 260 të LPP-së dhe nenit 11 të Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve, masat e posaçme hetimore mund të zgjasin më së shumti 4 muaj, ndërsa në paragrafin 2 parashihet që me kërkesë me shkrim të argumentuar nga prokurori publik, gjykatësi në procedurë paraprake mund t'i vazhdojë masat edhe **për 4 muaj**. Për vepra penale për të cilat parashihet dënim me burg prej së paku 4 vitesh, e për të cilat ekziston dyshim i bazuar se janë kryer nga grup i organizuar, bandë apo bashkim tjetër kriminel, masat pas 8 muajve të parë mund të *vazhdohen* edhe për 6 muaj të tjerë, respektivisht në ato raste masat mund të zgjasin më së shumti deri në 14 muaj.

Parimi i ligjshmërisë të zbatimit të masave të posaçme hetimore do të thotë që paraprakisht është përcaktuar sa mund të zgjasin masat, gjegjësisht kohëzgjatja e tyre është e kufizuar. Kohëzgjatja e masave përcaktohet shkallë-shkallë, vazhdimi i tyre mund të bëhet edhe në intervale njëmuajshe, por kohëzgjatja e tyre është e kufizuar. Zbatimi i masave të posaçme hetimore përfundon me kalimin e afatit të paraparë ose me përfundim të shkaqeve për të cilat janë përcaktuar.

Siç përmendet më lart, nëse masat e posaçme hetimore nga neni 252, paragrafi 1 pikat 1, 2, 3 dhe 4 përcaktojnë vepra penale për të cilat parashihet dënim me burg prej së paku 4 vitesh, e për të cilat ekziston dyshim i bazuar se janë kryer nga grup i organizuar, bandë apo bashkim tjetër kriminel, gjykatësi në procedurë paraprake mund ta vazhdojë afatin nga paragrafi 2 i këtij neni edhe **më së shumti për gjashtë muaj**. Krahas ekzistimit të kërkesës me shkrim nga prokurori publik, gjykatësi në procedurë paraprake vendos për vazhdim të afatit edhe në bazë të vlerësimit të dobishmërisë nga të dhënat e siguruara deri atëherë përmes zbatimit të masave dhe ekzistimit të pritjes së arsyeshme se me këtë masë edhe më tutje mund të sigurohen të dhëna në interes të procedurës.

Kohëzgjatja e zbatimit të masave të posaçme hetimore nga neni 252, paragrafi 1 i LPP-së që përcaktohen me urdhëresë me shkrim nga prokurori publik, mund të vazhdohet deri në arritjen e qëllimit për të cilin është përcaktuar masa, e më së voni deri në përfundim të hetimit.

Nëse gjykatësi në procedurë paraprake nuk e aprovon propozimin me shkrim të prokurorit publik dhe merr vendim me të cilin nuk e aprovon vazhdimin e kohëzgjatjes së masave të posaçme hetimore, prokurori publik mund të parashtrojë ankesë kundër këtij vendimi në Këshillin e Gjykatës, i cili vendos për ankesën e parashtruar në afat prej 24 orëve.

### 6.1. Refuzimi i kërkesës për shqiptimin e masës së posaçme hetimore

Konform nenit 294, paragrafi 3 i LPP-së, me propozim të prokurorit publik, gjykatësi në procedurë paraprake jep urdhëresë për zbatim të masave të posaçme hetimore. Paragrafi paraprak i nenit të njëjtë në mënyrë decide parasheh që në rast se gjykatësi i procedimit paraprak nuk pajtohet me propozimin e prokurorit publik për dhënie urdhëresë për bastisje të shtëpisë, hapësirave dhe personave të tjerë, do ta shpreh mospajtimin para Këshillit të përbërë nga tre gjykatës, përbërja dhe kompetencat e të cilit janë të përcaktuara me nenin 25, paragrafi 5 të LPP-së. Në afat prej 24 orëve nga pranimi i mospajtimit të shprehur, Këshilli merr vendim, gjegjësisht ka mundësi ta vërtetojë atë, që do të thotë ta refuzojë kërkesën për dhënie të urdhëresës ose ta refuzojë mospajtimin e gjykatësit të procedurës paraprake dhe ta konfirmojë urdhëresën e kërkuar.



Mospajtimi për dhënie urdhërese vërtetohet me vendim, pa të drejtë ankimi, sepse është në shqyrtim të shkallës së dytë dhe është përfundimtare.

Për dallim nga reagimi, kur bëhet fjalë për urdhëresë për bastisje të shtëpisë, hapësirave apo personave të tjerë, në rastin e kërkesave për dhënie të urdhëresave për masa të posaçme hetimore, ligji nuk parasheh në mënyrë të qartë çfarë ndodh nëse gjykatësi i procedurës paraprake nuk miraton dhënien e urdhëresës për masa të posaçme hetimore. Ligji për Ndjekje të Komunikimeve në nenin 11 parasheh që nëse gjykatësi i procedurës paraprake nuk pajtohet me kërkesën për zbatim të masës së posaçme hetimore, atëherë zbatohen dispozitat e LPP-së me të cilat rregullohet procedura në raste kur gjykatësi i procedurës paraprake nuk pajtohet me propozimin e prokurorit publik. Në kontekst të kësaj dispozite ligjore, në rast se gjykatësi i procedurës paraprake nuk pajtohet me dhënien e urdhëresës për zbatim të masës së posaçme hetimore, do shprehë mospajtimin para këshillit penal, që ose do ta vërtetojë me vendim pa të drejtë ankimi ose do ta refuzojë mospajtimin dhe do ta konfirmojë urdhëresën e kërkuar.

Për dallim nga ajo që ligjvënësi nuk ka paraparë qartë se çka ndodh nëse gjykatësi i procedurës paraprake nuk pajtohet me propozimin për përcaktimin e masës së posaçme hetimore për herë të parë, në mënyrë decide përcaktohet procedurë kundër vendimit të gjykatësit të procedurës paraprake me të cilin nuk miratohet *vazhdim* i kohëzgjatjes së masës, pas ankesës së prokurorit publik në afat prej 24 orëve vendos Këshilli i përbërë nga tre gjykatës (LPP, neni 260, paragrafi 5).

## 6.2. Zgjerim i urdhëresës

Masat e posaçme hetimore mund të përcaktohen vetëm për vepra penale të parapara me nenin 253 të LPP-së. Mirëpo, me zbatimin e ndonjë mase të posaçme hetimore mund të sigurohen të dhëna për vepër penale që nuk përfshihet në urdhëresë.

Lidhur me çështjen për zgjerim të urdhëresës, imponohen dy aspekte:

- Aspekti i parë ka të bëjë me çështjen e zgjerimit të urdhëresës ndaj (subjektit apo targetit) personave të cilët paraprakisht nuk janë përfshirë me urdhëresën, e që janë paraqitur gjatë zbatimit të masave; dhe
- Aspekti i dytë ka të bëjë me çështjen e zgjerimit të urdhëresës për (lëndën apo objektin) vepër të re penale, për të cilën është kuptuar gjatë zbatimit të masës.

Në rastet e këtylla ligji parasheh që masa të vazhdojë, edhe pse bëhet fjalë për vepër penale që nuk cilësohet në urdhëresë, por vetëm nëse bëhet fjalë për vepër penale të parapara me nenin 253 të LPP-së, respektivisht vetëm nëse është vepër penale për të cilën është parapara se mund të përcaktohet masë e posaçme hetimore. Të dhënat e siguruar në këtë mënyrë mund të përdoren si provë në procedurë penale që do të ngrehej kundër autorit të kësaj vepre penale. Të dhënat e siguruar nga zbatimi i masave të posaçme hetimore në raste kur të dhënat tregojnë për vepër tjetër penale të parapara me nenin 253 të LPP-së që ka kryer personi i njëjtë për të cilin është lëshuar urdhëresa për zbatim të masës së posaçme, nuk paraqet problem në praktikën gjyqësore.

Problemi ndodh kur të dhënat kanë të bëjnë me vepër penale nga neni 253 i LPP-së, ku autori i veprës është person tjetër, e jo personi ndaj të cilit zbatohet masa e posaçme hetimore. Duke marrë parasysh që LPP parasheh që masa e posaçme hetimore mund të përcaktohet vetëm ndaj një personi të njohur (të identifikuar) apo ndaj një lënde të një vepre penale (sipas nenit 252, paragrafi 2 i LPP-së), del se kështu siç është definuar dispozita lë të kuptohet se këto të dhëna për vepër penale

të kryer nga person tjetër nuk mund të përdoren në procedurë sepse nuk ka urdhëresë ndaj atij personi, që nuk është qëllim i ligjit. Për këtë shkak, dispozita duhet të interpretohet më gjerësisht, respektivisht se edhe të dhënat e siguruarra për veprë penale të kryer nga person tjetër mund të përdoren në procedurë, nëse janë përmbushur kushtet tjera të parapara me LPP-në.

**Praktika gjyqësore:**

*Kur prokurori publik ka hequr dorë nga ndjekja penale për veprën penale "Bashkim kriminal" nga neni 394, paragrafi 1 i KP, për të cilën janë zbatuar masa të posaçme hetimore, gjykata nuk ka bazë ligjore t'i vlerësojë provat e siguruarra me masa të posaçme hetimore dhe ta mbështesë vendimin mbi provat që kanë shpallur të akuzuarin fajtor për veprë penale - "Pranim ryshfeti" nga neni 357, paragrafi 1 lidhur me nenin 22 të KP, që nuk është paraparë si veprë penale për të cilën nuk mund të zbatohen masa të posaçme hetimore.*

**Vendim i Gjykatës Supreme, KVP-97/2010**

*Gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat e procedurës penale të nenit 355, paragrafi 1, pika 8 nga Ligji për Procedim Penal, ku si prova ka paraqitur vendime të mëhershme gjyqësore, për të cilat Gjykata Supreme tani më ka vendosur se janë joligjore për shkak se janë bazuar në prova të siguruarra me zbatim të masave të posaçme hetimore në kundërshtim me ligjin.*

**Vendim i Gjykatës Supreme, KVP KOK 1-3/2013**

### **6.3. Ndërprerja e MPH**

Kur do të arrihen qëllimet për të cilat janë përcaktuar masat ose do të përfundojnë së ekzistuari, organi që ka lëshuar ose ka vazhduar urdhëresën është i detyruar që menjëherë të urdhërojë ndërprerje të masave.

Nëse prokurori publik heq dorë nga ndjekja penale ose nëse të dhënat e siguruarra me masa të posaçme hetimore nuk kanë relevancë për zhvillim të procedurës, të dhënat do të shkatërrohen nën mbikëqyrje të gjykatësit, e për këtë prokurori publik do të përpilojë procesverbal.

### **6.4. Informimi i personit përkatës**

Neni 262 i LPP-së ka paraparë mundësinë që personi i prekur të mundet të kërkojë që urdhëresa me shkrim me të cilën përcaktohen masat e posaçme hetimore t'i dorëzohet, pa marrë parasysh nëse pas zbatimit të masave të posaçme hetimore janë ngritur apo jo aktakuza kundër atij personi.

Vendimin se a do t'i jepet ky lloj urdhri personit të prekur e merr prokurori publik, sepse ligji ia jep të drejtën të vlerësojë a do ta dëmtojë procedurën me dërgimin e urdhrit.

Për dallim nga LPP i RMV-së, LPP i Bosnjës dhe Hercegovinës parasheh informim të detyrueshëm të personit ndaj të cilit është përcaktuar dhe zbatohet ndonjë masë e posaçme hetimore, pas përfundimit të kësaj mase. Në këtë rast nuk është me rëndësi për cilat arsye ka përfunduar masa e posaçme hetimore, gjegjësisht a ka përfunduar për shkak të skadimit të afatit ose është ndaluar sepse kanë përfunduar shkaqet për të cilat është përcaktuar. Ky përcaktim i ligjit mbështetet në të drejtën e personit (ndaj të cilit është përcaktuar masa) për ta kontestuar ligjshmërinë e saj, respektivisht të parandalojë kufizimin eventual të pabazë dhe joligjor të të

drejtave dhe lirive të tij (*H. Sierciq, Coliq, Komente për Ligjin për Procedim Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës, Sarajevë 2005, faqe 371*).

Ligji i lejon personit të prekur që kërkesën për t'ia dhënë urdhëresën me shkrim të mund ta dorëzojë edhe në gjykatë, respektivisht gjykatësit për procedurë paraprake si organ që përcakton masën e posaçme hetimore. Edhe pse kjo nuk potencohet në ligj, edhe gjykatësi i procedurës paraprake mund të vendosë që të mos e dërgojë urdhëresën nëse për këtë ka tregues se do ta dëmtojë procedurën.

Krahas lajmërimit të personave të prekur, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut një herë në vit Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut i dorëzon raport për masat e posaçme hetimore, të kërkuara për vitin paraprak kalendarik. Në këtë mënyrë opinioni publik kryen kontroll të zbatimit të masave të posaçme hetimore, të cilat duhet të jenë të rregulluara me ligj që të pamundësohet keqpërdorimi i tyre dhe shkelja e pabazë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Por, kontrolli që kryen Kuvendi paraqet vetëm një vështrim në dinamikën statistikore të zbatimit të këtyre masave.

### **6.5. Qasja ligjore në të dhënat e siguruar**

Sipas nenit 264 të LPP-së, secili person që në cilëndo mënyrë siguron të dhëna që kanë të bëjnë me zbatimin e masave të posaçme hetimore apo burojnë nga to, është i detyruar t'i ruajë si sekret zyrtar.

Neni 31 i LPP-së po ashtu detyron ose obligon personat nga organe të autorizuara për zbatim të masave për ndjekje të komunikimeve, personat nga ATO dhe përfaqësuesit e operatorëve që në çfarëdo lloj mënyre kanë mësuar të dhëna që kanë të bëjnë ose burojnë nga zbatimi i masave për ndjekje të komunikimeve, t'i ruajnë ato si sekret zyrtar. Ky obligim zgjat derisa zgjat mandati i ATO-s, gjegjësisht marrëdhënia e punës, si dhe pas përfundimit të kontratës, për periudhë pesëvjeçare. Kjo nuk përfshin të dhënat e siguruar në mënyrë joligjore.

### **6.6. Shlyerja ose shkatërrimi i të dhënave të mbledhura personale**

Duke marrë parasysh faktin se objekt përpunimi i masës së posaçme hetimore nga neni 252, paragrafi 1, pika 5 e LPP-së janë të dhëna personale të qytetarëve, kjo pjesë është rregulluar si segment në vete dhe parasheh obligim për shlyerje, respektivisht shkatërrim të të dhënave personale të mbledhura.

Afati lidhet me mosprocedim penal, pas përfundimit të 15 muajve nga ndalesa e zbatimit të masës.

Neni 267 i LPP-së përkufizon:

Nëse në afat prej 15 muajve pas përfundimit të zbatimit të masës nga neni 252, paragrafi 1, pika 5 të këtij ligji nuk ngrihet procedurë penale, të gjitha të dhënat e mbledhura personale shlyhen ose shkatërrohen nën mbikëqyrje të gjykatësit të procedurës paraprake, prokurorit publik dhe përfaqësuesit të Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për këtë prokurori publik do të përpilojë procesverbal.

Shlyerje, gjegjësisht shkatërrimi kryhet nën mbikëqyrje të gjykatësit të procedurës paraprake, si organ kompetent për përcaktim të kësaj mase të posaçme hetimore, prokurorit publik, si dhe në prani të përfaqësuesit të Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Drejtoria paraqet or-

gan të pavarur me karakter të subjektit juridik, që është kompetent për mbikëqyrje të ligjshmërisë së aktiviteteve të ndërmarra gjatë përpunimit të të dhënave personale dhe mbrojtjen e tyre në territorin e vendit tonë. Prokurori publik e ka për detyrim të përpilojë procesverbal nga shlyerja, respektivisht shkatërrimi i të dhënave të mbledhura personale.

### **6.7. Ruajtja dhe asgjësimi i të dhënave të siguruara me masat e posaçme hetimore për ndjekje të komunikimeve**

Në çdo shoqëri demokratike një nga çështjet kryesore është si të ruhen të dhënat e siguruara me masat e posaçme hetimore, gjegjësisht si do të asgjësohen, respektivisht “kush do t’u bëjë roje rojtarëve” (*Quis custodiet ipsos custodes*).

Ruajtjen e të dhënave të mbledhura dhe të përpunuara me ekzekutim të Urdhrit për zbatim të masave për ndjekje të komunikimeve, derisa zgjasin masat, e bën prokurori publik përgjegjës, e pas vendimit të Prokurorisë Publike, të dhënat dorëzohen në gjykatë. Nëse prokurori publik merr vendim me të cilin hetimi mbyllet pa mundësi rihapjeje, të dhënat e siguruara me masat e posaçme hetimore i dorëzohen gjykatësit të procedurës paraprake. Kur prokurori publik ngre aktakuzë, e gjykata merr vendim për lirim ose refuzim, në atë rast të dhënat e siguruara me masat e posaçme hetimore ruhen në gjykatë, derisa të përfundojnë afatet për parashkrim të ndjekjes penale. Në rast se është marrë vendim për dënim, këto të dhëna ruhen deri në përfundim të afatit për parashkrim të ekzekutimit të sanksionit penal. Pas përfundimit të afateve të parapara, të dhënat asgjësohen dhe për këtë përgatitet raport.

Vendimin për asgjësimin e të dhënave e merr gjykatësi i procedurës paraprake, mbi bazë të një kërkesëje të posaçme apo në vijë zyrtare. Kërkesën e parashtron prokurori publik përgjegjës ose person i interesuar. Asgjësimin e të dhënave e bën gjykatës i emëruar nga kryetari i gjykatës ku zhvillohet procedura penale për të cilën përdoren të dhënat. Për asgjësimin e kryer, gjykatësi përgatit raport. Të dhënat e siguruara përmes masave të posaçme hetimore të dekretuara nga Gjykata Themelore 1 Shkup nga viti 2007 deri më tani, ruhen në gjykatë. Deri më tani nuk është formuar komision për asgjësim të këtij materiali.

Kur për shkaqe mbrojtjeje të interesave dhe sigurisë së shtetit do të vlerësohet se janë të rëndësishme për masën e zbatuar, të dhënat e siguruara me masa për ndjekje të komunikimit do të ruhen te organe të autorizuara për zbatim të masave, konform rregullave për mbrojtje të të dhënave personale dhe informatave të klasifikuara, në periudhë 3 vjeçare, llogaritur nga përfundimi i kohëzgjatjes së urdhëresës. Ky afat prej 3 vitesh mund të rifillojë në rast të sigurimit të informatës së re, që drejtpërdrejtë lidhet me të dhënat specifike të cilave ende nuk u ka përfunduar afati i ruajtjes. Në raste kur periudha prej 3 vitesh vazhdohet, duhet të bëhet dhe dokumentohet vlerësim periodik i nevojës për ruajtje të të dhënave specifike në nivel vjetor. Këto të dhëna janë objekt vlerësimi me qëllim që të përcaktohet a janë të rëndësishme për qëllimet për të cilat është zbatuar masa për ndjekje të komunikimeve. Mënyrën e përcaktimit të relevancës së të dhënave e përcakton Drejtori i Agjencisë për Siguri Kombëtare, respektivisht Ministri i Mbrojtjes, secili nga kompetenca e vet.

Të dhënat dhe informatat e siguruara përmes zbatimit të MPH-së, do të asgjësohen nën mbikëqyrje të gjykatësit të procedurës paraprake, i cili do të përpilojë raport special për këtë në dy raste: nëse prokurori tërhiqet nga ndjekja dhe nëse informatat dhe të dhënat e siguruara nuk

janë të domosdoshme për procedura penale. Kur ndërmerret veprimi për asgjësim dhe shlyerje, personi përkatës njoftohet me shkrim. Pas kësaj, gjykatësi i procedurës paraprake do ta njoftojë personin ndaj të cilit procedura është sjellë pa shtyrje dhe ai person mund të kërkojë nga gjykata ta shqyrtojë ligjshmërinë e fleturdhëresës dhe mënyrën se si ajo është realizuar për masën e zbatuar. Rrjedhimisht, personi që mendon se është dëmtuar me zbatimin e masës në raport me të drejtat dhe liritë e tij, mund të kërkojë nga gjykata ta shqyrtojë ligjshmërinë, mënyrën e zbatimit të saj, si dhe urdhëresat gjyqësore që japin bazën për zbatimin e saj, e që është edhe një aspekt i mbrojtjes së qytetarëve nga ndërhyrja jolegale në të drejtat dhe liritë e tyre. Të dhënave dhe informatat e siguruar me ndërmarrje të veprimeve të posaçme hetimore ruhen deri sa të zgjasë procedura gjyqësore.

### **Praktika gjyqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

Bëhet fjalë për lëndën e njohur si “Hiri”, KOK. nr.03/09, ku janë zbatuar edhe masat e posaçme hetimore ndaj avokatëve që kanë përfaqësuar të akuzuarit. Ndaj avokatëve nuk është zhvilluar proces, e as që kanë qenë të dyshuar; të gjitha të dhënat janë dorëzuar nga PSP pas përfundimit të procedurës hetimore, kur tani më kishte filluar seanca dëgjimore kryesore pas akuzës së ngritur. Këto të dhëna në vazhdim të procedurës janë tërhequr nga PSP, por deri më tani personat ndaj të cilëve nuk është ngritur aktakuzë dhe zbatuar masat e posaçme hetimore, nuk janë ftuar për asgjësim të të dhënave të siguruar me MPH.

## SHTOJCA TË PJESËS 2

### HAPAT GJATË ZBATIMIT TË MPH

#### PROPOZIM

- **Policia gjyqësore përgatit propozim për përcaktim të MPH-së deri te prokurori publik.**
- **Propozimi përmban:**
  - Të dhëna të sakta për personat dhe objektet për të cilët propozohet zbatimi i MPH-së (në qoftë se është përcaktuar identiteti i tyre);
  - Llojin e masës që propozohet;
  - Shkaqet e arsytuara për të cilat propozohet përcaktimi i masave MPH.

#### PRANIMI

- **Pranimi i propozimit të policisë gjyqësore në Prokurorinë Themelore Publike**
  - Personi i autorizuar, propozimin e prokurorit publik e evidenton në librat e posaçëm intern, të cilat ruhen në kasafortë të posaçme;
  - Propozimi merr numër unik identifikues, i cili mbetet i njëjtë gjatë tërë kohës së zbatimit të masave MPH.

#### VLERËSIMI

- **Prokurori publik me vetiniciativë ose me propozim të personit të autorizuar nga policia gjyqësore vlerëson se a ka nevojë për masat MPH.**

#### PËRGATITJA E KËRKESËS

- **Nëse ka nevojë për zbatim të masave MPH, prokurori publik përgatit kërkesë.**
- **Kërkesa është në formë të shkruar dhe përmban:**
  - Emërtim ligjor të veprës penale, person apo objekt ndaj të cilit do të zbatohen masa MPH;
  - Mjete teknike që do të zbatohen;
  - Vëllimin dhe vendin e zbatimit të masave MPH;
  - Njohuritë dhe dëshmitë mbi të cilat mbështeten bazat e dyshimit;
  - Arsyetimin e shkaqeve, sipas të cilave të dhënat apo dëshmitë nuk mund të grumbullohen në mënyrë tjetër;
  - Organin i cili duhet ta zbatojë urdhëresën;
  - Kohëzgjatjen e masës;
  - Llojin e sistemit të telekomunikacionit, numrin e telefonit apo të dhënë tjetër për identifikim, si dhe numrin identifikues të secilit prej tyre veç e veç.

#### DORËZIMI

- **Prokurori publik ia dorëzon kërkesën gjykatësit kompetent.**

#### VEPRIMI

- **Veprimi në bazë të kërkesës për përcaktimin e masave MPH nga ana e gjykatësit kompetent/gjykatësit në procedurë paraprake:**

- Kërkesa e prokurorit publik për ndjekje dhe incizim të telefonit apo të komunikimeve të tjera elektronike evidentohet në regjistrin RNAK;
- Evidentohet numri rendor i urdhëresës së dhënë, data e pranimit të kërkesës, personi që e bën kërkesën, personat për të cilët kërkohet zbatimi i MPH-së, vepra penale, kohëzgjatja e masës dhe data e dhënies së saj;
- Pas marrjes së numrit të regjistrimit, kërkesa dorëzohet te gjykatësi kompetent.

## LISTA E DORËZIMIT

- **Përpilimi i listës së dorëzimit.**
- **Lista e dorëzimit përmban:**
  - Numrin e lëndës, shkallën e klasifikimit, shenjën e Prokurorisë Publike, datën dhe orën e pranimit dhe të dhënat, nënshkrim personal dhe datë të çdo personi që ka qasje tek ajo.
- **Të gjithë personat që kanë qasje deri te këto masa posedojnë certifikatë të sigurisë.**

## LËSHIMI I URDHËRESËS

- **Gjykatësi/gjykatësi në procedurë paraprake e përgatit urdhëresën.**

## ANONIMIZIMI

- **Anonimizimi i urdhëresës, e cila dorëzohet në ATO:**  
Numri i urdhëresës dhe organi që e ka lëshuar;  
Mjetet teknike që do të zbatohen;  
Kohëzgjatja e MPH-së dhe numri ID;  
Lloji i sistemit të telekomunikacionit, numri i telefonit apo e dhënë tjetër për identifikim si dhe numri ID për secilin veç e veç.
- **Anonimizimi i urdhëresës për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit:**  
Numri i urdhëresës dhe organi që e ka lëshuar;  
Kohëzgjatja e masës;  
Numri identifikues.

## DORËZIMI I URDHËRESËS

- **Urdhëresa dorëzohet në Prokurori Publike.**

## RAPORTET

- **Gjatë kohës së zbatimit të MPH-së, policia gjyqësore përgatit raport të cilin ia dorëzon prokurorit publik me kërkesë të tij dhe për çdo rast në çdo 30 ditë**

## RAPORTI PËRFUNDIMTAR

- **Pas zbatimit të masave, policia gjyqësore përgatit raport përfundimtar, të cilin e dorëzon te prokurori publik.**


## VENDIMI

- **Prokurori publik merr vendim.**

## DORËZIMI NË GJYKATË


- **Raportin përfundimtar dhe dokumentacionin e përgjithshëm për shënimin teknik, prokurori publik në afat prej tetë ditësh e dorëzon tek gjykata.**

## NDJEKJA E KOMUNIKIMEVE TE HETIMET PENALE ME NDËRMJETËSIM TË ATO-S





**NDJEKJA E KOMUNIKIMEVE TE HETIMET PENALE PA NDËRMJETËSIMIN E ATO-S**





# PJESA 3

---

SIGURIA KOMBËTARE



## 1. Nocioni i sigurisë kombëtare

### 1.1. Përkufizimi i nocioneve siguri dhe mbrojtje kombëtare në legjislacionin vendor

Nocioni i sigurisë kombëtare në vendin tonë për herë të parë me ligj është përkufizuar në Ligjin për Koordinimin e Bashkësisë së Sigurimit dhe Zbulimit (Gazeta zyrtare e RMV-së, nr. 108 i datës 28.5.2019). **Domethënë, Siguria kombëtare është gjendje e stabilitetit social, ekonomik dhe politik, e cila është e nevojshme për ekzistimin dhe zhvillimin e shtetit si shtet sovran, demokratik, i pavarur dhe social, si dhe për ruajtjen e rendit kushtetues, ose gjendje për realizimin e papengueshëm të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit në pajtueshmëri me Kushtetutën.**

Ky përkufizim ligjor në parim është në pajtueshmëri me përkufizimet në dokumentet ndër-kombëtare, mirëpo sigurinë kombëtare e përcakton në mënyrë më të ngushtë. Interesat e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare të vendit tonë burojnë drejtpërdrejt nga vlerat themelore të përcaktuara në Kushtetutë, të cilat janë:

- ruajtja e pavarësisë, e sovranitetit dhe integritetit territorial, e karakterit unitar të shtetit si kornizë e rëndësishme për ruajtjen dhe përparimin e identitetit shtetëror si dhe kultivimin e shprehjes së lirë të identitetit etnik dhe kulturor të të gjithë qytetarëve;
- mbrojtja dhe avancimi i paqes dhe sigurisë, të jetës dhe të shëndetësisë, të pronës dhe të sigurisë personale të qytetarëve;
- ruajtja dhe avancimi i vlerave demokratike të shtetit;
- të drejtat dhe liritë e njeriut;
- ruajtja dhe avancimi i demokracisë së fortë dhe funksionale multietnike;
- integrim politik dhe mbrojtës në NATO, integrim politik, ekonomik dhe të sigurisë në Bashkimin Evropian dhe pjesëmarrje aktive në format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Mbrojtja e shtetit është sistem i mbrojtjes së pavarësisë dhe integritetit territorial të tij, ndërkaq realizohet në pajtueshmëri me Kushtetutën, Ligjin për Mbrojtje dhe ligjet e tjera, me Strategjinë për Mbrojtjen e Shtetit, dokumenteve dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të ratifikuara në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Mbrojtjen e shtetit e realizojnë qytetarët, organet e pushtetit dhe Armata si forcë e armatosur. Personat juridikë, sipas nevojës mund të kryejnë detyra të caktuara nga fusha e mbrojtjes. Mbrojtja e shtetit mund të realizohet edhe përmes bashkëpunimit të sistemeve kolektive të sigurisë dhe mbrojtjes në të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut është e anëtarësuar (Ligji për Mbrojtje).

Bota sot karakterizohet me ndryshime të shpejta dhe dinamike, të cilat, shpesh me vete bartin rreziqe të reja, shpesh të paparashikueshme dhe rreziqe për sigurinë e shteteve. Edhe pse rreziku nga kanosja klasike për luftë në një periudhë të gjatë nuk pritët, kanosjet joluftarake jo vetëm që janë të llojllojshme, por edhe u rritën në intensitet, në kohë dhe në hapësirë.

Trendi i globalizimit të botës, përsëri përparësive, solli edhe kërcënime, të provokuara nga ndër-kombëtarizimi i disa rreziqeve të caktuara, nga të cilat më ekstremë janë terrorizmi ndërkombëtar dhe krimi i organizuar. Përveç këtyre, në rritje e sipër janë edhe migrimi ilegal si dhe tregtia ilegale me drogë, armë, njerëz dhe materiale strategjike. Gjithashtu, është rritur edhe rreziku nga përdorimi i armatimit për shfarosje masive, gjë që është e ndaluar sipas së drejtës ndërkombëtare.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare të sigurisë - OKB, NATO, BE dhe OSBE mundëson pjesëmarrje aktive në krijimin e politikave globale të mbrojtjes dhe përmirësimit të aftësive kombëtare për menaxhimin me kanosjet, rreziqet dhe sfidat e reja si dhe udhëheqjen me kapacitetet civile dhe ushtarake.

Koncepti i sigurisë kombëtare ka të bëjë me vlerat shtetërore: territorin, sovranitetin, interesat e politikës së jashtme dhe ekonomisë kombëtare, që mbrohen nga sulmet ushtarake nga jashtë, kryengritje të armatosura nga brenda dhe aktivitete subversive zbuluese nga persona të brendshëm dhe të jashtëm.

Në nenin 8, paragrafin 2 të KEDNj-së në mënyrë eksplicite është theksuar nocioni “siguri kombëtare” si një nga bazat legjitime për zbatimin e masave invazive dhe kufizim të të drejtave dhe lirive themelore të mbrojtura me paragrafin 1 nga i njëjti nen (“në interes të sigurisë kombëtare”). Në praktikën gjyqësore të KEDNj-së më shumë herë theksohet arsyeshmëria dhe rëndësia e kësaj baze legjitime për shtrëngim shtetëror.

Kështu, në rastin e *Klas kundër Gjermanisë*, KEDNj thekson se “autorizimet për mbikëqyrje të fshehtë të qytetarëve, karakteristike për shtetet policore, tolerohen në kuadër të KEDNj-së vetëm kur në mënyrë strikte është e nevojshme për mbrojtjen e institucioneve demokratike”. Kështu, mendohet se krimi i organizuar, terrorizmi apo spiunimi mund të sajojnë nevojën e shkallës së lartë të përzjerjes në jetën private të individit, për shkak të rrezikut serioz ndaj shoqërisë demokratike, por në çdo rast duhet të merret parasysh nga njëra anë rëndësia shoqërore e qëllimit, ndërkaq nga ana tjetër niveli i imponimit në jetën private të qytetarëve.

Në Kushtetutën e Republikës së MV-së nuk është theksuar në mënyrë eksplicite nocioni siguri kombëtare, as edhe nuk ka dispozita të cilat sqarojnë kuptim të ndryshëm, të sigurisë së brendshme dhe të jashtme, megjithatë ngjashëm me nenin 8 nga KEDNj, paragrafi 2 nga neni 17 (Amendamenti 19) i Kushtetutës (njëlloj edhe neni 122) si një nga bazat legjitime për zbatim të masave për ndjekje të komunikimeve theksohet: “kur atë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës”. Kjo dispozitë pa dyshim tregon se ligjvënësi bën dallim në mes të nocioneve “siguri” dhe “mbrojtje”, ku me nocionin siguri Kushtetuta nënkupton siguri të brendshme, ndërsa me nocionin “mbrojtje” Kushtetuta nënkupton siguri të jashtme. Të dyja, kushtimisht thënë, lloje të ndryshme të sigurisë, janë të lidhura mes veti, përbëjnë një bashkësi të pandarë dhe paraqesin ekuivalent të nocionit siguri kombëtare.

Siguria kombëtare sot e nënkupton sigurinë e shtetit dhe shoqërisë pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, racore dhe ideologjike të qytetarëve të tij. Shtetet ndajnë resurse të konsiderueshme (njerëzore, materiale, teknike dhe organizative) për mbrojtje në të gjitha nivelet e sigurisë kundër provokimeve të ndryshme, kanosjeve dhe rreziqeve. Siguria nënkupton gjendje të implementimit të papenguar, zhvillim dhe mbrojtje të vlerave dhe interesave kombëtare dhe shtetërore që arrihen, ruhen dhe avancohen përmes sistemit të sigurisë kombëtare dhe mekanizmeve të sigurisë, me qëllim që të arrihet zhdukja e frikës individuale dhe kolektive nga kanosjet

si dhe krijimi i ndjenjës kolektive të qetësisë, sigurisë dhe kontrollit të ngjarjeve të ardhshme me rëndësi për jetën e shoqërisë dhe shtetit.

Për këtë, është e nevojshme themelimi dhe ngritja e institucioneve specialistike të sigurisë në bazë të ligjeve në përputhje me Kushtetutën e shtetit, po ashtu edhe në përputhje me konventat ndërkombëtare, rezolutat, deklaratat, marrëveshjet, rekomandimet, aktgjykimet dhe vendimet e gjyqeve ndërkombëtare. Në parim, legjislacioni kombëtar duhet të bazohet në të drejtën ndërkombëtare, për këtë në vazhdim më detajisht do të sqarohet baza juridike ndërkombëtare për siguri kombëtare.

## 1.2. Dokumente juridike ndërkombëtare për siguri kombëtare dhe ndërkombëtare

**Deklarata e Kombeve të Bashkuara** paraqet një nga bazat juridike ndërkombëtare të sigurisë kombëtare. Qëllimet e Kombeve të Bashkuara, të theksuara në nenin 1 të Deklaratës janë: ruajtja e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, dhe, për atë qëllim të ndërmerren masa kolektive efikase me qëllim që të parandalohen dhe të evitohen kanosjet për paqen, në përputhje me parimet e drejtësisë dhe të drejtës ndërkombëtare të përdoren mjete paqësore për zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare ose situatave që do të mund të sillnin deri te prishja e paqes; zhvillim i marrëdhënieve miqësore mes popujve në bazë të respektimit të parimit të barazisë dhe vetëvendosjes së popujve, arritja e bashkëpunimit ndërkombëtar me zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare; promovim dhe respektim i të drejtave dhe lirive themelore të çdo qenieje njerëzore, pa dallim të racës, gjinisë, gjuhës ose religjionit.

**Deklarata për Parimet e të Drejtës Ndërkombëtare për Marrëdhënie Miqësore dhe Bashkëpunim mes Shteteve**, e cila është miratuar në pajtueshmëri me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara, i promovon dhe i operacionalizon idetë dhe vlerat e Deklaratës së Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë para së gjithash si vijon: ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare; zhvillimin e marrëdhënieve miqësore, bashkëpunim dhe tolerancë mes kombeve; respektimin e sundimit të së drejtës dhe obligimet e marra me nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Në këtë kontekst **Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)** ka rëndësi të madhe. Gjegjësisht, në dokumentet përfundimtare të Samiteve të OSBE-së theksohet bashkëpunimi i shteteve në planin e sigurisë, pastaj respektimi i të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të së drejtës; lirisë ekonomike, të drejtës sociale si dhe përgjegjësisë ndaj mjedisit jetësor; marrëdhënieve miqësore mes vendeve pjesëmarrëse; sigurisë në bazë të zvogëlimit të forcave të armatosura konvencionale dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë; udhëzime për ardhmërinë sa i përket dimensionit njerëzor (të drejta dhe liri njerëzore dhe minoritare); kultura dhe zhvillimi; të drejtat e punëtorëve migrantë; forcimin e rolit të organizatave joqeveritare e të tjera. Deklarata e Lisbonës e OSBE-së, e miratuar në vitin 1996, ka të bëjë me modelin e përbashkët dhe gjithëpërfshirës të sigurisë për Evropën në shekullin njëzet e një. Kështu, në këtë Deklaratë theksohet nevoja për veprimin e përbashkët ndaj provokimeve që ndikojnë në sigurinë dhe sovranitetin e shteteve si dhe në stabilitetin e shoqërive. Strategjia e OSBE-së për zgjidhjen e kërcënimeve për sigurinë dhe stabilitetin në shekullin njëzet e një, e miratuar në fundin e vitit 2003 i identifikonte kërcënimet më serioze për sigurinë në Evropë dhe mekanizmat për luftën kundër këtyre kërcënimeve. Kërcënimet më serioze përfshijnë konflikte në dhe mes shteteve dhe lidhjet e tyre me terrorizmin, prodhimi i armëve për zhdukje masive, akumulimi dhe distribuimi i pakontrolluar i ar-

matimit të imët dhe të lehtë, shkeljen e të drejtave të njeriut, keqësimi i gjendjes sociale dhe ekonomike dhe migrimet ilegale; terrorizmi; krimi i organizuar, sidomos kontrabanda me migrantë, trafikimi me qenie njerëzore, tregtia me droga jolegale, armë, materiale dhe teknologji të dijshme; diskriminimi dhe jotoleranca, posaçërisht ksenofobia, racizmi, antisemitizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm; provokimet dhe kërcënimet ekonomike, të cilat e rrezikojnë stabilitetin dhe sigurinë; rreziqet dhe kërcënimet ekologjike, në rend të parë duke përfshirë eksploatimin e papërmbytur të resurseve natyrore, menaxhimin e keq me mbeturinat dhe ndotjen dhe të tjera. Gjithashtu, Strategjia përmban orientime strategjike për preventivë, zbutjen e pasojave nga këto provokime, rreziqe dhe kërcënime për sigurinë përmes bashkëpunimit ndërkombëtar mes sistemeve kombëtare të sigurisë dhe qasjes multidimensionale për siguri të përbashkët, gjithëpërfshirëse, kooperative dhe unike.

**Këshilli i Evropës**, nga ana tjetër, standardet e veta për mbikëqyrje dhe zbatimin ligjor të masave intruzive si dhe mbikëqyrjen e kompetencave të organeve të ndjekjes i krijon dhe i riafirmon përmes trupave të tij dhe atë: *Komisionit të Venecias, Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës*.

Në këtë kontekst, **Komisioni i Venecias** i Këshillit të Evropës ka rol të rëndësishëm në sigurinë e kontrollit demokratik mbi shërbimet e sigurisë. Raporti i Komisionit të Venecias për vitin 1988 për mbikëqyrje demokratike të shërbimeve të sigurisë ishte dokumenti i parë i rëndësishëm i miratuar nga ndonjë organizatë ndërkombëtare lidhur me mbikëqyrjen e punës së shërbimeve për siguri. Përmes raporteve plotësuese gjithëpërfshirëse, Komisioni siguroi analizë gjithëpërfshirëse të formave dhe modeleve të mbikëqyrjes si dhe të punës së shërbimeve të sigurisë, që përfshin konkluzione të detajuara për mbikëqyrje parlamentare, gjyqësore dhe të ekspertëve të këtyre shërbimeve.

Rekomandimet udhëzojnë në:

- zmadhimin e kapaciteteve të shërbimeve për kontroll të shërbimeve për siguri gjatë ndjekjes së komunikimeve dhe
- vendosjen e mekanizmave për përgjegjësi dhe vendosjen e mekanizmave adekuat për ankesa.

Komisioni përmes raporteve i identifikoi nevojat për kontroll të brendshëm dhe efektiv në kuadër të shërbimeve të sigurisë dhe zbatimin e masave intruzive në përputhje me ligjin, njëkohësisht duke përfshirë edhe kontrollin e shërbimeve që i zbatojnë ato masa, procedurë për të siguruar kërkesë për zbatimin e atyre masave në rastet e mbrojtjes së sigurisë së shtetit dhe mbikëqyrje gjyqësore si dhe edukim për të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike të të gjitha subjekteve në këtë proces.

Lidhur me mbikëqyrjen parlamentare, Komisioni i Venecias rekomandon që parlamenti të ketë kompetencë të jashtëzakonshme që të zgjedhë anëtarët e trupit parlamentar për mbikëqyrje të zbatimit të masave intruzive, pa sugjerime nga ana e pushtetit ekzekutiv. Përbërja e trupit mbikëqyrës duhet të jetë ndërpartiake me përfshirje të drejtë të anëtarëve të partive opozitare, si dhe personelin ndihmës me ekspertizë adekuate.



Lidhur me mbikëqyrjen gjyqësore, Komisioni i Venecias rekomandon zbatimin e edukimeve të specializuara për gjykatës, të cilët do të lejojnë edhe mbikëqyrjen e masave intruzive për qëllime të sigurisë kombëtare.

Rekomandimet për trupat mbikëqyrëse të ekspertëve tregojnë se Kuvendi (e jo pushteti ekzekutiv) duhet t'i emërojë anëtarët e trupave për mbikëqyrje të shërbimeve të sigurisë nga opinioni i ekspertëve si edhe t'i kontrollojë raportet e tyre. Çdo ndikim nga ana e pushtetit ekzekutiv është i reduktuar. Raporti, gjithashtu udhëzon se nuk është e mjaftueshme që mekanizmat mbikëqyrëse të koncipohen teoretikisht, por patjetër duhet të sigurohen mekanizma adekuatë dhe kapacitete njerëzore për zbatimin e tyre në praktikë. Lidhur me raportin për mbikëqyrjen e punës së shërbimeve të sigurisë, në Raportin e Komisionit të Venecias të vitit 2015 janë dhënë rekomandime të detajuara të mekanizmave për mbrojtje dhe mbikëqyrje të punës së shërbimeve të sigurisë dhe zbatimin e masës intruzive lidhur me mbikëqyrjen e përgjithshme (mbikëqyrje pa synim të caktuar) dhe shfrytëzimin e meta të dhënave (*meta data*).

**Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE)** përmes parimeve të miratuara

për mbikëqyrje të shërbimeve të sigurisë dhe zbatimin e masave intruzive në formë të rezolutave, udhëzimeve dhe raporteve ka luajtur rolin e vet drejt ngritjes së kornizës juridike për mbikëqyrje të punës së shërbimeve të sigurisë në të gjitha shtetet - anëtare të Këshillit të Sigurisë. Rekomandimet e aprovuara të APKE, (të përbërë nga 47 shtete evropiane) fokusohen drejt etablimit të komiteteve të specializuara në kuadër të parlamenteve kombëtare për përmirësimin e kapaciteteve të mbikëqyrjes parlamentare ndaj masës intruzive dhe punës së shërbimeve të sigurisë. Theksi i rekomandimeve është vënë te bashkëpunimi institucional dhe shkëmbimi i informatave mes shërbimeve të sigurisë të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

Në punën e Komitetit për Marrëdhënie Juridike dhe të Drejtat e Njeriut, është shprehur nevoja e vënies së mekanizmave efikas mbikëqyrës, të cilët do të kishin për qëllim këmbimin e informatave ndërmjet shërbimeve të sigurisë. Kjo, posaçërisht është e rëndësishme duke pasur parasysh sasinë e madhe të informatave të dërguara dhe të marra nga partnerët e jashtëm.

**Komisariati për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës** gjithashtu ka miratuar konkluzione dhe rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e punës së shërbimeve të sigurisë në raport me ndjekjen e përgjithshme të komunikimeve. Në rekomandimet e Komisarariatit theksohet rëndësia e respektimit të të drejtave të njeriut në kuadër të masave intruzive nga ana e shërbimeve të sigurisë me qëllim të pasjes së sistemit efikas për mbikëqyrje demokratike. Këtu, rekomandimet e theksojnë rëndësinë e drejtimit të brendshëm të shërbimeve të sigurisë si dhe mbikëqyrjen dhe kontrollin e tyre, ashtu si është theksuar në rekomandimet e Komisionit të Venecias. Komisaritati ka kompetenca të japë edhe rekomandime individuale për drejtimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut të theksuara në Konventën e të Drejtave të Njeriut për çdo shtet anëtar nga aspekti i përforcimit të mbikëqyrjes të punës së shërbimeve për siguri në zbatimin e masave intruzive.

Sa i përket **Bashkimit Evropian** mund të thuhet se Marrëveshja e Mastroitit e vitit 1992 paraqet projekt serioz për drejtësi dhe punë të brendshme, shtylla e tretë e BE-së. Më saktësisht, dispozitat theksojnë se Bashkimi dhe vendet anëtare e përkufizojnë dhe e zbatojnë politikën e jashtme dhe të sigurisë si të përbashkët me qëllim: mbrojtjen e vlerave të përbashkëta, interesat bazë dhe pavarësinë e Unionit; forcimin e sigurisë së Unionit dhe të vendeve anëtare në të gjitha format; ruajtjen e paqes dhe forcimin e sigurisë ndërkombëtare në përputhje me Kartën e

Kombeve të Bashkuara, sundimin e ligjit si dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Unioni (BE), këto qëllime i ushtron me vënien e bashkëpunimit të përhershëm mes vendeve anëtare për zbatimin e politikës, me këmbimin e informatave dhe sjelljen e vendimeve në Këshillin e Bashkimit Evropian për çdo çështje nga interesi i përgjithshëm në sferën e politikës së jashtme dhe të sigurisë, sinkronizimin e politikave kombëtare me pozicionet e përbashkëta të shteteve anëtare me organizata të tjera ndërkombëtare, zbatimin e aksioneve të përbashkëta përmes procedurave të përcaktuara me dispozitat për politikën e përbashkët të sigurisë.

Maqedonia është anëtare e programit paqësor **Partneritet për Paqe në Aleancën Veriatlantike (NATO)**, por me nënshkrimin e Marrëveshjes për qasje dhe anëtarësimi i pritshëm i plotë në NATO imponon nevojën për pajtueshmëri të kornizës juridike, procedurat dhe punën praktike në sferën e sigurisë. Marrëveshja Veriatlantike e vitit 1949 i obligon vendet anëtare që të zhvillojnë marrëdhënie ndërkombëtare paqësore dhe miqësore, gjegjësisht përforcimin e institucioneve të tyre të sigurisë si dhe me eliminimin e konflikteve në politikën ekonomike ndërkombëtare, dhe, të zhvillojnë bashkëpunim ekonomik. Për këtë qëllim, palët e marrëveshjes obligohen t'i ruajnë dhe zhvillojnë kapacitetet e tyre vetanake dhe kolektive, ndaras, dhe bashkërisht t'u kundërvihen sulmeve të armatosura, me ndihmë të ndërsjellë efikase dhe të vazhdueshme vetanake. Sulmi i armatosur ndaj njërit anëtar apo më shumë prej tyre do të konsiderohet sulm ndaj të gjithë anëtarëve nënshkrues të Marrëveshjes.

Koncepti i ri strategjik i NATO-s i vitit 2010 thekson disa çështje: përkushtim për parandalimin dhe menaxhimin me krizat dhe stabilizimin e situatave postkonfliktuale, para së gjithash përmes bashkëpunimit të ngushtë me OKB-në dhe BE-në; hapja ndaj të gjitha vendeve demokratike të Evropës, të cilat mund t'i përmbushin standardet për anëtarësim sepse zgjerimi kontribuon për Evropë të bashkuar, rritjen e efikasitetit të mbrojtjes së NATO-s me kërcënimet nga prodhimi i armatimit nuklear dhe armëve të tjera për shkatërrim masiv dhe nga terrorizmi, konfliktet jashtë Aleancës, sulmet kibernetike, kërcënimet për përdorim të armëve laserike, lufta elektronike, teknologjia etj. Përfundimisht, theksohet rëndësia e mjedisit jetësor, resurseve natyrore, kërcënimet shëndetësore, mungesa e ujit dhe zmadhimi i nevojave energjetike.

## **2. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar**

Siguria ndërkombëtare karakterizohet me ndryshime të shpejta, komplekse dhe dinamike si dhe ballafaqohet me kërcënime dhe rreziqe të reja asimetrike që janë në rritje: terrorizmi, krimi i organizuar transnacional, prodhimi i armatimit për shkatërrim masiv, radikalizmi dhe ekstremizmi, migracioni ilegal dhe sulmet kibernetike.

Sfidat, si pavarësia energjetike dhe ndryshimet klimatike po ashtu mund të kenë ndikim negativ në sigurinë ndërkombëtare. Duke i marrë parasysh dimensionet e kërcënimeve dhe rreziqeve bashkëkohore, qasja globale dhe bashkëpunimi me OKB-në, NATO-n, BE-në dhe OSBE-në janë instrumente të domosdoshëm për menaxhim të suksesshëm me ta në secilin vend, e sidomos në vendet e vogla, siç është Republika e Maqedonisë së Veriut.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare të sigurisë - OKB, NATO, BE dhe OSBE mundëson pjesëmarrje aktive në krijimin e politikës globale mbrojtëse dhe përmirësimin e aftësive

kombëtare për menaxhim me kërcënimet e reja, rreziqet dhe sfidat, si dhe udhëheqje më efikase me kapacitetet civile dhe ushtarake.

Shteti ynë obligohet të bashkëpunojë në planin ndërkombëtar, sepse këtë e kërkojnë dokumente të shumta juridike ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar nga Parlamenti ynë, siç janë: Konventat e OKB-së për shkatërrim të akteve të terrorizmit nuklear, për shkatërrim të financimit, të terrorizmit, pastrimit, kontrollit dhe konfiskimit të të ardhurave nga veprat kriminale që shfrytëzohen për financim të terrorizmit, si dhe Konventat e Këshillit të Evropës të cilat kanë të bëjnë me sfera të njëjta ose të ngjashme të sigurisë dhe sjellje të tjera kriminale.

Lufta kundër terrorizmit, kriminit të organizuar etj., është detyrë posaçërisht e ndërlikuar për të cilën duhet të ndërmerren një varg masash dhe aktiviteteve specifike, ndër të cilat bartëse duhet të jenë: bashkërenditje e mekanizmave dhe procedurave për këmbim të të dhënave, bashkëpunimi dhe ndërmarrja e aktiviteteve të përbashkëta, sidomos aktivitete që janë etabluar në vendet anëtare të BE-së dhe NATO-s.

Në kornizat e normave dhe parimeve demokratike si dhe respektimin e të drejtës ndërkombëtare, shteti ynë merr pjesë në parandalimin dhe zgjidhjen e krizave në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, sidomos në bashkëpunim me partnerët, me qëllim të mbrojtjes së interesave të bashkësisë ndërkombëtare. Në kuadër të atyre kornizave, në Programin Partneritet për Paqe, përfaqësues të Armatës së RMV-së marrin pjesë në aktivitete të stërvitjeve ushtarake dhe të tjera, si dhe misione humanitare për ruajtje të paqes nga ana e NATO-s dhe të udhëhequra nga NATO-ja.

Partneriteti strategjik me SHBA-në është me rëndësi të posaçme për sigurinë, stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe rajonit. Partneriteti dhe përkrahja nga ana e SHBA-ve rezultoi me ndihmë të fortë në ndërtimin e forcave ushtarake të Armatës së RMV-së, si dhe me kontribut të rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut në luftën globale kundër terrorizmit. Aktivitetet e mëtutjeshme do të vazhdojnë në drejtim të forcimit të kapaciteteve institucionale për identifikimin dhe ndarjen e obligimeve të cilat do të dalin nga anëtarësimi në NATO dhe BE.

Shërbimet e sigurisë janë të obliguara të ristrukturohen gjatë procesit të qasjes në NATO dhe të intensifikojnë bashkëpunimin me shërbimet gjegjëse të vendeve anëtare të NATO-s përmes implementimit të standardeve ekzistuese për mbledhje dhe këmbim të të dhënave dhe informatave me interes të përbashkët.

Bashkëpunimi i shërbimeve të sigurisë nënkupton mbledhje të të dhënave dhe informatave me interes të përbashkët ose me interes për vetëm një vend. Por, kur bëhet fjalë për vend anëtar të NATO-s atëherë Aleanca obligon të mblidhen informata për vend tjetër, nëse personi ose personat që paraqesin kërcënim për sigurinë qëndrojnë në territorin e vendit tonë. Kur do të vlerësohet se informatat nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër pos me zbatim të masave të posaçme - ndjekje të komunikimeve, atëherë shërbimi ynë i sigurisë do të veprojë në përputhje me procedurën ligjore të vendit tonë. Në rastet e këtilla, Prokuroria dhe Gjykata duhet të vlerësojnë propozimin ose kërkesën si edhe në rastet e tjera, por duhet të kenë parasysh edhe rrezikun e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare.

### **3. Roli dhe pozita e shërbimeve të sigurisë dhe të zbulimit në shoqërinë demokratike**

Nocioni shërbime të sigurisë dhe zbulimit ka të bëjë me të gjitha shërbimet e kundërzbulimit dhe zbulimit, shërbimet ushtarake dhe civile, të cilat me ligj janë të autorizuar të ndërmarrin masa dhe aktivitete për mbrojtjen e sigurisë së shtetit. Ata kanë rol të rëndësishëm në mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe respektimin e sundimit të së drejtës. Qëllimi kryesor i tyre është të mbledhin, analizojnë dhe përcjellin informata që ndihmojnë në krijimin e politikave shtetërore dhe institucioneve të tjera të autorizuara për ndërmarrje të masave të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Funksionet e këtyre shërbimeve ndryshojnë nga vendi në vend, megjithatë mbledhja, analiza dhe përcjellja e informatave relevante për mbrojtjen e sigurisë kombëtare është detyra kryesore e tyre.

Në esencë, shumica e shteteve e kufizojnë rolin e të ashtuquajturave shërbime sekrete të tyre që t'i pengojnë këto shërbime të ndërmarrin edhe aktivitete të tjera lidhur me sigurinë, të cilat tashmë kryhen nga institucione dhe organe të tjera shtetërore. Definimi i aktiviteteve që mund t'i kryejnë këto shërbime në shumë shtete janë përcaktuar me ligj, e me këtë mundësohet që aktivitetet e tyre të kufizohen në mbrojtjen e vlerave kushtetuese që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare.

Detyrat dhe autorizimet e shërbimeve për siguri dhe zbulim, të cilat përkufizohen në mënyrë precize me ligj, patjetër duhet të kufizohen në mbrojtjen e interesave legjitime të sigurisë kombëtare dhe të kërcënimeve të identifikuara për sigurinë kombëtare, të cilat shërbimet e kanë për detyrë t'i pengojnë. Njëkohësisht në më shumë vende evropiane (Rumani, Gjermani, Kroaci, Austri etj.) në ligje në mënyrë precize janë formuluar dhe numëruar të gjitha kërcënimet për sigurinë kombëtare, gjë që e lehtëson procesin e dhënies së llogarisë, duke u mundësuar organeve dhe trupave mbikëqyrëse për mbrojtje juridike t'i kontrollojnë këto shërbime gjatë kryerjes së funksioneve specifike. Po ashtu, shumë shtete kanë miratuar legjislacion që mundëson definicione precize të nocioneve: terrorizëm, grupe dhe aktivitete terroriste, financim dhe ndihmë të aktiviteteve terroriste etj., me çka zvogëlohet mundësia që nën ombrellën e luftës kundër terrorizmit të ndërmerren aktivitete të tjera ndaj grupeve dhe personave që nuk paraqesin kërcënim terrorist.

Shërbimet për siguri dhe zbulim janë organe shtetërore dhe pjesë e pushtetit ekzekutiv që kanë obligim të respektojnë sistemin juridik kombëtar dhe dokumentet e miratuara juridike ndërkombëtare nga ana e shtetit, sidomos atyre që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut. Kështu, nëse institucionet shtetërore të sigurisë shkelin ndonjë dispozitë të së drejtës ndërkombëtare, këtë nuk mund ta arsyetojnë me ligjet ose aktet kombëtare. Ideja e sundimit të së drejtës kërkon që këto shërbime sekrete të mos mund të ndërmarrin çfarëdo veprimi që do të shkelin të drejtën kombëtare apo ndërkombëtare. Në shumë shtete, aktet nënligjore që kanë të bëjnë me organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të shërbimeve të këtilla, si dhe mënyra e zbatimit të masave të caktuara janë sekrete, gjegjësisht nuk janë publike për opinionin, por në to kanë qasje trupat kontrollues.

E drejta kombëtare këtyre shërbimeve duhet t'ua ndalojë angazhimin në çfarëdo aktiviteteesh politike ose veprim në interes të ndonjëres parti, grupi fetar, etnik, social apo ekonomik. Po ashtu, shtetet janë ndërkombëtarisht përgjegjës për aktivitete të shërbimeve të tyre për siguri dhe zbulim, si dhe të punësuarve të tyre pa marrë parasysh ku zhvillohen këto aktivitete dhe kush janë

viktimat. E drejta kushtetuese, administrative dhe penale ndërkombëtare ka të bëjë me anëtarët e këtyre shërbimeve si dhe të çdo të punësuarit tjetër shtetëror.

Nga ana tjetër, të punësuarit në këto shërbime duhet të kenë mundësi të paraqesin parregullsi ose shkelje të caktuara të ligjeve gjatë punës së shërbimit. Praktika e vendeve të caktuara tregon se ekzistojnë disa mënyra të paraqitjes; trupave kontrollues të brendshëm të shërbimit, institucioneve të jashtme mbikëqyrëse dhe kontrolluese dhe komunikim me opinionin publik. Shpallja publike e parregullsive ka të bëjë me shkelje të rënda, siç është kërcënimi për jetën.

Kultura institucionale në shërbimet për siguri dhe zbulim ka të bëjë me vlerat, qëndrimet dhe sjelljen e të punësuarve. Që do të thotë, vetëm korniza institucionale juridike nuk mund të sigurojë garanci të mjaftueshme se pjesëtarët e këtyre shërbimeve do t'i përmbahen sundimit të ligjit dhe se do t'i respektojnë të drejtat e njeriut.

Një numër i madh i shteteve dhe shërbimet e tyre kanë miratuar kodeks etik ose parime profesionale me qëllim që të promovojnë kulturë institucionale. Kodekset e sjelljes etike zakonisht përfshijnë dispozita për sjellje adekuate, disiplinë dhe vlera morale që duhet t'i posedojnë të punësuarit në shërbime. Praktikë e mirë është që kodekset e sjelljes të jenë objekt i kontrollit të institucioneve mbikëqyrëse të brendshme dhe të jashtme.

Bashkë me kodeksin etik duhet të lidhet edhe edukimi i vazhdueshëm i të punësuarve me qëllim të forcimit të punës profesionale. Shumë shërbime të sigurisë kanë programe të edukimit, të cilat e potencojnë profesionalizmin dhe i edukojnë të punësuarit për standardet relevante, kushtetuese dhe ligjore dhe të drejtën ndërkombëtare. Etika dhe kultura profesionale mund të forcohen me politikat e brendshme të udhëheqjes me kapitalin njerëzor nëse shpërblehet sjellja etike dhe profesionale.

Bashkësia e sigurisë dhe zbulimit në RMV përbëhet prej tri institucioneve për siguri dhe zbulim:

1. Agjencia për Siguri Kombëtare,
  2. Agjencia për Zbulim, dhe
  3. Njësia Organizative Kompetente për Siguri dhe Zbulim Ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes.
- Agjencia për Siguri Kombëtare (ASK) paraqet agjenci të pavarur. Nga natyra e saj paraqet shërbim kundërzbulues, civil, i ngarkuar për zbulimin dhe parandalimin e veprimtarisë së spiunazhit të shërbimeve të huaja zbuluese, zbulimin dhe parandalimin e kërcënimeve, aktiviteteve dhe veprimtarive të orientuara kundër rendit kushtetues, zbulimin dhe parandalimin e terrorizmit dhe të formave të tjera serioze të akteve të krimit të organizuar dhe aktiviteteve të drejtuara kundër shtetit. Agjencia është e sistematizuar përbrenda në njësi të posaçme organizative, hierarki të centralizuar të subordinimit dhe metodë të punës linjore-territoriale.
  - Agjencia për Zbulim (AZ), paraqet agjenci zbulimi nën kompetenca të Presidentit të RMV-së, e ngarkuar për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave politike, ekonomike dhe ushtarake për shtete, institucione, shërbime dhe persona të huaj me interes për Maqedoninë. Në kornizat e saj, ekzistojnë departamente të posaçme për luftë kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar. Agjencia brenda saj është e sistematizuar në më shumë pjesë organizative, me hierarki të centralizuar të subordinimit me metodë të punës linjore-territoriale.

- Njësia Organizative Kompetente për Siguri dhe Zbulim Ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes (më parë Shërbimi Ushtarak për Kundërzbulim dhe Zbulim - ShUKZ), e cila paraqet agjenci ushtarake për kundërzbulim dhe zbulim në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, e ngarkuar për zbulimin dhe pengimin e veprimit të shërbimeve të huaja ushtarake për zbulim në Maqedoni, si dhe ndërmarrje të aktiviteteve të zbulimit kundrejt shteteve dhe personave të huaj me interes për sigurinë kombëtare të shtetit. Ajo nga brenda është e sistematizuar në më shumë njësi me hierarki të centralizuar të subordinimit me metodë të punës linjore-territoriale.

Në kuadër të AZ, ASK dhe MM ekzistojnë departamente të posaçme për zbatim të masave invazive, në veçanti të masave për ndjekje të komunikimeve. Në kuadër të këtyre shërbimeve, po ashtu ekzistojnë edhe departamente të posaçme për vëzhgim dhe ndjekje të personave dhe lëndëve.

Sistemi i sigurisë së RMV-së, në kuadër të të cilit bën pjesë edhe Bashkësia për Siguri dhe Zbulim, ballafaqohet me më shumë vështirësi, mes të cilave një pjesë janë relikte të së kaluarës historike, ndërsa pjesa tjetër si pasojë nga ngritja jo e mjaftueshme e “arkitekturës” ligjore lidhur me përcaktimin e padyshimtë dhe ndarjen e kompetencave të shërbimeve të sigurisë dhe autorizimeve të tyre. Në këtë kontekst vërehen këto anomalitë:

- tejkalimi i kompetencave ligjore, respektivisht trajtimi nga aspekti i sigurisë së çështjeve që nuk janë në kompetencë të shërbimit përkatës;
- keqpërdorimi i masave invazive si metoda për mbledhjen e indicieve;
- mungesa apo mosrespektimi i mekanizmave ekzistues për eliminimin ose zvogëlimin e joseslektimit përmbajtjesor dhe personal të masave për ndjekje të komunikimeve etj.
- në kuadër të vet Komunitetit për Siguri dhe Zbulim, ekzistojnë mbivendosje të caktuara të kompetencave që kanë të bëjnë me lëndën dhe fushën e veprimit. Kështu, shpesh ndodh që disa ngjarje ose dukuri dhe persona të caktuar të vendit dhe të huaj, aktivitetet e të cilëve janë klasifikuar si kërcënime për sigurinë e shtetit, të paraqiten si objekt i punës së tri shërbimeve të sigurisë.

#### **4. Masat invazive si pjesë përbërëse e metodologjisë së punës së shërbimeve për siguri dhe zbulim**

Masat për ndjekje të komunikimeve janë pjesë e një tërësie të mjeteve dhe metodave sekrete të veprimit, të cilat vite me radhë paraqesin të drejtë ekskluzive të përdorimit të shërbimeve për siguri dhe zbulim, respektivisht të shërbimeve sekrete. Ekskluziviteti i tillë vinte nga obligimi funksional i këtyre shërbimeve për mbrojtjen e interesave vitale të shtetit. Mbrojtja e vlerave vitale të shtetit mund të arrihet me sukses vetëm nëse kërcënimet destruktive zbulohen, identifikohen dhe parandalohen në fazën e hershme të përgatitjes, kur akoma nuk paraqesin rrezik konkret për vlerat që duhet të mbrohen. Objekti i mbrojtjes që është lëndë e obligimit funksional të këtyre shërbimeve, në këtë fazë nuk është konkretisht i rrezikuar, por ekzistojnë indicie ose i ashtuquajtur rrezik abstrakt nga kërcënimi i afërt apo i largët për lëndim apo rrezikim. Konceptimi i këtyre shërbimeve para deliktit, që është veçori e mënyrës së funksionimit të shërbimeve sekrete, tash imponohet si obligim edhe i shërbimeve kriminalistike të obliguara me zbulimin dhe parandalimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Kështu, ishte e natyrshme të pritet që moria e metodave dhe mjeteve të veprimit të shërbimeve sekrete padyshim që do të pasqyrohet edhe në veprimin legal dhe ligjor të shërbimeve kriminalistike sepse ato instrumente janë të vetme, adekuate, efikase dhe të verifikuara vite me radhë dhe u përgjigjen sfidave që të parashikohet dhe parandalohet krimi para realizimit të tij. Këto instrumente ligjore të veprimit para deliktit, sot në literaturën penalo-juridike në botë janë të njohura me sinonime të ndryshme: *special investigative measures*, masa të posaçme hetuese, *undercover operations*, operacione të fshehta apo sekrete, masa të hetimit të fshehtë, masa të posaçme etj.

Moria e masave invazive, të cilat janë në përdorim legal të shërbimeve për siguri dhe zbulim patjetër duhet të jenë në përputhshmëri me parimet dhe standardet e miratuara të zbatimit të masave invazive.

Kështu që shërbimet për siguri dhe zbulim janë pjesë e pushtetit ekzekutiv të shtetit dhe si të tilla nuk janë dhe nuk guxojnë të jenë jashtë sistemit të kontrollit dhe respektimit të parimit të pranuar përgjithësisht të sundimit të së drejtës. Lufta kundër terrorizmit, spiunazhit dhe aktiviteteve të tjera subversive nuk guxojnë të shndërrohen në instrument për anulimin e shoqërisë demokratike.

Kështu, parimet për ligjshmëri, subsidiaritet, proporcionalitet dhe (paraprakisht) lejimit gjyqësor të masave invazive si dhe standardet e miratuara në lidhje me to, janë të karakterit të domosdoshëm në punën dhe funksionimin e shërbimeve për siguri dhe zbulim.

## 5. Parandalimi te siguria

Puna e shërbimeve për siguri dhe zbulim si dhe zbatimi i masave të posaçme për mbrojtje dhe siguri kombëtare bazohet në konceptin e veprimit për mbrojtje nga rreziku. Koncepti i këtillë proaktiv i veprimit *antedelictum*, i cili është i pandashëm nga koncepti penal - rrezikim abstrakt, penalo-juridikisht e përfshin fushën e parahetimit, respektivisht fushën e realizimit para krimin. Masat për nga natyra e vet janë posaçërisht të qëlluara për parandalimin e të gjitha aktiviteteve që paraqesin një lloj kërcënimi për sigurinë kombëtare.

Për dallim nga ky koncept proaktiv i veprimit, koncepti reaktiv i ndjekjes penale *post delictum*, nisët nga shkelja tashmë e kryer ose së paku kërcënimi i vlerës së mbrojtur dhe penalo-juridikisht e përfshin fushën e fazës paraprake të procedurës penale, respektivisht hetimit.

Kështu, plotësisht është e arsyeshme frika se nga zbatimi i këtyre masave ekziston rreziku i fshirjes së kufirit në mes të hetimit dhe procedurës parahetimore, çka në vazhdim paraqet “rrezik që e drejta materiale dhe penalo-procedurale me zbatimin e këtyre masave të shndërrohen në një mënyrë në instrument taktik policor”. (Bačić F.: *Kazneno-pravni aspekti problematike organiziranog kriminaliteta*, Problematika e aspektet ndëshkuese-juridike të krimin të organizuar) HLjKPP, 1/1999)

Në këtë rast, ajo që e lartëson sensibilitetin ligjor është se kërcënimi ose vepra penale është në fazën më të hershme të përgatitjes, në kuptimin e gjerë të fjalës, që sipas rregullit parimisht është e padënueshme. Kështu, këtu bëjnë pjesë veprimet dhe aktivitetet e fazës më të hershme të krijimit, të qëllimit për krim deri te veprimet dhe aktivitetet që paraqesin përgatitje të veprës penale (nxitje, organizim, planifikim, përgatitje etj.). Këto stadi të hershme, para delikti të veprës penale, në mënyrë të kuptueshme më rrallë sanksionohen, ndërsa pjesa më e madhe e tyre mbeten në fushën e zonës së pandëshkuar sepse akoma qëllimi për krim i vepruesit nuk ka formë

paraqitëse në realitetin e jashtëm, që në kuptimin penalo-juridik paraqet kërcënim konkret për vlerën e mbrojtur.

Me fjalë të tjera, nuk ka dëm objektiv ligjor që ka ndodhur ose kërcënim të vlerës së mbrojtur, por kërcënimi akoma është në formë të rrezikut abstrakt, të padënueshëm ligjërisht. Të gjitha njohuritë lidhur me qëllimin e të pandehurit për të bërë vepër penale janë në sferën e supozimeve, që sipas rregullit janë në fushën e bazës së dyshimit, dikur edhe më pak se atë. Për këtë arsye ligjvënësi me kujdes të madh dhe me shkallë të lartë të selektimit qaset në përcaktimin e veprave penale, për të cilat është parashikuar zbatimi i këtyre masave invazive, sepse ka rrezik real që e drejta penale të ndërhyjë në zonën e ndaluar të dënimit të mendimit.

Frika se mund të keqpërdoren masat në këtë drejtim dhe se mund të legalizohet regjimi totalitar dhe policia politike është reale dhe vazhdimisht e pranishme, por duket se me gjetjen e mekanizmit adekuat efikas të kontrollit dhe mbikëqyrjes mbi zbatimin e të njëjtave mund të tejkalohet ai rrezik.

Shërbimet e sigurisë dhe zbulimit nuk mund të ndikojnë tek shkaqet e kërcënimeve të sigurisë dhe rreziqeve, por mundën me aktivitetet e tyre t'i zvogëlojnë kushtet e mundshme dhe rastet për aktivitete që janë të orientuara kundër sigurisë kombëtare. Metoda bazë për këtë është shfrytëzimi i analizës së zbulimit, e cila paraqet grumbullimin e të dhënave dhe informatave, përpunimin e tyre dhe nxjerrjen e konkluzave relevante për ngjarje apo dukuri të caktuara.

Pranimi i preventivës si pjesë integrale e një qasjeje gjithëpërfshirëse, do të ndihmojë në eliminimin e parakushteve që mbase çojnë individët të përfshihen apo kyçen në grupet ekstreme të dhunës, gjegjësisht qasjes preventive për luftë kundër kërcënimit për sigurinë dhe mbrojtjen që është orientuar në "shenja të hershme". Ashtu si edhe me praktikën e preventivës së krimit, rezultatet mund të mos shihen menjëherë dhe do të kërkojnë angazhim afatgjatë dhe të durueshëm. Kështu, zbatimi i masave të posaçme, në rastin konkret të ndjekjes së komunikimeve, kur kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen, rëndom janë të afatit më të gjatë krahasuar me zbatimin e tyre në hetimet e veprave të tjera penale.

## **6.Kërcënimi ndaj sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare**

Ligji për Agjencinë për Siguri Kombëtare (ASK) dhe Ligji për Mbrojtje i identifikojnë kërcënimet për sigurinë e shtetit.

Sipas nenit 4 të Ligjit për ASK, kërcënime (dhe rreziqe) të sigurisë për sigurinë kombëtare të shtetit janë:

- spiunazhi;
- terrorizmi dhe financimi i tij;
- ekstremizmi i dhunshëm;
- të gjitha format e aktiviteteve serioze të krimit të organizuar serioz dhe aktiviteteve kriminale të drejtuara kundër shtetit;
- parandalimi i veprave penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare;
- prodhimi joligjor dhe prodhimi i armatimit për shkatërrim masiv apo të komponentëve të tyre, si dhe të materialeve dhe pajisjeve të cilat janë të nevojshme për prodhimin e tyre;
- prishja e interesave vitale ekonomike dhe sigurisë financiare të shtetit;



- prishja e sigurisë së bartësve të funksioneve të larta shtetërore dhe të objekteve që janë me rëndësi strategjike për shtetin, dhe
- zbulimi dhe parandalimi i aktiviteteve të tjera që lidhen me kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë për sigurinë kombëtare të shtetit.

Në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtje si kërcënime kanë identifikuar:

- Zbulimin dhe parandalimin e veprimtarisë zbuluese dhe të veprimtarisë tjetër subverzive të shërbimeve të huaja ushtarako-zbuluese dhe shërbimeve zbuluese që bëhet në vend apo nga jashtë, e që është e orientuar drejt mbrojtjes së shtetit;
- Zbulimin dhe parandalimin e të gjitha formave të veprimtarive terroriste të drejtuara drejt mbrojtjes së shtetit, dhe
- Zbatimin e mbrojtjes kundërzbuluese, të detyrave dhe planeve, dokumenteve, mjeteve materiale dhe teknike, rajoneve, zonave dhe objekteve me interes për mbrojtjen e shtetit.

Në esencë, këto kërcënime sipas LP paraqesin vepra serioze penale kundër shtetit, forcave të armatosura dhe kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare. Forcat e sigurisë, aktivitetet i ndërmarrin para së gjithash për veprim preventiv kur bëhet përgatitja, organizimi apo pjesëmarrja në vepra penale kundër interesave të shtetit ose në paaftësinë e sistemit të tij të sigurisë për të zbatuar funksionet e tij.

Në zbatimin e kompetencave të tyre kushtetuese shërbimet e sigurisë mund të përdorin masa dhe aktivitete të fshehta të përcaktuara me ligj, dhe në përputhje me Kushtetutën. Kushtet për përdorimin e masave të ndjekjes së komunikimeve për mbrojtje të interesave shtetërore të sigurisë dhe mbrojtjes janë qartë të parashikuara në Kushtetutë dhe detajisht të përpunuara në Ligjin për Ndjekje të Komunikimeve dhe Ligjin për AKS

## **7. Organet e autorizuara për zbatimin e masës për ndjekjen e komunikimeve me qëllim të ruajtjes së sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit**

Organet e autorizuara për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe të mbrojtjes të shtetit janë:

- Agjencia për Siguri Kombëtare dhe
- Ministria e Mbrojtjes: Përgjegjëse Njësia Organizative Punuese për Siguri dhe Zbulim

Ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes (Shërbimi Ushtarak për Siguri dhe Zbulim) dhe Qendra për Rishikimin Elektronik në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pjesën për spektrin e frekuencës në valët e radios, të larta, shumë të larta dhe ultra të larta (HF, VHF dhe UHF).

Rol udhëheqës në zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve për ruajtje të sigurisë kombëtare ka Agjencia për Siguri Kombëtare, si shërbim i vetëm kundërzbulues civil. Agjencia ligjërisht është kompetente për trajtimin në aspektin e sigurisë të personave dhe dukurive vetëm të karakterit civil, gjegjësisht ajo nuk ka të drejtë ligjore dhe as kompetencë të trajtojë persona dhe dukuri nga fusha ushtarake.

Njësia e Punës e Autorizuar për Siguri dhe Zbulim Ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes, apo ish-Shërbimi Ushtarak për Kundërzbulim dhe Zbulim - ShUKZ, nuk ka traditë në zbatimin e shpeshtë të masave për ndjekje të komunikimeve, megjithatë ka kontinuitet dhe zbatim të shpeshtë

të aplikimit të ashtuquajturit vëzhgim, gjegjësisht zbulimit radio-ushtarak në pjesën e spektrit të frekuencave të radio valëve të larta, shumë të larta dhe ultra të larta.

Sipas dispozitave të LNK-së dhe LASK-së, me masat e ndjekjeve të komunikimeve përfshihen të gjitha format e komunikimit, gjegjësisht komunikimi telefonik apo i ashtuquajtur i komunikimi përmes telave, i drejtpërdrejtë apo i ashtuquajtur i komunikimi gojor, të gjitha format e komunikimit elektronik, letrat dhe dërgesat postare si formë e komunikimit mes njerëzve. Masat përfshijnë telekomunikimin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Ligji lejon zbatimin e mjeteve të posaçme teknike për përgjime (të ashtuquajturat çimka) të cilët mund të jenë me afat të shkurtër apo me afat më të gjatë të shfrytëzimit (varësisht nga burimi i furnizimit të pajisjeve teknike), dhe më shpesh të njëjtat shfrytëzohen për "përgjim" për dhomat-hapësirat e mbyllura ku jeton apo punon personi, për të cilin ekziston interes sigurie.

Në raport me të ashtuquajturat përgjime personale dhe konsensuale, gjegjësisht ndjekjen e komunikimeve, Ligji i tanishëm i NK-së, për dallim nga ai i vitit 2006 (neni 2), nuk ka dispozita të cilat në mënyrë eksplicite e rregullojnë këtë materie. Pra, sipas dispozitave ekzistuese ligjore dhe nocionit të pranuar juridik, kuptimi i ndalimit kushtetues për ndjekjet e paligjshme të komunikimeve, ka për qëllim të pengojë dhe ndalojë ndërhyrjen joligjore shtetërore në komunikimet private të qytetarëve, ndërkaq gjatë komunikimeve personale, secili pjesëmarrës i komunikimeve përgjigjet vetë për rrezikun se mund të jetë e incizuar biseda pa pajtueshmërinë apo dijen e tij nga ana e pjesëmarrësit tjetër në komunikim.

Edhe pse nuk ekziston dispozitë eksplicite ligjore, e cila e ndalon incizimin e përmbajtjes së bisedës gjatë komunikimeve personale, pa pajtueshmëri të bashkëbiseduesit në komunikim, ligji nuk i pranon bisedat e këtilla të përgjuara si dëshmi në procedurë, sepse të njëjtat paraprakisht nuk janë lejuar nga gjyqi. Në anën tjetër, pos shkeljes nga aspekti moral (besimi i lëkundur), bashkëbiseduesi i përfshirë në komunikim mund të kërkojë përgjegjësi penale nga pjesëmarrësi tjetër në komunikim, nëse bisedat e publikuara përmbajnë të dhëna nga jeta private dhe familjare e të përfshirit në përgjim.

E ngjashme është situata edhe në rastin e ndjekjes konsensuale të komunikimit, respektivisht ndjekje të komunikimit pa urdhëresë gjyqësore, por me pëlqim paraprak të njërit nga pjesëmarrësit e komunikimit. Pra, ligji nuk e lejon këtë, por megjithatë lejon hapësirë për pranim, nëse personi është hetues sekret policor (pjesëtar i shërbimit ose bashkëpunëtor policor i shërbimit), kështu që edhe në këtë rast njohuritë e fituara nuk kanë vlerë gjyqësore, por vetëm operative.

Ligji (NK), për shkak të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, lejon qasje më liberale dhe përdorim (pa leje gjyqësore, por vetëm me kërkesë të organit të autorizuar dhe të informimit të mëvonshëm të prokurorit publik të RMV-së) të të dhënave të pjesëmarrësve në komunikimin elektronik, të cilët përveç masave për ndjekje të komunikimeve, paraqesin një ndër instrumentet më të përdorura gjatë punës së shërbimeve për siguri dhe zbulim.

## **8. Masa për ndjekje të komunikimeve**

Në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve, masa për ndjekje të komunikimeve për shkak të mbrojtjes së interesave shtetërore të sigurisë dhe mbrojtjes janë:

1. Ndjekja dhe incizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike;
2. Ndjekja dhe incizimi në brendësi të objektit, hapësira dhe objekte të mbyllura, për shkak të krijimit të kushteve për zbatim të masës;
3. Ndjekje dhe incizim me dritë të personave në hapësirë të hapur dhe në vende publike dhe
4. Ndjekja dhe incizimi i zërit të përmbajtjes të komunikimeve të personave që komunikojnë në hapësirë të hapur dhe në vende publike.

**Masat nga pika 1 - Ndjekja dhe incizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve elektronike,** ka të bëjë me të gjitha komunikimet që paraqesin proces teknik të bartjes, përcjelljes dhe pranimit të çfarëdo bisede, të dhëne, zëri, sinjali, teksti të shkruar, fotografi statike apo lëvizëse, të cilat përdoren për këmbim të informatave midis njerëzve dhe objekteve, në mes objekteve që udhëhiqen me ndihmën e ndonjë sistemi telekomunikues, siç është protokollit i internetit, bisedë përmes protokollit të internetit, faqe interneti dhe postë elektronike. Me këtë masë nuk përfshihen komunikimet e drejtpërdrejta gojore (përgjim ambiental) në mes njerëzve, letrat dhe dërgesat postare si forma të posaçme të komunikimit mes njerëzve.

Për nga përmbajtja masa ka të bëjë me komunikimet e njëjta që janë të përfshira me masat nga neni 252, paragrafi 1, pika 1 e LPP-së, *diferentia specifica* është qëllimi dhe kushti i zbatimit të masës. Kështu, në raport me qëllimin (neni 18 nga LNK, respektivisht neni 34, paragrafi 1 i LASK), masa është në funksion të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit, ndërsa në raport me qëllimet, masa ka qëllim parandalues dhe përfshin:

- shkallën e realizimit parakriminal - përgatitje, tek veprat penale kundër shtetit, kundër forcave të armatosura ose kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare;
- parandalimin (prevenimin) e rrezikut konkret, e cila në kuptimin penalo-juridik paraqet: nxitje, organizim ose pjesëmarrje në sulm të armatosur kundër shtetit ose paaftësimin e sistemit të sigurisë që të kryejë funksionet e veta, dhe
- parandalimin (prevenimin) e rrezikut abstrakt, i cili në kuptimin penalo-juridik paraqet ekzistim të bazës për dyshim për aktivitete tashme të ndërmarra, që kanë të bëjnë me veprat penale: organizim terrorist (neni 394-a) terrorizëm (393-b) dhe financim i terrorizmit (neni 394-v).

Ligjvënësi bën dallim (neni 4, paragrafi 1, pika 4 e LNK-së) mes ndjekjes dhe incizimit të komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike për qëllime të realizimit të procedurës penale nga neni 252, paragrafi 1 i LPP-së dhe atë masë e quan - masë të posaçme hetuese, ndërsa kur e njëjta masë përdoret për mbrojtjen e sigurisë dhe interesave kombëtare (neni 4, paragrafi 1, pika 5 e LNK-së) atë e quan - ndjekje dhe incizim të komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike. Pra, për nga natyra e saj bëhet fjalë për të njëjtën masë, e cila ka për qëllim njohjen sekrete të përmbajtjes së komunikimit cak, megjithatë, për shkak të qëllimeve të ndryshme gjatë zbatimit, ajo nga ana formale-juridike emërtohet ndryshe.

Masa për ndjekje dhe incizim të telefonit dhe komunikimeve të tjera elektronike, e përcaktuar me Ligjin për Ndjekje të Komunikimeve, mund të zbatohet edhe me ndihmën e aparaturave dhe aparateve të posaçme teknike të cilët mundësojnë realizimin e masës pa ndërmjetësimin e ATO-s dhe operatorëve.

Programet informative malicioze (infektuese) janë ndërhyrje teknike në sistemin elektronik të të përfshirit me çka mundësohet të ndiqen të gjitha format e komunikimit telefonik dhe elektro-

nik që i realizon i përfshiri përmes aparatit të tij telefonik. Nga fushëveprimi dhe sfera e përfshirjes së privatësisë ajo paraqet ndjekje *online* të të gjitha komunikimeve të personit të përfshirë përmes aparatit të tij elektronik.

Për përfshirjen e kësaj mase të posaçme teknike ligjvënësi ka parashikuar respektimin e vazhdueshëm të parimeve të lejimit paraprak të lejes gjyqësore, ligjshmërisë, subsidiaritetit dhe proporcionalitetit.

Mënyra e shfrytëzimit, kontrollit dhe zbatimit të kësaj mase të posaçme të pajisjes teknike është e rregulluar me dispozitat e LASK-së, ndërkaq drejtori i ASK-së (me akt normativ nënligjor e vërteton specifikimin dhe karakteristikat e aparateve dhe pajisjeve teknike, si dhe mënyrën e ruajtjes dhe përdorimin e tyre.

**Masat nga pika 2 - Ndjekja dhe incizimi në brendësi të objektit, dhoma-hapësira dhe objekte të mbyllura, për shkak të krijimit të kushteve për zbatim të masës,** paraqet pandan të masës nga neni 252 paragrafi 1, alineja 2 e LPP-së. - *Diferentia specifica* të kësaj mase, pos qëllimit dhe kushteve paraqet edhe brezin e hapësirës së masës për të gjitha llojet e hapësirave të mbyllura, si të karakterit publik apo privat. Sipas brezit dhe llojit të përfshirjes të privatësisë së individit, masa ka të bëjë vetëm me komunikimet gojore të drejtpërdrejta (jo edhe për komunikimet e drejtpërdrejta elektronike dhe komunikimet e tjera), (i ashtuquajtur përgjimi ambiental) të cilat realizohen në hapësira-dhoma të mbyllur. Duke pasur parasysh se kushtet për zbatimin e masave me qëllim të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe atyre mbrojtëse të shtetit janë të parashikuara me LPP-në (neni 19), zgjerimi i shtrirjes e zbatimit të masës ka reperkusione edhe nga aspekti i kufizimit të zbatimit të masave të posaçme hetuese (neni 268 i LPP-së). Pra, masa *delegelata* mund të zbatohet në shtëpi, por edhe të personit tjetër, dhe gjatë kësaj procedure mos kërkohet shkallë e dyshimit të bazuar se i dyshuari qëndron aty.

**Masat nga pika 3 - Ndjekje dhe incizim me dritë të personave në hapësirë të hapur dhe në vende publike,** paraqet formë të mbikëqyrjes së fshehtë të të dyshuarit në vend publik me mjete të posaçme teknike për incizim me dritë (me rreze infra të kuqe, UV, ose lloj tjetër të valëve, apo të natës, termale etj.) qëllimi i të cilës sipas rregullit nuk është përmbajtje e komunikimeve të të dyshuarit, por (ndodhitë e jashtme të “objektit” që mbikëqyret) takimet dhe kontaktet e të dyshuarit me persona dhe vende të tjerë ku lëviz.

Sipas natyrës, masa është shumë më e afërt me masën nga neni 252 paragrafi 1, alineja 3 e LPP-së (observimi i fshehtë), sesa nga masat e ndjekjes së komunikimeve. Megjithatë, ndonjëherë, në bazë të observimit të këtillë të të dyshuarit, kur i njëjti është më larg nga fusha normale e shikimit, mund të fitohen njohuri konkludente (të drejtpërdrejta) për “përmbajtjen” e komunikimit të të dyshuarit (lëvizja kah qëllimi i caktuar, dhënia e sendeve, lëvizje të shenjave, gjestikulacione apo mimika etj.) me persona të tjerë..

**Masat nga pika 4 - Ndjekja dhe incizimi i zërit të përmbajtjes të komunikimeve të personave që komunikojnë në hapësirë të hapur dhe në vende publike,** është pandan i masës

- ndjekja e fshehtë dhe incizim i personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo vendit të punës e shënuar si private (neni 225 al.1, p.3 i LPP-së). Kjo ka të bëjë me ndjekjen dhe krijimin vetëm të incizimeve me zë (ky është dallimi i vetëm nga masa e cekur më parë) të komunikimeve në vend publik, që bëhen me ndihmën e mjeteve të posaçme teknike për përforcim të zërit, me çka arrihet “kapja” e komunikimit cak nga distanca më e madhe. Kuptohet se masa është

sekrete dhe e fshehtë, respektivisht ajo zbatohet në mënyrë të pa hetuar, kështu që ai që ndiqet nuk është i vetëdijshëm se “përgjohet”. Zakonisht, zbatimi i masave për ndjekje të komunikimeve në hapësirë të hapur (dhe vend publik) nuk është i ndaluar, për shkak të qëndrimit të miratuar se në rrethanat ku bëhet komunikimi, personi që përgjohet nuk ka pritje se do të ketë privatësi. Me fjalë të tjera, secili për vete bart rrezik të privatësisë së komunikimit, në qoftë se ai realizohet në vend të hapur ku kanë qasje një numër i pakufizuar dhe i paftuar personash.

Përveç masave të lartpërmendura për ndjekje të komunikimeve me qëllim të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit, në pajtim me dispozitat e LNK-së (nenet 32 dhe 33) me kërkesë të organeve të autorizuara për zbatim të masave (për kërkesën e parashtruar informohet prokurori publik i RMV-së), operatorët janë të obliguar t’i deponojnë meta të dhënat e kërkuara për pjesëmarrësit e komunikimit elektronik.

ASK ka të drejtë ekskluzive në bazë të urdhëresës gjyqësore (nenet 25, 28 dhe 32 nga LASK) të kryejë ndjekje dhe incizim të telekomunikimeve ndërkombëtare me ndërmjetësim të operatorëve, kur ndjekja e telekomunikimeve ndërkombëtare nuk është e mundur të realizohet në tjetër mënyrë, njëkohësisht të bëhet mbikëqyrja e dërgesave postare dhe të tjera.

### **8.1. Kushtet e përdorimit të masave për ndjekje të komunikimeve**

Baza juridike, kushtet, llojet e masave për ndjekje të komunikimeve dhe procedura e zbatimit të tyre për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit në mënyrë të qartë janë të parashikuara në Kushtetutë, në LNK dhe në LASK. Dispozitat kushtetuese në nenin 17, respektivisht Amendamenti XIX (viti 2003) i përkufizojnë bazat juridike, diapazonin dhe sferën e devijimit legjitim nga garancia kushtetuese për mosshkeljen e privatësisë në komunikimin e qytetarëve.

Disa paqartësi kushtetuese në Kushtetutën e RMV-së, lidhur me zbatimin e masave invazive plotësohen me dispozitat e miratuara të KEDNj-së, si kornizë e përgjithshme juridike dhe drejtim për të gjitha aspektet e zbatimit të këtyre masave.

Në Ligjin për Ndjekje të Komunikimeve (Kapitulli III) janë përcaktuar kushtet, procedura dhe llojet e masave për ndjekje të komunikimeve me qëllim të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit.

Duke marrë parasysh rolin kontrollues të gjykatës, gjatë lejimit të masave, gjykata duhet ta ketë parasysh praktikën gjyqësore të KEDNj-së në raport me standardet e miratuara për zbatim të masave invazive me qëllim që të evitohet rreziku i keqpërdorimit të tyre si dhe shkelja e rendit demokratik, me arsyetimin se veprimet e tilla ndërmerren për mbrojtjen e rendit demokratik.

### **8.2. Kushtet për dhënien e urdhrit**

Kushtet për dhënien e urdhrit për ndjekje të komunikimeve janë paraparë në nenin 19 të LNK-së (përcaktime identike përmban edhe LAKS). Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni “gjykata mund të urdhërojë masa për ndjekje të komunikimeve nga neni 18 kur ekzistojnë baza të dys-

himit se përgatitet realizimi i veprës penale kundër shtetit, kundër forcave të armatosura ose të drejtave humanitare dhe ndërkombëtare”.

De lege lata, nga këndvështrimi i zbatimit të masës, ligji “kërkon” ekzistim të bazës së dyshimit për zbatim të masave dhe e përfshin (vetëm) shkallën e aktiviteteve përgatitore për lëndët penale kundër shtetit, kundër forcave të armatosura apo kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare.

Në paragrafin (2) të nenit 19 të LNK-së, është paraparë zbatimi i masave edhe për parandalimin (veprimin preventiv) e veprimeve që në kuptimin juridiko-penal nënkuptojnë përgatitje, nxitje, organizim ose pjesëmarrje në sulm të armatosur kundër shtetit apo paaftësimin e sistemit të mbrojtës së tij për realizimin e funksioneve të veta si edhe për parandalimin e çfarëdo aktiviteti lidhur me vepra penale: organizim terrorist (neni 394-a, terrorizëm (neni 394-b) si dhe financimi i terrorizmit (neni 394-v). Në të njëjtin paragraf, ligji pa kushtëzim “kërkon” përmbushje të parimit të subsidiaritetit, respektivisht informata për aktivitete të tilla që të mos mund të sigurohen në mënyrë tjetër apo siguri i tyre të bëhet me vështirësi të mëdha dhe kumulativisht ligji kërkon ekzistencë të rrezikut tashmë “të konstatuar” të drejtpërdrejtë për shoqërinë nga: realizimi i (ndonjë nga të lartpërmendurave) veprës penale, sulmit të armatosur ose paaftësim të sistemit të sigurisë.

Në paragrafin (3) të të njëjtit nen parashihet mundësia e zgjedhjes nga shumë masa për ndjekje të komunikimeve, duke i dhënë përparësi gjithmonë masës që më së paku ndërhyjnë në të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutën, ligjin dhe marrëveshjet ndërkombëtare të miratuara në përputhje me Kushtetutën.

### **8.3. Kërkesa për dhënie të urdhëresës dhe vendimmarrja në bazë të kërkesës**

Duke e pasur parasysh seriozitetin e vlerës që mbrohet, ligjvënësi këtë masë e ngre në shkallë më të lartë, si në raport me personin që bën kërkesë ashtu edhe në raport me organin kompetent për vendosje në bazë të kërkesës dhe për këto shkaqe ekziston kapitulli i posaçëm i Ligjit që do të thotë, Kapitulli III - Kushtet dhe procedura e zbatimit të masës për ndjekje të komunikimeve për shkak të mbrojtjes së interesit për siguri dhe mbrojtje të shtetit. Në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 20, paragrafit 1 të LNK-së, personi i autorizuar për të bërë kërkesë për dhënie të urdhëresës për zbatim të masës për ndjekje të komunikimeve me qëllim të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit, është prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të drejtorit të ASK-së ose nga personi i autorizuar prej tij si dhe me propozim të ministrit të Mbrojtjes apo personit të autorizuar prej tij. Përmbajtja e kërkesës nga ky nen duhet domosdoshmërisht t'i ketë këto elemente:

- llojin e masës për ndjekje të komunikimit, për të cilin është bërë kërkesa;
- të dhënat për personin fizik apo juridik, ndaj të cilit do të zbatohet masa;

- të dhëna për objektin, hapësirën ose lëndën për të cilën do të zbatohet masa;
- organi i cili duhet ta zbatojë urdhëresën;
- arsyetimi i shkaqeve dhe nevojës për propozimin e zbatimit të masës
- kohëzgjatja e masës dhe strategji, si dhe
- lloji i sistemit telekomunikues, numri telefonik ose e dhënë tjetër identifikuese, si numër identifikimi për secilin prej tyre në veçanti.

Ekzistojnë dallime në lidhje me përmbajtjen e kërkesës për përcaktim të masës për ndjekje të komunikimeve për caqet e procedurës penale (neni 8 i LNK-së) dhe Kërkesës për dhënien e urdhëresës për ndjekje të komunikimeve për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit (neni 20 i LNK-së).

Kështu, kërkesa për dhënien e urdhëresës për ndjekje të komunikimeve me qëllim të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit nuk duhet të përmbajë të dhëna për:

- emërtimin ligjor të veprës penale;
- vëllimin dhe vendin e zbatimit të masës së posaçme hetuese, dhe
- njohuritë dhe faktet në bazë të të cilave mbështetet dyshimi i bazuar dhe sqarimi për shkaqet e të cilave është dhënë urdhëresa, të dhënat dhe faktet nuk mund të grumbullohen në mënyrë tjetër.

Në rast të dorëzimit të kërkesës sipas nenit 20 të LNK-së për sjelljen e vendimit për më shumë masa të ndjekjes së komunikimeve, detyrimisht jepen të dhënat për çdo masë në veçanti. Kërkesën e bën prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut te gjykatësi i Gjykatës Supreme i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i caktuar sipas orarit të brendshëm të gjykatës, i cili merr vendim menjëherë ose më së voni në afat prej 24 orësh nga dhënia e kërkesës.

Me përjashtim, me kërkesë të prokurorit publik, në raste urgjente, kur ekziston rreziku nga shtyrja, gjykatësi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mundet menjëherë të japë urdhëresë të përkohshme me shkrim për zbatim të masës në kohëzgjatje prej 48 orësh (neni 30 paragrafi 1 i LNK-së). Urdhëresën e përkohshme me shkrim dhe të dhënat anonime të kërkesës me shkrim për nevoja të ATO-s si dhe për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit, gjykatësi ia dorëzon prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili ia përcjell ATO-s përmes personit të autorizuar nga organi i autorizuar që është propozues i masës; nëse propozues është vetë prokurori publik i RMV-së atëherë ai ia dorëzon ato ATO-s.

Personi i autorizuar në ATO është i autorizuar menjëherë të veprojë (neni 64 i LNK-së), gjegjësisht:

- a) Ta aktivizojë dhe bëjë të qasshëm komunikimin për të cilin është dhënë urdhëresa;
- b) Ta ndalojë zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve në rastet kur kohëzgjatja e zbatimit të masës ka përfunduar apo kur është dhënë urdhëresa për ndërprerje të masës.

Sa i përket vendimmarrjes lidhur me Kërkesën e prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ligji (neni 21 i LNK-së) parasheh procedurë dy shkallëshe. Gjegjësisht, nëse gjykatësi nuk pajtohet me kërkesën, prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka të drejtë ankimi në Gjykatën Supreme të RMV-së në afat prej 12 orësh nga lajmërimi për mospajtim. Pas dorëzimit të ankesës, në afat prej 12 orësh vendos Këshilli prej tre gjykatësish të GJSRMV-së, ku nuk mund të jetë anëtar gjykatësi i cili nuk është pajtuar me kërkesën.

## 8.4. Arsyeshmëria e zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve

Gjatë vetë vendimmarrjes për dhënien e urdhëresës për zbatim të masës për ndjekje të komunikimeve me qëllim të mbrojtjes së interesave për siguri dhe mbrojtje të shtetit, gjykatësi i Gjykatës Supreme të RMV-së ose Këshilli nga tre gjykatës, duhet të ketë elemente të mjaftueshme teorike dhe praktike (supozime, informata), përmes të cilave do të përcaktojë rëndësinë e dëmit direkt, indirekt dhe konkret për sigurinë kombëtare. Në kontekst të vendosjes pas urdhëresës së tillë, ndonjëherë edhe informatat minimale të sigurisë dhe vlerësimet e shërbimeve të sigurisë të pranuar nga ana e prokurorit publik të RMV-së, të cilat në më shumë situata mund të jenë abstrakte dhe si të tilla të mbesin vetëm si paralajmërim, mund të paraqesin bazë të mjaftueshme që gjykatësi ta pranojë kërkesën dhe të japë urdhëresë, nëse kërcënimi i paralajmëruar dhe vlera që mbrohet kanë rëndësi të madhe dhe prioritet mbi të drejtën e privatësisë së personit.

Gjithsesi, qëllimi për të cilin është vendosur masa dhe vlera që mbrohet, iu lënë hapësirë më të madhe manovruese organeve të ndjekjes, pa argumentim dhe në mënyrë rutinore t'i përcaktojnë masat, deri edhe ta keqpërdorin zbatimin e masave si dhe gjatë kësaj, gjykatësi të sillt "para aktit të kryer". Megjithatë, duke pasur parasysh rolin e gjykatës si kontrollues në zbatimin e masave invazive, gjykatësi nuk është mënjeluar nga çfarëdo lloj mundësie të bëjë vlerësim relevant, duke i pasur parasysh të gjitha elementet që duhet t'i përmbajë kërkesa për ndjekje të komunikimeve e dorëzuar nga ana e prokurorit publik të RMV-së. Përkundrazi, autorizimi gjyqësor për lejimin e masave invazive llogaritet si parim i rëndësishëm dhe mbrojtje e madhe parandaluese nga rrezikimi pa nevojë i privatësisë së personave dhe keqpërdorim i pushtetit diskrecional të shtetit, mirëpo kjo e vetme nuk mund të realizojë mbrojtje të plotë nga përdorimi i stërmadhuar i këtyre masave.

Gjatë shqyrtimit të çështjeve lidhur me sigurinë kombëtare dhe mbrojtjen e shtetit, Gjykata, respektivisht gjykatësit duhet t'i kenë parasysh kriteret dhe rregullat si vijon:

- në rastin e ekzistimit të supozimeve, gjithmonë duhet të merret parasysh e drejta e personit (in dubio pro reo);
- në mënyrë kritike dhe me skepticizëm të shëndoshë të pranohet dhe shqyrtohet kërkesa për zbatim të masave për ruajtje të sigurisë kombëtare;
- zhvillimi i bashkëpunimit profesional dhe ndihmës mes shërbimeve për siguri dhe zbulim (sidomos të Agjencisë për Siguri Kombëtare) dhe Prokurorisë;
- kërkesa patjetër duhet të orientojë në dëmin direkt, të drejtpërdrejtë, të rëndë dhe konkret të sigurisë kombëtare;
- kufizimi i kërkuar për privatësi të personit, duhet të jetë i shkallëzuar, duke filluar nga përfshirja më e vogël deri te ajo më e madhe e privatësisë së personit;
- gjithmonë kur është e mundur, gjykatësit duhet të formulojnë dhe zbatojnë rregulla të forta dhe të shpejta, në vend të atyre të ngadalshme „*balancing test*”. Këtu, posaçërisht mendohet për profilin e subjektit ndaj të cilit do të zbatohet masa, të dhënat për objektin, hapësirën ose lëndën për të cilën do të zbatohet masa, duke pasur kujdes gjithmonë në të drejtat qytetare të garantuara me Kushtetutë dhe standarde ndërkombëtare për zbatim të masave intruzive.

Gjykatësit duhet të insistojnë që të jenë mjaftueshëm të informuar, në kufijtë e normales, për gjendjen faktike, vlerësimin e relevancës, besueshmërinë e fakteve të dhëna në kërkesë, si dhe me vlerësimin e mundësisë së grumbullimit të informatave të nevojshme në tjetër mënyrë.



Më tutje, çdo kërkesë për urdhëresë gjyqësore duhet të përmbajë sqarim dhe arsytim se me besnikëri është respektuar (krahas parimit të subsidiaritetit) parimi i proporcionalitetit, respektivisht se në mënyrë të kujdesshme është bërë balancimi mes çështjes së sigurisë kombëtare dhe diapazonit dhe sferës që përfshin të drejtat dhe liritë e njeriut

Ato parime tregojnë se gjatë vendimmarrjes, me rëndësi të madhe gjykatësit duhet t'i prezantohen arsyet relevante për përdorim të masave, si dhe përse të dhënat dhe faktet nuk mund të grumbullohen në mënyrë tjetër, apo përse mënyra tjetër e grumbullimit të informatave do të kanoste jetën apo shëndetin e njerëzve. Ky fakt, krahas fakteve të tjera të prezantuara, ka ndikim të tërthortë (indirekt) ndaj vendimit të gjykatësit gjatë vlerësimit të arsyeshmërisë së kërkesës për dhënie të urdhëresës për ndjekje të komunikimeve. Për këto arsye masat për ndjekje të komunikimeve si masa ultima ratio ndihmojnë që bazat e dyshimit të shndërrohen në dyshim të arsyeshëm në veprat e krimit të organizuar dhe vepra të tjera penale të numëruara taksativisht.

### **8.5. Përmbajtja e urdhëresës për ndjekje të komunikimeve dhe anonimizimi i saj**

Sipas nenit 22 të LNK-së (identike si në nenin 37 të LASK-së), urdhëresa për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve për shkak të mbrojtjes së sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit, i përmban elementet vijuese:

- llojin e masës për ndjekje të komunikimit, për të cilin është bërë kërkesa;
- të dhënat për objektin, hapësirën ose lëndën për të cilën do të zbatohet masa për ndjekje;
- organin i cili duhet ta zbatojë urdhëresën;
- arsyetimin e shkaqeve dhe nevojës për propozimin e zbatimit të masës;
- kohëzgjatjen e masës, dhe
- llojin e sistemit telekomunikues, numrin telefonik ose e dhënë tjetër identifikuese, si numër identifikimi për secilin prej tyre veç e veç.

Pa marrë parasysh minimumin e elementeve të përshkruara të kërkesës dhe urdhëresës gjyqësore për ndjekje të komunikimeve, në legjislaturën kombëtare janë të nevojshme elemente plotësuese edhe atë si për kërkesën, ashtu edhe për urdhrin gjyqësor, me qëllim që të jenë në pajtueshmëri me standardet e zhvilluara me praktikën gjyqësore të KEDNj-së. Në këtë drejtim disa çështje më të rëndësishme që meritojnë vëmendjen e gjykatësit dhe i ndihmojnë të sjellë vendim valid gjyqësor në raport me zbatimin e masave janë:

- caku legjitim i masave dhe a është ajo e domosdoshme në shoqërinë demokratike;
- baza ligjore për zbatimin e masave, parë nga prizmi i së drejtës domicile, megjithatë edhe të parimeve dhe standardeve të pranuar ndërkombëtare, posaçërisht të praktikës së KEDNj-së;
- a janë theksuar rrethanat të cilat tregojnë se me përpikëri janë respektuar parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit para propozimit të masave;
- kualiteti i bazave të theksuara të dyshimit, gjegjësisht baza e kuptueshme për besueshmëri dhe relevancë të fakteve të deponuara që e arsyetojnë kërkesën për zbatimin e masave, dhe
- a mundet gjatë zbatimit të masave të garantohet barasvlefshmëria e ndjekjes së komunikimeve, gjegjësisht a ekziston mundësi që me zbatimin e masave të vendoset e ashtuquajtura ndjekje masive e komunikimeve të qytetarëve.

Gjykata, nga propozuesi i masës për zbatimin e masës invazive, mund të kërkojë edhe informacione plotësuese, sqarime dhe shpjegime para se të vendosë lidhur me kërkesën e dorëzuar. Informatat plotësuese mund t'i dorëzohen gjykatës në formë të shkruar apo alternative, të premtohen gojarisht gjatë kohës së marrjes në pyetje në dhomat e mbyllura për opinionin.

Dëgjimi në *dhomën e mbyllur për opinionin* mund të jetë adekuat kur Agjencia për Siguri dhe Zbulim dëshiron ta mbrojë burimin e informatave si këmbim të informatave të zbuluesve me institucionet partnere të huaja, dhe, gjykatësi duhet të vlerësojë nëse vallë burimi i informatave është mjaftueshëm i sigurt.

Dëgjimi në *dhomën e mbyllur për opinionin* mund të jetë adekuat atëherë kur Agjencia për Siguri dhe Zbulim dëshiron të mbrojë burimin e informatave si këmbim për informatat zbuluese me institucionet partnere të huaja dhe gjykatësi duhet të vlerësojë nëse vallë burimi i informatave është mjaftueshëm i sigurt. Dëgjimi në “dhomën e mbyllur për dëgjim” mund të caktohet nga gjykata edhe kur është iniciuar procedurë e përshpejtuar nga trupi i autorizuar.

## 8.6. Mënyra e anonimizimit

Mënyrën e anonimizimit dhe të evidentimit në regjistrin gjyqësor të urdhëresave e përshkruan ministri i Drejtësisë me Rregullore për mënyrën e anonimizimit për zbatimin e masës të ndjekjes së komunikimeve me qëllim të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit dhe mënyrës së evidentimit në regjistrin e urdhëresave të anonimizuara (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 200 datë 1 nëntor 2018).

Sipas nenit 22 të LNK-së, gjykatësi i Gjykatës Supreme urdhëresën për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve me mostra të anonimizuara të urdhëresës i dorëzon te prokurori publik i Republikës së Maqedonisë, i cili urdhëresën e përcjell te personi i autorizuar i organit, me propozimin e të cilit është dorëzuar kërkesa te gjykatësi i Gjykatës Supreme.

Personi i autorizuar mostrat e anonimizuara nga urdhëresa sipas nenit 21 të LNK-së ia dorëzon personit të autorizuar të ATO-s.

Gjykatësi që e lëshon urdhëresën për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve në përputhje me LNK-në, menjëherë pas dhënies së saj, bën anonimizimin e saj edhe atë:

- një ekzemplar të urdhëresës së anonimizuar për nevoja të ATO-s, dhe
- dy ekzemplare të urdhëresës së anonimizuar për nevoja të mbikëqyrjes dhe kontrollit, nga të cilat një ekzemplar për nevojat e ATO-s, ndërsa tjetri për nevojat e organeve të autorizuar.

Ekzemplari i urdhëresës së anonimizuar për nevojat e ATO-s është i ndryshëm nga ekzemplari i anonimizuar për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit, për shkak se në përputhje me Ligjin, janë të ndryshme elementet që mbeten të dukshme tek këto dy lloje të urdhëresave të anonimizuara.

### 8.6.1. Anonimizimi i urdhëresës për nevoja të ATO-s

Anonimizimin e urdhëresës për nevoja të ATO-s e bën gjykatësi në mënyrë që të gjitha elementet e urdhëresës, me përjashtim të elementeve të cilat urdhëresa duhet t'i përmbajë sipas Ligjit, zëvendësohen me shenjën “X”.

**Shembull:** të dhënat për personin fizik “Petar Petrovski” me numrin unik amë ose të dhënat për personin juridik “Skopje ShPKNJP” ndaj të cilit do të zbatohet masa; ose të dhënat për objektin, hapësirën ose lëndën për të cilin do të zbatohet masa, zëvendësohen me shenjën “X”.

Pas kryerjes së anonimizimit gjykatësi që e ka dhënë urdhëresën, mostrën e anonimizuar të urdhëresës e dorëzon në ATO-s dhe ajo përmban vetëm të dhëna të përcaktuara në pajtueshmëri me LNK-në edhe atë:

- numrin e urdhëresës,
- kohëzgjatjen e masës, dhe
- llojin e sistemit telekomunikues, numrin e telefonit ose të dhëna të tjera për identifikim, si dhe numrin e identifikimit për secilin prej tyre veç e veç.

### 8.6.2. Anonimizimi i urdhëresës për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit

Anonimizimin e urdhëresës për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit e bën gjykatësi ashtu që të gjitha elementet e urdhëresës, me përjashtim të elementeve të cilat urdhëresa duhet t'i përmbajë në përputhje me ligjin, zëvendësohen me shenjën "X".

**Shembull:** të dhënat për personin fizik " Petar Petrovski" me numrin unik amë ose të dhënat për personin juridik "Skopje ShPKNjP" ndaj të cilit do të zbatohet masa; ose të dhënat për objektin, hapësirën ose lëndën për të cilin do të zbatohet masa, zëvendësohen me shenjën "X".

Pas anonimizimit nga gjykatësi i cili e ka dhënë urdhëresën, mostra e anonimizuar e urdhëresës e dorëzuar për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit përmban vetëm të dhëna të përcaktuara në përputhje me Ligjin për ndjekje të komunikimeve edhe atë:

- numrin e urdhëresës,
- kohëzgjatjen e masës, dhe
- numrin e identifikimit.

**Rregullorja për mënyrën e anonimizimit të urdhëresave nuk parashikon mënyrë të anonimizimit të arsytimit të urdhëresës, siç është e parashikuar te anonimizimi i vendimeve të tjera ose aktgjykimeve, i cili arsyetim përmban të dhëna përmes të cilave subjekti i të dhënave personale mund të identifikohet direkt ose indirekt, për çka te pjesa e arsytimit të urdhëresës ato të dhëna duhet të jenë të shënuara me X.**

### 8.6.3. Evidentimi në Regjistrin e Urdhëresave

Ekzemplarët e anonimizuar të urdhëresës evidentohen në Regjistrin e Urdhëresave me numër dhe datë.

Për nevoja të mbikëqyrjes dhe kontrollit, gjykatësi i cili e ka dhënë urdhëresën dhe personi i autorizuar në ATO e evidentojnë datën dhe numrin e ekzemplarit të anonimizuar në dy regjistra të ndarë, të cilët evidentohen në gjykatë dhe në ATO.

Evidentimin për nevojat e mbajtjes së evidencës në Regjistrin e Urdhëresave e bën:

- Gjykatësi në momentin e dhënies së urdhëresës së anonimizuar për personin e autorizuar në ATO dhe urdhëresës së anonimizuar për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit, dhe
- Personi i autorizuar në ATO pas marrjes së ekzemplarit të anonimizuar.

Dispozitat nga Rregullorja për mënyrën e anonimizimit zbatohen në mënyrë adekuate edhe në raport me dhënien e urdhëresave të përkohshme, me shkrim, për zbatimin e masës për ndjekjen e komunikimeve, gjatë veprimit në raste urgjente në pajtim me nenin 30 nga LNK.

## 8.7. Kohëzgjatja dhe vazhdimi i masës për ndjekje të komunikimeve

Masa për ndjekje të komunikimeve duhet të zgjasë në afat kohor sa është e mundur më të shkurtër. Në këtë kontekst, neni 24 i Ligjit, e përcakton kornizën e përgjithshme. Kështu, paragrafi 1 nga i njëjti nen, fillimisht e përdor formulimin “për kohë sa është domosdoshmërisht e nevojshme”, por, megjithatë duke e kufizuar të njëjtën në kohë “jo më shumë se gjashtë muaj”. Sërish, duke u nisur nga formulimi “koha e cila është e nevojshme”, neni 26 i LNK-së, i jep mundësi gjykatësit të urdhërojë zgjatjen e zbatimit të masës për ndjekje të komunikimeve, por jo më gjatë se gjashtë muaj, me mundësi për vazhdim të sërishëm të masës për gjashtë muaj, ku masa e ndjekjes së komunikimeve mund të vazhdohet më së shumti dy vjet, duke e llogaritur edhe kohën e përcaktuar me urdhëresën e parë të lëshuar për masën e ndjekjes së komunikimeve.

Neni 26 i Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve, e rregullon procedurën për vazhdimin e masës për ndjekje të komunikimeve. Me këtë rast, gjatë veprimit konkret, posaçërisht është e rëndësishme që secili prej organeve kompetente të veprojë në drejtim të përcaktimit të nevojës së vërtetë, respektivisht të domosdoshmërisë për vazhdimin e saj. Fillimisht, prokurori publik është i obliguar gjatë vlerësimit të propozimit të organit të autorizuar, i cili e zbaton masën e ndjekjes së komunikimeve ta përcaktojë nevojën e vazhimit të saj, duke i shqyrtuar arsyet për vazhdimin e tillë përmes analizës së rezultateve të arritura, të fituara në Raportin e organit kompetent në pajtim me nenin 27 të LNK-së, prej ku do të dilte arsyeshmëria e vazhimit të saj.

Gjatë vendosjes lidhur me kërkesën e prokurorit publik të RMV-së për vazhdimin e masës, gjykatësi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, fillimisht vendos për nevojën e vazhimit të saj, pastaj, duke marrë parasysh arsyetimin e dhënë nga prokurori publik tek Kërkesa për vazhdim të masës për ndjekje të komunikimeve dhe Raportet e marra nga organet kompetente, mundet të vazhdojë masën, gjithmonë duke u udhëhequr me formulimin e kohës së nevojshme si postulat themelor, dhe, në bazë të efekteve të pritura në kornizën e caktuar kohore, përsëri duke e pasur parasysh kufizimin që masa të mos zgjasë më shumë se gjashtë muaj (neni 26 paragrafi 3 i Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve). Edhe në këtë situatë, ligjvënësi e parashikon mundësinë, në rast të mospajtueshmërisë së shprehur të gjykatësit, pas ankesës, të vendosë Këshilli i përbërë nga tre gjykatës të Gjykatës Supreme, në pajtim me nenin 21 paragrafi 3 nga Ligji për Ndjekjen e Komunikimeve.

Çështja është se a mundëson Ligji kualitet të mjaftueshëm në kuptimin e parashikimit të mjaftueshëm sepse lejon vazhdim kur “ka nevojë”, që është term shumë i paqartë dhe se nuk është në mënyrë eksplicite i përkufizuar nëse vazhdimi i masës lejohet një apo më shumë herë (Szabo dhe Vissy, Hungari, në 12 janar 2016).

Për këtë shkak Gjykata duhet me kujdes t'i zbatojë autorizimet e veta gjatë vendosjes për vazhdimin e masës invazive. Rekomandohet kriteri i përgjithshëm për vazhdim t'i përfshijë supozimet si vijon:

- a. Ekzistimi i pritjeve të arsyeshme se me vazhdimin e masës, e cila është e domosdoshme për mbrojtjen e institucioneve demokratike, do të fitohen informata plotësuese;
- b. Ekzistimi i shkaqeve të arsyeshme, të cilat kanë penguar grumbullimin e informatave gjatë periudhës paraprake të vazhimit të masave invazive;
- c. Praktika për vazhdim të masave invazive të lejohet për periudhë më të shkurtër nga ajo që kërkohet (për shembull për një muaj në vend të periudhës më të gjatë);

- ç. Raportim i obligueshëm për qëllimet e arritura nga zbatimi i deriatëhershëm i masave invazive si prolog për kërkesë të vazhdimit të tyre, dhe
- d. Kryerje të kontrollit të rregullt dhe të paparalajmëruar me këqyrje të drejtpërdrejtë të transkripteve nga ndjekjet e komunikimeve.

### **8.8. Raportet**

Organi i autorizuar, çdo tre muaj, nga fillimi i zbatimit të masës për ndjekje të komunikimeve, e përgatit dhe dorëzon te prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut raport për rrjedhën e zbatimit të masës.

Përveç raporteve që patjetër dorëzohen çdo tre muaj, organi i autorizuar dorëzon raport edhe kur atë e kërkon prokurori publik i RMV-së, si dhe pas përfundimit të kohës për kur është lejuar zbatimi i masës për ndjekje të komunikimeve. Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, raportet e dorëzuara nga organi i autorizuar që e zbaton masën ia përcjell Gjykatës Supreme të RMV-së.

### **8.9. Ndërprerja e masës për ndjekje të komunikimeve**

Masa ndërpritet pas përfundimit të afatit për të cilin është lejuar.

Duke u udhëhequr nga qëllimet dhe shkaqet e përcaktimit të masës për ndjekje të komunikimeve, ligjvënësi i ka përcaktuar shkaqet dhe situatat kur masa do të ndërpritet. Kështu, ajo ndërpritet kur arrihen qëllimet, për të cilat masa është përcaktuar ose kanë përfunduar shkaqet për të cilat ajo është përcaktuar.

Përveç kësaj, neni 25 i LNK-së e rregullon procedurën e pushimit të masës dhe kompetencat konkrete të tre subjekteve kompetente të përfshira në këtë aktivitet, respektivisht procedurë. Kështu, sipas këtij neni, pas dorëzimit të kërkesës për pushim të masës, gjykatësi menjëherë kërkon nga prokurori publik pushim të masës, ndërsa prokurori publik e përcjell urdhëresën te personi i autorizuar, i cili urdhëresën ia dorëzon personit të autorizuar në ATO. Personi i autorizuar na ATO është i obliguar që menjëherë ta zbatoj urdhëresën për pushim të masës, në përputhje me nenin 164 paragrafi 2 të LNK.

## **9. Veprimi në rastet urgjente**

Me përjashtim të rasteve urgjente kur ekziston rreziku nga shtyrja, gjykatësi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë menjëherë mund të lejojë urdhëresë të përkohshme me shkrim për zbatim të masës nga neni 18, paragrafi 1 i LNK-së, për kohëzgjatje prej 48 orësh.

Në këtë kontekst, ligjvënësi në nenin 30 të LNK-së, nën konceptin veprim në raste urgjente nënkupton gjendje kur ekziston rreziku i shtyrjes, duke mos e përcaktuar konkretisht se çka nënkupton me rrezik të shtyrjes. Megjithatë, edhe në këtë rast, duke i pasur parasysh qëndrimet e theksuara më parë në lidhje me institucionin “veprim në raste urgjente”, gjykatësit udhëhiqen nga rregulla të caktuara (analogji), të cilat tashmë janë etabluar në degë të tjera juridike dhe i përkasin përcaktimit të gjendjes së urgjencës. Gjatë kësaj procedure, në rastet kur masat ndërmerren për shkak të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, element shtesë që mund të përdoret për përcaktim të urgjencës është qëllimi i zbatimit të masave.

Kështu, duke u nisur nga qëllimet e kësaj mase dhe organeve që e zbatojnë atë, nënkuptohet se gjatë zbatimit praktik, gjykatësi i njeh ato, edhe atë si aktivitete me qëllim të parandalimit të kërcënimit të mundshëm ndaj segmenteve vitale të sigurisë nga njëra anë apo kur bëhet fjalë për parandalimin e autorëve të veprave penale, respektivisht veprim parandalues lidhur me aktivitetet për vepra penale sipas LP-së, siç janë organizimi terrorist (neni 394-a), terrorizëm (neni 394-b) dhe financimi i terrorizmit (neni 394-v), kur në situatën konkrete duhet të reagohet me urgjencë të posaçme.

Karakteristikë e urgjencës edhe në këtë rast është se kjo masë mund të urdhërohet menjëherë dhe është e kufizuar në kohëzgjatje prej 48 orësh. Duhet të theksohet se urdhëresa e tillë e përkohshme jepet nga gjykatësi i RMV-së, në formë të shkruar në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit publik të RMV-së, i cili vepron me propozim të arsyetuar të dhënë me shkrim nga personi i autorizuar.

Neni 30 i LNK-së e rregullon në mënyrë detale procedurën për dhënien e kësaj mase dhe veprimin sipas saj të organeve të autorizuar, duke përfshirë këtu edhe ATO-n, përmbajtjen e urdhëresës, anonimizimin e të dhënave dhe evidentimin e urdhëresave në regjistër.

Urdhëresa e përkohshme me shkrim dhe ekzemplarët e anonimizuar nga urdhëresa e dhënë me shkrim për nevojat e ATO-s dhe për nevojat për kryerje të mbikëqyrjes dhe kontrollit gjykatësi i dorëzon tek personi i autorizuar i organit të autorizuar që i bart tek ATO. Personi i autorizuar nga ATO është i obliguar që të veprojë menjëherë pas urdhrit të marrë.

Urdhëresën e përkohshme, me shkrim, gjykatësi i Gjykatës Supreme e jep në bazë të kërkesës të bërë me shkrim nga prokurori publik i Republikës së Maqedonisë, i cili vepron me propozimin e arsyetuar në formë të shkruar të dorëzuar nga personi i autorizuar i organit të autorizuar.

Urdhëresa e përkohshme me shkrim nga paragrafi (1) i këtij neni i përmban të dhënat si dhe urdhëresën e cila jepet në procedurë të rregullt. Gjykatësi e bën edhe anonimizimin e urdhëresës së përkohshme të dhënë me shkrim në mënyrën dhe formën adekuate si edhe për urdhëresën e dhënë në procedurë të rregullt, përgatitet:

- Ekzemplar i anonimizuar i urdhëresës për nevojat e ATO-s, dhe
- Ekzemplar i anonimizuar për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit.

Anonimizimin e të dhënave në urdhëresën e përkohshme të bërë me shkrim e bën gjykatësi i cili e ka dhënë atë urdhëresë.

Nëse vlerësohet se ka nevojë për vazhdimin e afatit për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve, para skadimit të afatit veprohet në kushte dhe procedurë si edhe gjatë kërkesës për vazhdimin e masës së ndjekjes së komunikimeve të lëshuar me urdhëresë në procedurë të rregullt.

## **10. Ruajtja dhe asgjësimi i të dhënave të grumbulluara me zbatimin e masës së ndjekjes së komunikimeve**

Ligji për Ndjekjen e Komunikimeve, në nenin 29 i rregullon dispozitat për ruajtjen dhe asgjësimin e të dhënave të grumbulluara me zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve me qëllim të mbrojtjes së interesave të shtetit. Në përputhje me dispozitat e këtij neni të dhënat e grumbulluara dhe të përpunuara me realizimin e urdhëresës për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve si dhe me vlerësimin se ato janë me rëndësi për masën e zbatuar, të dhënat ruhen në organet e autorizuar për zbatim të masave, në përputhje me aktet për mbrojtje të të dhënave

personale dhe klasifikimin e informatave, për periudhë prej tre vjetësh, llogaritur nga përfundimi i kohës së përcaktuar në urdhëresë.

Megjithatë kur përcaktohet se ekziston informatë e re, e cila është e lidhur në mënyrë direkte me të dhënat specifike për të cilat nuk ka kaluar koha e ruajtjes, atëherë periodha prej 3 vjetësh mund të vazhdohet. Në atë rast ligji parasheh vlerësim periodik të nevojës për ruajtje të të dhënave specifike në bazë vjetore, me të cilën përcaktohet se a janë të rëndësishme të dhënat e grumbulluara për qëllimet për të cilat është zbatuar masa për ndjekje të komunikimeve. Në qoftë se rezultatet nga përcaktimi tregojnë se të dhënat e grumbulluara nuk janë të rëndësishme, ato asgjësohen. Ndërkaq, mënyra e përcaktimit të relevancës së të dhënave dhe mënyra e asgjësimit të tyre janë përcaktuar në Rregullore të posaçme, të cilat janë në kompetencë të ministrit të Mbrojtjes dhe atij të Punëve të Brendshme. Gjithashtu, edhe në Agjencinë e re për Siguri Kombëtare duhet miratuar një Rregullore e këtillë.

Të dhënat e grumbulluara dhe të përpunuara me realizimin e urdhëresës për zbatim të masave për ndjekje të komunikimeve me qëllim të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit, në kuptimin e të dy rregulloreve të cekura më sipër janë:

- përmbajtja e komunikimit të ndjekur dhe të dhënat lidhur me atë komunikim në mënyrë unike;
- vetëm përmbajtja e komunikimit të ndjekur;
- vetëm të dhëna lidhur me komunikimin e ndjekur, dhe
- transkriptet nga përmbajtja e komunikimit të ndjekur të cilat mund të jenë në tërësi (fjalë për fjalë) ose të sublimuara (me përshkrim të përmbajtjes së komunikimit). Transkriptet mund të jenë në formë të shkruar në letër ose në formë elektronike.

Të dhënat e grumbulluara me ndjekjen e komunikimeve në formë elektronike, mund të ndodhen në aparaturën për ndjekje të komunikimeve (LEMF) ose të barten në çfarëdo mediumi për ruajtje (CD, DVD etj.) ose të barten dhe ruhen në çfarëdoq sistemi elektronik (sistem për udhëheqjen e dokumenteve) i cili ndodhet në organin e autorizuar për ndjekje të komunikimeve dhe me të cilin udhëheq organi i autorizuar për ndjekje të komunikimeve.

Relevanca e të dhënave të grumbulluara me ndjekjen e komunikimeve vlerësohet dhe përcaktohet nga ana e të punësuarit në shërbimin ushtarak për siguri dhe zbulim në Ministrinë e Mbrojtjes (në tekstin e mëtutjeshëm: Shërbimi), i cili punon në lëndën konkrete dhe ka dhënë iniciativë dhe propozim për dhënien e urdhëresës për zbatim të masës për ndjekje të komunikimeve, për çka përgatit raport, ose nga ana e punëtorit të MPB-së, i cili punon në lëndën konkrete dhe i cili ka dhënë iniciativë dhe propozim për dhënien e urdhëresës për zbatim të ndjekjes së komunikimeve, për çka po ashtu përgatit raport.

Nëse vlerësohet se të dhënat janë me rëndësi për masën e zbatuar, ato ruhen deri në përfundim të kohës së përcaktuar në urdhëresë për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve, në përputhje me rregullat për mbrojtje të të dhënave personale dhe informatave të klasifikuara.

Sipas të dyja rregulloreve, MPB dhe MM formojnë Komisione për përcaktim të asaj se a janë të dhënat e grumbulluara me zbatimin e MPH-së (Masave të Përkohshme Hetimore) me rëndësi për masën që të ruhen tre vjet, llogaritur nga përfundimi i kohës së përcaktuar në urdhëresën për zbatim të masës për ndjekje të komunikimeve.

Vazhdimi i afatit për ruajtje të të dhënave të grumbulluara me zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve për një vit, me mundësi të vazhdimit të sërishëm për një vit, duke marrë parasysh se afati mund të vazhdohet më së shumti tre vjet në përputhje me ligjin, kjo vlerësohet nga ana e Komisionit (neni 21 nga të dyja rregulloret).

Pas përfundimit të afatit për ruajtjen e të dhënave të grumbulluara me zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve, të dhënat dhe të gjitha materialet që lidhen me realizimin e urdhëresës për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve asgjësohen nga ana e Komisionit të formular në MPB ose në MM. Komisioni, asgjësimin e të dhënave dhe të gjitha materialeve të lidhura me realizimin e urdhëresës për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve e kryen nën mbikëqyrje të gjykatësit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të përcaktuar me orarin e brendshëm të gjykatës për dhënien e urdhëresave, në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me ligj. Të dhënat në formë elektronike të cilat ruhen në aparaturë të caktuar elektronike, shkatërrohen me fshirjen nga vendet e caktuara fizike dhe logjike ku ndodhen, me përdorimin e interfejsit të caktuar dhe përkrahjen programore që aparatura i ka të instaluar nga prodhuesi.

Komisioni për asgjësim nuk mund të ketë ose të kërkojë qasje tjetër direkte ose indirekte në vendet fizike apo logjike, ku ndodhen të dhënat në aparaturën e caktuar elektronike.

Në aparaturën elektronike mbetet shënimi (log) për atë se cilat të dhëna janë fshirë, kur janë fshirë ato, kush e ka bërë fshirjen dhe në çfarë baze është realizuar fshirja. Nëse mundësitë teknike e mundësojnë atë, në shënimin elektronik ruhet edhe numri identifikues i të dhënës që është fshirë. Të dhënat në formë elektronike që ndodhen në mediume që barten, asgjësohen në mënyrë fizike nga mbajtësi i të dhënave, i instaluar në mediumin bartës.

Në varësi të kompleksitetit konstruktiv, mediumi mund të shpërbëhet në pjesët e tij përbërëse (hard disk ose USB) dhe të asgjësohen ajo pjesë ku ndodhen të dhënat, në mënyrë që të mos mund të bashkohen përsëri ose të lidhen pjesët e mediumit me qëllim që përsëri të mundësohet restaurimi dhe përdorimi i të dhënave të asgjësuara.

Të dhënat që ruhen të shkruara në letër asgjësohen përmes makinave për prerje ose imtësim të letrës në mënyrë që letrat e prera në pjesë mos mund përsëri të bashkohen në një tërësi nga e cila do të bëhet i mundur leximi i të dhënave.

Për asgjësimin e realizuar nga ana e Komisionit përgatitet një protokoll në të cilin regjistrohet vetëm numri i urdhëresës gjyqësore. Protokollin përgatitet në dy ekzemplarë (njëri ekzemplar për gjyqin dhe tjetri për parashtruesin e kërkesës për ndjekje të komunikimeve) dhe ruhet 10 vjet.

## **11. Obligimi për ruajtje të sekretit zyrtar**

Obligimi për ruajtje të sekretit zyrtar për personat e organeve të autorizuar për zbatim të masave për ndjekje të komunikimeve, personit nga ATO dhe personit nga operatorët, i cili në çfarëdo mënyre mëson për të dhëna që kanë lidhje ose dalin nga zbatimi i masave për ndjekje të komunikimeve, parashihet në nenin 31 të LNK-së.

Në përputhje me dispozitat e këtij ligji personi në fjalë është i obliguar t'i ruajë si sekret zyrtar ose informatë e klasifikuar të gjitha të dhënat që dalin nga masa për ndjekje të komunikimeve, përveç në rastet kur ato janë grumbulluar në mënyrë joligjore. Në atë rast personi është i obliguar menjëherë ta informojë prokurorin gjegjës publik. Personi në fjalë ka për obligim ta ruajë sekretin zyrtar lidhur me



të dhënat që i ka mësuar nga zbatimi i masave për ndjekje të komunikimeve në kohëzgjatjen e mandatit të tij ose marrëdhënies së punës, respektivisht pesë vjet pas përfundimit të tyre.

Obligimi për ruajtjen e sekretit zyrtar ka të bëjë me llojin e të dhënave nga neni 29 i LNK-së, respektivisht për të dhënat e grumbulluara dhe përpunuara me realizimin e urdhëresës për zbatim të masave për ndjekje të komunikimeve, kur do të vlerësohet se ato janë me rëndësi për masën e zbatuar. Ato ruhen në organet e autorizuara për zbatim të masave, në përputhje me rregullat e mbrojtjes së të dhënave personale dhe informatave të klasifikuara, për periudhë prej tre vjetësh, duke llogaritur nga përfundimi i kohës së përcaktuar në urdhëresën për ndjekje të komunikimeve, si dhe në rastet e vazhdimit të atij afati.

## SHTOJCA TË PJESËS 3

### HAPAT GJATË ZBATIMIT TË MASAVE TË NDJEKJES SË KOMUNIKIMEVE ME QËLLIM TË MBROJTJES SË INTERESAVE TË SIGURISË DHE MBROJTJES SË SHTETIT

#### PËRGATITJA E KËRKESËS

- **Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të drejtorit të ASK-së ose personit të autorizuar nga ai, apo me propozim të ministrit të Mbrojtjes apo të personit të autorizuar nga ai, përgatit kërkesë.**
- **Kërkesa është në formë të shkruar dhe përmban:**
  - Llojin e masës për ndjekje të komunikimit për të cilin është shtruar kërkesa;
  - Të dhëna për personin fizik apo juridik ndaj të cilëve do të zbatohet masa;
  - Të dhëna për objektin, hapësirën apo lëndën për të cilët do të zbatohet masa;
  - Organin që duhet ta zbatojë urdhëresën;
  - Arsyetimin e shkaqeve dhe nevojës për të cilat propozohet zbatimi i masës;
  - Kohëzgjatjen e masës; dhe
  - Llojin e sistemit të telekomunikacionit, numrin e telefonit ose e dhënë tjetër e identifikimit, si dhe numrin e identifikimit për secilin në veçanti.

#### DORËZIMI I KËRKESËS

- **Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut e dorëzon kërkesën tek Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut.**

#### VENDOSJA

- **Gjykatësi i Gjykatës Supreme i Republikës së Maqedonisë së Veriut i caktuar me orarin e brendshëm të Gjykatës vendos menjëherë, më së voni në afat prej 24 orëve nga dorëzimi i kërkesës.**
- **Me përjashtim, me kërkesë të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në rastet urgjente kur ekziston rreziku i shtyrjes, gjykatësi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mund të japë menjëherë urdhëresë të përkohshme me shkrim për zbatimin e masave për kohëzgjatje prej 48 orëve (neni 30, al. 1 i LNK-së).**

#### DHËNIA E URDHËRESËS

- **Gjykatësi i Gjykatës Supreme përgatit urdhëresë.**
- **Urdhëresa përmban:**
  - Llojin e masës për ndjekje të komunikimit për të cilin është shtruar kërkesa;
  - Të dhëna për personin fizik apo juridik ndaj të cilëve do të zbatohet masa;
  - Të dhëna për objektin, hapësirën apo lëndën për të cilët do të zbatohet masa;
  - Organin që duhet ta zbatojë urdhëresën;
  - Arsyetimin e shkaqeve dhe nevojës për të cilat propozohet zbatimi i masës;
  - Kohëzgjatjen e masës; dhe
  - Llojin e sistemit të telekomunikacionit, numrin e telefonit ose e dhënë tjetër e identifikimit, si dhe numrin e identifikimit për secilin në veçanti.

## ANONIMIZIMI

- **Anonimizimi i urdhëresës është përshkruar në Rregulloren për mënyrën e anonimizimit për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve me qëllim të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit dhe për mënyrën e evidentimit në regjistrin e urdhëresave të anonimizuara (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 200, e 1 nëntorit 2018).**
- **Gjykatësi i cili jep urdhëresë për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve në përputhje me LNK, menjëherë pas lëshimit të saj, e bën anonimizimin e urdhëresës edhe atë:**
  - Një ekzemplar të urdhëresës së anonimizuar për nevojat e ATO-s dhe
  - Dy ekzemplarë të urdhëresës së anonimizuar për nevojat e mbikëqyrjes dhe kontrollit, prej të cilëve një ekzemplar është për nevojat e ATO-s, ndërkaq tjetri për nevojat e organeve tjera të autorizuara.

## DORËZIMI I URDHËRESËS

- **Urdhëresa dorëzohet te Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.**
- **Prokurori Publik i RMV-së urdhëresën e dorëzon te personi i autorizuar në organin me propozim të të cilit e ka dorëzuar kërkesën te gjykatësi i Gjykatës Supreme.**
- **Personi i autorizuar, ekzemplarët e anonimizuar të urdhëresës i dorëzon te personi i autorizuar në ATO.**


## RAPORTET

- **Organi i autorizuar çdo tre muaj nga fillimi i zbatimit të masës për ndjekje të komunikimeve deri te Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përgatit dhe dorëzon raport për zbatimin e masës.**
- **Bashkë me raportet që dorëzohen detyrimisht në çdo tre muaj, organi i autorizuar dorëzon raport edhe atëherë kur atë e kërkon Prokurori Publik i RMV-së, si dhe pas kalimit të kohës që është lejuar zbatimi i masës për ndjekje të komunikimeve.**


## DORËZIMI I RAPORTEVE

- **Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut raportet e marra nga organi i autorizuar që e zbaton masën i dorëzon në Gjykatën Supreme të RMV-së.**

**NDJEKJA E KOMUNIKIMEVE ME QËLLIM TË MBROJTJES SË INTERESAVE TË SIGURISË DHE MBROJTJES SHETËTËRORE ME NËRDMJETËSIMIN E ATO-S**



**NDJEKJA E KOMUNIKIMEVE ME QËLLIM TË MBROJTJES SË INTERESAVE TË SIGURISË DHE MBROJTJES SHITETËRORE PANDËRMJETËSIMIN E ATO-S**





# PJESA 4

---

MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI MBI MASAT E POSAÇME TË HETIMIT





## 1. Hyrje

Në rastin *Klas kundër Gjermanisë*, GjEDNj thekson: “Në shoqëritë bashkëkohore demokratike masat e posaçme hetimore paraqesin instrument të domosdoshëm të organeve të ndjekjes penale si mjet adekuat për pengimin dhe zbulimin e krimit. Megjithatë, nëse zbatimi i këtyre masave nuk është rregulluar me ligj, paraqitet rrezik nga rrënimi ose edhe shkatërrimi i demokracisë me arsyetimin se kjo bëhet për mbrojtjen e saj. Shteti duhet të sigurojë dëshmi të qarta për domosdoshmërinë e zbatimit të masave dhe njëkohësisht të ndërtojë kornizë juridike, e cila do të mundësojë dhe sigurojë mbrojtje adekuate dhe efikase nga keqpërdorimi, si dhe të njëjtat dëshmi të mos shfrytëzohen rastësisht dhe pa kujdesin adekuat. Kjo nënkupton edhe ekzistencën e metodave adekuate të përgjegjësisë për zbatimin e masave të posaçme të hetimit si dhe mbikëqyrje dhe kontroll efikas ndaj tyre. Në këtë drejtim, mbikëqyrja parlamentare dhe kontrolli gjyqësor janë të mjaftueshme që të plotësohen kriteret nga neni 8, paragrafi 2 i GjEDNj-së, gjatë së cilës kontrolli gjyqësor jep garanci më të mira për pavarësi, paanësi dhe procedurë adekuate.”

Pamundësia që të realizohet në tërësi sigurimi i përgjegjësisë, transparencës, mbikëqyrja dhe kontrolli mbi punën e shërbimeve të sigurisë dhe të zbulimit është problem serioz, dhe si i tillë është i pranishëm pothuajse në të gjitha shtetet në botë. Shkaqet dhe faktorët për gjendjen e tillë janë të shumta, ndërkaq disa prej tyre janë:

- Mosekzistenca ose ngritja jo e mjaftueshme e sistemit për kontroll dhe mbikëqyrje mbi punën e shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit;
- mbyllja “natyrore” e shërbimeve që buron nga regjimi i posaçëm i sekretit të punës së shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit, shpesh e kufizon qasjen dhe shikimin e të gjitha dokumenteve, aktiviteteve dhe informatave relevante;
- ekzistimi i autorizimeve diskrecionale të shërbimeve u jep liri të madhe autoktone në drejtim të vlerësimit të llojit dhe shkallës së rrezikut nga kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare, llojit të masave dhe aktiviteteve që ndërmerren;
- mungesa e mekanizmave mbrojtës procedural të kontrollit dhe mbikëqyrjes gjatë procedurës së propozimit dhe zbatimit të masave si dhe marrje të aktiviteteve të tjera operative;
- politizimi, gjegjësisht mbisundimi i kriterëve politike mbi ato të sigurisë gjatë punës së shërbimeve, posaçërisht gjatë klasifikimit dhe vlerësimit të llojit të kanosjeve dhe rrezikut nga ato dhe
- Fshehja e punës jotransparente, jollogaridhënëse dhe joligjore nën mbulesën e “sekretit shtetëror” apo lloj tjetër kufizimi të qasjes së organeve kontrolluese dhe mbikëqyrëse ose opinionit publik me arsyetimin se fshehtësia e tillë është e domosdoshme për të parandaluar dëmin e pakompensueshëm ndaj sigurisë kombëtare etj.

Sipas rregullit bëhet dallimi mes koncepteve mbikëqyrje dhe kontroll.

Kështu, me konceptin mbikëqyrje rëndom nënkuptohet këqyrje e planifikuar (e tërësishme apo e pjeshme), monitorim ndaj institucionit të caktuar, të përcjellë me hulumtim sistematik, hetim dhe paraqitje të gjendjeve që janë subjekt i mbikëqyrjes, përfundim dhe evaluim të gjendjes së konstatuar.

**Mbikëqyrja** është mjet relativisht i ri dhe efikas (nga fundi i shekullit njëzet) i shoqërisë demokratike për realizimin dhe promovimin e llogaridhënies të shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit, të cilat për dallim nga organet tjera shtetërore kanë kufizime të transparencës dhe hapjes ndaj opinionit publik për shkak të llojit të besueshmërisë së punës. E drejta e qytetarëve të jenë të informuar për funksionimin dhe aktivitetet e shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit buron nga fakti se ata shfrytëzojnë mjete publike, gjë që i mundëson opinionit publik me të drejtë të plotë të dijë nëse ato mjete shfrytëzohen në mënyrë adekuate, ligjore, efektive dhe efikase. Mbikëqyrja (sidomos ajo parlamentare) është instrument efikas për parandalimin dhe kufizimin e tendencave për keqpërdorim të sistemit të sigurimit dhe zbulimit në shoqërinë demokratike. Detektimi, konstatimi dhe sinjalizimi me kohë i mospërputhjeve të caktuara nga ana e përfaqësuesve të Kuvendit (dhe institucioneve të tjera që kanë të drejtë të mbikëqyrjes) mundëson reagim në kohë për mbrojtjen e vlerave themelore të shoqërisë demokratike.

Dobësitë e mbikëqyrjes parlamentare dalin nga natyra dhe struktura e anëtarëve të mbikëqyrjes parlamentare, gjegjësisht:

- ata si personalitete politike nuk kanë njohuri të mjaftueshme profesionale nga fusha që është lëndë e mbikëqyrjes;
- për shkak të përkatësisë politike partiake, zakonisht mendohet se janë nën ndikim politik, dhe
- për shkak të prioritetit të funksionit politik, deputetët kujdes shumë më të vogël i kushtojnë rëndësisë dhe kuptimit të mbikëqyrjes.

Për dallim nga mbikëqyrja, **kontrolli** paraqet instrument të modeluar ligjor të fuqisë për ndikim të drejtpërdrejtë dhe udhëheqje të të gjitha segmenteve të punës së institucionit që është lëndë e kontrollit, gjegjësisht ndikimit dhe udhëheqjes së strategjisë së punës, drejtimit, udhëheqjes dhe veprimit. Për këtë, kontrolli është prerogativ i pushtetit ekzekutiv dhe fillon me kontrollin e brendshëm që zbatohet në mënyrë hierarkike në vetë shërbimin.

Kontrolli nuk është element i rëndësishëm vetëm për sigurimin e suksesit (efikasiteti dhe efektiviteti) të zbatimit të politikave të përcaktuara të pushtetit ekzekutiv, por (njësoj si edhe mbikëqyrja) instrument i rëndësishëm me të cilin garantohet dhe sigurohet sundimi i së drejtës, gjegjësisht parimi i punës ligjore të shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit. Për dallim nga mbikëqyrja, kontrolli nuk ka për qëllim vetëm konstatimin e gjendjes, por gjithmonë përcillet me udhëzime të detyrueshme, masa, obligime deri edhe përcaktim të përgjegjësisë për punën e konstatuar joligjore të institucionit që është subjekt i kontrollit.

Kontrolli realizohet edhe nga organe të tjera përveç atyre të ekzekutivit, në këtë kontekst kontrolli që zbatohet nga gjyqi dhe prokuroria është më i rëndësishmi.

*Qëllimi i mbikëqyrjes dhe kontrollit të zbatimi i masave të posaçme hetuese janë: **ligjshmëria** (sundimi i ligjit), **efikasiteti** (përshtatshmëria dhe efektiviteti ekonomik i planifikimit në realizimin e kompetencave dhe qëllimeve të parashikuara) dhe **efektiviteti** (sukses në realizimin e qëllimeve të vëna) në zbatimin e masave. Mbikëqyrja dhe kontrolli efikas në zbatimin e masave paraqet mbrojtje më të mirë për tejkalimin ose keqpërdorimin e autorizimeve nga ana e organeve që i zbatojnë masat. Pushteti ekzekutiv përmes procedurave të mekanizmave mbrojtës rëndom arrin të vendosë dhe të mbajë kontroll dhe mbikëqyrje efikase mbi aktivitetet e shërbimeve për siguri dhe zbulim. Megjithatë, me rëndësi thelbësore për demokracinë në një shoqëri është të ekzistojë mbikëqyrje efikase, e vendosur nga organet parlamentare si dhe organet e ekspertëve jashtëparlamentarë, të cilët janë të pavarur nga pushteti aktual.*

**Mbikëqyrja parlamentare** rëndom konstituohet në formë të organeve ose trupave të posaçëm (më shpesh komisione ose komitete) me mandat të gjerë të mbikëqyrjes (mbikëqyrje e punës së përgjithshme të shërbimeve), ose në formën e komisioneve të specializuara (me mandat të ngushtë), kompetenca e të cilave për mbikëqyrje është e orientuar vetëm në një segment të punës së shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit (për shembull: mbikëqyrja *ex ante* ose *ex post* e zbatimit të aktiviteteve operative të ndërlikuara të shërbimeve, mbikëqyrja e zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve, etj.).

Instrument shumë i rëndësishëm dhe efikas për mbikëqyrje dhe kontroll është “revizioni” financiar i punës së shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit (vendimi për lartësinë e buxhetit, zgjerimit apo plotësimit të tij, analiza e raporteve vjetore financiare të dorëzuara etj.). Përmes këqyrjes efikase dhe faktike të punës financiare të shërbimeve mund të fitohen njohuri për keqpërdorime dhe parregullsi gjatë punës së tyre. Aktivitetet e dyshimta financiare më shpesh mbulohen si “shpenzime speciale ose të posaçme teknike dhe operative”, të cilat opinioni publik nuk ka qasje.

Puna financiare është segmenti më i ndjeshëm për të cilin shërbimet gati asnjëherë nuk kanë “disponim të mirë” për t’i dhënë opinionit publik llogari dhe pasqyrë të plotë e transparente, me arsyetimin se me atë do të provokojë “dëm i paparashikuar” i interesave të sigurisë së shtetit.

**Organet eksperte jashtëparlamentare** (inspeksionet) për mbikëqyrje themelohen dhe funksionojnë të pavarura nga pushteti ekzekutiv, nga strukturat parlamentare dhe shërbimet e sigurisë dhe zbulimit të cilat janë objekt i mbikëqyrjes. Ata zgjidhen dhe i japin llogari Parlamentit dhe llogaritet se janë më efektiv nga komisionet parlamentare sepse kanë njohuri profesionale adekuate dhe tërësisht i përkushtohen mbikëqyrjes (më shpesh bëhet fjalë për persona të cilët profesionalisht janë marrë ose kanë punuar në shërbimet e sigurisë dhe zbulimit).

**Efikasiteti i mbikëqyrjes dhe i kontrollit mund të arrihet vetëm me normim preciz të mekanizmave për kontroll dhe mbikëqyrje dhe me krijimin e kushteve për zbatimin adekuat dhe objektiv të mekanizmave të përcaktuar për kontroll dhe mbikëqyrje.**

Në të kundërtën, organet e autorizuar mund të shndërrohen në gjeneratorë të krizave dhe në vend se ta kenë besimin e qytetarëve si garantues të sigurisë publike dhe kombëtare, ata, opinioni publik do t’i shohë me dyshim dhe mosbesim.

Efikasiteti i mekanizmave për kontroll dhe mbikëqyrje përcaktohet nga disa faktorë të ndërlidhur mes veti, si dhe nga ambienti i përgjithshëm shoqëror, politik dhe i sigurisë në një shtet.

**Posaçërisht është i rëndësishëm integriteti dhe pavarësia e institucioneve për mbikëqyrje dhe kontroll dhe bashkëpunimi i tyre me institucionet tjera relevante. Parakusht i rëndësishëm për mbikëqyrje dhe kontroll efikas është eliminimi i ndikimeve partiake-politike ndaj personave që udhëheqin me këto institucione.**

Në këtë mënyrë do të mundësohet që mbikëqyrja dhe kontrolli të jenë korrektorë të vërtetë të punës së organeve të autorizuar për realizimin e masave invazive. Kjo, posaçërisht është e rëndësishme për mbikëqyrje dhe kontroll të ndjekjes së komunikimeve, duke marrë parasysh strukturën e ndërlikuar të sistemit të vendosur për ndjekje të komunikimeve.

## 2. Mbikëqyrja e zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve në përputhje me legjislacionin kombëtar

Në përputhje me dispozitat (nenet 35, 40 dhe 47) e LNK-së, mbikëqyrje ndaj masave për ndjekje të komunikimeve që zbatohen nga organet e autorizuar për ndjekje të komunikimeve, operatorëve dhe ndaj Agjencisë Teknike Operative (ATO), mund të bëjë:

- **Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut;**
- **Drejtoria për Siguri të Informatave të Klasifikuara;**
- **Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;**
- **Avokati i Popullit;**
- **Këshilli Qytetar për Mbikëqyrje;**
- **Subjekte të tjera (mediumet, sektori joqeveritar, opinioni më i gjerë, etj.);**

**Për dallim nga kontrolli, qëllimi i mbikëqyrjes, sipas rregullit kufizohet me ligjshmërinë e punës së shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit (apo të një pjese të punës së tyre), përmes efektivitetit të tyre, pa mundësi të përfshirjes së efikasitetit të punës së tyre.**

*Mbikëqyrjen parlamentare të punës së shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit në sistemin e sigurisë dhe zbulimit në R. e Maqedonisë së Veriut e bëjnë:*

- 1. Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri** - që bën mbikëqyrje (ndërmjetësuese) të punës së shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit në Ministrinë e Mbrojtjes;
- 2. Komisioni për Mbikëqyrje të Punës së Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe të Agjencisë së Zbulimit** - që kryen mbikëqyrjen e punës së Agjencisë për Siguri Kombëtare (ish-Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim) dhe Agjencisë për Zbulim.
- 3. Komisioni për Mbikëqyrje të Realizimit të Masave për Ndjekje të Komunikimeve.**

Komisioni i tretë special parlamentar i përbërë nga anëtarë të përbërjes aktuale të parlamentit është kompetent për të mbikëqyrë ligjshmërinë dhe efektivitetin e zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve në të gjitha institucionet të cilat janë të përfshira në procesin e zbatimit të masave (neni 40 paragrafi 1 nga LNK) përveç në Agjencinë për Zbulim.

Me qëllim të realizimit të suksesshëm të mbikëqyrjes (neni 39 i LNK-së) Komisioni për Mbikëqyrje të Zbatimit të Masave për Ndjekje të Komunikimeve (në tekstin në vazhdim-Komisioni) mund të angazhojë ekspertë teknikë vendorë dhe ndërkombëtarë me njohuri adekuate profesionale, të cilët në bazë të akreditimit të tyre mund të marrin pjesë në punën e Komisionit. Mbikëqyrja teknike që mund ta realizohet nga Komisioni me ndihmën e ekspertëve teknikë, nuk ka mundësi ligjore të bëjë mbikëqyrje në përmbajtjen e komunikimit as të bëjë mbikëqyrje të çfarëdo të dhëne lidhur me identitetin e personit apo komunikimit të subjektit ndaj të cilit zbatohet masa e ndjekjes së komunikimeve.

Mbikëqyrja teknike në ATO dhe operatorët është e kufizuar vetëm me këqyrje të urdhëresës gjyqësore të anonimizuar dhe kontrollin e të dhënave elektronike automatike të krijuara dhe të ruajtura në mjetet teknike mediatike tek operatorët dhe tek ATO (nenet 41 dhe 42 nga LNK), të cilat kanë të bëjnë me kohën e aktivizimit dhe përfundimit të masave, numrit të urdhëresave gjyqësore të anonimizuara si dhe numrit të përgjithshëm të masave të realizuara në një periudhë të caktuar kohore, ndërsa tek organet e autorizuar mbikëqyrja teknike është e kufizuar (neni 43

i LNK-së) vetëm me këqyrje të urdhëresës gjyqësore të anonimizuar dhe dokumenteve të fillimit dhe përfundimit të zbatimit të masës.

Mbikëqyrja gjithmonë është *ex post* dhe e kufizuar në pjesën e përcaktimit të ligjshmërisë gjatë zbatimit të masave. Kështu, pos të dhënave gjatë kohës së fillimit dhe përfundimit të masave, Komisioni ka mundësi të marrë të dhëna për numrin e urdhëresave gjyqësore të lëshuara, numrin e përgjithshëm të komunikimeve të ndjekura, mandej mund të bëjë këqyrje te secila urdhëresë e anonimizuar për mbikëqyrje dhe kontroll, por megjithatë nuk ka mundësi të marrë të dhëna për përmbajtjen e komunikimit dhe identitetin e vërtetë të personit, komunikimi i të cilit ndiqet.

Kështu që, për dallim nga kontrolli, Komisioni e kontrollon barasvlefshmërinë e komunikimit që ndiqet nga operatorët, ATO dhe organet e autorizuar për zbatimin e masave, përmes krahasimit të numrave identifikues (që janë zëvendësim për të dhënat e vërteta të identitetit të bartësit të komunikimit) të cekura tek urdhëresat gjyqësore të anonimizuara për mbikëqyrje dhe kontroll (neni 41, 42 dhe 43 të LNK-së).

Gjatë mbikëqyrjes, Komisioni mund të bëjë këqyrje dhe të konstatojë a kanë institucionet që janë të kyçura në procesin e zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve, rregullativë adekuate juridike, e cila rregullon:

- procedurën e pranimit dhe përcjelljen e urdhëresave gjyqësore,
- mënyrën dhe procedurën e kontrollit të brendshëm,
- procedurën e refuzimit të urdhrave nga ana e eprorëve, të cilat janë të kundërligjshme, si dhe
- procedurën e paraqitjes së parregullsive dhe joligjshmërive gjatë punës.

Komisioni mund të bëjë këqyrje dhe të konstatojë (neni 68, paragrafi 6 nga LNK) a thua operatorët (përfshirë ATO-n dhe organet e autorizuar) kanë siguruar kushte adekuate të domosdoshme për ndjekje të saktë dhe të barasvlefshme të komunikimeve, për shkak të parandalimit të të ashtuquajturës ndjekje masive të komunikimeve.

Mbikëqyrjen e efektivitetit të zbatimit të masave, Komisioni e realizon drejtpërdrejt dhe përmes shikimit dhe analizës së Raportit Vjetor të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi zbatimin e masave të posaçme hetimore (neni 40, paragrafi 3 i LNK-së).

Komisioni mund të bëjë mbikëqyrje pa paralajmërim paraprak, sipas nevojës, e së paku një herë në tre muaj, edhe në mungesë të shumicës së votave. Mbikëqyrja mund të jetë e terrenit, gjegjësisht me praninë e drejtpërdrejtë të Komisionit në hapësirat e institucionit që mbikëqyret, por mbikëqyrja mund të zbatohet edhe në hapësirat e Komisionit, përmes shikimit dhe analizimit të raporteve të dorëzuara ose përmes bisedës me persona të cilët punojnë në institucionet ndaj të cilëve realizohet mbikëqyrja.

Procedura për verifikim të sigurisë për personat e emëruar në organet mbikëqyrëse, si edhe për ekspertët teknik të angazhuar në organet mbikëqyrëse, qofshin ato kombëtar apo ndërkombëtar, në vend të gjashtë muajve të deritashme, tani ajo procedurë zgjat një muaj. Ndryshimet janë të orientuara drejt krijimit të parakushteve për mbikëqyrje efikase përmes eliminimit të vështirësive të caktuara, posaçërisht atyre me të cilat ballafaqohen anëtarët e komisioneve parlamentare, bile edhe atëherë kur ekzistonte vullneti politik për të realizuar mbikëqyrje efikase.

### 3. Kontrolli i zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve në përputhje me legjislacionin kombëtar

**Kontrolli gjyqësoro-prokurorial për dallim nga mbikëqyrja, nuk ka kurrfarë kufizimesh të spektrit, gjerësisë dhe llojit të aktiviteteve dhe të të dhënave që mund t'i kontrollojë në organet e autorizuar për zbatimin e masave të posaçme, operatorët dhe ATO (nenet 59 dhe 50 të LNK-së).**

Kufizimi i vetëm, kuptohet del nga kompetencat e vërteta të dy institucioneve (neni 57 i LNK-së), gjegjësisht secili institucion mund ta kontrollojë problematikën që është kompetenca e vërtetë e saj.

Me fjalë të tjera, Gjykata Themelore nuk guxon të bëjë kontroll ndaj masave që janë përcaktuar nga Gjykata Supreme. E njëjta vlen edhe për kontrollin e instancave të Prokurorisë Publike. Kuptohet, ligji nuk lejon që edhe instanca më e lartë të bëjë kontroll ndaj masave që janë propozuar dhe përcaktuar nga instancat më të ulëta, me një përjashtim që ka të bëjë me kontrollin e pajisjeve të posaçme teknike dhe pajisjeve që janë vendosur në Prokurorinë Themelore Publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit (neni 60, paragrafi 5 i LNK-së) dhe në Agjencinë për Siguri Kombëtare.

Pra, në bazë të nenit 60 të LNK-së dhe neneve 55 dhe 58 nga LASK, kontrollin mbi pajisjet e posaçme teknike dhe materialet e zbaton vetëm prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjykatësi në procedurë paraprake, gjegjësisht gjykatësi i Gjykatës Supreme i cili e ka dhënë urdhëresën për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve.

Kështu, vetëm në këtë rast prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të zbatojë kontroll (përjashtim nga kompetencat reale) në evidencat zyrtare që mbahen në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit si dhe në organet e autorizuar.

Sipas dispozitave ligjore, kontrolli kufizohet në ligjshmërinë e zbatimit të masave (nenet 57 deri 61 të LNK-së) dhe sipas rregullit të *ex post*, megjithatë duke marrë parasysh se institucionet e gjyqësisë dhe prokurorisë janë drejtpërdrejt të përfshira në procedurë që nga vetë lejimi i masave deri te përdorimi i fundit i të dhënave të fituara si dëshmi në procedurë penale, kontrolli gjithmonë është i pashmangshëm *ex ante* (parimi i lejimit gjyqësor paraprak të masave), por i pashmangshëm edhe aktualisht (raporte për zbatimin aktual, zgjatjen dhe zgjerimin e masave). Pos formës së drejtpërdrejtë të kontrollit (në terren), që është e rekomandueshme, ekziston edhe kontrolli indirekt i cili zbatohet duke analizuar raportet e pranuar nga masat e ndërmarra për ndjekje të komunikimeve dhe të dokumenteve të tjera zyrtare që janë në lidhje me zbatimin e masave në organet e autorizuar, ATO-s dhe operatorëve.

Për shkak të kycjes së drejtpërdrejtë të të dy institucioneve, kontrolli i pashmangshëm e përfshin edhe efikasitetin dhe efektivitetin gjatë zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve, fillimisht dhe më së shumti tek organet e autorizuar për zbatimin e masave, e më pak tek operatorët dhe ATO.

Në pajtim me nenin 57 të LNK-së, në rastet kur masat për ndjekje të komunikimeve zbatohen për shkak të qëllimeve penale, prokurori publik i cili e udhëheq procedurën dhe gjykatësi në procedurë paraprake i cili e ka dhënë urdhëresën për masën e posaçme hetuese, janë kompetentë të kryejnë kontroll të ligjshmërisë së zbatimit të masës së posaçme hetuese ndaj organeve të autorizuar për zbatimin e masave të posaçme hetuese, operatorëve dhe ATO-s.

Në rastet kur masat për ndjekje të komunikimeve zbatohen me qëllim të mbrojtjes së intereseve të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit, kompetentë për kryerjen e kontrollit të ligjshmërisë për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimit janë prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjykatësi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili e ka dhënë urdhrin për ndjekje të komunikimeve.

*De lege lata* (neni 59 paragrafi 2), Ligji nuk e përcakton kur të bëhet kontrolli, por ajo paraqet të drejtë diskrete të dy instancave, gjegjësisht sipas nevojës edhe pa paralajmërim. Lëndë të kontrollit paraqet ligjshmëria e zbatimit të masës së posaçme të hetimit (neni 57, paragrafi 1 dhe neni 59, paragrafi 1), gjegjësisht trajtimi në pajtueshmëri me përcaktimet ligjore që kanë të bëjnë me zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve. Kontrolli i përfshin tri institucionet që janë ligjërisht të përfshira në tërë procesin për zbatimin e masave: 1. Organet e autorizuara për zbatimin e masave të posaçme hetuese, 2. Operatorët dhe 3. ATO.

Kështu, sipas nenit 59 të LNK-së, trupat kontrollues *ex post* mund:

- të bëjnë këqyrje në vendet ku janë stacionet punuese që i shfrytëzojnë organet e autorizuara, si edhe në hapësirat e ATO-s ku gjendet pajisja për ndjekje të komunikimeve dhe pajisjet mediatike, por edhe në vendin ku operatorët i ruajnë pajisjet për riorientim të sinjalit deri te ATO;
- të kërkojnë ose drejtpërdrejt të qasen tek sistemi për regjistër elektronik;
- të kërkojnë shikim ose të kërkojnë kopje nga regjistri në formë të shkruar;
- të kërkojnë ose drejtpërdrejt të marrin urdhëresën e anonimizuar për ndjekje të komunikimeve
- t'i lexojnë të gjitha shkrimet që janë krijuar, incizuar apo që janë të ruajtura nga sistemi që i shfrytëzon ATO dhe operatorët, si dhe nga stacionet punuese që i shfrytëzojnë organet e autorizuara, përfshi edhe të dhënat të cilat gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kërkohen nga operatori, nga ATO dhe nga organet e autorizuara.

**Për herë të parë në praktikën gjyqësore-prokuroriale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut (prill 2019) dhe Prokuroria Themelore Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar (maj 2019) bëri kontroll të paparalajmëruar, aktual dhe *ex post* të ligjshmërisë, efikasitetit dhe efektivitetit të masave të zbatuara për ndjekje të komunikimeve në: ATO, organet e autorizuara dhe operatorët. Qasja e këtillë është në pajtueshmëri me rolin crucial që e ka gjyqi dhe prokuroria në sferën e kontrollit të zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve.**

Për kryerje të kontrollit të suksesshëm (neni 58 dhe 59 i LNK-së) Ligji parasheh mundësinë e angazhimit të ekspertëve teknikë nga radhët e ekspertëve të regjistruar, të cilët me njohuritë e tyre profesionale mund të ndihmojnë në gjykatë apo prokurori që të zbatojnë kontroll teknik të aparateve dhe pajisjeve mediatike për ndjekje të komunikimeve që ndodhen në stacionet punuese të organeve të autorizuara për zbatimin e masave në ATO, tek operatorët, në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit si dhe në Agjencinë për Siguri Kombëtare.

Kontrolli teknik është kontroll i vetëm objektiv, i cili pakontestueshëm vërteton ekzistencën e ndjekjes joligjore të komunikimeve, gjë që realizohet me krahasimin e barasvlefshmërisë së lloqeve elektronike (të cilat gjenerohen automatikisht) në pajisjet mediatike të stacioneve punuese të organeve të autorizuar; ATO, operatorëve, pajisjeve e aparateve të posaçëm teknik të vendosur në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit.

Kontroll të posaçëm kryen Ministria e Punëve të Brendshme e R. së Maqedonisë së Veriut (nenet 2 dhe 62 të LNK-së), që nuk përfshihet brenda kornizës së kontrollit të lartpërmendur, por ka të bëjë me: prodhimin, ofertën për shitje, shitjen, importin, eksportin, riekportin ose ruajtjen e mjeteve për ndjekjen e komunikimeve. Ky kontroll realizohet *ex ante* përmes dhënies së lejes subjekteve juridike që merren me veprimtari të tillë dhe me kontroll *ex post* të përhershëm (mbikëqyrje inspektuese) të punës së tyre.

## **4. Mbikëqyrja (e pavarur) publike mbi zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve**

### **4.1. Këshilli për Mbikëqyrje Qytetare**

Me ndryshimet e LNK-së (neni 47) në vitin 2018, u themelua Këshilli për Mbikëqyrje Qytetare, si organ i ri, joshtetëror, mbikëqyrës i masave që zbatohen nga organet e autorizuar dhe ATO-s, pa pasur mundësi të ushtrojë mbikëqyrje të operatorëve. Për punën e vet, Këshilli dorëzon raport vjetor, ndërkaq vepron me iniciativë vetanake ose me kërkesë të parashtruar nga ndonjë qytetar.

Këshilli vepron me kërkesë të ndonjë qytetari apo personi juridik për ndonjë veprim apo zbatim joligjor të masave për ndjekje të komunikimeve, posaçërisht në rastet kur ka të bëjë me shkeljen kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarit. Për parregullsitë e konstatuara Këshilli e informon Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrje të Zbatimit të Masave për Ndjekje të Komunikimeve, prokurorin publik kompetent dhe Avokatin e Popullit. Këshilli punon në mbledhje, të cilat mbahen sipas nevojës.

Këshilli e kryen mbikëqyrjen me paralajmërim, përpos në rastet kur natyra e kërkesës udhëzon në veprim të shpejtë. Ai mund të kërkojë nga personat udhëheqës të organeve të autorizuar, ATO-s dhe nga operatorët, informata dhe të dhëna që janë të nevojshme për përcaktimin e arsyeshmërisë së elementeve të kërkesës. Nga mbikëqyrja e kryer, Këshilli (po ashtu edhe Komisioni) mund të konstatojë vetëm se a është bërë keqpërdorim, por jo edhe nëse është ndjekur apo jo numri telefonik i dorëzuesit të kërkesës.

Këshilli zgjidhet nga ana e Kuvendit me mandat prej tre vjetësh. Këshilli për Mbikëqyrje Qytetare përbëhet nga kryetari dhe 6 anëtarë, prej të cilëve 3 anëtarë janë ekspertë, ndërkaq 3 anëtarët e tjerë janë përfaqësues prej organizatave qytetare nga fusha e mbrojtjes së të drejtave qytetare, sigurisë dhe mbrojtjes. Këshilli ka për detyrë që për punën e vet të dorëzojë raport vjetor në Kuvend, i cili raport shqyrtohet në mbledhje të Kuvendit.

### **4.2. Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale bën kontroll të kufizuar te organet e autorizuar për zbatimin e masave, te operatorët dhe te ATO, edhe atë vetëm për ligjshmërinë e aktiviteteve të ndërmarra gjatë përpunimit të të dhënave personale, si dhe për zbatimin e masave për mbrojtjen e tyre të përcaktuara me ligj (neni 54 i LNK-së).



### **4.3. Drejtoria për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara**

Drejtoria për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara, gjithashtu ka mbikëqyrje të kufizuar të organet e autorizuar për zbatimin e masave, të operatorët dhe të ATO, dhe atë vetëm për ligjshmërinë gjatë punës me informata të klasifikuara të përcaktuara me ligj dhe aktet e miratuara në bazë të atij ligji. Objekt i mbikëqyrjes është mënyra dhe procedura e klasifikimit të informatave dhe dokumenteve të sigurisë, mënyra dhe procedura e ruajtjes së tyre, mënyra dhe procedura për këmbimin e brendshëm dhe të jashtëm të informatave dhe dokumenteve të klasifikuara, shënimi zonal i hapësirave ku operohet me informatat e klasifikuara (neni 55 i LNK-së).

### **4.4. Avokati i Popullit**

**Avokati i Popullit**, po ashtu mund të bëjë mbikëqyrje të ligjshmërisë së zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve. Si organ që i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur ato shkelen me akte, veprime ose mosveprime të organeve të autorizuar. Avokati i Popullit është i autorizuar të ndërmarrë veprime dhe masa adekuate dhe të ngrëjë procedura pas ankesës ose me vetiniciativë. Në kuadër të kompetencave të përcaktuara, ai është i autorizuar të realizojë kontroll të jashtëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në pajtim me nenin 24 të Ligjit për Avokatin e Popullit, për shkak të shqyrtimit të ankesës si dhe në kuadër të kompetencave të veta, Avokati i Popullit mund të kërkojë sqarime, informata dhe dëshmi, të hyjë në hapësirat zyrtare, të bëjë këqyrje të drejtpërdrejt, të ftojë në bisedë persona zyrtarë si dhe të ndërmarrë masa tjera të përcaktuara me ligj apo akt tjetër.

### **4.5. Raporti vjetor i Prokurorit Publik të R. së Maqedonisë së Veriut**

Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut një herë në vit dorëzon raport në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e masave të posaçme hetimore që janë ndërmarrë në vitin paraprak kalendarik.

Edhe pse në Ligj nuk është paraparë se çfarë kompetencash ka Kuvendi lidhur me këtë raport, nga përmbajtja e këtij neni rezulton se qëllimi i Raportit është informimi i Kuvendit për të dhëna që paraqesin në mënyrë statistikore dinamikën e zbatimit të këtyre masave, ndërkaq Kuvendi nuk ushtron kontroll aktiv për ligjshmërinë e zbatimit të masave. Në këtë raport, pos të dhënave për numrin e procedurave për të cilat janë dhënë urdhëresa për zbatim të procedurave të posaçme hetimore dhe për cilat vepra penale janë zbatuar këto masa, numri i objekteve dhe personave të vëzhguar, kohëzgjatja e secilës masë në veçanti, etj., Prokurori Publik duhet të arsyetojë nëse nga zbatimi i masave të posaçme hetimore kanë dalë rezultate që janë relevante për procedurën apo besohet se mund të jenë relevante gjatë procedurës (neni 271, paragrafi 2, pika 6 e LNK-së), si dhe të deklarohet për shkaqet nëse nga ndjekja nuk kanë dalë rezultate relevante (neni 271, paragrafi 2, pika 7 e LNK-së).

Në përvojën e deritashme, raportet vjetore të Prokurorit Publik nuk përmbajnë të dhëna të detajuara lidhur me atë se a kanë dalë rezultate relevante nga ndjekja e komunikimeve dhe cilat janë arsyet që këto rezultate nuk janë fituar.


Raportet e deritanishme vjetore për zbatimin e masave të posaçme hetimore përmbajnë vetëm të dhëna statistikore për numrin dhe llojin e zbatimit të masave të posaçme hetimore, veprat penale ndaj të cilave janë zbatuar masat, etj. Nga ana tjetër, nga raportet është evidente se zbatim më të madh ka masa e posaçme hetimore - *Ndjekja dhe incizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike në procedurë të përcaktuar me ligj të posaçëm*, kundrejt masave tjera të cilat i përcakton LPP.

#### **4.6. Subjekte të tjera**

Përveç subjekteve të theksuara më lart, korrektiv tjetër gjegjës i punës së organeve për ndjekje të komunikimeve janë edhe **mediat, sektori joqeveritar dhe opinioni i gjerë publik**. Ky kontroll është i rëndësishëm nëse vërtet është objektiv dhe i liruar nga ndikimet dhe presionet partiake-politike. Parakusht për këtë mënyrë të kontrollit është zhvillimi i gazetarisë hulumtuese si dhe transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve.

# SHTOJCA TË PJESËS 4

## PASQYRA E SUBJEKTEVE DHE AKTIVITETEVE GJATË ZBATIMIT TË MASAVE PËR NDJEKJE TË KOMUNIKIMEVE (numrat në skemë janë nenet e Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve)



\*Organe të autorizuar për ndjekje të komunikimeve janë: Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria Doganore dhe Drejtoria e Policisë Financiare.

\*\* Komisioni për Mbikqyrje të Zbatimit të Masës së Posaçme Hetimore për Ndjekje të Komunikimeve dhe Këshilli për Mbikqyrje Qytetare në mënyrë direkte bëjnë mbikqyrje të trupave të autorizuar (43, 51/2).



## BIBLIOGRAFIA

### Libra dhe artikuj

- Bloustein, E., Privacy as an aspect of Human Dignity, 39 New York University Law Review, 1964
- Flaerty, D., Protecting Privacy in Surveillance Society, The University of North Carolina press, 1989
- Гундерман, Л., Коментар на Законот за заштита на личните податоци, Дирекција за заштита на личните податоци, Скопје, 2010
- Камбовски, В., Организиран криминал, Скопје, 2005
- Kilkelly, U., The right to respect for private and family life, A guide to the implementation of Article 8 of the European Convention on Human Rights, Council of Europe, Strasbourg, 2001
- Ruiz, B., Privacy in telecommunications, A European and American Approach, Kluwer Law International, The Hague, 1997
- Харис, Д. Ј., О'Бојл, М., Варбрик, К., Право на Европската конвенција за човекови права, второ издание, Просветно дело, 2009
- Westin, A.F., Privacy and Freedom, Bodley Head, 1970

### Dokumente

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 84/03
- Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 74/04
- Ligji për procedurë penale, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 150/10
- Ligji për ndjekje të komunikimeve, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 71/18, 108/19
- Ligji për Agjencinë Teknike Operative, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 71/18
- Ligji për komunikime elektronike, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 13/05, 14/07, 55/07, 83/10, 13/12, 123/12, 11/18
- Ligji për punë të brendshme, Gazeta Zyrtare e R.M. numër 42/14, 116/14, 33/15, 5/16, 120/16, 127/16, 142/16, 190/16
- Ligji për polici, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 114/06, 6/09, 145/12, 41/14, 33/15, 31/16, 106/16, 120/16, 21/18, 64/18
- Ligji për mbrojtje (tekst i konsoliduar), Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 185/11
- Ligji për prokurorinë publike, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 150/07, 111/08
- Ligji për Administratën Doganore, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 46/04, 81/05, 107/07, 103/08, 64/09, 48/10, 158/10, 53/11, 113/12, 43/14, 167/14, 33/15, 129/15, 23/16, 120/18
- Ligji për Agjencinë e Sigurisë Kombëtare, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 108/19
- Ligji për koordinim të bashkësisë të sigurisë dhe kundërzbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 108/19
- Rregullore për sigurinë administrative të informatave të klasifikuara, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 9/04
- Strategjia për mbrojtjen e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 30/10
- Rregullore për mënyrën e përcaktimit të të dhënave të siguruara dhe përpunuara me zbatim të urdhëresës për zbatim të masave për ndjekje të komunikimeve për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit dhe mënyrën e mbrojtjes së tyre Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 243/18
- Raporti i Komisionit të Venecias për mbikëqyrjen demokratike të punës së shërbimeve të sigurisë nr. 388/2006,  
[http://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2009\\_2014/documents/libe/dv/3\\_cdl-ad\(2007\)016\\_/3\\_cdl-ad\(2007\)016\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2009_2014/documents/libe/dv/3_cdl-ad(2007)016_/3_cdl-ad(2007)016_en.pdf)

- Rezoluta 2625 (XXV) e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në 1970 (*The Declaration on Principles of International Law concerning Friendly Relations and Co-operation among States*, United Nations, A/RES/25/2625)
- Memorandum Shpjegues për Rec (2005)10
- Parliamentary oversight of the security sector: Principles, mechanisms and practices, mund të gjehet në: <http://archive.ipu.org/PDF/publications/decaf-e.pdf>
- Rekomandimi (1996) 8 mbi Evropën në kohëra të ndryshimeve: politikat mbi krimet dhe ligjet penale, miratuar nga Komiteti i Ministrave më datë 5 shtator 1996
- Rekomandimi (2001) 11 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare lidhur me parimet udhëheqëse për luftë kundër krimit të organizuar, miratuar nga Komiteti i Ministrave më datë 19 shtator 2001
- Rekomandimi (2005) 10 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi “teknikat e posaçme për hetim” lidhur me krimet serioze duke përfshirë aktet terroriste, miratuar nga Komiteti i Ministrave më datë 20 prill 2005
- Rekomandimi 1713/2005, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, <http://www.assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=17360&lang=en>
- Rekomandimi mbi Mbikëqyrje Demokratike të Shërbimeve Kombëtare të Sigurisë, Komisionari për të Drejta të Njeriut i Këshillit të Evropës, 2015, [https://rm.coe.int/ref/CommDH/IssuePaper\(2015\)2](https://rm.coe.int/ref/CommDH/IssuePaper(2015)2)
- Memorandum Shpjegues për Rekomandimin Rec (2005)10 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi “teknikat e posaçme të hetimit” lidhur me krimet serioze dhe aktet terroriste, CM/DEL/DEC (2005) 925/10.8, 10 maj 2005
- Këshilli i të Drejtave të Njeriut i KB 2009; OKB 2010a, <https://fas.org/irp/eprint/unhrc.pdf>

### **Praktikat gjyqësore**

- Olsson kundër Suedisë, 24.05.1988 (Nr. 10465/83)
- Sunday Times kundër MB, 1980, 2 EHRR 245
- James kundër MB, 1986, 8 EHRR
- Sporrang kundër Suedisë, 1983, 5, EHRR
- Smith dhe Grady kundër MB, 2000, 29 EHRR 493
- Kopp kundër Zvicrës, 1999, 27 EHRR 91
- Klass kundër Gjermanisë, 1979/80, EHRR 213
- Campbell kundër MB, 1992, 15 EHRR 137
- Craxi kundër Italisë, 17.07.2003 (No. 25337/94)
- Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar, 27.06.1986 (No. 8691/79)
- Silver kundër Mbretërisë së Bashkuar (1983) 5 EHRR 347
- Taylor-Sabori kundër Mbretërisë së Bashkuar (2002) 36 EHRR 17
- Doerga kundër Holandës, 27.04.2004 (No. 50210/99)
- Khan v. Mbretërisë së Bashkuar [1997] AC558
- Ramanuskas kundër Lituanisë, 2008, Aplikacioni nr. 74420/01
- Shannon kundër Mbretërisë së Bashkuar, 5.4.2004, No 120
- P.G. and J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 44787/98, ECHR 2001-IX
- Dragojević kundër Kroacisë (nr. 68955/11, §§ 52-61, 15 janar 2015)
- Funke kundër Francës (1993) 16 EHRR 297

## **SHTOJCAT E DORACAKUT**

### **TEPËR SEKRET**

#### **PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE**

#### **PPMH NAK nr.**

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Deri te

#### **GJYKATA THEMELORE SHKUPI 1**

- Gjykatësi në Procedurë Paraprake -

SH K U P

Në bazë të nenit 39, paragrafi (2) lidhur me nenin 256, nenin 252, paragrafi (1), pika 1 dhe nenin 253 të LPP, parashtroj

### **K Ë R K E S Ë**

#### **PËR SJELLJEN E URDHËRESËS**

#### **PËR PËRCAKTIMIN E ZBATIMIT TË MASËS SË POSAÇME HETIMORE VIJUESE**

**Ndjekje dhe inçizim të komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike nga neni 252, paragrafi (1), pika 1 e LPP,**

NDAJ PERSONIT:

Emri dhe mbiemri me NUPQ xxx me adresë banimi në xxx në rr. xxx nr.xxx numri telefonik i maqedonisë xxx, me numra identifikues

NAK\_NAK1\_XXXXXXXXX\_1\_TM dhe

NAK\_NAK1\_XXXXXXXXX\_1\_OV.

Për të cilin ekzistojnë dyshime të bazuara se ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale - Mitmarrje nga neni 357 i Kodit penal, vepër penale - Keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit nga neni 353 i Kodit penal.

Pasi është e besueshme se do të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për të udhëhequr me sukses procedurën penale, të cilat të dhëna në mënyrë tjetër nuk do të mund të mblidhen.

Masën e posaçme hetimore ta zbatojë Policia Gjyqësore nën kontrollin e Prokurorit Publik.

Masa e posaçme hetimore, ndjekje dhe inçizim i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike përfshin ndjekjen e komunikimeve të personit në linjën telefonike: xxx.

Gjatë zbatimit të masës së përmendur të posaçme hetimore do të shfrytëzohen mjetet dhe pajisjet teknike me të cilat disponon Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Urdhëresa të jepet me afat kohor të përcaktuar për zbatim të masës së posaçme hetimore në kohëzgjatje prej tre muajve, duke filluar nga viti xxx, ora xxx, deri në vitin xxx, në ora xxx.

## **ARSYETIMI**

Prokuroria Themelore Publike xxx disponon me njohuri dhe dëshmi se personat ndërmarrin veprime për kryerjen e veprës penale - Mitmarrje nga neni 357 i Kodit penal, veprës penale - Keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit nga neni 353 i Kodit penal.

Njohuritë e tilla dalin nga dëshmia e personit xxx.

Në këtë kontekst, nga shënimi zyrtar dalin njohuritë se personat që janë lëndë e masave të posaçme hetimore, secili në pjesën e vetë të veprimit dhe të ndikimit ndaj të punësuarve xxx, të cilët drejtëpërdrejtë janë përgjegjës.

Nga e gjithë ajo që u tha më lartë, del se ekziston dyshimi i bazuar se personat ndërmarrin veprime për kryerjen e veprës penale - Mitmarrje nga neni 357 i Kodit Penal, veprës penale - Keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimeve nga neni 353 i Kodit Penal.

Në rastin konkret të dhënat dhe dëshmitë e domosdoshme për të udhëhequr me sukses procedurën penale, të cilat në mënyrë tjetër nuk mund të grumbullohen, jo vetëm për shkak të llojit dhe karakterit të veprës së theksuar penale, por edhe për shkak se bëhet fjalë për vepra penale të cilat realizohen në konspiracion të theksuar mes personave përmendur, për këtë shkak e parashtrij këtë kërkesë për zbatimin e masave të posaçme hetimore - Ndjekje dhe inçizim të komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike nga neni 252, alineja 1, pika 1 e LPP, ndaj personave.

Në pajtueshmëri me nenin 258, paragrafi (1) dhe (2) e LPP, pas zbatimit të kësaj mase Policia Gjyqësore të përgatisë raport të posaçëm, të cilin do ta dorëzojë te Prokurori Publik.

**PROKURORI PUBLIK**

---

**TEPËR SEKRET**



## TEPËR SEKRET

### PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

PPMH nr.

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Deri te

### GJYKATA THEMELORE SHKUPI 1

- Gjykatësi në Procedurë Paraprake -

SH K U P

Në bazë të nenit 39, paragrafi (2), alineja 2 lidhur me nenin 256, nenin 252, paragrafi (1), pika 2, neni 253, pika 2 e LPP, parashtroj

### K Ë R K E S Ë

#### PËR SJELLJEN E URDHËRESËS

#### PËR PËRCAKTIMIN E ZBATIMIT TË MASËS SË POSAÇME HETIMORE VIJUESE

**Ndjekje dhe inçizim në shtëpi, hapësirë të mbyllur apo të ndërtuar që i përket asaj shtëpie apo hapësire afariste, e shënuar si private ose në veturë dhe hyrje në ato hapësira për krjimin e kushteve për ndjekje të komunikimeve nga neni 252, paragrafi (1), pika 2 e LPP,**

NDAJ PERSONIT:

XXX

Për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale - Mitmarrje nga neni 357 i Kodit penal, veprës penale - Dhënia e mitos nga neni 358 i Kodit Penal dhe veprës penale - Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimeve zyrtare nga neni 353 i Kodit Penal.

Pasi është e besueshme se do të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për të udhëhequr me sukses procedurën penale, të cilat në mënyrë tjetër nuk mund të grumbullohen.

Ndjekje dhe inçizim në shtëpi, hapësirë të mbyllur apo të ndërtuar që i përket asaj shtëpie apo hapësire afariste, e shënuar si private ose në veturë dhe hyrja në ato hapësira për krjimin e kushteve për ndjekje të komunikimeve nga neni 252, paragrafi (1), pika 2 e LPP.

Masat e posaçme hetimore ti zbatojë Policia Gjyqësore nga MPB e RMV nën kontrollin e Prokurorit Publik.

Urdhëresa për zbatimin e masës së posaçme hetimore të jepet në kohëzgjatje prej një muaji dhe atë nga viti xxx ora xxx deri në vitin xxx ora xxx.

### A R S Y E T I M I

Deri te kjo Prokurori, Ministria e Financave, Drejtoria e Policisë Financiare dorëzoi lajmërim nr. xxx nga viti xxx ku theksohet se ekziston dyshimi i bazuar se xxx.

Nga shkaqet e dhëna për njërin nga personat xxx, janë lëshuar dy urdhëresa për masa të posaçme hetimore edhe atë xxx.

Prokuroria Publike nga masat e posaçme hetimore të ndërmarra deri më tani, vlerëson se veprimet e inkriminuara përgatiten në hapësirën punuese të personit xxx, kjo veçanërisht nëse merret parasysh se personi punon i izoluar në hapësirën xxx.

Në rastin konkret të dhënat dhe dëshmitë e nevojshme për udhëheqjen me sukses të procedurës penale, nuk mund të grumbullohen në mënyrë tjetër, jo vetëm për shkak të llojit dhe karakterit të veprës së theksuar penale, por edhe për shkak se bëhet fjalë për vepra penale, të cilat kryhen me konspiracion të rreptë në mes të personave të theksuar, për çka e parashtroj Kërkesën për sjelljen e urdhëresës për përcaktimin e masës së theksuar të posaçme hetimore - Ndjekje dhe inçizim në shtëpi, hapësirë të mbyllur apo të ndërtuar që i përket asaj shtëpie apo hapësire afariste, e shënuar si private ose në veturë dhe hyrje në ato hapësira për krjimin e kushteve për ndjekje të komunikimeve nga neni 252 paragrafi (1), pika 2 e LPP, ndaj personit xxx, gjatë së cilës të përfshihen hapësirat vijuese xxx.

**PROKURORI PUBLIK**

---

**TEPËR SEKRET**

## TEPËR SEKRET

### PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

PPMH nr.

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Deri te

### GJYKATA THEMELORE SHKUPI 1

- Gjykatësi në Procedurë Paraprake -  
SH K U P

Në bazë të nenit 39, paragrafi (2), alineja 2, lidhur me nenin 256, nenin 252, paragrafi (1), pika 3 dhe nenit 253, pika 2 e LPP, parashtroj

### K Ë R K E S Ë

#### PËR SJELLJEN E URDHËRESËS

#### PËR PËRCAKTIMIN E ZBATIMIT TË MASËS SË POSAÇME HETIMORE VIJUESE:

**Ndjekje dhe inçizim i fshehtë i personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo hapësirës afariste, të shënuar si private nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 e LPP,**

NDAJ PERSONIT:

PERSONI, por pa numër telefoni.....

Për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se ndërmerr aktivitete për kryerjen e veprës penale -

Për shkak se besohet se do të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër.

Masën e posaçme hetimore ta zbatojë Policia Gjyqësore nën kontrollin e Prokurorit Publik.

Gjatë zbatimit të masave të posaçme hetimore të shfrytëzohet pajisja të cilën e ka në disponim Ministria e Punëve të Brendshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Urdhëresa jepet me kohëzgjatje të zbatimit të masës së posaçme hetimore duke filluar nga viti xxx, ora xxx deri në vitin xxx, në ora xxx.

### A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore Publike Shkup disponon me njohuri dhe dëshmi se personi ...

Nga e gjithë ajo që u tha më lartë se ekziston dyshimi i bazuar se personi xxx, i cili ka realizuar kontakte me ndihmësin e xxx në xxx dhe në raste të caktuara i ka dhënë paket - zarf me përmbajtje të panjohur, ka ndërmarrë masa për kryerjen e veprës penale - xxxxxx.

Në rastin konkret të dhënat dhe dëshmitë e domosdoshme për udhëheqjen e suksesshme të procedurës penale, të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër, jo vetëm për shkak të llojit dhe karakterit të veprës së theksuar penale, por edhe për shkak se bëhet fjalë për vepër penale, e cila kryhet në konspiracion të rreptë mes personave të theksuar, për çka e parashtroj këtë kërkesë për zbatimin e masës së posaçme hetimore - Ndjekje dhe inçizim i fshehtë i personave dhe

objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo hapësirës afariste, të shënuar si private nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 e LPP, ndaj personit xxx.

Në pajtueshmëri me nenin 258, paragrafi (2) i LPP pas zbatimit të kësaj mase, Policia Gjyqësore të përgatisë raport të posaçëm, të cilin do t'ia dorëzojë Prokurorit Publik.

**PROKURORI PUBLIK**

---

**TEPËR SEKRET**

## TEPËR SEKRET

### PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

PPMH nr.

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Deri te

### GJYKATA THEMELORE SHKUPI 1

- Gjykatësi në Procedurë Paraprake -  
SH K U P

Bazuar në nenin 39, paragrafi (2), alineja 2 lidhur me nenin 256, nenin 252 paragrafi (1), pika 4 e LPP, parashtroj

### K Ë R K E S Ë

### PËR SJELLJEN E URDHËRESËS

### PËR PËRCAKTIMIN E ZBATIMIT TË MASËS SË POSAÇME HETIMORE VIJUESE:

**Kqyrje dhe kërkim të fshehtë në sistemin kompjuterik nga neni 252, paragrafi (1), pika 4 e LPP,**

NDAJ PERSONIT:

XXX

Për të cilin ekzistojnë dyshime të bazuara se ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale - Keqpërdorim i detyrës dhe autorizimit zyrtar nga neni 353 i Kodit penal.

Pasi është e besueshme se do të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër.

Masën e posaçme hetimore ta zbatojë Policia Gjyqësore nën kontrollin e Prokurorit Publik.

Gjatë zbatimit të masave të posaçme hetimore të shfrytëzohet pajisja, të cilën e ka në dispozitim Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Urdhëresa jepet me kohëzgjatje të zbatimit të masës së posaçme hetimore prej katër muajsh, duke filluar nga viti xxx, ora xxx deri në vitin xxx në ora xxx.

### A R S Y E T I M I

Duke e pasur parasysh se nga Drejtoria e Policisë Financiare jemi të informuar se ajo disponon me njohuri për kryerjen e veprave penale nga fusha e kriminalitetit financiar, gjegjësisht vepra penale - Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar nga neni 353 i Kodit penal, të kryer nga persona përgjegjës të grupit të parë të subjekteve juridike, në mënyrën që XXX.

Për shkak të sigurimit të të dhënave dhe dëshmimeve, të cilat në mënyrë tjetër nuk mund të mblidhen ose sigurimi i të njëjtave do të realizohej me vështirësi më të mëdha dhe njëkohësisht personat e involvuar në aktivitetet joligjore kanë përfituar dhe do të përfitojnë pasuri joligjore duke i kryer veprat penale - Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar neni 353 i LPP, në interes të zbulimit efikas të kryerësve të veprës penale propozojmë Gjykatësi i Procedurës Paraprake

të japë urdhëresë për zbatimin e masës së posaçme hetimore - Kqyrje dhe kërkim të fshehtë në sistemin kompjuterik nga neni 252, paragrafi (1), pika 4 e LPP, ndaj personit xxx.

**PROKURORI PUBLIK**

---

**TEPËR SEKRET**

## TEPËR SEKRET

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE NË GJYKATËN THEMELORE - Sektori i Procedurës Paraprake XXXX**, duke vepruar sipas Kërkesës së Prokurorisë Themelore Publike PPMH-NAK nr. Viti XXX, për sjelljen e urdhërësës për përcaktimin e zbatimit të masës së posaçme hetimore - Ndjekje dhe inçizim i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike, në pajtueshmëri me nenin 252, paragrafi (1), pika 1 e LPP dhe nenin 256 të LPP lidhur me nenin 9 lidhur me nenin 8 dhe nenin 15 të Ligjit për ndjekje të komunikimeve, në vitin XXXX jep :

### URDHËR ESË

Për shkak të sigurimit të të dhënave dhe dëshmive të domosdoshme për udhëheqjen e procedurës penale, të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër, përcaktohet zbatimi i masës së posaçme hetimore:

**Ndjekje dhe inçizim i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike, në procedurë sipas ligjit të posaçëm me nenin 252, paragrafi (1), pika 1 e LPP,**

#### NDAJ PERSONAVE:

1. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX
2. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX
3. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX
4. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX
5. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX
6. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX
7. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX

Për të cilët ka dyshim të bazuar se ndërmarrin veprime për realizimin e veprave penale - XXXX nga KP, vepër penale - XXXX nga KP dhe vepër penale - XXXXXX nga KP.

Për shkak se besohet se do të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër.

Masa e posaçme hetimore - Ndjekje dhe inçizim i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike, në procedurë të përcaktuar me ligj të posaçëm nga neni 252, paragrafi (1), pika 1 e LPP, përfshin ndjekjen e komunikimeve të personave:

1. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX
2. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX
3. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX
4. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX
5. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX
6. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX
7. X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXX

Masa e posaçme hetimore të zbatohet përmes mjeteve teknike, të cilat i ka në disponim Agjencia Teknike Operative dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Urdhëresën ta realizojë Ministria e Punëve të Brendshme e RMV me ndërmjetësimin e ATO, nën kontrollin e Prokurorit Publik.

Në pajtueshmëri me nenin 258, paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të LPP, MPB e RMV të përgatisë raport, të cilin do ta dorëzojë te Prokurori Publik me kërkesë të tij dhe në çdo rast në çdo 30 ditë, ndërkaq pas zbatimit të masës të përgatitet raporti i posaçëm që do t'i dorëzohet Prokurorit Publik.

Urdhëresa jepet me kohëzgjatje të zbatimit të masës së posaçme hetimore prej katër muajsh, duke llogaritur nga viti X nga ora 15,00 deri në vitin X në ora 15,00

## **ARSYETIMI**

Prokuroria Themelore Publike, deri te Gjykatësi për Procedurë Paraprake të kësaj Gjykate, në vitin X nën PPMH-NAK nr.X viti X, Kërkesë për sjelljen e urdhëresës për përcaktimin e zbatimit të masës së posaçme hetimore - Ndjekje dhe inçizim i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike, në procedurë sipas ligjit të posaçëm me nenin 252, paragrafi (1), pika 1 e LPP, ndaj personave: X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXXX, X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXXX, X me X numër telefonik X, numra identifikues XXXXXXXXXX, X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXXX, X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXXX, X me X numër telefonik X, me numra identifikues XXXXXXXXXX. E gjithë kjo për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar se ndërmerr veprime të realizimit të veprës penale -X prej KP, veprës penale - X nga KP dhe veprës penale - X nga KP. Bashkangjitur Kërkesës, PTHP dorëzon Lajmërim TS nr. nga viti X e përgatitur nga Republika e Maqedonisë së Veriut, Ministria e Financave, Drejtoria e Policisë Financiare.

Duke i pasur parasysh theksimet e arsyetuara në kërkesë për përcaktimin e zbatimit të masës së posaçme hetimore dhe në lidhje me Lajmërimin TS.nr. X i vitit X, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se masa është e bazuar.

Me qëllim të sigurimit të të dhënave dhe dëshmive për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, të cilat nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër apo sigurimi i tyre do të lidhej me vështirësi të mëdha, posaçërisht për shkak të faktit se të dhënat dhe informatat e fituara me të cilat disponohet për momentin nuk mundet në tërësi të vërtetohet me sukses, involvimi dhe lidhja e personave, të cilët janë të përfshirë në aktivitete joligjore dhe kanë përfitime joligjore pronësore, në interes të zbulimit efikas të kryerësve të veprave penale dhe në interes të gjetjes së kryerësve të tjerë të veprave penale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake sjell urdhëresë për zbatimin e masës së posaçme hetimore - Ndjekje dhe inçizim i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike, me nenin 252, paragrafi (1), pika 1 e LPP.

GJYKATA THEMELORE X,  
X RNAK nr.X nga viti X

Gjykatësi i Procedurës Paraprake,

---

**TEPËR SEKRET**



## TEPËR SEKRET

**GJYKATA THEMELORE** duke vepruar me kërkesë të PTHP PPMH.nr viti X për sjelljen e urdhëresës për vazhdimin e zbatimit të masës së posaçme hetimore në përputhje me nenin 256 dhe nenin 260 të LPP, në vitin X, jep:

### URDHËRESË

Për arsye të sigurimit të dëshmive për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, të cilat nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër dhe të mblidhen vazhdohet zbatimi i masës së posaçme hetimore:

**Ndjekje dhe inçizim i fshehtë i personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo hapësirës afariste, të shënuar si private nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 e LPP**

#### NDAJ PERSONAVE:

1. X me NUPQ X, me vendbanim në X
2. X me NUPQ X, me vendbanim në X

Për të cilët ekzistojnë dyshime të bazuara se ndërmarrin veprime për kryerjen e veprës penale - X të KP.

Masa e posaçme hetimore nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 e LPP përfshin ndjekje dhe inçizim të fshehtë të personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë, apo hapësirës afariste e shënuar si private edhe atë të personave X, për të cilët ekziston dyshim i bazuar se janë të involvuar në kryerjen e veprës penale - X të KP.

Gjatë zbatimit të masës së posaçme hetimore të shfrytëzohet pajisja që e ka në disponim Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Urdhëresa jepet me kohëzgjatje prej katër muajve llogaritur nga viti X prej orës 15,00 deri në vitin X në ora 15,00.

Zbatimi i masës së posaçme hetimore të ndërpritet edhe para kalimit të afatit të përcaktuar menjëherë pas ndërprerjes së bazave për të cilat është lejuar apo kur do të arrihen qëllimet për të cilat ajo është përcaktuar.

Urdhëresën ta zbatojë Policia Gjyqësore nën kontrollin e Prokurorit Publik, të përgatisë raport të cilin ia dorëzon Prokurorit Publik me kërkesë të tij.

### ARSYETIMI

Prokuroria Themelore Publike, deri te Gjykatësi në Procedurë Paraprake të kësaj Gjykate ka dorëzuar nën PPMH nr. X viti, kërkesë për dhënien e urdhërit për vazhdimin e zbatimit të masës së posaçme hetimore nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 e LPP - Ndjekje dhe inçizim i fshehtë i personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo hapësirës afariste të shënuar si private ndaj personave X për të cilët ekzistojnë dyshime të bazuara se ndërmarrin veprime për kryerje të veprës penale X nga KP. Me propozimin ajo dorëzon edhe informatën nga Ministria e Financave, Drejtoria e Policisë Financiare nr. X nga viti X.

Në propozimin e PTHP theksohet se Drejtoria e Policisë Financiare disponon me njohurinë për XXXXXXXXXXXX.

Duke i patur parasysh pretendimet në kërkesën për vazhdimin e zbatimit të masave të posaçme hetimore, Gjykatësi në Procedurë Paraprake ka arritur deri te konstatimi se kërkesa është e bazuar.

Me qëllim që të dëshmohet përfshirja e personave XXXX në realizimin e veprës penale XXXXX nga KP si dhe me qëllim të sigurimit të të gjitha dëshmive të nevojshme, të cilat janë të domosdoshme për të udhëhequr me sukses procedurën penale, të cilat nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër, gjegjësisht zbatimi i tyre do të lidhej me vështirësi më të mëdha, Gjykatësi në Procedurë Paraprake solli urdhëresë për vazhdimin e masës së posaçme hetimore.

GJYKATA THEMELORE X,  
PPpm.nr.X nga viti X.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

---

**TEPËR SEKRET**

## TEPËR SEKRET

**GJYKATA THEMELORE** duke vepruar sipas Kërkesës së PTHP PPMH.nr. X nga viti X sjell urdhëresën për përcaktimin e zbatimit të masës së posaçme hetimore në përputhje me nenin 256 dhe nenin 260 të LPP, të vitit X, jep :

### URDHËRESË

Për shkak të sigurimit të dëshmive për zbatim të suksesshëm të procedurës hetimore, të cilat nuk mund të sigurohen dhe mblidhen në mënyrë tjetër, përcaktohet zbatimi i masës së posaçme hetimore vijuese:

**Kqyrje dhe kërkim i fshehtë në sistemin kompjuterik sipas nenit 252 paragrafi (1) pika 4 e LPP,**

#### **NDAJ PERSONAVE:**

1. X me NUPQ X, me vendbanim në X
2. X me NUPQ X, me vendbanim në X

Për të cilët ekzistojnë dyshimi i bazuar se ndërmarrin veprime për kryerje të veprës penale - X të KP. Masa e posaçme hetimore nga neni 252, paragrafi (1), pika 4 e LPP përfshin ndjekje dhe inçizim të fshehtë të personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë, apo hapësirës afariste e shënuar si private edhe atë të personave X, për të cilët ekzistojnë baza dyshimi se janë të involvuar në kryerjen e veprës penale - X të KP.

Gjatë zbatimit të masës së posaçme hetimore të shfrytëzohet pajisja që e ka në disponim Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Urdhëresa jepet me kohëzgjatje prej katër muajve llogaritur nga viti X prej orës 15,00 deri në vitin X në ora 15,00.

Zbatimi i masës së posaçme hetimore të ndërpritet edhe para kalimit të afatit të përcaktuar menjëherë pas ndërprerjes së bazave për të cilat është lejuar apo kur do të arrihen qëllimet për të cilat ajo është përcaktuar.

Urdhëresën ta zbatojë Policia Gjyqësore nën kontrollin e Prokurorit Publik, të përgatisë raport të cilin ia dorëzon Prokurorit Publik me kërkesë të tij.

### ARSYETIMI

Prokuroria Themelore Publike Shkup, deri te Gjykatësi i Procedurës Paraprake të kësaj Gjykate dorëzon me PPMH nr. viti X, kërkesë për dhënien e urdhëresës për përcaktimin e zbatimit të masave të posaçme hetimore: nga neni 252, paragrafi (1) pika 4 të LPP - Ndjekje dhe inçizim të fshehtë të personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë, apo hapësirës afariste e shënuar si private edhe atë personave X, për të cilët ekzistojnë dyshime të bazuara se ndërmarrin veprime në realizimin e veprës penale X të KP. Bashkë me propozimin dorëzon edhe informatën nga Ministria e Financave, Drejtoria e Policisë Financiare nr. X nga viti X.

Në propozimin e PTHP theksohet XXXXXXXX

Duke marrë parasysh pretendimet në kërkesën për përcaktimin e zbatimit të masës së posaçme hetimore, Gjykatësi në Procedurë Paraprake ka arritur te konstatimi se kërkesa është e bazuar.

Me qëllim të konstatimit të përfshirjes të personave X në kryerjen e veprës penale X nga KP, si dhe me qëllim që të sigurohen të gjitha dëshmitë e nevojshme, të cilat janë të të domosdoshme për udhëheqjen e suksesshme të procedurës penale, të cilat në mënyrë tjetër nuk mund të sigurohen, gjegjësisht zbatimi i tyre do të lidhej me vështirësi më të mëdha, Gjykatësi në Procedurë Paraprake përcaktoi ndërmarrjen e masave të posaçme hetimore.

GJYKATA THEMELORE X,  
PPPm.nr.X nga viti X.

Gjykatësi në Procedurë Paraprake

---

**TEPËR SEKRET**

## TEPËR SEKRET

### PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

#### PPMH nr.

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Në bazë të nenit 39 paragrafi (2), alineja 2 lidhur me nenin 256, nenin 252 paragrafi (1) pika 6 dhe nenin 253, pika 2 e LPP e solli urdhëresën vijuese

### URDHËRESË

#### PËRCAKTOHET zbatimi i masës së posaçme hetimore

#### **Kqyrje në bisedat e realizuara telefonike dhe komunikimet tjera elektronike nga neni 252 paragrafi (1), pika 6 e LPP,**

NDAJ PERSONAVE:

XXX

XXX

Gjatë së cilës për të dyshuarin ekziston dyshimi i bazuar se ka ndërmarrë aktivitete për kryerje të veprës penale - Mitmarrje nga neni 357, paragrafi (1) i Kodit Penal dhe veprën penale - Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimeve zyrtare nga neni 353, paragrafi (1) nga Kodi Penal, ndërkaq për të dyshuarin xxx ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer vepër penale - Dhënie e mitos nga neni 358, paragrafi (1) i KP dhe vepër penale - Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimeve zyrtare nga neni 353, paragrafi (1) lidhur me nenin 23 të Kodit penal.

Megjenëse është e besueshme se do të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për udhëheqjen me sukses të procedurës penale në kuadër të së cilës ishte sjellë - Urdhëresa për zbatimin e procedurës hetimore PP nr. xxx nga viti xxx, të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër.

Masa e posaçme hetimore - Kqyrje në bisedat e realizuara telefonike dhe komunikimet tjera elektronike nga neni 252, paragrafi (1), pika 6 e LPP, përfshin përcaktimin e pronësisë të telefonit celular tipi xxx modeli xxx, emri:xxx dhe numri thirrës:xxx, si dhe nga ky numër telefoni a është realizuar kontakt telefonik me telefonin numër xxx të të dyshuarit, si dhe fakte të tjera të cilat mund të shërbejnë si dëshmi nga aspekti i veprave të lartpërmendura dhe të dyshuarve si kryerës të të njëjtave.

Masën e posaçme hetimore ta zbatojë Policia Gjqësore, MPB-BSP-SHQP-SLKOS nën kontrollin e Prokurorit Publik.

Gjatë zbatimit të masës së posaçme hetimore, të shfrytëzohet pajisja teknike vijuese:

- Pajisja kompjuterike pronë e MPB

Urdhëresa jepet me kohëzgjatje për zbatim prej 10 ditëve duke filluar nga viti xxx nga ora xxx deri në vitin xxx në ora xxx.

## **ARSYETIMI**

Prokuroria Themelore Publike Shkup disponon me të dhëna dhe dëshmi edhe atë: xxx, prej të cilave del se ekzistojnë dyshime të bazuara se i dyshuari xxx ka ndërmarrë aktivitete për kryerje të veprës penale - Mitmarrje nga neni 357, paragrafi (1) nga Kodi Penal dhe vepër penale - Keqpërdorim i detyrës dhe pozitës zyrtare nga neni 353, paragrafi (1) nga Kodi Penal, ndërsa i dyshuari xxx ka ndërmarrë aktivitete për kryerje të veprës penale - Dhënie e mitos nga neni 358, paragrafi (1) nga KP dhe vepër penale - Keqpërdorim i detyrës dhe pozitës zyrtare nga neni 353, paragrafi (1) lidhur me nenin 23 të Kodit penal.

Gjegjësisht nga njohuritë dhe dëshmitë del se në ditën xxx.

Në rastin konkret të dhënat dhe dëshmitë për zbatim të suksesshëm të procedurës penale, të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër në mënyrë tjetër, jo vetëm për shkak të llojit dhe karakterit të veprave penale të theksuara, por edhe për shkak se bëhet fjalë për vepër penale që realizohet në fshehtësi të plotë ndërmjet personave të theksuar.

Duke patur parasysh sa theksova më sipër e sjell këtë urdhëresë.

**PROKURORI PUBLIK**

---

**TEPËR SEKRET**

## TEPËR SEKRET

### PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

PPMH nr.

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Në bazë të nenit 39, paragrafi (2), alineja 2 lidhur me nenin 256, paragrafi (1), pika 7 dhe neni 253, paragrafi (2) të LPP, Prokurori Publik i Prokurorisë Themelore Publike Shkup e sjell këtë

### URDHËRESË

**PËRCAKTOHET** zbatimi i masës së posaçme hetimore

**Blerje e simuluar e sendeve nga neni 252, paragrafi (1), pika 7 e LPP,**

NDAJ PERSONAVE:

XXX

XXX

Për të cilët ekzistojnë dyshime të bazuara se ndërmarrin aktivitete për kryerjen e veprës penale - Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psihotropike dhe prekursorëve nga neni 215 i Kodit Penal.

Pasi besohet se do të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për të udhëhequr me sukses procedurën penale, të cilat nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër, gjegjësisht me përcaktimin e masës së posaçme hetimore për lëndën - Simulim i blerjes së sendeve nga neni 252, paragrafi (1), pika 7 nga LPP, do të siguroheshin dëshmi të veprës konkrete penale dhe të veprimeve që i ndërmarrin personat xxx për ta realizuar atë, por krahas saj do të zbulohen edhe persona të tjerë që janë të lidhur me ta në realizimin e veprës penale.

Masa e posaçme hetimore - Simulim i blerjes së sendeve nga neni 252, paragrafi (1), pika 7 nga LPP, përfshin infiltrimin e personit me identitet të fshehur nga i cili do të realizohej blerja e simuluar e drogës narkotike.

Masën e posaçme hetimore ta realizojë Policia Gjyqësore e MPB e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nën kontrollin e Prokurorit Publik.

Gjatë zbatimit të masës së posaçme hetimore të shfrytëzohet pajisja, të cilën e ka në disponim MPB e RMV.

Urdhëresa jepet në kohëzgjatje prej dy muajsh për zbatimin e masës së posaçme hetimore duke filluar nga viti xxx nga ora xxx deri në orën xxx të vitit xxx.

### ARSYETIM

Deri te Prokuroria Themelore Publike Shkup është dorëzuar raport nga ana e MPB SPB Shkup, NAK Sektori për tregëti të palejueshme të drogës, TS nr. xxx nga viti xxx prej ku del se personat xxx, ndërmarrin veprime të cilat kanë të bëjnë me shitblerjen e drogës narkotike - xxx në sasi më të mëdha, me të cilat veprime e realizojnë ekzistimin e veprës penale - Prodhim i paautorizuar

dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215, paragrafi (1) të Kodit penal.

Në rastin konkret, me sjelljen e urdhëresës për përcaktimin e masës së posaçme - Simulim i blerjes së sendeve nga neni 252, paragrafi (1), pika 7 e LPP, do të mundësohet blerja e simuluar e drogës narkotike nga personat e përmendur, me çka do të siguroheshin të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për udhëheqjen me sukses të procedurës penale, të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër, jo vetëm për shkak të llojit dhe karakterit të veprës së theksuar penale, por edhe për shkak se bëhet fjalë për vepër penale e cila realizohet në fshehtësi të plotë mes personave të përmendur.

Duke marrë parasysh atë që u theksua më lartë, e jap këtë urdhëresë.

**PROKURORI PUBLIK**

---

**TEPËR SEKRET**



## TEPËR SEKRET

### PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

PPMH nr.

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Në bazë të nenit 39, paragrafi (2), alineja 2 lidhur me nenin 256, nenin 252 paragrafi (1), pika 8 dhe neni 253, pika 2 e LPP, Prokurori Publik i Prokurorisë Themelore Publike Shkup e sjell këtë

### URDHËRESË

**PËRCAKTOHET** zbatimi i masës së posaçme hetimore

**Dhënie dhe pranimi i simuluar i mitos nga neni 252, paragrafi (1), pika 8 e LPP,**

NDAJ PERSONAVE:

XXX

XXX

Për të cilët ekziston dyshimi i bazuar se ndërmarrin aktivitete për kryerjen e veprës penale - Pranim i mitos nga neni 357 të Kodit penal, vepër penale - Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar nga neni 353 të Kodit penal.

Pasi besohet se do të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për të udhëhequr me sukses procedurën penale, të cilat nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër. Masa e posaçme hetimore - Dhënia dhe marrja e simuluar e mitos nga neni 252 paragrafi (1), pika 8 e LPP, e cila përfshin dhënien e simuluar të mjeteve materiale-parave që lidhen me lëndën si mito dhe merr pjesë me aktivitete ndërmjetësuese mes personave xxx, si dhe mes personave xxx, ndaj personave xxx.

Masën e posaçme hetimore ta realizojë Policia Gjyqësore e MPB të RMV, nën kontroll të Prokurorit Publik.

Gjatë zbatimit të masave të posaçme hetimore të shfrytëzohen pajisjet që i ka në disponim MPB e RMV.

Urdhëresa jepet me kohëzgjatje të realizimit të masës së posaçme hetimore duke filluar nga viti xxx nga ora xxx deri në vitin xxx në ora xxx.

### ARSYETIMI

Prokuroria Themelore Shkup disponon me të dhëna dhe dëshmi edhe atë se xxx,

Për këto rrethana nga ana e personit xxx në vitin xxx, në ora xxx, është paraqitur në xxx dhe në SHQP, SLKOS - SK.

Për këtë janë dhënë urdhëresa për zbatimin e masës së posaçme hetimore, dhënie dhe marrje të simuluar të mitos nga neni 252, paragrafi (1), pika 8 e LPP ndaj personit xxx nën PPMH NAK nr. xxx viti xxx nga Prokuroria Themelore Publike Shkup dhe nga Gjykatësi në Procedurë Paraprake pranë Gjykatës Themelore Shkupi I- Shkup është dhënë urdhëresa PPP nr.xxx viti xxx për ndër-

marrje të masës së posaçme - Vëzhgim, ndjekje dhe inçizim i fshehtë i personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo hapësirës afariste të shënuar si private nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 e LPP kundër xxx.

Në mënyrë plotësuese nga ana e MPB SHQP, Sektori për luftimin e krimit të organizuar dhe serioz, Sektori për korrupsion është lëshuar lajmërimi nr.xxx i vitit xxx ku theksohet se xxx

Nga sa u theksua më lartë del se ekziston dyshim i bazuar se personi xxx, ndërmerr aktivitete për kryerjen e veprës penale - Mitmarrje nga neni 357 i Kodit penal dhe vepër penale - Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimeve zyrtare nga neni 353 i Kodit penal, dhe se xxx.

Për aktivitetet e theksuara më lartë nga ana e Prokurorit Publik është dhënë urdhëresë PPMH NAK nr.xxx viti xxx, ndaj personit xxx për zbatimin e masës së posaçme hetimore - Dhënie dhe marrje të simuluar të mitos nga neni 252, paragrafi (1), pika 8 e LPP.

Në rastin konkret të dhënat dhe dëshmitë e domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër jo vetëm për shkak të natyrës dhe karakterit të veprës së theksuar penale, por edhe për shkak se bëhet fjalë për vepër penale e cila kryhet në fshehtësi të rreptë mes personave të theksuar.

Duke patur parasysh sa theksova më sipër e sjell këtë urdhëresë.

**PROKURORI PUBLIK**

---

**TEPËR SEKRET**

## TEPËR SEKRET

### PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

#### PPMH nr.

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Në bazë të nenit 39, paragrafi (2), alineja 2 lidhur me nenin 256, paragrafi (1), pika 10 dhe nenin 253, paragrafi (2) të LPP, Prokurori Publik i Prokurorisë Themelore Publike Shkup e sjell këtë

### URDHËRESË

**PËRCAKTOHET** zbatimi i masës së posaçme hetimore

**Shfrytëzimi i personave me identitet të fshehur për ndjekje dhe mbledhjen e informatave ose të dhënave nga neni 252, paragrafi (1), pika 10 e LPP,**

NDAJ PERSONAVE:

XXX

XXX

Për të cilët ekziston dyshimi i bazuar se kanë ndërmarrë aktivitete për kryerjen e veprës penale - Prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215 i Kodit penal.

Për shkak se është e besueshme se mund të sigurohen të dhënat dhe dëshmitë, të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër, respektivisht me përcaktimin e masave të posaçme hetimore për lëndën - Shfrytëzimi i personave me identitet të fshehur për ndjekje dhe mbledhjen e informatave apo të dhënave nga neni 252, paragrafi (1), pika 10 të LPP, kështu do të siguroheshin dëshmi për veprën konkrete penale dhe veprime që i ndërmarrin personat xxx për kryerjen e veprës dhe njëkohësisht do të zbuloheshin edhe persona të tjerë të lidhur me ta në kryerjen e veprës penale.

Masa e posaçme hetimore - Shfrytëzimi i personave me identitet të fshehur për ndjekje dhe mbledhjen e informatave apo të dhënave nga neni 252, paragrafi (1), pika 10 e LPP, përfshin infiltrimin e personit me identitet të fshehur nga i cili do të bëhej blerja e simuluar e drogës narkotike.

Masën e posaçme hetimore ta zbatojë Policia Gjyqësore e MPB të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nën kontrollë të prokurorit publik.

Gjatë zbatimit të masës së posaçme hetimore të shfrytëzohet pajisja të cilën e posedon MPB e RMV.

Urdhëresa jepet me kohëzgjatje prej katër muajve për realizimin e masës së posaçme hetimore duke filluar nga viti xxx në ora xxx deri në vitin xxx dhe në ora xxx.

### ARSYETIMI

Deri te Prokuroria Themelore Publike Shkup është dorëzuar raporti për zbatimin e masës së posaçme hetimore nga ana e MPB të SPB Shkup, NAK- Sektori për tregëti të palejuar me drogë, TS nr. xxx viti xxx, ndërkaq me kërkesë të PTHP Shkup nga viti xxx PPMH nr. xxx viti xxx dhe me urdhëresë P-PP nr. xxx viti xxx, e lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranë Gjykatës Themelore xxx, prej ku del se personat xxx, ndërmarrin aktivitete, të cilat kanë të bëjnë me shitblerjen e drogës narkotike - xxx në sasi më të mëdha, me të cilat veprime e kryejnë thelbin e veprës

penale- Prodhim dhe lëshim në qarkullim të pa autorizuar të drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve nga neni 215, paragrafi (1) i Kodit penal.

Nga sa u theksua më lartë del se ekziston dyshimi i bazuar se personat xxx, ndërmarrin veprime të kryerjes së veprës penale - Prodhim dhe lëshim i paautorizuar në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215, paragrafi (1) i Kodit penal.

Në rastin konkret, me urdhëresën e dhënë për përcaktimin e masës së posaçme hetimore - Shfrytëzim të personave me identitet të fshehur për ndjekje dhe mbledhje të informatave dhe të dhënave nga neni 252, paragrafi (1), pika 10 e LPP, me të cilën masë të posaçme do të bëhet infiltrimi i personit me identitet të fshehur në mjedisin konkret të inkriminuar, me çka do të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër, jo vetëm për shkak të llojit dhe karakterit të veprës së theksuar penale, por edhe për shkak se bëhet fjalë për veprë penale e cila kryhet në konspiracion të rreptë në mes të personave të theksuar.

Duke patur parasysh sa theksova më sipër e sjell këtë urdhëresë.

**PROKURORI PUBLIK**

---

**TEPËR SEKRET**

## TEPËR SEKRET

### PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

#### PPMH NAK NR.

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Deri te

#### GJYKATA THEMELORE SHKUPI 1

- Gjykatësi në Procedurë Paraprake -

SH K U P

Në bazë të nenit 7, nenit 8, nenit 11 dhe nenit 15 të Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve lidhur me nenin 39, paragrafi (2), alineja 2 lidhur me nenin 256 lidhur me nenin 260, paragrafi (2) lidhur me nenin 252, paragrafi (1), pika 1 e LPP, parashtroj

### K Ë R K E S Ë

#### PËR DHËNIEN E URDHËRESËS PËR VAZHDIMIN E ZBATIMIT TË MASËS SË POSAÇME HETIMORE

Ndjekja dhe inçizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike në procedurë të rregulluar me ligj të posaçëm nga neni 252, paragrafi (1), pika 1 e LPP.

NDAJ:

- 1., shfrytëzues i numrit telefonik.
- 2., shfrytëzues i numrit telefonik.

Masa e posaçme hetimore - Ndjekja dhe inçizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike në procedurë të rregulluar me ligj të posaçëm nga neni 252, paragrafi (1), pika 1 të LPP, përfshin ndjekje të komunikimeve të personave XXXXXX i cili shfrytëzon numër telefoni ---, XXXXXX i cili shfrytëzon numër telefoni ---, XXXXXX i cili shfrytëzon numër telefoni ---, XXXXXX i cili shfrytëzon numër telefoni ---, XXXXXX i cili shfrytëzon numër telefoni ---, përmes të cilëve pritet realizim i bisedave që lidhen me veprën penale - Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimeve zyrtare nga neni 353 të KP, veprën penale - Mitmarrje nga neni 357 i KP dhe vepra penale - Pranim të shpërblimit për ndikim kundërligjor nga neni 359 të KP.

Masa e posaçme hetimore të realizohet përmes mjeteve teknike me të cilat disponon Agjencia Teknike Operative dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Urdhëresën e jep Ministria e Punëve të Brendshme e RMV me ndërmjetësim të Agjencisë Teknike Operative, nën kontrollin e Prokurorit Publik.

Urdhëresa të jepet me kohëzgjatje prej një muaji, duke llogaritur nga viti xxx, nga ora xxx deri në vitin xxx dhe ora xxx.

### ARSYETIMI

Në ditën xxx të vitit, deri te kjo prokurori MPB e RMV, Byroja për Sigurim Publik, Sektori për Luftimin e Krimit të Organizuar dhe Serioz pranë Byrosë për Sigurim Publik në MPB të TS nr. xxx dorëzoi raport të posaçëm ku theksohet se nga zbatimi i masës së posaçme hetimore, si dhe nga njohuritë tjera të fituara, është përcaktuar se personat e lartpërmendur vazhdojnë të ndërmar-

rin aktivitete në drejtim të kryerjes së veprës penale - Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimeve zyrtare nga neni 353 i KP, veprës penale - Mitmarrje nga neni 357 të KP, veprës penale - Pranim të shpërblimit për ndikim kundërligjor nga neni 359 të KP, për të cilat vepra penale edhe më parë janë dhënë urdhëresa për zbatimin e masave të posaçme hetimore, kur është theksuar se në mënyrë plotësuese është zbuluar se personi xxxxxxxx shfrytëzon edhe një linjë telefonike edhe atë xxx dhe propozohet masa e posaçme hetimore të përcaktohet edhe për atë numër telefonik.

Duke e marrë parasysh sa u tha më lartë, dhe kur është e besueshme se do të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, të cilat të dhëna nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër, parashtrij kërkesë për vazhdim të masës së posaçme hetimore - Ndjekje dhe inçizim të komunikimeve telefonike dhe të komunikimeve tjera elektronike në procedurë të rregulluar me ligj të posaçëm nga neni 252, paragrafi (1), pika 1 e LPP, ndaj personave XXXXXXXXXXXXXXXX, ndërsa sa i përket veprave penale të theksuara më lartë edhe kërkesë për përcaktimin e masës së posaçme hetimore për dy numrat e rinj të personit.

Masa e posaçme hetimore - Ndjekje dhe inçizim të komunikimeve telefonike dhe të komunikimeve tjera elektronike në procedurë të rregulluar me ligj të posaçëm nga neni 252, paragrafi (1), pika 1 e LPP përfshin ndjekjen e komunikimit të personave XXXXX, i cili shfrytëzon numër telefoni ----, XXXXX, i cili shfrytëzon numër telefoni ----, XXXXX, i cili shfrytëzon numër telefoni ---, përmes të cilëve pritet realizimi i bisedave që lidhen me kryerjen e veprave penale.

Nga Gjykatësi për Procedurë Paraprake është lëshuar urdhëresa RNAK nr. / nga viti xxx.

Deri te kjo Prokurori nga ana e MPB, BSP, SHQP, Sektori për Luftimin e Krimin të Organizuar dhe Serioz, Sektori për Korrupsion është dorëzuar raport i posaçëm TS nr. xxx nga viti xxx ku theksohet se personat e lartëpërmendur vazhdojnë të ndërmarrin veprime në drejtim të kryerjes së veprës penale - Keqpërdorim i pozitës dhe autorizimeve zyrtare nga neni 353 të KP, veprës penale - Mitmarrje nga neni 357 të KP, veprës penale - Pranim të shpërblimit për ndikim kundërligjor nga neni 359 të KP, si dhe nga masat e posaçme hetimore të zbatuara deri më tani, duke marrë parasysh se do të sigurohen të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, të cilat nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër shtrohet kërkesa për vazhdim të zbatimit të masës së posaçme hetimore.

Masa e posaçme hetimore - Ndjekje dhe inçizim të komunikimeve telefonike dhe të komunikimeve tjera elektronike në procedurë të rregulluar me ligj të posaçëm nga neni 252, paragrafi (1), pika 1 e LPP përfshin ndjekjen e komunikimit të personave- XXXXX, i cili shfrytëzon numër telefoni ----, XXXXX, i cili shfrytëzon numër telefoni ---, përmes të cilëve pritet realizimi i bisedave që lidhen me kryerjen e veprave penale.

Urdhëresën ta realizojë Minsitria e Punëve të Brendshme të RMV, me ndërmjetësim të Agjencisë Teknike Operative, nën kontrollin e Prokurorit Publik.

**PROKURORI PUBLIK**

---

**TEPËR SEKRET**

## TEPËR SEKRET

### PROKURORIA THEMELORE PUBLIKE

PPMH nr.

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Deri te

### GJYKATA THEMELORE SHKUPI 1

- Gjykatësi në Procedurë Paraprake -

SH K U P

Në bazë të nenit 39, paragrafi (2), alineja 2 lidhur me nenin 256, nenin 252, paragrafi (1), pika 3, nenin 253, pika 2 e LPP, parashtroj

### K Ë R K E S Ë

#### PËR DHËNIEN E URDHËRESËS PËR VAZHDIMIN E ZBATIMIT TË MASËS SË POSAÇME HETIMORE

**Vëzhgim, ndjekje dhe inçizim të fshehtë të personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo hapësirës afariste të shënuar si private nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 të LPP,**

NDAJ PERSONAVE:

Masa e posaçme hetimore - Vëzhgim i fshehtë, ndjekje dhe inçizim i personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo hapësirës afariste, të shënuara si private nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 e LPP, përfshin vëzhgim, ndjekje dhe inçizim të fshehtë të personave XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë ose hapësirës afariste të cilësuar si private, sepse për personat e lartpërmendur ekziston dyshimi i bazuar se ndërmarrin veprime të realizimit të veprës penale - Keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar nga neni 353 të KP, veprës penale - Mitmarrje nga neni 357 të KP dhe veprës penale - Pranimit të shpërblimit për ndikim joligjor nga neni 359 të KP.

Për shkak se është e besueshme se mund të sigurohen të dhënat dhe dëshmitë, të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër.

Masën e posaçme hetimore ta realizojë Policia Gjyqësore nën kontrollin e Prokurorit Publik.

Gjatë zbatimit të masave të posaçme hetimore të shfrytëzohet pajisja të cilën e disponon MPB e RMV.

Urdhëresa të jepet me kohëzgjatje prej një muaji duke llogaritur nga viti xxx, nga ora xxx deri në vitin xxx, në ora xxx.

### ARSYETIMI

Në ditën xxx të vitit, deri te kjo prokurori MPB e RMV, Byroja për Sigurim Publik, Sektori për Luftimin e Krimit të Organizuar dhe Serioz pranë Byrosë për Sigurim Publik në MPB të nr. xxx dorëzoi lajmërimin, ku theksohet se nga zbatimi i masës së posaçme hetimore, si dhe nga njohtimet tjera të fituara operative, është përcaktuar se personat e lartpërmendur vazhdojnë të ndërmarrin aktivitete në drejtim të kryerjes së veprës penale - Keqpërdorim i pozitës dhe autori-

zimeve zyrtare nga neni 353 të KP, veprës penale - Mitmarrje nga neni 357 të KP, veprës penale - Pranim të shpërblimit për ndikim kundërligjor nga neni 359 të KP, për të cilat vepra penale edhe më parë janë dhënë urdhëresa për zbatimin e masave të posaçme hetimore.

Për këtë, Gjykatësi në Procedurë Paraprake pranë Gjykatës Themelore Shkupi I, Shkup solli urdhëresë për vazhdimin e marrjes së masave të posaçme hetimore - Vëzhgim, ndjekje dhe inçizim të fshehtë të personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë ose objektit afarist, të shënuar si private nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 e LPP, PPP nr. xxx i vitit xxx.

Duke e pasur parasysh atë që u tha më lartë, si dhe besueshmërinë se do të sigurohen të dhënat dhe dëshmitë të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale, të cilat nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër, parashtroj kërkesë për vazhdimin e masës së posaçme hetimore - Vëzhgim, ndjekje dhe inçizim të fshehtë të personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo hapësirës afariste, të shënuar si private nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 e LPP, ndaj personave xxx, sa i përket veprave penale të theksuara më lartë.

Masa e posaçme hetimore - Vëzhgim, ndjekje dhe inçizim i fshehtë i personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo hapësirës afariste, të shënuar si private nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 të LPP, realizohet për arsye se të dhënat dhe dëshmitë e domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale nuk mund të mblidhen në mënyrë tjetër, jo vetëm për shkak të llojit të karakterit të veprave të theksuara penale, por edhe për arsye se bëhet fjalë për vepra penale të cilat kryhen në konspiracion të rreptë mes personave të përmendur, për çka parashtroj - Kërkesë për vazhdimin e zbatimit të masës së posaçme hetimore edhe atë për personat xxx.

Në përputhje me nenin 258, paragrafi (2) i LPP, pas zbatimit të kësaj mase Policia Gjyqësore të përgatisë raport të veçantë, të cilin do t'ia dorëzojë Prokurorit Publik.

**PROKURORI PUBLIK**

---

**TEPËR SEKRET**



## TEPËR SEKRET

**GJYKATA THEMELORE** duke vepruar sipas Kërkesës së PTHP PPMH nr. të vitit X për sjelljen e urdhëresës për ndërprerjen e zbatimit të masës së posaçme hetimore në pajtim me nenin 256 dhe nenin 260 të LPP, në vitin X, e lëshon këtë:

### U R D H Ë R E S Ë NDËRPRITET ZBATIMI I MASËS SË POSAÇME HETIMORE:

**Ndjekje e fshehtë dhe inçizim i personave dhe objekteve me mjete teknike, jashtë shtëpisë ose hapësirës afariste të shënuar si private sipas nenit 252, paragrafi (1), pika 3 e LPP,**

#### **NDAJ PERSONIT:**

**X** me NUPQ X, të punësuar si XXX.

Të përcaktuar me urdhëresë PPP nr. Viti XXXX .

Pasi që mbaruan bazat për të cilat ishte lejuar.

#### **A R S Y E T I M I**

Prokuroria Themelore Publike, deri te Gjykatësi në Procedurë Paraprake të kësaj Gjykate dorëzoi kërkesë me PPMH nr. viti XXXX për dhënien e urdhëresës për ndërprerjen e zbatimit të masave të posaçme hetimore nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 e LPP - Ndjekje dhe inçizim i fshehtë i personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo hapësirës afariste të shënuar si private ndaj personit XXX për veprën penale - XXX ntë KP.

Në propozimin e PTHP theksohet se gjatë zbatimit të masës së posaçme hetimore janë marrë të dhëna dhe dëshmi të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale të cilat në mënyrë tjetër nuk mund të mblidhen, për atë qëllim edhe ishte përcaktuar masa e posaçme hetimore ndaj personit XXX për vepër penale XXX të KP, e cila ishte realizuar përfundimisht deri në vitin X përmes takimeve dhe ndodhive të dokumentuara, kur nga liria në orën X ishte privuar personi X për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale - X të KP. Dhe, për këto arsye në tërësi përfundojnë të ekzistojnë bazat për të cilat ishte përcaktuar masa e posaçme hetimore.

Me këtë urdhëresë ndërpritet zbatimi i masës së posaçme hetimore - Ndjekja dhe inçizimi i fshehtë i personave dhe objekteve me mjete teknike jashtë shtëpisë apo hapësirës afariste të shënuar si private nga neni 252, paragrafi (1), pika 3 e LPP ndaj personit X, ndaj të cilit është përcaktuar masa e posaçme hetimore me urdhëresë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake pranë Gjykatës Themelore për vepër penale - X të KP.

Duke i patur parasysh pretendimet e kërkesës për ndërprerjen e zbatimit të masës së posaçme hetimore, Gjykatësi në Procedurë Paraprake arriti te përfundimi se e njëjta është e bazuar, për këtë shkak edhe vendosi si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE

PPPM.nr viti X.

Gjykatësi në Procedurë Paraprake

TEPËR SEKRET



**SEKRET SHKETËROR**

**PROKURORIA PUBLIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

**NAK nr.-/2019**

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Deri te

**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË SË VERIUT**

SH K U P

Në bazë të nenit 20 lidhur me nenin 18, 19 dhe 21 të Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 71 nga 19 prill, viti 2018) parashtroj:

**K Ë R K E S Ë**

**PËR SJELLJEN E URDHËRESËS PËR NDJEKJE TË KOMUNIKIMEVE**

**1. Ndjekje dhe inçizim i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike nga neni n 18 paragrafi (1), pika 1 e Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve**

**NDAJ PERSONIT:**

**1. N.N.**, nga baba N dhe nëna N, i lindur në vitin ----- në -----, me adresë të lajmëruar të banimit në rr. ----- nr. ----- në ---, NUPQ \_\_\_\_\_

- Shfrytëzues i numrit të telefonit -----
- Numri identifikues MPP-----
- Numri identifikues MPP-----

Për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar se përgatitet kryerja e veprës penale kundër shtetit "*Rrezikim terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë*", nga **neni 313** i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Dyshimi i bazuar del nga njohuritë operative me të cilat disponon Agjencia për Siguri Kombëtare, të theksuar në propozimin SSH nr \_\_\_\_\_ nga viti ----- dhe lajmërimi SSH nr. \_\_\_\_\_ nga viti -----.

Urdhëresa për ndjekje të komunikimeve për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit përfshin ndjekjen dhe inçizimin e komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike të personit **N.N.** shfrytëzues i numrit të telefonit -----, numri identifikues MPP \_\_\_\_\_, numri identifikues MPP \_\_\_\_\_

Urdhëresën për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve për arsye të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit ta realizojë organi i autorizuar, në pajtim me nenin 4, paragrafi (1), pika 7 e Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve, me pajisje për atë qëllim të stacionit punues, në përputhje me nenin 4, paragrafi (1), pika 21 e Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve, me ndërmjetësim të Agjencisë Teknike Operative, e cila do të sigurojë lidhje teknike mes operatorit dhe organit të autorizuar për zbatimin e masës, në pajtim me nenin 64 të Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve dhe nenit 2 dhe 3 të Ligjit të Agjencisë Teknike Operative (Gazeta Zyrtare e RM nr. 71 nga 19.04.2018).

Urdhëresa për ndjekje të komunikimeve të jepet në kohëzgjatje prej ???.?. të vitit 2019 nga ora 13,00 deri në ???.?. të vitit 2019 deri në ora 13,00.

## ARSYETIMI

Agjencia për Siguri Kombëtare, deri te Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dorëzon propozim për dhënien e kërkesës për sjellje të urdhëresës për zbatimin e masës së ndjekjes së komunikimeve, në pajtim me nenin 20, paragrafi (1) nga Ligji për Ndjekje të Komunikimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.71, 19 prill 2018) SSH nr. \_\_\_\_\_ nga ----- viti 2018.

Në propozim theksohet se në R. e Maqedonisë së Veriut vepron një grup joformal, përkrahës të selefizmit ekstrem, të cilët bëjnë përpjekje për funksionim në mjedise të mbyllura me respektimin e mënyrës së jetesës sipas Sherijatit dhe me distancim të plotë nga normat e përcaktuara demokratike dhe lirive të qytetarëve, që rezulton me izolimin e pjestarëve të grupit, të cilët funksionojnë si një formë e shoqërisë paralele, gjegjësisht:

Pas vuajtjes së dënimit në burgje, militantët islamik dhe ish xhihadistët fillojnë me nxitjen e ndjekësve të tyre të selektuar që më parë për të organizuar aktivitete që do të sjellin deri te rrezikimi terrorist brenda shtetit, gjegjësisht krijimin e mjediseve të izoluar sherijate të mjediseve shoqërore me zbatim të plotë të së drejtës sipas Sherijatit. Gjatë kësaj periudhe janë marrë informacione se janë angazhuar që Sherijati të zbatohet menjëherë, nëse është nevoja do të fillonin me force, dhunë dhe xhihad.

Personat e theksuar realizojnë kontakte direkte me imamët selefistë dhe të tjerët të cilët pos ligjëratave të rregullta fetare realizojnë edhe kontakte të fshehta me individë të selektuar, të cilëve iu mbajnë edukim privat fetar dhe edukim për kondicionim. Në aktivitetet e kontrollit të personave të selektuar janë kyçur të kthyerit nga Siria, pjesëtarë të Shtetit Islamik, të cilët pas kthimit nga Siria kanë formuar grupe të mbyllura selefiste, anëtarët e të cilave kanë edukim fetar dhe fizik.

Nga ana e autoriteteve fetare, për shkallë më të lartë të edukimit për kondicionim të mbështetësve të tyre është rekrutuar N.N. Në periudhën e kaluar regjistrohen vizitat e ndërsjella të mbyllura të individëve të selektuar nga xhematet e ndryshme me organizimin e ligjëratave fetare si dhe qëndrimeve dhe ushtrimeve të përbashkëta në natyrë me elemente të trajnimit ushtarak, të cilat qëllim të fundit kanë krijimin e mjediseve jetësore të izoluar ku do të zbatohet në tërësi e drejta e Sherijatit.

Të dhënat dhe njohuritë për veprimtarinë e këtij grupi jofomal ndërmjet personave të lidhur mes veti, nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër, për çka mendojmë se duhet të zbatohet masa e ndjekjes së komunikimeve, gjegjësisht *ndjekja dhe inçizimi i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera*, në pajtim me nenin 18, paragrafi (1), pika 1 nga Ligji për Ndjekje të Komunikimeve.

Urdhëresën për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve për arsye të mbrojtjes së interesave të mbrojtjes dhe sigurisë së shtetit ta zbatojë organi i autorizuar, në pajtim me nenin 4, paragrafi (1), pika 7 e Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve, me pajisjet për atë qëllim nga stacioni punues, në përputhje me nenin 4, paragrafi (1), pika 21 nga Ligji për Ndjekje të Komunikimeve, me ndërmjetësim të Agjencisë Teknike Operative, e cila do të sigurojë lidhje teknike midis operatorit dhe organit të autorizuar për zbatimin e masës, në pajtim me nenin 64 të Ligjit për Ndjekje të

Komunikimeve dhe nenit 2 dhe 3 të Ligjit për Agjencinë Teknike Operative (Gazeta Zyrtare e RM nr. 71 me datë 19.04.2018).

Urdhëresa për ndjekje të komunikimeve jepet me afat kohor viti -----2019 nga ora 13,00 deri në vitin -----2019 në ora 13,00.

**PROKURORI PUBLIK  
NN**



## SEKRET SHKETËROR

SHNK.nr.\_\_\_\_/2019-PPRMV

**GJYKATËSI I GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT N.N.** duke vepruar sipas kërkesës së Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut NAK nr.\_\_\_\_/2019 nga viti \_\_, për marrjen e vendimit për ndjekje të komunikimeve, në pajtim me nenin 21 dhe 22 të Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.71/2018 nga 19.04.2018) dhe neni 2 dhe 3 i Ligjit për Agjencinë Teknike Operative në datën \_\_\_\_ viti, sjell:

### URDHËRESË

Për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar se përgatitet realizim i veprës penale kundër shtetit "Rrezikim terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë" nga neni 313 i KP, "Vrasje të përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore" nga neni 309 të KP dhe "Dhunë ndaj përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore" nga neni 311 të KP. **URDHËROHET:**

#### NDAJ PERSONAVE:

1. **XXX.**,

- shfrytëzues i numrit telefonik \_\_\_\_\_
- numri identifikues MPP \_\_\_\_\_
- numri identifikues MPP \_\_\_\_\_

2. **XXX.**,

- shfrytëzues i numrit telefonik \_\_\_\_\_
- numri identifikues MPP \_\_\_\_\_
- numri identifikues MPP \_\_\_\_\_

3. **XXX.**,

- shfrytëzues i numrit telefonik \_\_\_\_\_
- numri identifikues MPP \_\_\_\_\_
- numri identifikues MPP \_\_\_\_\_

#### NDJEKJA DHE INÇIZIMI I KOMUNIKIMEVE TELEFONIKE DHE KOMUNIKIMEVE TË TJERA ELEKTRONIKE

Këtë urdhëresë për zbatimin e masës për ndjekje të komunikimeve për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit ta realizojë organi i autorizuar – Agjencia për Siguri Kombëtare, me ndërmjetësimin e Agjencisë Teknike Operative e cila do të sigurojë lidhje teknike midis operatorit dhe organit të autorizuar për zbatimin e masës.

Urdhëresa për ndjekje të komunikimeve jepet në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh, duke filluar nga viti \_\_\_\_\_ me fillim në ora 15.30, deri në vitin \_\_\_\_\_ deri në ora 15.30.

<sup>1</sup> Formulari i Gjykatës Supreme për urdhëresë për PPRMV - në pajtim me ligjin dhe rregulloren e brendshme urdhëresa nuk anonimizohet, dhe për këtë të dhënat që i përmban janë me vijë të poshtme dhe është formular për tu shtypur. Formulari i Gjykatës Supreme për urdhëresë deri te ATO anonimizohet dhe përmban XXXXXXXX në atë pjesë, ndërkaq atë që do ta mbajë si të dhënë dhe që nuk është për tu shtypur, formulari është me vijë të poshtme..

Obligohet kërkuesi që raportet, të cilat në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve i merr nga organi i autorizuar, në afat prej tre ditësh nga pranimi i raporteve t'i dorëzojë deri te kjo Gjykatë.

### **A R S Y E T I M I**

Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut deri tek Gjykatësi i kësaj Gjykate në vitin\_\_\_\_, dorëzon kërkesë për sjelljen e urdhëresës për ndjekjen e komunikimeve në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve me të cilën ka kërkuar të jepet urdhëresë për ndjekje dhe inçizim të komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike të personave N.N. sepse ekziston dyshimi se përgatitet kryerja e veprës penale kundër shtetit “ Rrezikimi terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë” nga neni 313 i KP. “Vrasje të përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore” nga neni 309 të KP dhe “Dhunë ndaj përfaqësuesve të organeve më të larta shtetërore” nga neni 311 të KP.

Kërkesës i bashkangjitet propozimi SSH nr. \_\_\_\_ nga viti \_\_\_\_ dhe njoftimi SSH nr. \_\_\_\_ nga viti \_\_\_\_ të Agjencisë për Siguri Kombëtare.

Kjo Gjykatë e ka vlerësuar bazën e kërkesës dhe mbështetur në pretendimet e kërkesës dhe propozimin e ofruar përcakton se janë plotësuar kushtet për sjelljen e Urdhëresës në pajtim me nenin 21 të Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve, për çka vendosi si në thënien e urdhëresës, e cila urdhëresë do të zbatohet me ndërmjetësimin e Agjencisë Teknike Operative, e cila do të sigurojë lidhje teknike midis operatorit dhe organit të autorizuar për zbatimin e masës në pajtim me nenin 2 dhe 3 të Ligjit për Agjencinë Teknike Operative (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.71/2018 nga 19.04.2018).

**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**  
**SHNK.nr. \_\_/2019-PPRMV nga viti \_\_\_\_.**

**Gjykatësi,**  
**N.N.**

---

**SEKRET SHETËROR**



## SEKRET SHTTËROR

**PROKURORIA PUBLIKE  
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT  
NAK.--/2019**

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Deri te  
**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË SËS VERIUT**  
SH K U P

Në bazë të neni t 29 dhe nenit 33 lidhur me nenin 30, paragrafi (3) i Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve, parashtroj:

**K Ë R K E S Ë  
PËR SJELLJEN E URDHËRESËS PËR VAZHDIMIN E NDJEKJES TË KOMUNIKIMEVE**

**LIDHJA: E juaja SHNK nr.---/20--- nga viti ----.**

**NDAJ PERSONAVE:**

1. **N.N.**, i lindur në vitin-----, në --, me adresë të lajmëruar të jetesës në rr.----- nr.----- në ----, NUPQ \_\_\_\_\_  
- shfrytëzues i numrit telefonik -----
2. **N.N.**, lindur në vitin-----, në --, me adresë të lajmëruar të jetesës në rr.----- nr.----- në ----, NUPQ \_\_\_\_\_  
- Shfrytëzues i numrit telefonik -----

Për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar se përgatitet, nxitet dhe organizohet kryerja e veprës penale kundër shtetit, edhe atë: Rrezikim terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë nga neni 313 i KP.

Dyshimi i bazuar del nga njohuritë operative me të cilat disponon Agjencia për Siguri Kombëtare të theksuara në propozimin SSH nr.\_\_\_\_ nga viti ----, njoftimi SSH nr.\_\_\_\_ nga viti -----.

Urdhëresa për ndjekje të komunikimeve përfshin ndjekjen e të gjitha llojeve të komunikimeve telefonike të personave NN si shfrytëzues i numrit telefonik ----- dhe **NN** si shfrytëzues i numrit telefonik -----.

Gjatë zbatimit të Urdhëresës për ndjekje të komunikimeve të shfrytëzohet pajisja me të cilën disponon ---.

Urdhëresën për ndjekje të komunikimeve ta realizojë Agjencia Teknike Operative.

Urdhëresa për ndjekje të komunikimeve të jepet me kohëzgjatje të zbatimit në periudhë duke filluar nga viti-----, ora 12,00, deri në vitin-----, në ora 12,00.

## ARSYETIMI

Agjencia për Siguri Kombëtare deri te Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka dorëzuar propozim për ndjekje të komunikimeve SSH nr.\_\_\_\_ nga viti -----, ndaj personave NN dhe NN, për të cilët është dhënë Urdhëresa SHNK nr.--/20--nga viti----- .

Në kërkesë theksohet se Agjencia për Siguri Kombëtare ka marrë të dhëna se situata e sigurisë në Siri/Irak, aktiviteti aktual i angazhimit ushtarak të ushtrive të Sirisë dhe Irakut dhe ushtritë e huaja kundër formacioneve të caktuara paramilitare, të cilat kohëve të fundit tërësisht po tërhiqen nga territoret e marra dhe në mënyrë masive dorëzohen tek ushtritë e Sirisë dhe Irakut, gjë që nuk e zvogëlon mbështetjen nga ana e individëve dhe grupeve në R. e Maqedonisë për këta formacione paramilitare.

Kështu, janë marrë informacione se disa imamë nga R. e Maqedonisë të cilët e përfaqësojnë dhe e promovojnë ideologjinë selefiste, kanë filluar me nxitjen e përkrahësve të selektuar më parë për të organizuar aktivitete të dhunshme në R. e Maqedonisë. Në këtë kornizë, sipas instruksioneve të tyre, N.N. dhe N.N. duhet të selektojnë dhe rekrutojnë individë të zgjedhur, të cilët duhet të kryejnë akt terrorist, gjegjësisht aktivitete të kohëpaskohshme të dhunës në shtet me qëllim të shkakimit të frikës dhe panikut tek popullata dhe demonstrimin e pranisë së "luftëtarëve për Sherijat në rajon"... Në këtë drejtim, të përmendurit realizojnë takime të fshehta me qëllim që të instruojnë individët për përgatitje për kryerje të aktit terrorist, si dhe zgjedhin logjistikën e tyre.

Nga zbatimi i masës u dëshmuar se NN pos numrit të telefonit ndaj të cilit është përcaktuar masa, aktivitetin e tij e realizon edhe përmes numrit telefonik -----, ndërkaq NN pos numra telefonik ndaj të cilëve është përcaktuar masa, aktivitetin e tij e realizon edhe përmes numrit telefonik -----.

Duke patur parasysh llojin dhe karakterin e aktiviteteve që ndërmerren nga ana e personave të përmendur ekziston dyshimi i bazuar se përgatitet, nxitet dhe organizohet kryerja e veprave penale kundër shtetit, edhe atë Rrezikim terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë nga neni 313 i KP.

Ndjekja e komunikimeve do të mundësojë ndërmarrjen me kohë të masave për mbrojtjen e sovranitetit, integritetit territorial dhe sigurisë së shtetit, regjistrimin e punkteve për shpërndarjen e ideologjisë militante dhe neutralizimin e saj, përcaktimi i pjesëtarëve të grupeve militante me qëllim të pengimit me kohë të aktiviteteve të tyre të dhunshme, përcaktim të lokacioneve të mundshme ku ata bëjnë ushtrime kondicioni dhe të ngjajshme.

Të dhënat apo dëshmitë nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër, për çka mendoj se duhet të zbatohet masa e ndjekjes së komunikimeve.

Me sa u tha mendoj se është e bazuar që të jepet Urdhëresa për ndjekje të komunikimeve për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar se përgatitet, nxitet dhe organizohet kryerja e veprës penale kundër shtetit, edhe atë Rrezikim terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë nga neni 313 i KP.

Dyshimi i bazuar del nga njohuritë operative me të cilat disponon Agjencia për Siguri Kombëtare, të theksuara në propozimin SSH nr. \_\_\_\_ nga viti -----, lajmërim SSH nr. \_\_\_\_ nga viti ----- .

Urdhëresa për ndjekje të komunikimeve përfshin ndjekje të të gjitha llojeve të komunikimeve telefonike të personave NN si shfrytëzues i numrit telefonik ----- dhe NN si shfrytëzues i numrit telefonik -----.

Gjatë zbatimit të masës për ndjekje të komunikimeve të shfrytëzohet pajisja me të cilën disponon ---.

Urdhëresën për ndjekje të komunikimeve ta realizojë Agjencia Teknike Operative.

Urdhëresa për ndjekje të komunikimeve të jepet me kohëzgjatje të zbatimit në periudhë duke llogaritur nga viti----- ora 12,00 deri në vitin----- ora 12,00.

**PROKURORI PUBLIK  
NN**



## SEKRET SH TETËROR

NAK nr. --/18

Shkup, viti \_\_\_\_\_

Deri te  
**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË SËS VERIUT**  
SH K U P

**LIDHJA: SHNK--/2018**

Në bazë të nenit 25 lidhur me nenin 20, 18, 19 dhe 21 nga Ligji për Ndjekje të Komunikimeve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 71 nga 19.04.2018) parashtroj:

### K Ë R K E S Ë

**PËR SJELLJEN E URDHËRESËS PËR NDËRPRERJEN E ZBATIMIT TË MASËS -NDJEKJE DHE INÇIZIM I KOMUNIKIMEVE TELEFONIKE DHE TË KOMUNIKIMEVE TË TJERA ELEKTRONIKE**

#### ND AJ PERSONAVE:

1. **XXX.**,

- shfrytëzues i numrit telefonik \_\_\_\_\_

- numri identifikues MPP \_\_\_\_\_

- numri identifikues MPP \_\_\_\_\_

2. **XXX.**,

- shfrytëzues i numrit telefonik \_\_\_\_\_

- numri identifikues MPP \_\_\_\_\_

- numri identifikues MPP \_\_\_\_\_

Për shkak të mosaktivitetit të numrave telefonik të përmendur.

### A R S Y E T I M I

Agjencia për Siguri Kombëtare deri te Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka dorëzuar propozim për sjelljen e urdhëresës për ndërprerjen e zbatimit të masës - Ndjekje dhe inçizim të komunikimeve telefonike dhe të komunikimeve të tjera elektronike SSH nr. \_\_\_ nga viti- ----, në bazë të nenit 25, paragrafi (1) i Ligjit për Ndjekje të Komunikimeve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 71 nga 19.04.2018).

Në propozim theksohet se në numrat telefonik të personave XXX XXX nuk ka kurrfarë aktivitetesh.

Pasi kanë pushuar të ekzistojnë bazat për të cilat është lejuar zbatimi i masës -ndjekje dhe inçizim i komunikimeve telefonike dhe i komunikimeve të tjera elektronike me urdhëresë të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë SHNK ??/2018 nga ???.??.??? viti, në raport me numrat

telefonik të theksuar, propozoj ndaj të njëjtëve, të ndërpritet zbatimi i mëtutjeshëm i masës- ndjekje dhe inçizim i komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike.

**PROKURORI PUBLIK  
NN**

---


**SEKRET SHETËROR**



# DCAF Geneva Centre for Security Sector Governance

Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) promovon qeverisje të drejtë dhe reforma në sektorin e sigurisë. Kjo qendër hulumton praktikat më të mira, nxit zhvillimin e normave të duhura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, bën rekomandime për politikën dhe siguron programe për këshillim dhe ndihmë në vend. Partnerët e DCAF mes tjerësh janë edhe qeveritë, parlamentet, shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe gama e shërbimeve të sektorit të sigurisë, duke përfshirë këtu agjencitë ushtarake, policore, gjyqësore, zbuluese si dhe shërbimet për siguri kufitare.

na vizitoni në [www.dcaf.ch](http://www.dcaf.ch)



**Disejni teknik:**  
Polyesterday

**Shtypi:**  
Polyesterday

**Tirazhi:**  
500



